



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SPITALIN RAJONAL DURRËS

RAPORT AUDITIMI
“MBI PËRPUTHSHMËRINË”
NË
SPITALIN RAJONAL DURRËS

Tetor 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II.	HYRJA	
1.	Titulli.....	18
2.	Marrësi.....	19
3.	Objektivat dhe qëllimi.	19
4.	Identifikimi i çështjes.....	19
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	20
6.	Përgjegjësitë e audituesve.....	20
7.	Kriteret e vlerësimit.....	20
8.	Standardet e auditimit.....	21
9.	Metodat e auditimit.....	21
10.	Dokumentimi i auditimit.....	22
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	22
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	22
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	22
3.2	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	22-27
3.3.	Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet.....	27-39
3.4.	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prokurimit, si dhe realizimi i tij.....	39-44
3.5.	Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	44-92
3.6.	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj).....	92-109
3.7	Mbi zbatimin dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore...109-112	
3.8.	Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë; analiza e debitorëve e kreditorëve; arkëtimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.....	112-130
3.9.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	130-139
3.10.	Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm.....	139-142
3.11.	Mbi auditimin e fondeve të akorduara dhe të shpenzuara , për përballimin e situatës së pandemisë COVID – 19.....	142-145
3.12.	Të tjera që mund të dalin gjatë procesit auditues.....	146-149
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	149-182

I PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi i kryer pranë “Spitalin Rajonal Durrës” për periudhën 01.01.2019.-31.01.2021 lidhur me, përputhmërinë e veprimtarisë së Spitalit Rajonal Durrës me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi rezultoi se:

-Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht kryesisht me veprimet dhe mosveprimeve të administratës së Spitalit nga të cilat janë konstatuar dëme ekonomike në vlerën **prej 1,578,214 lekë**, në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, shpenzime pagash, tejzgjatje e çështjeve gjyqësore, mosgarantimin e zbatimit të plotë të vendimeve, mosmarrjen e masave për pjesëmarrjen në proceset për njohjen e vendimeve gjyqësore , mungesën e një analize paraparake përpara nisjes së këtyre procedurave, etj, të cilat më vete dhe së bashku kanë ndikime financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit të cilat kapin vlerën në rreth **29,388,108 lekë**.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

-Institucioni pavarësisht përpjekjeve nuk ka arritur të garantojë zbatimin në kohë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore moszbatimi në kohë i të cilave ka prodhuar efekte financiare të vazhdueshme në dëm të buxhetit të shtetit gjithashtu janë konstatuar efekte dhe dëme ekonomike në buxhetin e shtetit në zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

Mbi proceset e mësipërme të cilët kanë rezultuar me penalitete financiare, mungojnë analizat mbi dëmet e shkaktuara nga veprimet dhe mosveprimet e Spitalit Rajonal Durrës, shkaqet, masat që mund të merren ndaj shkaktarëve dhe masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes në vijim.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHËSE GJETJES	E	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi mbi ligjshmërinë e vendimmarrjeve të Bordit të Spitalit Rajonal Durrës (BSRD) u konstatua: - BSRD, gjatë vitit 2019 ka marrë 25 vendime gjithsej, nga të cilat 9 vendime i ka marrë në mënyrë qarkulluese dhe gjatë vitit 2020 ka marrë 19 vendime gjithsej të cilat i ka marrë të gjitha në mënyrë qarkulluese. Marrja e vendime qarkulluese nuk mundëson pasqyrimin e mendimeve dhe diskutimeve të secilit prej anëtarëve të bordit, në kundërshtim kjo me nenet 3; 8 dhe 11, të VKM nr.237, datë 12.04.2006 “Për disa ndryshime në VKM nr.560, datë 23.10.2000 "Për Miratimin e Projektit Pilot Për Përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor" dhe nenin 16, të rregullores së Bordit Drejtues.		22-27	E lartë	Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në respektim të rolit dhe detyrës si organi më i lartë ekzekutiv i SRD, të shmangë vendimmarrjen e vendimeve qarkulluese përveçse në rastet kur e ka të pamundur mbledhjen si dhe të pasqyrojë me transparencë diskutimin e anëtarëve të bordit gjatë vendimmarrjes, duke argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

	- Po kështu, ky Bord në vitin 2019 nuk është mbledhur 4 herë por është mbledhur 3 herë, në kundërshtim kjo me nenin 8, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës dhe me kërkesat e VKM nr.237, datë 12.04.2006.			
2	Për sa i përket respektimit të strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës konstatohet se për periudhën objekt auditimi, struktura është ndryshuar nga Bordi Drejtues i Spitalit, dymbëdhjetë herë. Këto ndryshime konsistojnë në lëvizjet e pozicioneve të punonjësve të spitalit, si në administratë dhe në stafin mjekësor. Këto ndryshime tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar, duke krijuar kështu pasiguri dhe performancë të ulët lidhur me pozicionet e punës. Sa më sipër bie në kundërshtim me misionin e Spitalit Rajonal Durrës: “Misioni i Spitalit Rajonal Durrës është të përmirësojë shëndetin e komunitetit duke ofruar një standard të ri në kujdesin shëndetësor, kujdesin klinik dhe ngritjen profesionale të mjekëve specialistë duke siguruar një qendër mjekësore për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve.”			Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojnë situatën e krijuar për shkak të ndryshimeve të shpeshta dhe të marrin masa lidhur me konsolidimin dhe unifikimin e strukturës të spitalit.
3	Nga auditimi konstatohet se nga Spitali Rajonal Durrës, janë dhënë 75 vërejtje gjatë vitit 2019 dhe 38 vërejtje gjatë vitit 2020. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk këto procedura nuk janë transparente, dhe nuk ka nuk ka komision apelimi për dhënien e masave disiplinore. -Nga grupi i auditimit konstatohet se në Spitalin Rajonal Durrës, për vitin 2019 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 68 punonjës dhe për vitin 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 79 punonjës. -Referuar të dhënave të më sipërme rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pjesën			Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e masave disiplinore në këtë spital. Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e dosjeve të

	<p>më të madhe të rasteve është me arsyen “dorëheqje”. Konkretisht nga numri total i të larguarve nga detyra në vitin 2019 (68 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 41% infermierë/laborantë dhe 25% mjekë. Kurse për vitin 2020 (79 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 31% infermierë/laborantë dhe 22% mjekë.</p> <p>Po ashtu, referuar të dhënave për dhënien e masave disiplinore, nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2019 (75 masa disiplinore në total), 60% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 8% mjekëve. Për vitin 2020 (38 masa disiplinore në total) 18% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 10% i janë dhënë mjekëve.</p> <p>-Pra sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se për periudhën objekt auditimi, situata e krijuar në Spitalin Rajonal Durrës, për shkak të masave disiplinore të dhëna pa kriter dhe pa mundësi apelimi, mund të ndikojë në performancën e punës, në motivimin e punonjësve, dhe për më tepër të mjekëve dhe infermierëve të cilët përbëjnë 62% të stafit të larguar për periudhën objekt auditimi. Duke pasur parasysh dhe periudhën e pandemisë Covid – 19, ku nevoja për mjekë është jashtëzakonisht e rëndësishme, situata e krijuar në SRD, ndikon negativisht në plotësimin e nevojave emergjente për staf të specializuar në përmbushjen e detyrës funksionale të këtij spitali.</p> <p>-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 158 dosje personeli me përzgjedhje rastësore, nga 662 punonjës që ka Spitali Rajonal Durrës, pra 23 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërsëritur, Dëshmia e Penalitetit mungon në pjesën më të madhe të rasteve, mungon</p>			<p>personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.</p>
--	---	--	--	--

	<p>raporti mjeko ligjor, vërtetimi nga gjykata mungon në 20 raste, vërtetimi nga prokuroria mungon në 25 raste.</p> <p>-Mos zbatimi i procedurave të dhënies masave disiplinore sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi dhënien e masave disiplinore duke ndikuar në performancën dhe motivimin e punonjësve të spitalit. Parregullsitë në plotësimin e dosjeve të personelit sjell parregullsi procedurale.</p>			
4	<p>Nga auditimi konstatohet se në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës janë regjistruar të dhëna të gabuara sa i takon zërit të numrit të punonjësve dhe zërit të të ardhurave dytësore. Në bilancin e shoqërisë rezultojnë 82 punonjës të larguar nga detyra në vitin 2020. Bazuar në verifikimin e të dhënave me burimet njerëzore rezulton se numri i të larguarve është 79 punonjës. Po ashtu, rezulton se dhe numri i të punësuar te rinj në vitin 2020 në bilanc është regjistruar 78, në fakt nga verifikimet rezultojnë të jenë 73 të punësuar. Po ashtu nga regjistrimi në zërin “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” në vlerën 2,866,327 lekë. Për vitin 2019 nuk ka asnjë vlerë lidhur me këtë zë të bilancit. Nga ana e Spitalit Rajonal të Durrësit është e paqartë se në cilin zë janë regjistruar këto të ardhura për vitin 2019. Veprimet e më sipërme bien në kundërshtim me pikën 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar.</p>	112-130	E lartë	<p>Spektori i Financës të marrë masa për rakordimin dhe korrigjimin e të dhënave të punonjësve të marrë rishtas në punë, atyre të larguar, si dhe të verifikojë dhe sistemojë vlerën e të ardhurave dytësore të spitalit.</p>
5	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se: Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD</p>	112-130	E lartë	<p>Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK me qëllim pajisjen</p>

	<p>zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-brefotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Gjatë vitit 2003 nga ana e ASHK-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhornimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Nga personat përgjegjës në vijimësi, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekar të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.</p>			<p>me dokumentacionin e plotë hipotekar. Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme, për përditësimin dhe azhurnimin e statusit ligjor dhe fizik të pronave të SRD me qëllim përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK dhe pajisjen me Titullin e Pronësisë.</p>
6	<p>Nga grupi i auditimit u konstatua se inventarizimi fizik nuk është kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, për shkak të situatës të pandemisë Covid – 19. Komisionet përkatëse të inventarizimit janë ngritur gjatë 2020. Komisioni vlerësimit ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse. Në disa raste mungon fletë – hyrja në magazinë lidhur me materialet të cilat janë kthyer në hekurishte për tu shitur në ankand si skrap, ky veprim janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat</p>	112-130	E lartë	<p>Spektori i Financës të marrë masa për realizimin e procesit të inventarizimit fizik në Spitalin Rajonal Durrës, dhe të ndjekë e plotësojë me përgjegjshmëri hapat e proceseve të cilat lindin pas këtij procesi, si asgjësimin, plotësimin i dokumentacionit justifikues etj.</p>

	<p>financiare”, neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku citohet: <i>I. në pasqyrat financiare vjetore.</i>”, dhe pikat 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.</p> <p>-Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.</p> <p>Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.</p>			
7	<p>Spitali Rajonal Durrës nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.</p> <p>-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga spitali nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.</p> <p>Këto veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.</p> <p>-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre.</p> <p>Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe</p>	112-130	E lartë	Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës dhe Sektori i Financës të merren masa për verifikimin e vlerës së mbetur dhe jetës të dobishme të AAM-ve me vlera materiale, të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin.

	objektive të situatës së Aktiveve Afatgjata Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme.			
8	<p>Nga grupi i auditimit konstatohet në datën 07.04.2021 hyrje daljet në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës mbahen me programin financiar “Financa 5”. Gjendja e farmacisë nga ekstrakti i datës 07.04.2021 rezulton: 628,854 copë medikamente në vlerën 46,866,206 lekë. Bazuar në përzgjedhjen rastësore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas regjistrimit në sistem.</p> <p>-Nga grupi i auditimit konstatohet se programi financiar “Financa 5” është lehtësisht i aksesueshëm, dhe i modifikueshëm, duke mos dhënë kështu sigurinë e arsyeshme, rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.</p> <p>- Hyrjet dhe daljet në farmacinë e spitalit nuk mbahen me një libër të posaçëm regjistrimi, lidhur me hyrje daljet e bëra sipas kërkesave spitalore për medikamente.</p> <p>-Nga grupi i auditimit u konstatua se dalja e medikamenteve nga farmacia, lidhur me nevojat spitalore nuk bëhet në çdo rast me kërkesë me shkrim dhe fletë daljen përkatëse. Kërkesa bëhet verbale nga mjekët, infermierët apo imazheristët, në varësi të kërkesave. Pasqyrimi i këtyre lëvizjeve në farmaci nuk është i menjëhershëm, por ka vonesa të cilat variojnë nga 1 – 21 ditë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar “Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e</p>	146-149	E lartë	<p>Spektori i Farmacisë së Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me aksesin dhe modifikimin në programin Financa 5, duke specifikuar punonjësin dhe kriteret e caktuara, bazuar në të cilat do të kryhen modifikimet. Të hartohet dhe mbahet libri i posaçëm i hyrje – daljeve, si dhe të merren masa lidhur me regjistrimin dhe pasqyrimin në kohë reale të lëvizjeve në farmaci, duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë justifikues.</p>

	shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi ne dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.”			
9	Gjendja e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2020 paraqitet me vlerën 9,146,697 lekë , krahasuar me vlerën e vitit 2019 prej 10,452,818 lekë , pra ka një rritje prej 1,306,121 lekë krahasuar me periudhën ushtrimore pasardhëse. Kjo rritje vjen si pasojë e njohjes së debitorëve të viteve të kaluara. Konstatohet se Sektori i Financës nuk e ka të qartë afatin dhe kohën në cilin duhet kryer kontabilizimi i këtyre detyrimeve, duke sjellë kështu pasiguri për shkak të paqartësisë lidhur me afatet e kontabilizimit të debitorëve lidhur me vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës për llogarinë 468. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, shkronjat g dhe gj, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.	112-130	E lartë	Nga Sektori i Financës të merren masa për analizimin e vlerës prej 9,146,697 lekë të debitorëve, ndjekjes të procedurave të regjistrimit të tyre referuar afateve të përcaktuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.
10	Shmangja e procedurave të prokurimit , mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen nga Titullari i SRD-së dhe strukturat e ngarkuara me prokurimin e këtij malli, në Spitalin Rajonal Durrës për vitin 2019 . Në nëntor të vitit 2018, Spitali Rajonal Durrës për mbulimin e nevojave me oksigjen ka filluar procedurën e prokurimit me Objekt “ Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019 ”, me fond 6,085,206 lekë pa TVSH . Sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit të kësaj procedure, furnizimi me oksigjen do të mbulojë nevojat për oksigjen për gjithë vitin 2019. Procedura e prokurimit ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit datë 30.04.2019 me	44-92	E lartë	Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në raport me planifikimet , nevojat dhe realizimet e kontratave të oksigjenit të analizojë dhe të identifikojë nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me këtë proces, kronologjinë e gjendjes reale të këtij malli në magazinat e SRD-së, shpërndarjen e tij dhe shmangien e procedurave që nuk sanksionohen në

<p>vlere me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH me operatorin fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS.</p> <p>Ndërsa, furnizimi i Spitalit Rajonal Durrës me oksigjen për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën e lidhjes se kësaj kontrate (30.04.2019), është bërë faktikisht nga operatori “Me. A”. Spitali Rajonal Durrës me këtë operator nuk kishte lidhur kontratë furnizimi (nëpërmjet procedurave të prokurimit) , por furnizimi bëhej dhe evidentohej vetëm në bazë të procesverbaleve të marrjes në dorëzim. Referuar dokumentacionit që ju vu në dispozicion grupit të auditimit mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratës për furnizimin e SRD me oksigjen , u konstatua se në lidhjen e dokumentacionit të likuidimit të operatorit fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS, ka 12 procesverbale furnizimi me oksigjen të mbajtura midis operatorit “M. A” në cilësinë e shitësit por jo të operatorit fitues që sipas tenderit të zhvilluar në datën 19.04.2019 është shpallur bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH.</p> <p>Kështu deri në datën 19.04.2019, operatori furnizues “M. A” ka furnizuar spitalin me 47,073 litra oksigjen, me anë të procesverbaleve ku deklarohet si furnizues dhe huadhënës i oksigjenit duke ju vënë si kusht që pagesa do t’i kryhet menjëherë kur SRD t’i akordohet fondi në buxhetin e tij për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e këtij malli.</p> <p>Konkretisht:</p> <p>Në datën datë 20.05.2019, një muaj më pas lidhjes se kontratës më operatorin e shpallur fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS, Drejtori i Spitalit ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 për shlyerjen e detyrimit që kishte ndaj operatorin “M. A” i cili kishte furnizuar spitalin me oksigjen deri në 19.04.2019. Kjo</p>			<p>kontratat e lidhura me operatorët fitues të tenderit.</p> <p>Titullari i Autoritetit Kontraktor në SRD, të marrë masa që të organizojë strukturat që ka ngarkuar me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në Spitalin Rajonal Durrës, për të ndjekur trajnimet që organizohen nga Agjencia e Prokurimit Publik, në mënyrë që të shmangë parregullsitë në procedurat e prokurimit në të ardhmen.</p>
---	--	--	---

	<p>marrëveshje është nënshkruar edhe nga operatori fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS. Me dokumentin nr.967, datë 20.05.2019 është nënshkruar marrëveshje për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga ana e Spitalit Rajonal Durrës të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfungsionimin e Spitalit Rajonal Durrës midis Drejtorit të Spitalit, operatorit “M. A.” sh.p.k në cilësinë e furnizuesit dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k, në cilësinë e operatorit fitues të tenderit.</p> <p>Sipas kësaj marrëveshje subjekti bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k shlyen detyrimin vetëm për sasinë 45,000 litra oksigjen lëng dhe mbeten për likuidim edhe 2073 litra. Sasia në litra e furnizuar nga H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k për SRD është 8830 litra oksigjen në total.</p> <p>Sa sipër lidhja e marrëveshje tre palëshe mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 ka shmangur procedurat e prokurimit duke krijuar precedent për marrëveshje midis operatorit fitues të tenderit, operatorit furnizues dhe titullarit të Spitalit Rajonal Durrës, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.</p> <p>Për gjithçka më sipër, del qartë se, furnizimi me oksigjen deri në datën 19.04.2019 për sasinë 47,073 litra oksigjen është bërë pa procedura prokurimi në kundërshtim të hapur LPP, në një kohë Autoriteti Kontraktor i ka pasur të gjithë mundësitë që deri në përfundimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës të realizonte procedurat prokurimi me negociim pa shpallje të kontratës të parashikuara në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.</p> <p>Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi</p>			
--	--	--	--	--

	<p>titullari i autoritetit kontraktor, për shmangie të procedurave të rregullta të prokurimit për mos evidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.</p>			
11	<p>Dorëzim i mallit (“Furnizim vendosje me një ashensor të ri per godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe) të SRD”, për vitin 2020 pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë në Spitalin Rajonal Durrës.</p> <p>Për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)”, viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 lekë pa TVSH me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.</p> <p>Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç. Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, Titullari i AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletin e APP nr.94, datë 2.11.2020.</p> <p>Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.</p> <p>Amendimi kontratës bazuar në</p>	44-92	E lartë	<p>Strukturat përkatëse të SRD-së të ngarkuara me monitorimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratave të prokurimeve të marrin masa që në të ardhmen të raportojnë në kohë vonesat mbi dorëzimin e mallit/shërbimit apo punëve publike dhe arsyet mbi këto vonesa duke mbajtur procesverbale dhe raporte me operatorët fitues të këtyre procedurave duke i parashtruar detyrimet që rrjedhin nga kontratat përkatëse dhe penalitetet nëse nuk përmbushin kushtet e kontratave.</p>

	<p>shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.</p> <p>Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.</p> <p>Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit “Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)”, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.</p> <p>Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021 , me faturën nr.150, furnitori “Hy. Kl.” ka sjellë vlerën e prokurimit për likuidim 3,120,000 lekë me TVSH, por nuk është kryer akoma likuidimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t’i mbahen operatorit ekonomik “H. K.” sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se “Autoriteti Kontraktor mund të</p>			
--	--	--	--	--

	<p>zbrësë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes”.</p> <p>Ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t’i zbrësë faturës së likuidimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës është 661,440 lekë.</p> <p>Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet.Për pasojë vlera e penalitetit 661,440 lekë lekë përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “H. K.” sh.p.k. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës.</p>			
<p>12</p>	<p>Me vendimin e Bordit Drejtues nr.06, datë19.03.2018 është miratuar sistemi i punës 12 –orë për shërbimin e Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika1, 12/1, si dhe 12/2, pika c “për punonjësit e</p>	<p>27-39</p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojë efektin financiar negativ prej 15,001,225 lekësh dhe të marri masa për korrigjimin e pagesave të shoferëve për orët shtesë sipas turneve dhe ditëve përkatëse.</p>

	<p>infirmieristikës”.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se duke u bazuar nga VKM nr.555, datë 11.08.2011, Bordi Drejtues me vendimin e nr.21, datë 09.06.2011 ka caktuar pagesën e shoferëve me sistemin e shërbimit 12 – orësh, me qëllim motivimin e këtij stafi, konkretisht për ditë të zakonshme 1,880 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,350 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 3,055 lekë/ditë shërbimi. Kjo vlerë është më e lartë krahasuar me përcaktimet e VKM nr.555, datë 11.08.2011 lidhur me pagesat e mjekëve të urgjencës dhe infermierët, të cilët për të njëjtin shërbim paguhen si më poshtë:</p> <p>-Mjek urgjence: për ditë të zakonshme 1,800 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,000 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 2,300 lekë/ditë shërbimi,</p> <p>-Infermierë roje urgjence: për ditë të zakonshme 1,100 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 1,400 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 1,700 lekë/ditë shërbimi.</p> <p>Pra vendimi i Bordit është jokoherent dhe i pa argumentuar dhe i kategorizuar sipas niveleve të pagave e kriterëve përkatëse, dhe bie në kundërshtim me përcaktimet në pikën 1 dhe 2, neni 80 “Shtesa mbi Pagë” i Kodit të Punës, në të cilin citohet se: “1. Me punë nate kuptohet puna e kryer nga ora 22⁰⁰ deri në orën 6⁰⁰ të mëngjesit. Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej 15,001,225 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Spitalit Rajonal të Durrësit.</p>			
--	--	--	--	--

OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Spitalit Rajonal Durrës, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë², i mbështetur në ligjin nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Spitalit Rajonal Durrës, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e Spitalit Rajonal Durrës rezultoi se:

-Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht kryesisht me veprimet dhe mosveprimeve të administratës së Spitalit nga të cilat janë konstatuar dëme ekonomike në vlerën **1,198,100 lekë**, në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, shpenzime pagash, zvarritjen e çështjeve gjyqësore, mosgarantimin e zbatimit të plotë të vendimeve, mosmarrjen e masave për pjesëmarrjen në proceset për njohjen e vendimeve gjyqësore, mungesën e një analize paraparake përpara nisjes së këtyre procedurave, etj, të cilat më vete dhe së bashku kanë ndikime financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit cila kap vlerën në rreth **29,748, 222 lekë**.

Përgjegjësite e strukturave drejtuese në SRD

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Përgjegjësite e Audituesve mbi auditimin e përputhshmërisë.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

³ **ISSAI 4000** – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;
- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionet ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Spitalit Rajonal Durrës, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 4000 Udhërrëfyese i Auditimit të Përputhshmërisë;

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij .

II HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 132/1 prot., datë 27.01.2021, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.02.2021 deri më datë 30.04.2021 në subjektin Spitali Rajonal Durrës për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2021 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. J. Zh., Përgjegjëse grupi
2. I. S., Audituese
3. I. B. , Audituese
4. M. H., Auditues

1. Titulli.

Raport Përfundimtar Auditimi mbi përputhshmërinë e Spitali Rajonal Durrës për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2021.

Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej **11** drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionit i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt, në kreun e V-të

janë anekset. Raporti mbyllet me kreun VI-të , -Lista e dokumenteve të auditimit.

2. Marrësi.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i dërgohet subjektit të audituar Spitali Rajonal Durrës, pra marrësit Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës znj. N. J.

3. Objektivat dhe qëllimi. Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkëlqes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse:
 - Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
 - Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
 - Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
 - Veprimtaria e shoqërisë është në pajtueshmëri me politikën, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
 - Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.
4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullave përkatëse të prokurimit publik, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
5. Shkalla e realizimit të objektivat kryesore të përcaktuar në programet ekonomike dhe financiare;
6. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së Spitalit Rajonal Durrës.

4. Identifikimi i çështjes.

Raporti mbi përputhshmërinë e Spitalit Rajonal Durrës të periudhës 01.01.2019 deri më 31.01.2021 ka identifikuar sipas kriterëve të specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e Bordit të Spitalit dhe Drejtorit;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e programit ekonomik-financiar;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
- Organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Durrës;
- Auditimin e fondeve të akorduara dhe të shpenzuara , për përballimin e situatës së pandemisë COVID – 19;
- Të tjera që kanë dalë gjatë procesit auditues.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

6. Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

7. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislationin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC - Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit. Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së; Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”, i ndryshuar; VKM nr. 112, datë 22.2.2006 “Për kohën e punës dhe të pushimit në sistemin e shëndetësisë”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave për shërbimet mjekësore”; Urdhri i Ministrit nr. 526, datë “12.10.2009 “Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor”; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Spitalit; Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

8. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor,

rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

9. Metodatat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” të ndryshuar me VKM nr. 237, datë 12.04.2006 dhe VKM nr. 76, datë 19.01.2007. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: Organet drejtuese: Bordi Drejtues dhe Drejtoria; Organet konsultative: Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ, Komisionet e spitalit: Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë, Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

10. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Spitalit Rajonal Durrës, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohej për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” të ndryshuar me VKM nr.237, date 12.04.2006 dhe VKM nr. 76, datë 19.01.2007. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: Organet drejtuese: Bordi Drejtues dhe Drejtoria; Organet konsultative: Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ, Komisionet e spitalit: Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë, Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës.

Bordi i Spitalit është organi më i lartë ekzekutiv, i cili siguron zbatimin e politikave shëndetësore dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë. Mbledhjet e Bordit janë të hapura. Bordi mund të thërrasë në mbledhjet e tij të gjithë drejtuesit e spitalit dhe/ose specialistë, ekspertë të tjerë jashtë spitalit, për çështje të ndryshme. Spitali Rajonal Durrës, e zhvillon veprimtarinë e tij mbi bazën e Statutit të miratuar me VKM Nr. 560 datë 23.10.2000, i ndryshuar me VKM nr. 237 date 12.04.2006 dhe VKM Nr. 76 date 19.01.2007. Bazuar në Statutin e Spitalit Rajonal Durrës, organi më i lartë vendimarrës i Spitalit Rajonal Durrës është Bordi Drejtues, i cili perbehet nga 9 anetare (neni 4):1 përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë; 1 përfaqësues i DSHP-se Durrës; 1 përfaqësues i prefekturës; 1 përfaqësues i shoqatës së biznesmenëve Durrës; 2 përfaqësues të ISKSH-së; 1 përfaqësues i Urdhrit të Mjekut; 1 përfaqësues i shoqatës së pacienteve; 1 përfaqësues nga sindikata më e përfaqësuar për shëndetësinë në Durrës.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

3.2. Mbi e ligjshmërisë për emërimin e strukturave drejtuese të Spitalit Rajonal Durrës, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si vijon:

Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” të ndryshuar me VKM nr.237, date 12.04.2006 dhe VKM nr.76, datë 19.01.2007. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: Organet drejtuese: Bordi Drejtues dhe Drejtoria; Organet konsultative: Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ, Komisionet e spitalit: Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë, Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës.

Bordi i Spitalit është organi më i lartë ekzekutiv, i cili siguron zbatimin e politikave shëndetësore dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë. Mbledhjet e Bordit janë të hapura. Bordi mund të thërrasë në mbledhjet e tij të gjithë drejtuesit e spitalit dhe/ose specialistë, ekspertë të tjerë jashtë spitalit, për çështje të ndryshme. Spitali Rajonal Durrës, e zhvillon veprimtarinë e tij mbi bazën e

Statutit të miratuar me VKM Nr.560 date 23.10.2000, i ndryshuar me VKM Nr.237 date 12.04.2006 dhe VKM Nr. 76 date 19.01.2007. Bazuar Statutit, organi me i larte vendimmarres i Spitalit Rajonal Durres eshte Bordi Drejtues, i cili perbehet nga 9 anetare (neni 4):

1 përfaqësues të Ministrise së Shëndetësisë;

1 përfaqësues i DSHP-se Durrës;

1 përfaqësues i prefekturës;

1 përfaqësues i shoqatës së biznesmenëve Durrës;

2 përfaqësues të ISKSH-së;

1 përfaqësues i Urdhrit të Mjekut;

1 përfaqësues i shoqatës së pacienteve;

1 përfaqësues nga sindikata më e përfaqësuar për shëndetësinë në Durrës;

Anëtarët e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2019:

1. znj. M. Xh., përfaqësuese e MSHMS - Kryetare , emëruar me shkresën nr. 2835 prot, datë 22.11.2018 me periudhë angazhimi 6 muaj;

2. Dr. K. H. - Nënkyetar, emëruar me shkresën nr.5 prot, datë 07.01.2014 përfaqësues i Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës me periudhë angazhimi 5 vjet e 4 muaj;

3. znj. J. M. – Anëtare , emëruar me shkresën nr. 1110 prot, datë 27.12.2013 përfaqësuese e Prefekturës Durrës me periudhë angazhimi 5 vjet e 5 muaj;

4. z. D. Sh. – Anetar, emëruar me shkresën nr.957 prot, date 20.05.2019, përfaqësues i Shoqates se Biznesmeneve Durres me periudhë angazhimi 1 javë;

5. znj. A. A. – Anëtare, emëruar me shkresën nr. 2835/1 prot, date 11.12.2018, përfaqësuese e FSDKSH – Tiranë me periudhë angazhimi 5 muaj;

6. znj. N. P. - Anëtare , emëruar me shkresën nr. 3562/1 prot,date 04.07.2016, përfaqësuese e FSDKSH Durrës, me periudhë angazhimi 2 vjet e 10 muaj;

7. Dr. E. H. – Anetare, emëruar me shkresën nr. 1342/1 prot, datë 29.07.2015, përfaqësuese e Urdhërit të Mjekut Durrës, me periudhë angazhimi 3 vjet e 10 muaj;

8. Dr. A. N. – Anëtar, emëruar me shkresën nr. Nr. 1961 prot, date 05.11.2015, përfaqësues i Sindikatës Punonjesve të Shëndetësisë, me periudhë angazhimi 3 vjet e 6 muaj

9. Përfaqësues i Shoqatës së Pacientëve- Nga Spitali Rajonal Durrës nuk ka asnjë informacion për kryesinë e kësaj shoqate.

Anëtarët e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2020:

1. znj. M. Xh., përfaqësuese e MSHMS - Kryetare , emëruar me shkresën nr. 2835 prot, datë 22.11.2018;

2. znj. A. H. - Nënkyetar, Përfaqësues i Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës, emëruar me shkresën nr. 1994/2 prot, date 07.11.2019;

3. znj. E. C. – Anëtare, Përfaqësuese e Prefekturës Durrës, emëruar me shkresën nr. 175/1 prot, date 30.01.2020;

4. z. D. Sh. – Anëtar, Përfaqësues i Shoqatës së Biznesmenëve Durrës, emëruar me shkresën nr. 957 prot, datë 20.05.2019;

5. z. A. H. – Anetar, Përfaqësues e FSDKSH – Tiranë, emëruar me shkresën nr. 376/1 prot, datë 25.02.2020;

6. znj. N. P. - Anëtare, Përfaqësuese e FSDKSH Durres, emëruar me shkresën nr. 376/1 prot,date 25.02.2020;

7. Dr. E. H. – Anëtare në mandatin e dytë, Përfaqësuese e Urdhërit të Mjekut Durrës, emëruar me shkresën nr. 1342/1 prot, datë 29.07.2015;

8. Dr. F. Sh. – Anëtar, Përfaqësues Sindikatës Punonjësve të Shëndetësisë, emëruar me shkresën nr.219 prot, datë 27.01.2020,

9.Përfaqësues i Shoqatës së Pacientëve- Nga Spitali Rajonal Durrës nuk ka asnjë informacion për kryesinë e kësaj shoqate.

Gjatë vitit 2019 jane realizuar 3 (tre) mbledhje te Bordit Drejtues, konkretisht:

I – Mbledhja e I-re me date 13.03.2019, ku jane marr 8 (tete) vendime

II – Mbledhja e II-te me datë 20.05.2019, ku jane marrë 4 (kater) vendime

III – Mbledhja e III-te me date 13.11.2019, ku jane marr 4 (kater) vendime

IV-Gjate vitit 2019, per shkak te gjendjes se jashtezakonshme nga tërmeti i 26 Nentorit 2019, jane marrë 9 (nëntë) vendime qarkulluese.

Vendim - Qarkullues Nr.1 date 10.01.2019 per miratimin e rregjistrimit te prokurimeve per vitin 2019

Vendim nr.2 date 13.03.2019 per miratimin e Buxhetit te SRD per 2019, dhe strukturese se pagave

Vendim nr.3 date 13.03.2019 miratimin e ndryshimit te emertimeve te pozicioneve te bankes gjakut

Vendim nr.4 date 13.03.2019 miratimin e tarifave per disa nga sherbimet dytesore te SRD

Vendim nr.5 date 13.03.2019 miratimin e normativave te konsumit te karburantit per

Vendim nr.6 date 13.03.2019 miratimin e ndryshimeve ne strukturen organike te IT dhe Urgjenc

Vendim nr.7 date 13.03.2019 miratimin e dhenies se pages per mjeket e kujdesit paresor ne urgjencen pediatrike

Vendim nr.8 date 13.03.2019 miratimin e emerimit te Dr. E. S. - Shef Sherbimit Pathologji

Vendim nr.9 date 13.03.2019 miratimin e emerimit te Dr. E. Gj. - Shefe e Neonatologjise

Vendim nr.10 date 20.05.2019 miratimin e rritjes se rrogave per punonjesit e SRD

Vendim nr.11 date 20.05.2019 emerimi Dr. J. C. - Shef I Klinikes se Obstetrikes

Vendim nr.12 date 20.05.2019 emerimi Dr. S. Xh. - Shef I Sherbimit te Kardiologjise

Vendim nr.13 date 20.05.2019 per ndryshimin e strukturese organike te krematorium/lulishtar

Vendim nr.14 date 13.11.2019 caktimin e nenkryetares te Znj. A. H.

Vendim nr.15 date 13.11.2019 emerimi Dr. D. Sh. - Shef I Sherbimit te Gjinekologjise

Vendim nr.16 date 13.11.2019 emerimi Dr.E. M. - Shefe Labororit Klinik-Biokimik

Vendim nr.17 date 13.11.2019 miratimi shpenzimeve kapitale nga te ardhurat dytesore per hidroizolim

Vendim-qarkullues nr. 18 date 10.12.2019 miratimin e investimit nga te ardhurat dytesore per 3 brucatore

Vendim-qarkullues nr. 19 date 10.12.2019 miratimin e investimit nga te ardhurat dytesore per blerje ashensore

Vendim-Qarkullues nr.20 date 19.12.2019 për miratimin e rialokimeve nga te ardhurat dytesore dhe buxheti 2019

Vendim-Qarkullues nr.21 date 19.12.2019 për miratimin e shpenzimeve kapitale per vetraten e poliklinikes

Vendim-Qarkullues nr.22 date 19.12.2019 per miratimin e rialokimeve ne thesar

Vendim-Qarkullues nr.23 date 19.12.2019 per miratimin e ndryshimeve ne strukturen e Auditit dhe Sek.Kostos

Vendim-Qarkullues nr.24 date 19.12.2019 emerimi Dr. A. N. - Shef i Klinikes se Urologjise

Vendim-Qarkullues nr.25 date 19.12.2019 miratimin e rregullores se Bordit Drejtues

Gjatë vitit 2020, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme nga pandemia Covid-19, është realizuar 1 (një) mbledhje online e Bordit Drejtues dhe janë marrë 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime qarkulluese ne total 21 vendime:

I – Mbledhja e I-rë më datë 09.10.2020 e realizuar online, ku janë marrë 3 (tre) vendime.

Gjatë periudhës Janar – Shkurt 2021, është realizuar 1 (një) mbledhje online e Bordit Drejtues dhe janë marr 2 (dy) vendime qarkulluese.

I – Mbledhja e I-rë më date 15.02.2021 e realizuar online, ku jane marr 4 (kater) vendime.

Vendim - Qarkullues Nr.1 date 17.01.2020 miratimi rregjistrimit te parashikimeve te Sektorit te Prokurimeve per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.2 date 17.01.2020 miratimi i ndryshimit te strukturese ORL-Okulistik-Maksilofacial & Laboratori Klinik-Biokimik

Vendim - Qarkullues Nr.3 date 17.01.2020 miratimi i siperfaqeve per dhenien me qera te ambienteve te SRD per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.4 date 27.03.2020 per miratimin e rregullores se Funkcionimit Teknik dhe

Ekonomiko-Financiar 2020-2021 te SRD

Vendim - Qarkullues Nr.5 date 27.03.2020 per miratimin e normativave te konsumit te karburantit per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.6 date 27.03.2020 per emerimin e Shefit te Klinikes se Semundjeve Infektive (I komanduar) - Dr.Beqir Gelaj Propozim Drejtorise se SRD per Bordin per emerimin e Shefit te Klinikes se Semundjeve Infektive (I komanduar) - Dr.B. G.

Vendim - Qarkullues Nr.7 date 27.03.2020 Miratimin e Pasqyrave Financiare te SRD per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.8 date 27.03.2020 Miratimin e ndryshimit ne strukturen Organike te SRD

Vendim - Qarkullues Nr.9 date 27.03.2020 Miratimi i regjistrit te parashikimit te prokurimeve per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.10 date 27.03.2020 Për miratimin e zerave te buxhetit per vitin 2020

Vendim - Qarkullues Nr.11 date 15.05.2020 Miratimi i strukutres Organike dhe Organizative te vitit 2020

Vendim - Qarkullues Nr.12 date 15.05.2020 Per ndryshimin e struktures se Poliklinikes, emerimi Dr.H. D.

Vendim - Qarkullues Nr.13 date 15.05.2020 per ndryshimin ne strukture te kordinatorit per te drejten e informimit

Vendim - Qarkullues Nr.14 date 15.05.2020 per ndryshimin e struktures se Kabinetit te Onkologjise, emerimin e Dr. M. L.

Vendim - Qarkullues Nr.15 date 08.07.2020 per miratimin e projekt-buxhetit per periudhen 2021-2023

Vendim Nr.16 date 09.10.2020 emerimi Shefit te Konsultorit te Gruas te SRD, Dr.A. L.

Vendim Nr.17 date 09.10.2020 Miratimi krijimit te Sektorit te Auditit te Brendshem ne SRD me 3(tre) punonjes

Vendim Nr.18 date 09.10.2020 miratimin e shtimit te pozicionit te nje specialisti ne Njesine e Auditit

Vendim - Qarkullues Nr.19 date 02.11.2020 miratimi shpenzimeve nga te ardhurat dytesore per blerje gota oksigjeni

Vendim - Qarkullues Nr.20 date 07.12.2020 miratimi i shpenzimeve nga te ardhurat dytesore te vitit 2021, per blerje 236 gota dhe bombula oksigjeni mjekesor

Vendim - Qarkullues Nr.21 date 30.12.2020 miratimi i rialokimeve ne zerat e buxhetit dhe ne zerat e te ardhurave dytesore per vitin 2020 2300 30.12.2020

Vendim - Qarkullues Nr.22 date 30.12.2020 miratimi per dhenien me qera te ambienteve te SRD per vitin 2021

Për vitin 2019,2020, Janar 2021

Urdhurat e nxjerra nga Titullari e Spitalit Rajonal Durrës, për periudhën objekt auditimi është konstatuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion,titullari i Spitalit Rajonal Durrës për rregullimin e veprimtarisë funksionale të SRD ka nxjerrë rreth **81 urdhra**, që konsistojnë në punësime, procedura prokurimi, mbarëvajtje ose organizim i punës në pavionet e spitalit, zbatimi i rekomandimeve nga FSDKSH, ISHP dhe KLSH etj.

Parregullsi referuar zbatimit të kuadrit rregullator nga Bordi Drejtues i SRD:

-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Bordi i Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2019, ka funksionuar pa rregullore në kundërshtim me nenin 12, pika (m) të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr.237, datë 12.04.2006;

-Bordi i Spitalit Rajonal Durrës gjatë vitit 2019 ka marrë 25 vendime nga të cilat **9 vendime qarkulluese**.Bordi i Spitalit Rajonal Durrës gjatë vitit 2019 është mbledhur 3 herë dhe jo 4 herë, në kundërshtim me nenin 8, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr.237, datë 12.04.2006;

-Referuar i vendimarrjes së Bordit të Spitalit,konstatohet se në shumicën e rasteve për periudhën

objekt auditimi Bordi i Spitalit ka marrë vendime qarkulluese në të cilat nuk pasqyrohet diskutimi i anëtarëve të bordit.

-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Bordi i Spitalit Rajonal Durrës me Vendimin Qarkullues nr. 25, datë 19.12.2019 ka miratuar rregulloren e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, por kjo rregullore e Bordit Drejtues të Spitalit nuk është e përditësuar sipas terminologjisë së institucioneve të varësisë që alokojnë fondet për SRD-në pavarësisht se Drejtoria e SRD i ka dërguar një kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ndryshimin e VKM nr. 560, datë 23.10.2000 "Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e SRD në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", i ndryshuar. Për sa më lart është mbajtur aktkonstatimi nr.3, datë 30.04.2021.

2.2. Titulli i Gjetjes: Vendimmarrje në formën e vendimeve qarkulluese për periudhën objekt auditimi nga Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës, pa argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime nga anëtarët e këtij Bordi për çështje me rëndësi për veprimtarinë funksionale të Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: Bordi i Spitalit Rajonal Durrës gjatë vitit 2019 ka marrë 25 vendime nga të cilat 9 vendime qarkulluese dhe gjatë vitit 2020 ka marrë 19 vendime qarkulluese. Bordi i Spitalit Rajonal Durrës gjatë vitit 2019 është mbledhur 3 herë dhe jo 4 herë, në kundërshtim me nenin 8, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr. 237, datë 12.04.2006; Referuar vendimmarrjes së Bordit të Spitalit, konstatohet se në shumicën e rasteve për periudhën objekt auditimi Bordi i Spitalit ka marrë vendime qarkulluese në të cilat nuk pasqyrohet diskutimi i anëtarëve të bordit.

Kriteri: VKM nr. 237, datë 12.04.2006 "Për disa ndryshime në VKM nr. 560, DATË 23.10.2000 "Për Miratimin e Projektit Pilot Për Përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor"; neni 3; neni 8; neni 11, rregullorja e Bordit Drejtues neni 16.

Ndikimi/Efekti: Mos relativitet i çështjeve të veprimtarisë funksionale të Spitalit Rajonal Durrës nga Bordi i Spitalit por marrja e vendimeve qarkulluese pa argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

Shkaku: Mos vlerësim i rolit vendimmarrës të anëtarëve të Bordit Drejtues të çështjeve të veprimtarisë funksionale të Spitalit Rajonal Durrës nga Bordi i Spitalit por marrja e vendimeve qarkulluese pa argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

Rëndësia: e Lartë

2.2.1 Rekomandimi : Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në respektim të rolit dhe detyrës si organi më i lartë ekzekutiv i SRD, të shmangë vendimmarrjen e vendimeve qarkulluese përveçse në rastet kur e ka të pamundur mbledhjen si dhe të pasqyrojë me transparencë diskutimin e anëtarëve të bordit gjatë vendimmarrjes, duke argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

Afati : Në vijimësi

1.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr. 132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me rekomandimin 1.1 të masave organizative Bordi Spitalit sqaron se do marrë masa në zbatim të rekomandimit të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr. 132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me rekomandimin 1.1 të masave organizative Bordi Spitalit sqaron se do marrë masa në zbatim të rekomandimit të KLSH. Referuar për sa më sipër grupi i auditimit do ta trajtojë masën organizative në raportin e auditimit.

3.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit ,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Struktura Organizative

Për sa i përket strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës (më poshtë SRD) konstatohet se struktura është ndryshuar si më poshtë:

-Me vendimin nr. 46, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2019”.

-Me vendimin qarkullues nr. 03, datë 13.03.2019 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, ndryshuar emërtimin e pozicionit në strukturën e Bankës të Gjakut, ku nga dy pozicione “infermiere” bëhet një pozicion “infermiere” dhe një “kryeinfermiere”.

-Me vendimin qarkullues nr. 06, datë 13.03.2019 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, duke kaluar një pozicion në strukturë nga “infermier operator” të Sektorit të Menaxhimit të Teknologjisë në “shofer ambulance” në Shërbimin e Urgjencës.

-Me vendimin qarkullues nr. 13, datë 20.05.2019 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, duke shtuar një punonjës krematoriumi dhe duke pakësuar një punonjës lulishtar/punëtor oborri.

-Me vendimin qarkullues nr. 23, datë 19.12.2019 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, duke shtuar një punonjës në sektorin e Auditit të Brendshëm dhe duke pakësuar sektorin e Kostos me një punonjës.

-Me vendimin qarkullues nr. 02, datë 17.01.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve duke shtuar pozicionin e një mjeku maxillofacial dhe duke pakësuar një mjek te laboratorit Klinik Biokimik.

-Me vendimin qarkullues nr. 11, datë 15.05.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar struktura organike e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2020.

-Me vendimin qarkullues nr. 12, datë 15.05.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve duke shtuar pozicionin e mjekut neurolog në Shërbimin e Poliklinikës të Specialiteteve dhe duke pakësuar një mjek neurolog në Shërbimin e Neurologjisë.

-Me vendimin qarkullues nr. 13, datë 15.03.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve duke shtuar pozicionin “koordinator për të drejtën e informimit” dhe duke pakësuar një laborant klinik biokimik në Poliklinikën e Specialiteteve, Laboratori Klinik Biokimik.

-Me vendimin qarkullues nr. 14, datë 15.05.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, ku nga dy mjekë onkolog në strukturë kalon një mjek dhe një mjek është emëruar në pozicionin “Shef Klinike”.

-Me vendimin qarkullues nr.14, datë 15.05.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar ndryshimi në strukturën e SRD – së, ku nga dy mjekë onkolog në strukturë kalon një mjek dhe një mjek është emëruar në pozicionin “Shef Klinike”.

-Me vendimin qarkullues nr.17, datë 09.10.2020 të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, është miratuar krijimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm pranë SRD – së me tre specialistë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Ndryshimet e shpeshta tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar.

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 1131 prot., datë 26.06.2019 midis Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z.A. K. dhe Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë, të përfaqësuar nga z.K. N. Kjo kontratë është nënshkruar mes palëve në datën 26.02.2018, për një periudhë tre vjeçare. Pra

afati i kësaj kontrate ka përfunduar në 26.02.2021.

Procedura e Rekrutimit të Punonjësve

Me shkresën nr. 157 prot, datë 20.01.2020 është lidhur kontrata midis Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Të Kujdesit Shëndetësor, me përfaqësuese znj. N. P. dhe Spitalit Rajonal Durrës, me përfaqësuese znj. N. J. Drejtoria Qëndrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të punonjësve të administratës të spitaleve rajonale/bashkiake, procedurat e e pranimit dhe emërimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike dhe procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetësore Publike, referuar dispozitave paraprahe të kësaj kontrate, pika c “Spitali rajonal/bashkiak është institucion shëndetësor në varësi të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor që jep shërbim shëndetësor në bazë të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 ‘Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.” dhe udhëzimeve përkatëse.

Tabela nr.1: Të dhëna përmbledhëse për treguesit e punës.

Nr	Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020		Janar 2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Nr mesatar i punonjësve	700	656	700	641	700	662
2	Paga mesatare	58,692	62,699	60,714	63,170	76,393	71,500
3	Fondi i pagave	493,014,000	493,405,888	508,000,000	491,796,305	53,475,000	47,833,915

Burimi i të dhënave: Sektori i financës, përpunoi grupi i auditimit.

Niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit të ministrave nr. 555, datë 11.08.2011 “Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”.

Në vitin 2019, numri mesatar faktik i punonjësve në SRD ka qenë 656 punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat ka rezultuar në vlerën 493,405,888 lekë.

Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 655 punonjës. Fondi i pagave i planifikuar është 493,014,000 lekë, pra **391,888 lekë** më shumë se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 648.8 punonjës. Fondi i pagave është 508,000,000 lekë, kurse realizimi është 491,796,305, pra 16,203,695 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në **Janar 2021** është realizuar 669 punonjës. Fondi i pagave është 53,475,000 lekë, kurse realizimi është 47,833,915 lekë, pra 5,641,085 lekë më pak se programi.

-Lidhur me nivelin e pagave, nga grupi i auditimit konstatohet se për **vitin 2019**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 58,692 lekë/punonjës, kurse fakti është 61,599 lekë/ punonjës, pra **tejkalim** në vlerën **2,907 lekë/punonjës**.

-Për **vitin 2020**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 60,476 lekë/punonjës, kurse fakti është 63,167 lekë, pra ka **tejkalim** në vlerën **2,691 lekë/ punonjës**.

-Për **muajin Janar 2021**, parashikimi i nivelit të pagave është mesatarisht 76,393 lekë/punonjës, kurse fakti është mesatarisht 71,500 lekë, pra ka **mos realizim** në vlerën **4,893 lekë/ punonjës**.

Dosjet e Personelit

Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 158 dosje personeli me përzgjedhje rastësore, nga 662 punonjës që ka Spitali Rajonal Durrës, pra 23 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërtëritur, Dëshmia e Penalitetit mungon në pjesën më të madhe të rasteve, mungon raporti mjeko ligjor, vertetimi nga gjykata mungon në 20 raste, vertetimi nga prokuroria mungon në 25 raste.

Masat Disiplinore

Tabela nr.2 : Evidencat e masave disiplinore

Nr	Vërejtje	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	Këshillim	Masë zhdëmtuese	Tërheqje vëmendje	Ndalesë ditë pune
Viti 2019	25	16	31	1	1	1
Viti 2020	20	3	8	0	1	6
Janar 2021	0	0	0	1	0	0
Totali	45	19	39	2	2	7

Burimi i të dhënave: Sektori i Burimeve Njerëzore, përpunoi grupi i auditimit.

Nga grupi i auditimit konstatohet se janë dhënë 75 vërejtje gjatë vitit 2019 dhe 38 vërejtje gjatë vitit 2020.

1. Mbi procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të SRD për shkeljet administrative:

-Dhënia e masës disiplinore fillon me relacion nga eprori direkt i punonjësit, apo eprorit më lartë në nivel, si dhe grupet e kontrollit të ngritura nga titullari, që mund të kenë konstatuar shkeljen administrative.

-Drejtori ja kalon këtë relacion Burimeve Njerëzore me shënimin përkatës për masën disiplinore që do aplokohet, të cilët konceptojnë shkresën “Vendim për dhenie mase disiplinore” duke bazuar në relacionin përkatës.

-Punonjësi i cili nuk ka qenë dakord me masën disiplinore, i drejtohet Drejtorit të SRD brenda pesë ditëve të marrjes të njoftimit, me një ankesë me shkrim, ku paraqet rrethanat apo arsyet e tij, mbi bazën e të cilave pretendon se masa e dhënë është e padrejtë.

-Drejtori i SRD arsyeton rrethanat e paraqitura në ankesë dhe merr vendim për rishikimin ose jo të masës disiplinore përkatëse.

2.Masat disiplinore të lëna detyrë/rekomandim nga kontrollet e institucioneve eprore hartohen dh jepen duke u bazuar në aktet e kontrollit përfundimtar, të cilat konceptohen nga Sektori Juridik.

Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka nuk ka komision apelimi.

Këto veprime bien në kundërshtim me:

-Pika 3, kreu 6, Udhëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetësore Publike në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.

-Pika 3, kreu VII, Udhëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Platformës Elektronike”, ku përcaktohet se “Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.

-Pika 3, kreu V, Udhëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, spitalet rajonale/bashkiake dhe NJVKSH”, ku përcaktohet se “Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës:

Nga grupi i auditimit konstatohet se në vitin 2019 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 68 punonjës dhe për vitin 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 79 punonjës, të cilat specifikohen në tabelën më poshtë:

Tabela nr.3 : Evidencat e ndërprerjes të marrëdhënieve të punës

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës	Mjekë	Infermierë	Specialistë /Punonjës administrate	Sanitarë	Laborantë / Oksigjenistë (viti 2020)	Receptionistë	Farmacistë	Punëtorë
Viti 2019	17	28	5	7	3	1	1	6
Viti 2020	18	28	12	10	4	0	2	5
Totali	35	56	17	17	7	1	3	11

Burimi i të dhënave: Sektori i Burimeve Njerzore, përpunoi grupi i auditimit.

Referuar të dhënave të më sipërme rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pjesën më të madhe të rasteve është me arsyen “dorëheqje”. Konkretisht nga numri total i të larguarve nga detyra në vitin 2019 (68 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 41% infermierë/laborantë dhe 25% mjekë. Kurse për vitin 2020 (79 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 31% infermierë/laborantë dhe 22% mjekë.

Po ashtu, referuar të dhënave për dhënien e masave disiplinore, nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2019 (75 masa disiplinore në total), 60% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 8% mjekëve. Për vitin 2020 (38 masa disiplinore në total) 18% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 10% i janë dhënë mjekëve.

Pra sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se për periudhën objekt auditimi, situata e krijuar në Spitalin Rajonal Durrës, për shkak të masave disiplinore të dhëna pa kriter dhe pa mundësi apelimi, mund të ndikojë në performancën e punës, në motivimin e punonjësve, dhe për më tepër të mjekëve dhe infermierëve të cilët përbëjnë 62% të stafit të larguar për periudhën objekt auditimi. Duke pasur parasysh dhe periudhën e pandemisë Covid – 19, ku nevoja për mjekë është jashtëzakonisht e rëndësishme, situata e krijuar në SRD, ndikon negativisht në plotësimin e nevojave emergjente për staf të specializuar në përmbushjen e detyrës funksionale të këtij spitali.

Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto. Pagesat neto të pagës, kryhen nëpërmjet sistemit bankar,

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për

mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Afatet e deklaramit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.4: Të dhëna përmbledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës periudha 01.06.2017 – 30.06.2020

Nr	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Fondi i pagave gjithësej	493,405,888	520,675,587	56,674,935
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	0	0	0
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	38292	36	0
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0	0	0
5	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shendetesore	82,048,236	80,595,688	7,927,678
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	0	0	0
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e personelit, përpunoi grupi i auditimit.

-Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi 01.01.2019 – 31.01.2021 (janar, mars, prill, korrik, gusht, tetor, nëntor, dhjetor 2019, shkurt, mars, qershor, gusht, shtator, tetor, dhjetor 2020 dhe janar 2021) nga të cilat rezulton se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme me llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni është penalizuar me gjobë për pagesë të vonuar në vlerën 38,292 lekë.

Përshkrimi i procedurave për orët jashtë kohës normale të punës:

Në çdo pavion/shërbim ka një mjek roje që punon 24 orë. Por ky mjek nuk është specifik për çdo problematikë që mund të ketë gjatë shërbimit 24 - orësh, kështu që gjatë këtij shërbimi mund të ketë pacientë të cilët mund të kenë nevojë për shërbim tjetër nuk i përket fushës së mjekut roje dhe për këtë ky mjek thërret mjekun specialist të fushës.

Për sa më sipër, kjo thirrje për mjekë paguhet në vlerën 600 leke sipas (VKM nr.555, datë 11.8.2011 pika c, ç), në masën 20% të pagës bruto.

Thirrjet për infermier paguhen në vlerën 300 lekë sipas (VKM nr.555, datë 11.8.2011 pika c, ç), në masën 20% të pagës bruto.

Sqarim: Infermieri kryen thirrje vetëm në rastet kur vjen bashkë me mjekun për ato pavione të cilat nuk bëjnë shërbim me mjek roje 24 – orësh (ORL, ORTOPEDI, etj).

Për vitin 2019 janë bërë thirrje për mjekët në vlerën 2,860,800 lekë dhe për infermierët në vlerën 488,100 lekë.

Për vitin 2020 janë bërë thirrje për mjekët në vlerën 2,843,400 lekë dhe për infermierët në vlerën 511,500 lekë.

Për muajin Janar 2021 janë bërë thirrje për mjekët në vlerën 256,200 lekë dhe për infermierët në vlerën 55,800 lekë.

a) Për çdo shërbim roje 24 orë pa ndërprerje në shërbimin e kirurgjisë:

Bazuar në VKM nr. 70, datë 15.02.2001, ndryshuar me VKM nr.448, datë 09.07.2004, pika 1 “...dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës ...”, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e

personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika1, 12/1, pagesa e mjekëve roje të sektorit të kirurgjisë bëhet si më poshtë:

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 24 orësh, kirurgjia, viti 2019:

Për mjekë roje kirurg i parë: -ditë e zakonshme 254 ditë x 6,000 lekë = 1,524,000 lekë,
-ditë e shtunë 52 ditë x 7,000 lekë = 364,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 59 ditë x 8,000 lekë = 472,000 lekë.

Për mjekë roje kirurg i dytë: -ditë e zakonshme 254 ditë x 5,600 lekë = 1,422,400 lekë,
-ditë e shtunë 52 ditë x 6,400 lekë = 332,800 lekë,
-ditë e dielë/festa 49 ditë x 7,600 lekë = 448,400 lekë.

Për mjekë roje kirurg i përgjithshëm: -ditë e zakonshme 2,089 ditë x 5,600 lekë = 11,698,400 lekë,
-ditë e shtunë 446 ditë x 6,000 lekë = 2,676,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 545 ditë x 7,000 lekë = 3,815,000 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **shërbimin 24 – orësh** është **22,753,000 lekë**.

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 24 orësh, kirurgjia, viti 2020:

Për mjekë roje kirurg i parë: -ditë e zakonshme 257 ditë x 6,000 lekë = 1,542,000 lekë,
-ditë e shtunë 51 ditë x 7,000 lekë = 357,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 58 ditë x 8,000 lekë = 464,000 lekë.

Për mjekë roje kirurg i dytë: -ditë e zakonshme 257 ditë x 5,600 lekë = 1,439,200 lekë,
-ditë e shtunë 51 ditë x 6,400 lekë = 326,400 lekë,
-ditë e dielë/festa 58 ditë x 7,600 lekë = 440,800 lekë.

Për mjekë roje kirurg i përgjithshëm: -ditë e zakonshme 2,213 ditë x 5,600 lekë = 12,392,800 lekë,
-ditë e shtunë 462 ditë x 6,000 lekë = 2,772,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 545 ditë x 7,000 lekë = 3,976,000 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **shërbimin 24 – orësh** është **23,710,200 lekë**.

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 24 orësh, kirurgjia, Janar 2021:

Për mjekë roje kirurg i parë: -ditë e zakonshme 15 ditë x 6,000 lekë = 90,000 lekë,
-ditë e shtunë 3 ditë x 7,000 lekë = 21,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 7 ditë x 8,000 lekë = 56,000 lekë.

Për mjekë roje kirurg i dytë: -ditë e zakonshme 19 ditë x 5,600 lekë = 106,400 lekë,
-ditë e shtunë 4 ditë x 6,400 lekë = 25,600 lekë,
-ditë e dielë/festa 8 ditë x 7,600 lekë = 60,800 lekë.

Për mjekë roje kirurg i përgjithshëm: -ditë e zakonshme 18 ditë x 5,600 lekë = 1,008,000 lekë,
-ditë e shtunë 8 ditë x 6,000 lekë = 228,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 60 ditë x 7,000 lekë = 420,000 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **shërbimin 24 – orësh** është **2,015,800 lekë**.

b) Shërbimi 12 – orësh në Spitalin Rajonal Durrës:

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 06, datë 19.03.2018 është miratuar sistemi i punës 12 –orë për shërbimin e Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës, dhe VKM nr. 555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësine Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika1, 12/1, si dhe 12/2, pika c “për punonjësit e infermieristikës”, pagesa e mjekëve dhe infermierëve në shërbimin e urgjencës, bëhet si më poshtë:

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 12 – orësh në shërbimin e urgjencës, viti 2019:

Për mjekë urgjence: -ditë e zakonshme 1,250 ditë x 1,800 lekë = 2,250,000 lekë,
-ditë e shtunë 260 ditë x 2,000 lekë = 520,000 lekë,
-ditë e dielë/festa 311 ditë x 2,300 lekë = 715,300 lekë.

Për infermierë roje urgjence: -ditë e zakonshme 4,115 ditë x 1,100 lekë = 4,526,500 lekë,
-ditë e shtunë 911 ditë x 1,400 lekë = 1,275,400 lekë,
-ditë e dielë/festa 1,059 ditë x 1,700 lekë = 1,800,300 lekë.

Për shoferët: -ditë e zakonshme 2,343 ditë x 1,880 lekë = 4,404,840 lekë,
-ditë e shtunë 497 ditë x 2,350 lekë = 1,167,950 lekë,

-ditë e dielë/festa 618 ditë x 3,055 lekë = 1,887,990 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **orë shtesë** është **18,406,860 lekë**.

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 12 – orësh në shërbimin e urgjencës, viti 2020:

Për mjekë urgjence: -ditë e zakonshme 1,099 ditë x 1,800 lekë = 1,978,200 lekë,

-ditë e shtunë 235 ditë x 2,000 lekë = 470,000 lekë,

-ditë e dielë/festa 299 ditë x 2,300 lekë = 687,700 lekë.

Për infermierë roje urgjence: -ditë e zakonshme 4,332 ditë x 1,100 lekë = 4,765,200 lekë,

-ditë e shtunë 1,363 ditë x 1,400 lekë = 1,908,200 lekë,

-ditë e dielë/festa 717 ditë x 1,700 lekë = 1,218,900 lekë.

Për shoferët: -ditë e zakonshme 2,163 ditë x 1,880 lekë = 4,066,440 lekë,

-ditë e shtunë 441 ditë x 2,350 lekë = 1,036,350 lekë,

-ditë e dielë/festa 616 ditë x 3,055 lekë = 1,881,880 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **orët shtesë** është **24,089,095 lekë**.

Sa më sipër janë kryer pagesa për shërbimin 12 – orësh në shërbimin e urgjencës, Janar 2021:

Për mjekë urgjence: -ditë e zakonshme 97 ditë x 1,800 lekë = 174,600 lekë,

-ditë e shtunë 25 ditë x 2,000 lekë = 46,000 lekë,

-ditë e dielë/festa 29 ditë x 2,300 lekë = 66,700 lekë.

Për infermierë roje urgjence: -ditë e zakonshme 342 ditë x 1,100 lekë = 376,200 lekë,

-ditë e shtunë 87 ditë x 1,400 lekë = 121,800 lekë,

-ditë e dielë/festa 102 ditë x 1,700 lekë = 173,400 lekë.

Për shoferët: -ditë e zakonshme 165 ditë x 1,880 lekë = 310,200 lekë,

-ditë e shtunë 33 ditë x 2,350 lekë = 77,550 lekë,

-ditë e dielë/festa 55 ditë x 3,055 lekë = 168,625 lekë.

Vlera **totale** e orëve shtesë lidhur me **orët shtesë** është **1,230,825 lekë**.

-Nga kontratat e lidhura me FSDKSH rezulton se në asnjë nga nenet nuk përcaktohet fakti se shërbimi i kirurgjisë trajtohet si spital universitar. Nga grupi i auditimit është bërë përlllogaritja e vlerës që do të paguhej nëse mjekët e shërbimit të kirurgjisë do të paguheshin si pavijonet e tjera, vlerë e cila rezulton të jetë **8,563,800 lekë**. Referuar këtij fakti rezulton vlera e paguar shtesë prej **929,000 lekësh**. Po ashtu, dhe niveli i pagesës të mjekëve në këtë spital trajtohet si në spitalet universitare. Kjo vlerë u rillogarit pas të dhënave shtesë të ardhura nga observacionet.

- Nga grupi i auditimit është konstatuar se stafi i këtij spitali është i paqartë lidhur me shërbimin 24 – orësh pa ndërprerje të mjekëve të këtij pavijoni, duke bërë kështu që këto pagesa të kryhen në kushtet e pasigurisë dhe të pa qartësisë lidhur me statusin e pavijonit në fjalë.

-Me vendimin e Bordit Drejtues nr.21, datë 09.06.2011 është caktuar pagesa e shoferëve me sistemin e shërbimit 12 – orësh, me qëllim motivimin e këtij stafi. Ky vendim bie në kundërshtim me VKM nr.555, datë 11.08.2011, duke qenë se kjo VKM nuk e parashikon një dispozitë tillë. Po ashtu, bie në kundërshtim me Kodin e Punës neni 80 “Puna e natës”, pika 1 dhe 2, dhe neni 81 “Shtesa mbi Pagë”, pika 1 dhe 2.

Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej **15,001,225 lekë** përbën **efekt negativ** për buxhetin e Spitalit Rajonal të Durrësit.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve përdoret sipas nevojave të cilat dalin në pah në varësi të nevojave të ndryshme në periudhën objekt auditimi.

Tabela nr.5: Të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë periudha 01.06.2019 – 31.01.2021

Nr	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Janar 2021
1	Fondi i veçantë	0	0	0
2	Shpërblime për rezultate në punë	0	0	0
3	Shpërblime për fund viti	0	0	0
4	Shpërblime sëmundje	30,000	50,000	0
5	Për largime nga puna	0	0	0
6	Për raste fatkeqësie/lindjeje	130,000	359,120	0

7	Për dalje në pension	1,238,616	1,141,110	41,505
---	----------------------	-----------	-----------	--------

Burimi i të dhënave: Drejtoria e personelit, përpunoi grupi i auditimit.

Ky fond është përdorur në vlerën 2,990,351 lekë, për shpërblime për raste shpërblime në fund të vitit, largime nga puna, fatkeqësie/lindjeje dhe për dalje në pension.

Sipas VKM nr.717, datë 23.06.2009 të ndryshuar, 18/1, shoferët e urgjencës të spitaleve për natyrën e veçantë të punës përfitojnë një shtesë në masën 10,000 lekë në muaj, vlerë e cila shkon në total **4,873,636 lekë**.

Proceset Gjyqësore për Ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 8 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,466,291 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për vitin 2019 janë humbur 5 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerë **5,652,881 lekë**, dhe për vitin 2020 janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerën **2,818,410**. Këto çështje janë dërguar për rekurs në Gjykatën e Shkallës të Lartë në Tiranë.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **8,466,291 lekë** e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi znj. N. J. në cilësinë e Drejtuesit, znj. B. Ç. në cilësinë e përgjegjëses të sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. V. Gj. në cilësinë të përgjegjëses të sektorit Juridik, znj. I. V. në cilësinë të përgjegjëses të sektorit të Financës.

Sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 9, datë 30.04.2021

2.3.1 Titulli i Gjetjes: Ndryshimet e shpeshta në strukturën organizative të Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: Për sa i përket respektimit të strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës konstatohet se për periudhën objekt auditimi, struktura është ndryshuar nga Bordi Drejtues i Spitalit, dymbëdhjetë herë. Këto ndryshime konsistojnë në lëvizjet e pozicioneve të punonjësve të spitalit, si në administratë dhe në stafin mjekësor. Këto ndryshime tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar, duke krijuar kështu pasiguri dhe performancë të ulët lidhur me pozicionet e punës.

Ndikimi/Efekti: Ndryshimet e shpeshta tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar, duke krijuar kështu pasiguri dhe performancë të ulët lidhur me pozicionet e punës.

Shkaku: Vendimet e pa analizuara të Bordit Drejtues për ndryshimet në strukturën organizative.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2.3.1: Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit analizojnë situatën e krijuar për shkak të ndryshimeve të shpeshta dhe të marrin masa lidhur me konsolidimin dhe unifikimin e strukturës të spitalit.

Afati: Menjëherë.

3.3.2 Titulli i Gjetjes: Tejkalmimi i fondit të pagave dhe mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve.

Situata: Në vitin 2019, numri mesatar faktik i punonjësve në SRD ka qenë 656 punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat ka rezultuar në vlerën 493,405,888 lekë.

Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 655 punonjës. Fondi i pagave i planifikuar është 493,014,000 lekë, pra **391,888 lekë** më shumë se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të

vitit 2018 është realizuar 648.8 punonjës. Fondi i pagave është 508,000,000 lekë, kurse realizimi është 491,796,305, pra 16,203,695 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në **Janar 2021** është realizuar 669 punonjës. Fondi i pagave është 53,475,000 lekë, kurse realizimi është 47,833,915 lekë, pra 5,641,085 lekë më pak se programi.

-Lidhur me nivelin e pagave, nga grupi i auditimit konstatohet se për **vitin 2019**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 58,692 lekë/punonjës, kurse fakti është 61,599 lekë/ punonjës, pra **tejkallim** në vlerën **2,907 lekë/punonjës**.

-Për **vitin 2020**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 60,476 lekë/punonjës, kurse fakti është 63,167 lekë, pra ka **tejkallim** në vlerën **2,691 lekë/ punonjës**.

-Për **muajin Janar 2021**, parashikimi i nivelit të pagave është mesatarisht 76,393 lekë/punonjës, kurse fakti është mesatarisht 71,500 lekë, pra ka **mos realizim** në vlerën **4,893 lekë/ punonjës**.

Sa më sipër tejkallimi i fondit të parashikuar të pagave për vitin 2019 përbenë efekt **financiar negativ** në vlerën **391,888 lekë**.

Kriteri: Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2019, 2020 dhe Janar 2021.

Ndikimi/Efekti: Tejkallimi i fondit të parashikuar të pagave shkakton efekt financiar negativ për spitalin dhe mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën e tij.

Shkak: Tejkallimi i fondit të pagave dhe numri i punonjësve të shoqërisë është më i ulët se parashikimet e programit dhe për pasojë sjell mos plotësimin e nevojave të saj.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2.3.2.1 Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për analizimin e vlerës të efektit financiar negativ në vlerën **391,888 lekë** dhe për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Afati: Në vazhdimësi.

3.3.3 Titulli i Gjetjes: Dhënia e masave disiplinore pa kriter.

Situata: -Nga grupi i auditimit konstatohet se nga Spitali Rajonal Durrës, janë dhënë 75 vërejtje gjatë vitit 2019 dhe 38 vërejtje gjatë vitit 2020. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se këto procedura nuk janë transparente, dhe nuk ka komision apelimi për dhënien e masave disiplinore.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se në Spitalin Rajonal Durrës, për vitin 2019 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 68 punonjës dhe për vitin 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 79 punonjës.

-Referuar të dhënave të më sipërme rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pjesën më të madhe të rasteve është me arsyen “dorëheqje”. Konkretisht nga numri total i të larguarve nga detyra në vitin 2019 (68 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 41% infermierë/laborantë dhe 25% mjekë. Kurse për vitin 2020 (79 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 31% infermierë/laborantë dhe 22% mjekë.

Po ashtu, referuar të dhënave për dhënien e masave disiplinore, nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2019 (75 masa disiplinore në total), 60% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 8% mjekëve. Për vitin 2020 (38 masa disiplinore në total) 18% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 10% i janë dhënë mjekëve.

-Pra sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se për periudhën objekt auditimi, situata e krijuar në Spitalin Rajonal Durrës, për shkak të masave disiplinore të dhëna pa kriter dhe pa mundësi apelimi, mund të ndikojë në performancën e punës, në motivimin e punonjësve, dhe për më tepër të mjekëve dhe infermierëve të cilët përbëjnë 62% të stafit të larguar për periudhën objekt auditimi. Duke pasur parasysh dhe periudhën e pandemisë Covid – 19, ku nevoja për mjekë është jashtëzakonisht e rëndësishme, situata e krijuar në SRD, ndikon negativisht në plotësimin e nevojave emergjente për staf të specializuar në përmbushjen e detyrës funksionale të këtij spitali.

-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 158 dosje personeli me

përzgjedhje rastësore, nga 662 punonjës që ka Spitali Rajonal Durrës, pra 23 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërsëritur, Dëshmia e Penalitetit mungon në pjesën më të madhe të rasteve, mungon raporti mjeko ligjor, vërtetimi nga gjykata mungon në 20 raste, vërtetimi nga prokuroria mungon në 25 raste.

-Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi 01.01.2019 – 31.01.2021 (janar, mars, prill, korrik, gusht, tetor, nëntor, dhjetor 2019, shkurt, mars, qershor, gusht, shtator, tetor, dhjetor 2020 dhe janar 2021) nga të cilat rezulton se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme me llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni është penalizuar me gjobë për pagesë të vonuar në vlerën 38,292 lekë lidhur me detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale.

Kriteri: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 37.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i procedurave të dhënies masave disiplinore sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi dhënien e masave disiplinore duke ndikuar në performancën dhe motivimin e punonjësve të spitalit. Parregullsitë në plotësimin e dosjeve të personelit sjell parregullsi procedurale. Vonesat në shlyerjen e detyrimeve pranë organeve tatimore shkaktojnë gjoba dhe penalitete.

Shkaku: Mos zbatimi i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” dhe mangësitë në zbatimin e dhënies të masave disiplinore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2.3.3.1: Drejtorja e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e masave disiplinore në këtë spital.

Rekomandimi 2.3.3.2: Sektori i Burimeve Njerëzore të marri masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Afati: Në vijimësi.

3.3.4. Titulli i gjetjes: Pagesat e mjekëve të shërbimit të kirurgjisë si pjesë e një spitali universitar.

Situata: Bazuar në VKM nr. 70, datë 15.02.2001, ndryshuar me VKM nr.448, datë 09.07.2004, pika 1 “...dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës ...”, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika1, 12/1, shërbimi i kirurgjikal i Spitalit Rajonal të Durrësit trajtohet si pjesë e një spitali universitar.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të parë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,000 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 8,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 7,000 lekësh të spitaleve rajonale.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të dytë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 5,600 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,200 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,600 lekësh të spitaleve rajonale.

-Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, duke u bazuar në VKM – të e sipërpërmendura, për mjekët e Shërbimit të Kardiologjisë në Spitalin Rajonal Durrës, për çdo shërbim roje 24 orë pa ndërprerje, pagesat janë kryer duke e konsideruar këtë pavijon si qendër spitalore universitare, në vlerën **9,492,800 lekë**.

-Nga kontratat e lidhura me FSDKSH rezulton se në asnjë nga nenet nuk përcaktohet fakti se shërbimi i kirurgjisë trajtohet si spital universitar. Nga grupi i auditimit është bërë përlllogaritja e vlerës që do të paguhej nëse mjekët e shërbimit të kirurgjisë do të paguheshin si pavijonet e tjera, vlerë e cila rezulton të jetë **8,563,800 lekë**. Referuar këtij fakti rezulton vlera e paguar shtesë prej **929,000 lekësh**. Po ashtu, dhe niveli i pagesës të mjekëve në këtë spital trajtohet si në spitalet universitare.

- Nga grupi i auditimit është konstatuar se stafi i këtij spitali është i paqartë lidhur me shërbimin 24 – orësh pa ndërprerje të mjekëve të këtij pavijoni, duke bërë kështu që këto pagesa të kryhen në kushtet e pasigurisë dhe të pa qartësisë lidhur me statusin e pavijonit në fjalë.

Kriteri: VKM nr. 70, datë 15.02.2001, ndryshuar me VKM nr.448, datë 09.07.2004, pika 1 “...dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës ...”.

Ndikimi/Efekti: Pagesa e mjekëve të shërbimit të kirurgjisë si pjesë e një spitali universitar, i ka kushtuar Spitalit Rajonal Durrës kosto shtesë në vlerën **929,000 lekë**.

Shkaku: Paqartësia e stafit të Spitalit Rajonal Durrës lidhur me statusin e pavijonit të shërbimit të kirurgjisë.

Rekomandimi 2.3.4.1: Spitali Rajonal i Durrësit në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe FSDKSH – në të marrin masa për sqarimin e statusit të shërbimit kirurgjikal në këtë spital dhe për përcaktimin e saktë të nivelit të pagave mjekëve të shërbimit kirurgjikal.

Afati: Menjëherë.

3.3.5 Titulli i gjetjes: Pagesat e shoferëve për sistemin 12 – orësh në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 555, datë 11.08.2011.

Situata: Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 06, datë 19.03.2018 është miratuar sistemi i punës 12 –orë për shërbimin e Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika1, 12/1, si dhe 12/2, pika c “për punonjësit e infermieristikës”.

Nga auditimi u konstatua se duke u bazuar nga VKM nr.555, datë 11.08.2011, Bordi Drejtues me vendimin e nr.21, datë 09.06.2011 ka caktuar pagesën e shoferëve me sistemin e shërbimit 12 – orësh, me qëllim motivimin e këtij stafi, konkretisht për ditë të zakonshme 1,880 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,350 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 3,055 lekë/ditë shërbimi. Kjo vlerë është më e lartë krahasuar me përcaktimet e VKM nr.555, datë 11.08.2011 lidhur me pagesat e mjekëve të urgjencës dhe infermierët, të cilët për të njëjtin shërbim paguhën si më poshtë:

-Mjek urgjence: për ditë të zakonshme 1,800 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,000 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 2,300 lekë/ditë shërbimi,

-Infermierë roje urgjence: për ditë të zakonshme 1,100 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 1,400 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 1,700 lekë/ditë shërbimi.

Pra vendimi i Bordit nuk është i mirë menduar dhe i kategorizuar sipas niveleve të pagave e kriterëve përkatëse, dhe bie në kundërshtim me përcaktimet në pikën 1 dhe 2, neni 80 “*Shtesa mbi Pagë*” i Kodit të Punës, në të cilin citohet se: “1. Me punë nate kuptohet puna e kryer nga ora 22⁰⁰ deri në orën 6⁰⁰ të mëngjesit: 2. Kohëzgjatja e punës së natës dhe e punës së kryer një ditë para ose pas saj nuk duhet të jetë më shumë se tetë orë pa ndërprerje. Ato duhet të paraprihen ose pasohen me pushim ditor të menjëhershëm” dhe neni 80 “*Puna e natës*” i Kodit të Punës “1. Çdo orë pune e kryer nga ora 19⁰⁰ deri në 22⁰⁰ jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20%, dhe 2. Çdo orë pune e kryer midis intervalit 22⁰⁰ dhe 6⁰⁰ jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”.

Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej **15,001,225 lekë** përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Spitalit Rajonal të Durrësit.

Kriteri: VKM nr. 555, datë 11.08.2011, pika 1 dhe 2, neni 80 “*Puna e natës*” dhe pika 1 dhe 2,

dhe neni 81 “Shtesa mbi Pagë”, Kodi i Punës.

Ndikimi/Efekti: Vendimi i Bordit Drejtues në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit të Punës dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 i ka shkaktuar Spitalit Rajonal Durrës efekt financiar negativ në vlerën **15,001,225 lekë**.

Shkaku: Mos zbatimi i VKM-së nr. 555, datë 11.08.2011 dhe pika 1 dhe 2, dhe neni 81 “Shtesa mbi Pagë”, pika 1 dhe 2, neni 80 “Puna e natës” Kodi i Punës ka sjellë si pasojë efektin financiar negativ në buxhetin e spitalit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2.3.5.1: Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojë efektin financiar negativ prej **15,001,225 lekësh** dhe të marrë masa për korrigjimin e pagesave të shoferëve për orët shtesë sipas turneve dhe ditëve përkatëse.

Afati: Menjëherë.

3.3.6 Titulli i gjetjes: Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës.

Situata: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 8 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,466,291 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për vitin 2019 janë humbur 5 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerë **5,652,881 lekë**, dhe për vitin 2020 janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerën **2,818,410**. Këto çështje janë dërguar për rekurs në Gjykatën e Shkallës të Lartë në Tiranë.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **8,466,291 lekë** e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.

Ndikimi/Efekti: Efekt financiar negativ në shumën prej 8,466,291 lekë.

Shkaku: Mos zbatimi i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve, të Spitalit Rajonal Durrës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2.3.6.1: Nga Drejtori, sektori Juridik dhe sektori i Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Afati: Menjëherë.

- Observacionet

Në përgjigje të akt-konstatimit nr. 09 datë 30.04.2021 të grupit të auditimit është paraqitur observacioni nga znj. V. Gj. protokolluar në KLSH me nr. 132/7 datë 27.09.2021, dhe marrë në dorëzim nga Grupi i Auditimit në datë 01.10.2021, me pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1) *Vendimet e marra nga titullarët e spitalit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, janë marrë në periudha të ndryshme kohore dhe nga titullarë të ndryshëm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, nuk merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin me argumentet si vijon:

1) *Grupi i auditimit i ka lënë përgjegjësitë referuar periudhës objekt auditimi, dhe përgjegjësia juaj ka lidhje me ndjekjen e çështjeve në Gjykatat Përkatëse. **Observacioni juaj është jashtë kontekstit.***

- Observacionet

Në përgjigje të akt-konstatimit nr. 09 datë 30.04.2021 të grupit të auditimit është paraqitur observacioni nga znj. N. J. protokolluar në KLSH me nr. 132/7 datë 27.09.2021, dhe marrë në dorëzim nga Grupi i Auditimit në datë 01.10.2021, me pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

- 1) Për vitin 2019 ,masat disiplinore kanë qenë 75, dhe në një kolektiv me 700 punonjës, mos të këshillohen punonjësit dhe një pjese tjetër mos ti jepen vërejtje, nuk përben sens, atëherë KLSH, nuk do të kishte nxjerrë asnjë të metë në punën tonë, ose nuk mund të na japi vërejtje, për të mos cënuar integriteti ynë, dhe për të mos u bërë shkak i largimeve tona nga puna.
- 2) Nuk është e vërtetë që punonjësit nuk kanë patur ku të ankohen, sepse SRD është organ i varësisë nga DROSHKSH, të cilit si organ epror mund ti drejtohet çdo punonjës me ankesën e tij. Askush nuk ka bërë ankesë në Gjykatën Administrative, si e sanksionon ligji.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, nuk merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin me argumentet si vijon:

- 1) Dhënia e masave disiplinore pa kriter dhe pa patur një Komision Apelimi krijon një ambient jo të sigurt dhe ndikon në performancën e punonjësve. Masa disiplinore “Këshillim” është dhënë me shkrim, dhe është arkivuar për çdo rast në dosjet personale të punonjësve të Spitalit Rajonal Durrës. Në asnjë rast, KLSH, nuk ju ka adresuar rekomandimin që të mos jepen masa disiplinore të secilës kategori. Ajo që ne si grup auditimi rekomandojmë, është ndjekja e procedurave transparente dhe të mirë argumentuara në dhënien e masave disiplinore. **Observacioni juaj është jashtë kontekstit.**
- 2) Kontrolli i Lartë i Shtetit kryen auditim përputhshmërie dhe adreson problematikat e institucionit nëse janë ose jo në përputhje me ligjin. Problematika të cilës ju i jeni referuar është një problematikë e cila i drejtohet Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë të Spitalit Rajonal Durrës. Burimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë përherë dokumentat të cilat ju na i paraqisni bazuar në kërkesat tona, referuar Programit të Auditimit dhe e – mailët zyrtare përmes të cilave ju na dërgoni informacionin dhe dokumentacionin përkatës. Konkretisht informacioni ka ardhur me e – mail në datën 18.03.2021 nga ana juaj,ku nuk citohet në asnjë rast se në Spitalin Rajonal Durrës ka Komision Apelimi. Në dokumentacionin e administruar nga grupi i auditimit është konstatuar se nuk ka asnjë dokument që provon ngritjen e Komisionit të Apelitimit. Sa i takon Gjykatës Administrative, ky fakt është argument që SRD nuk ka ngritur Komision Apelimi. Observacioni nuk merret në konsideratë.

3.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe Shpenzimeve administrative, të Spitalit Rajonal Durrës.

2.4.1. Titulli i gjetjes: Nga SRD nuk është kryer një planifikim i saktë, ku t’i referohej kërkesave reale buxhetore.

Situata: Nga auditimi i procesit të programimit të buxhetit nga ana e SRD në shpenzimet korrente, fillimisht në PBA planifikohet në nivele të përafërta me vitin ushtrimor paraardhës konkretisht për vitin 2020 në vlerën 1,282,250 mijë lekë ose në vlerën 79,737 mijë lekë më shumë se vitin 2019 planifikuar në vlerën 1,202,513 mijë lekë. Ndërkohë që plani përfundimtar pas shtesave, pakësimeve dhe rialokimeve shkon për vitin 2019 në vlerën 903,656 mijë lekë realizuar në masën 100%, për vitin 2020 në vlerën 1,004,515 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 972,385 ose në masën 96.8%.

- Për vitin 2020 konstatohen nivele të ulta në realizimin e llogarive konkretisht, 600 “Paga personeli” në masën 98.7% ose ka mosrealizim në vlerën 6,734 mijë lekë, 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në masën 95.96% ose ka mosrealizim në vlerën 3,398 mijë lekë dhe 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në masën 94.46% ose ka mosrealizim në vlerën 22,000 mijë lekë. Nga analiza e artikujve buxhetor konstatohen diferenca ndërmjet planifikimit përfundimtar dhe realizimit faktik referuar veprime të kryera me bankë sipas shpenzimeve për

llogaritë 600, 601 dhe 602 në nivel 7-shifror.

- Për vitet 2019 dhe 2020 në disa zëra të artikujve buxhetor kryesisht paga personeli (raporte mjekësore, shtesë turne të dyta, shtesa page, shtesë pune jashtë orarit, shpërblime) mallra dhe shërbime të tjera (pagesa të energjisë, shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna) konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin përfundimtar të buxhetit. Ndërkohë në disa zëra të llogarive buxhetore paga personeli (shpërblime, paga të personelit të përkohshëm) mallra dhe shërbime të tjera (materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme, materiale dhe shërbime special, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale) konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit buxhetor. Në të dy rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh në këto grup llogarish në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim buxhetor.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontrata “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitin 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Objektiva të politikës së programit buxhetor” janë rezultatet specifike të matura saktësisht në kohë, sasi dhe kosto, të cilat realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme dhe që përbëjnë hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës së programit buxhetor”; “Të zbatohet buxheti sipas fondeve të planifikuara, duke mos lejuar tejkalime jashtë fondeve të miratuara”.

Shkaku: Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për SRD.

Ndikimi/Efekti: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme.

2.4.1.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që në raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi në vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.

2.4.1.2. Rekomandimi: Nga ana e SRD të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

2.4.1.3. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të eliminojnë planifikimet formale, dhe të kryejnë parashikime të besueshme, duke kryer analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatëse për këtë qëllim, me qëllimin e eliminimit të ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Sektori i Financës sipas periudhave respektive.

2.4.2. Titulli i gjetjes: Parregullsi në formatet për raportimin e të ardhurave dytësore.

Situata: Me shkresën nr. 107 prot., datë 14.01.2020, dhe shkresën 97 prot., datë 15.01.2021, SRD ka raportuar pranë FSDKSH realizimin e buxhetit për vitet 2019 dhe 2020. Nga auditimi konstatohet se, në këto raporte nuk është raportuar pasqyra e të ardhurave dytësore sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit.

Kriteri: Kontrata “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitin 2019 dhe 2020 miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 13, pika 6, neni 14, pika 6, aneksi 2, pasqyra 12, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Spitali

raporton të dhënat teknike, mjekësore dhe financiare sipas pasqyrave në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, ku janë përcaktuar dhe afatet”.

Shkaku: Nuk janë implementuar dispozitat ligjore përkatëse.

Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt.

Rëndësia: E ulët.

2.4.2.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa në mënyrë që raportimi i të ardhurave dytësore të bëhet sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit, referuar përcaktimeve në kontratën dypalëshe midis Spitalit dhe FSDKSH.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Sektori i Financës sipas periudhave respektive.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

VITI 2019

- Me vendimin nr. 25, datë 20.06.2018, Bordi Drejtues i SRD ka miratuar Projekt-Buxhetin për vitet 2019-2021, dërguar pranë MSHMS me shkresën nr. 1438/9 prot., datë 20.06.2018, dhe FSDKSH me shkresën nr. 1438/10 prot., datë 20.06.2018.

- Me vendimin nr. 6, datë 06.02.2019, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar buxhetin për vitin 2019 në vlerën 860,000 mijë lekë sipas llogarive 600, 601 dhe 602, dërguar pranë SRD me shkresën nr. 933 prot., datë 12.02.2019.

- Me vendimin nr. 25, datë 19.07.2019, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë buxheti për vitin 2019, në vlerën 15,188 mijë lekë sipas shkresës nr. 4001 prot., datë 31.07.2019, për llogarinë 600 “Paga personeli” në vlerën 13,014 mijë lekë dhe 601 “Kontribute për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore” në vlerën 2,174 mijë lekë.

- Me vendimin nr. 28, datë 31.10.2019, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë buxheti për vitin 2019, në vlerën 10,000 mijë lekë sipas shkresës nr. 6766 prot., datë 20.11.2019, për llogarinë 600 “Paga personeli” në vlerën 7,000 mijë lekë dhe 601 “Kontribute për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore” në vlerën 3,000 mijë lekë.

- Me vendimin nr. 20, datë 19.12.2019, Bordi Drejtues i SRD ka miratuar rialokimin e buxhetit sipas shkresës nr. 2281 prot., datë 19.12.2019.

- Me shkresën nr. 107 prot., datë 14.01.2020, SRD ka dërguar pranë FSDKSH realizimin e buxhetit për vitin 2019.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur:

000/lekë				
Llogaria	Përshkrimi	Fonde të miratuara + shtesa dhe rialokime	Realizimi i buxhetit	Realizimi në %
600	Paga e Shtesa	493,014	493,013	100%
601	Kontribut të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	82,174	82,173	100%
602	Mallra e shërbime	328,469	328,469	100%
Total 600+601+602		903,657	903,655	100%
231	Investimet	73,517	71,589	97.38%
Totali 600+601+602+231		977,174	975,244	99%

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

Të ardhurat dytësore si dhe realizimi i tyre sipas shpërndarjes në llogaritë respektive buxhetore.

000/lekë						
Llogaria	Përshkrimi	Të trashëguara nga viti paraardhës	Të ardhura dytësore të realizuara	Totali të trashëguara + rialokime	Realizimi i të ardhurave dytësore sipas shpërndarjes në llogaritë respektive	Realizimi në %
600	Paga e Shtesa	-	-	-	1,876	
601	Kontribut të sigurimeve shoqërore e shëndetësor	-	-	-	376	
602	Mallra e shërbime	-	50,990	50,990	37,349	
Të trashëguara nga viti paraardhës		16,138	-	16,138	-	
231	Investimet	-	-	-	22,177	
Total 600+601+602+231		16,138	50,993	67,128	61,778	92%

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

□ **Shpenzimet administrative në total nga buxheti i FSDKSH**, planifikuar sipas planit përfundimtar në vlerën 903,656 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 903,655 mijë lekë ose realizuar në masën 100% konkretisht:

- 600 “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” planifikuar në vlerën 493,014 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 493,013 mijë lekë, ose realizuar në masën 100%.

- 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” planifikuar në vlerën 82,174 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 82,173 mijë lekë, ose realizuar në masën 100%.

- 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” planifikuar në vlerën 328,468 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 328,469 mijë lekë, ose realizuar në masën 100%.

□ **Investimet nga buxheti i MSHMS**, planifikuar në vlerën 73,517 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 71,589 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 1,928 mijë lekë ose realizuar në masën 97.37%.

- Në disa zëra të llogarive buxhetore kryesisht paga personeli (raporte mjekësore, shtesë turne të dyta, shtesa page, shtesë pune jashtë orarit) mallra dhe shërbime të tjera (pagesa të energjisë, shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna) konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin e buxhetit si më poshtë:

- 6001 “Paga të personelit të përhershëm” planifikuar në vlerën 486,743 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 491,888 mijë lekë, ose angazhim më i madh në vlerën 5,145 mijë lekë ose realizuar në masën 101.06%.

- 6022 “Shërbime nga të tretët” planifikuar në vlerën 60,464 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 70,443 mijë lekë, ose angazhim më i madh në vlerën 9,979 mijë lekë ose realizuar në masën 116.51%.

- 6029 “Shpenzime të tjera operative” planifikuar në vlerën 3,238 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 7,436 mijë lekë, ose angazhim më i madh në vlerën 4,198 mijë lekë ose realizuar në masën 229.67%.

□ **Realizimi i buxhetit në total sipas fondeve të miratuara nga FSDKSH dhe MSHMS**, planifikuar sipas planit përfundimtar në vlerën 977,174 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 975,245 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 1,929 mijë lekë ose realizuar në masën 99.80%.

□ **Shpenzimet nga të ardhurat dytësore**, planifikuar në vlerën 78,138 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 61,778 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 16,778 mijë lekë ose realizuar në masën 79.06%.

Të ardhurat dytësore në vlerën 67,129 mijë lekë (50,990 mijë të arkëtuara + 16,138 mijë lekë të trashëguara) dhe realizuar në vlerën 61,778 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 5,351 mijë lekë ose realizuar në masën 92.03%.

Drejtimit kryesorë për shpenzimin e këtyre fondeve:

- 600 “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” planifikuar në vlerën 2,582 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,876 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 706 mijë lekë ose realizuar në masën 72.66%.

- 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” planifikuar në vlerën 517 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 376 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 141 mijë lekë ose realizuar në masën 72.66%.

- 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” planifikuar në vlerën 49,497 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 37,349 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 12,148 mijë lekë ose realizuar në masën 75.46%.

- 231 “Investimet” planifikuar në vlerën 25,541 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 22,177 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 3,364 mijë lekë ose realizuar në masën 79.06%.

VITI 2020

Projekt-Buxheti për vitet 2020-2022, është dërguar pranë MSHMS me shkresën nr. 1122/7 prot., datë 20.06.2019, dhe FSDKSH me shkresën nr. 1300/1 prot., datë 09.07.2019.

Me vendimin nr. 1, datë 06.02.2020, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar buxhetin për vitin 2020 në vlerën 961,000 mijë lekë, sipas llogarive 600, 601 dhe 602 dërguar pranë SRD me shkresën nr. 1479 prot., datë 18.02.2020.

- Me vendimin nr. 4, datë 26.02.2020, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë buxheti për vitin 2020, në vlerën 3,000 mijë lekë sipas shkresës 1802 prot., datë 27.02.2020, për

llogarinë 602 “Mallra e shërbime” në vlerën 3,000 mijë lekë.

- Me vendimin nr. 9, datë 28.07.2020, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë buxheti për vitin 2020, në vlerën 12,415 mijë lekë sipas shkresës nr. 4954 prot., datë 03.08.2020, për llogarinë 600 “Paga personeli” në vlerën 4,415 mijë lekë dhe 602 “Mallra e shërbime” në vlerën 8,000 mijë lekë.

- Me vendimin nr. 15, datë 31.10.2020, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë dhe pakësim buxheti për vitin 2020, në vlerën totale 8,100 mijë lekë sipas shkresës nr. 8123/35 prot., datë 16.11.2020, konkretisht shtesë për llogarinë 600 “Paga personeli” në vlerën 9,000 mijë lekë dhe pakësim për llogarinë 601 “Kontribute për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore” në vlerën 900 mijë lekë.

- Me vendimin nr. 24, datë 21.12.2020, Këshilli Administrativ i FSDKSH ka miratuar shtesë buxheti për vitin 2020, në vlerën 20,000 mijë lekë sipas shkresës nr. 8936/10 prot., datë 24.12.2020, për llogarinë 602 “Mallra e shërbime” në vlerën 20,000 mijë lekë.

Me vendimin nr. 21, datë 30.12.2020, Bordi Drejtues i SRD ka miratuar rialokimin e buxhetit sipas shkresës nr. 2300 prot., datë 30.12.2020.

Me shkresën nr. 97 prot., datë 15.01.2021, SRD ka dërguar pranë FSDKSH realizimin e buxhetit për vitin 2020.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur:

000/lekë				
Llogaria	Përshkrimi	Fonde të miratuara + shtesa dhe rialokime	Realizimi i buxhetit	Realizimi në %
600	Paga e Shtesa	523,415	516,681	98.71%
601	Kontribut të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	84,100	80,702	95.96%
602	Mallra e shërbime	397,000	375,000	94.46%
Total 600+601+602		1,004,515	972,383	96.8%
231	Investimet	194,942	182,487	93.61%
Totali 600+601+602+231		1,199,457	1,154,870	96.2%

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

Të ardhurat dytësore si dhe realizimi i tyre sipas shpërndarjes në llogaritë respektive buxhetore.

000/lekë						
Llogaria	Përshkrimi	Të trashëguara nga viti paraardhës	Të ardhura dytësore të realizuara	Totali të trashëguara + rialokime	Realizimi i të ardhurave dytësore sipas shpërndarjes në llogaritë respektive	Realizimi në %
600	Paga e Shtesa	-	-	-	1,708	
601	Kontribut të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	-	-	-	342	
602	Mallra e shërbime	-	46,088	46,088	45,137	
Të trashëguara nga viti paraardhës		5,357	-	5,357	-	
231	Investimet	-	-	-	2,097	
Total 600+601+602+231		5,357	46,088	51,445	49,286	95.8%

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

Shpenzime administrative në total nga buxheti i miratuar nga FSDKSH, planifikuar sipas planit përfundimtar në vlerën 1,004,515 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 972,385 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 32,130 mijë lekë ose realizuar në masën 96.80% konkretisht:

- 600 “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” planifikuar në vlerën 523,415 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 516,681 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 6,734 mijë lekë ose realizuar në masën 98.71%.

- 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” planifikuar në vlerën 84,100 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 80,702 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 3,398 mijë lekë ose realizuar në masën 95.96%.

- 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” planifikuar në vlerën 397,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 375,000 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 22,000 mijë lekë ose realizuar në masën 94.46%.

Investimet në total nga buxheti MSHMS, planifikuar në vlerën 194,942 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 182,487 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 12,455 mijë lekë ose realizuar në

masën 93.61%.

- Në disa zëra të llogarive buxhetore kryesisht paga personeli (shpërblime) konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin e buxhetit si më poshtë:

- 6003 “Shpërblime” planifikuar në vlerën 15,415 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 24,885 mijë lekë, ka tejkalim në vlerën 9,470 mijë lekë ose realizuar në masën 161.44%.

Theksojmë se, për të dyja rastet ku konstatohen angazhime më të mëdha ose më të ulta në zërat e llogarive buxhetore, kanë ardhur si pasojë e rialokimit të fondeve buxhetore të miratuara sipas vendimeve respektive të Bordit Drejtues të Spitalit.

□ **Realizimi i buxhetit në total sipas fondeve të miratuara nga FSDKSH dhe MSHMS**, planifikuar sipas planit përfundimtar në vlerën 1,199,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,154,872 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 44,585 mijë lekë ose realizuar në masën 96.28%.

□ **Shpenzimet nga të ardhurat dytësore**, planifikuar në vlerën 67,357 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 49,286 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 18,071 mijë lekë ose realizuar në masën 73.17%.

Të ardhurat dytësore në vlerën 51,445 mijë lekë (46,088 mijë lekë dhe 5,357 mijë lekë) dhe realizuar në vlerën 49,286 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 2,159 mijë lekë ose realizuar në masën 95.80%.

Drejtimit kryesorë për shpenzimin e këtyre fondeve:

- 600 “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” planifikuar në vlerën 2,582 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 874 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 706 mijë lekë ose realizuar në masën 66.18%.

- 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” planifikuar në vlerën 517 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 342 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 175 mijë lekë ose realizuar në masën 66.18%.

- 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” planifikuar në vlerën 57,919 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 45,137 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 12,782 mijë lekë ose realizuar në masën 77.93%.

- 231 “Investimet” planifikuar në vlerën 6,337 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,097 mijë lekë, ka mosrealizim në vlerën 4,240 mijë lekë ose realizuar në masën 33.10%.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.1, datë 30.04.2021

3.5. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Gjatë auditimit të kësaj çështjeje, grupi i auditimit të KLSH është fokusuar në auditimin që ka të bëjë me përputhjen e veprimtarisë së Spitalit Rajonal Durrës në fushën e prokurimeve publike me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar; Udhezimet e APP; Vendime të KPP; DST sipas procedurave të prokurimit të audituara, si dhe lidhja e zbatimi i kontratatave.

Grupi i auditimit ka proceduar me marrjen e regjistrave të parashikimit dhe më pas me ato të realizimit të prokurimeve dhe në vijim ka shqyrtuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për secilën prej tyre (kryesisht duke u përqendruar në vlerat e larta të fondit limit), numrin e opertaorëve ekonomik (OE) pjesëmarrës, OE të skualifikuar bashkë me shkaqet e skualifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave (KVO). Më pas, në varësi të sa më lart janë shqyrtuar analitikisht procedurat e prokurimit të përzgjedhura në SPE për dokumentet e tenderit (DST) lidhur me veprimtarinë e KVO, si dhe sipas rastit është vazhduar dhe me dosjen e auditimit lidhur me përcaktimin e fondit limit dhe vendosjen e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike nga komisioniet e posaçme. Gjatë auditimit është mbajtur në konsideratë shqyrtimi i të gjitha llojeve të procedurave të prokurimit, me fokus kryesor vlerën dhe numrin e pjesëmarrësve.

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, janë parashikuar dhe realizuar procedurat e prokurimit sipas të dhënave të mëposhtme:

-Për periudhën 1.01.2019-31.12.2019, Spitali Rajonal Durrës ka parashikuar dhe realizuar procedurat e prokurimit sipas të dhënave si më poshtë:

Vlera në lekë

Nr	Lloji i Procedures	Numri i procedurave te parashikuara	vlera e procedurave te parashikuara	Totali i Procedurave te Realizuara	vlera e procedurave te realizuara
1	Kerkese per Propozim	16	42,935,185.95	15	27,099,959.94
2	Procedurë e Hapur	6	176,356,401.67	Proc. të realizuara nga MSHMS	14,073,600
3	Amendament Kontrate	1	1,292,000.00	1	1,292,000

-Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, Spitali Rajonal Durrës ka parashikuar dhe realizuar të dhënat si më poshtë:

Vlera në lekë

Nr	Lloji i Procedures	Numri i procedurave te parashikuara	vlera e procedurave te parashikuara	Totali i Procedurave te Realizuara	vlera e procedurave te realizuara
1	Kërkesë për Propozim	13	105,845,112.00	12	75,251,292.60
2	Procedurë e Hapur	12	46,362,526.95	6	213694428
3	Amendament Kontrate	0	-	0	0

Më hollësisht procedurat e audituara si më poshtë vijon :

1.Të dhëna mbi procedurën “Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019”.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoritetit kontraktor znj N. J. Nr.597, datë 21.03.2019	Ngritur me urdhrin Nr.597/2, datë 21.03.2019	Ngritur me urdhrin Nr.597, datë 21.03.2019
Vlera e përllogaritur e kontratës 6,085,206 lekë pa Tvsh.		1- M. L. 2- E. R. 3- G. K.
Procedura e llojit. Kerkese per Propozim/Marreveshje Kuader/, prokurim me mjete elektronike –mallra “”Burim Financimi, Buxheti i Shtetit	1- A. M. 2- K. S. 3- N. M.	Komisioni për përllogaritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr.171/6, datë 01.02.2019
Operatori ekonomik fitues, B.O.E: “H. & A.” shpk dhe “GTS” shpk me vlerë oferte 6,085,206 lekë pa Tvsh		1- Sh. F. 2- A. D. 3- G. K. 4- Gj. Q. 5- M. Xh.
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr.597/10, datë 19.04.2019.	Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr.171/6, datë 01.02.2019. 1- Sh. F. 2- A. D. 3- G. K. 4- Gj. Q. 5- M. Xh.	Tenderi i zhvilluar me dt.09/04/2019 ,ora 12:30
Operatori fitues B.O.E: “H. & A.” shpk dhe “GTS” shpk Kontratë Nr.597/14 datë 30.04.2019 me vlerë oferte 6.085.206 lekë pa Tvsh	Ofertat e Paraqitura në Tender 1.E. S 0 leke. 2. B.O.E: “H. & A.” shpk dhe “GTS” shpk 6.085.206 leke.	Kualifikuar operatorët :12.04.2019
Ankimim/ nese ka :JO		
Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës ngritur me urdhrin 597/15, datë 30.04.2019. 1- E. P. 2- M. M. 3- M. Xh.	Njoftim fituesit, botuar në buletinin e prokurimit publik datë Nr.17, date 30.04.2019	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletinin e APP datë Nr.19, date 13/05/2020

Përgatitja e dokumenteve të tenderit:

Nga auditimi i procedurës “**Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019**” i dosjes fizike dhe në sistemin e APP, është konstatuar: Spitali Rajonal Durrës referuar informacionit nr.64, datë 09.01.2019 nga grupi i punës mbi monitorimin e kontratës së mëparshme për furnizimin mall Oksigjen Lëng për sasinë totale prej 146,400 litra oksigjen lëng i ka raportuar titullarit të AK mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit lëng për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019 dhe furnizimi deri më datë 04.01.2019 ka qënë 137,165 litra oksigjen lëng, ndërkohë sasia e mbetur për furnizim ka qënë 9235 litra oksigjen lëng.

Nga grupi i punës mbi monitorimin e kontratës së mëparshme për furnizimin mall Oksigjen gaz për sasinë totale prej 10,000 litra oksigjen gaz i ka raportuar titullarit të AK mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit gaz për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019 dhe furnizimi deri më datë 04.01.2019 ka qënë 5,520 litra oksigjen gaz, ndërkohë sasia e mbetur për furnizim ka qënë 4,480 litra oksigjen lëng.

Me shkresën nr.168, datë 21.01.2019 , shefi sektorit dhe oksigjenistet e SRD, drejtuar Titullares se AK “ Mbi planifikimin e oksigjen lëng dhe oksigjen gaz për vitin 2019” është parashikuar konsumi rreth 15800 oksigjen lëng në muaj.

Me shkresën nr.171, datë 21.01.2019 nga grupi i punës mbi monitorimin e kontratës së mëparshme për furnizimin mall Oksigjen Lëng për sasinë totale prej 146,400 litra oksigjen lëng i ka raportuar titullarit të AK mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit lëng për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019 dhe furnizimi deri më datë 17.01.2019 ka qënë 144,736 litra oksigjen lëng, ndërkohë sasia e mbetur për furnizim ka qënë 1664 litra oksigjen lëng.

Nga grupi i punës mbi monitorimin e kontratës së mëparshme për furnizimin mall Oksigjen gaz për sasinë totale prej 10,000 litra oksigjen gaz i ka raportuar titullarit të AK mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit gaz për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019 dhe furnizimi deri më datë 17.01.2019 ka qënë 4000 litra oksigjen gaz, ndërkohë sasia e mbetur për furnizim ka qënë 4,480 litra oksigjen lëng.

Me shkresën nr.193, datë 23.01.2019, nga grupi i punës mbi monitorimin e kontratës së mëparshme mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit gaz për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019, sasia e fundit e mbetur për furnizim ka qënë 1664 litra oksigjen lëng.

Me shkresën nr.193/1, datë 23.01.2019, nga oksigjenistet është vënë në dijeni titullari i AK mbi sasinë e mbetur për përdorim të oksigjenit lëng për kontratën e cila mbaron në 11.05.2019, sasia e fundit e mbetur në tank për furnizim ka qënë 2600 litra oksigjen lëng dhe referuar përdorimit të shpeshtë të periudhës Janar 2019 është analizuar që oksigjeni lëng përfundonte ***në datë 25.01.2019.***

Me shkresën nr.171/1, datë 22.01.2019 SRD i ka drejtuar MSHMS kërkesë për të prokuruar oksigjen lëng dhe oksigjen gaz për të përmbushur nevojat e SRD.

Me shkresën hyrëse nr.171/2, datë 25.01.2019 nga MSHMS drejtuar SRD , është deleguar kryerja e procedurës për prokurimin e nevojave për oksigjen për SRD.

Me shkresën nr.171/3, datë 30.01.2019 titullari i SRD ka nxjerrë urdhrin e brëndshëm për përgatitjen e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD”, nga grupi me përbërje Sh. F., Gj. Q. , M. Xh. brenda datës 31.01.2019.

Me relacionin nr.171/4, datë 31.01.2019, drejtuar titullarit të SRD anëtarja e grupit për përgatitjen e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD” M. Xh. me detyrë ekonomiste ka kërkuar zgjatjen e afatit kohor për përgatitjen e e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD” me arsye se ska informacion të plotë mbi procedurën , ka për të bërë detyra të tjera funksionale plus sipas saj me këtë punë merret njësia e prokurimit gjithashtu sipas saj ajo ska marrë asnjë trajnim për procedurat e prokurimit publik.

Me shkresën nr.171/5, datë 01.02.2019 nga sektori prokurimeve drejtuar titullares së AK , përgjegjsja e sektorit ka parashtruar sqarimet mbi rekomandimet/pretendimet e M. Xh. , me detyrë

ekonomiste pjese e grupit të për përgatitjen e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD”. Sipas kësaj shkrese sqarohet se çdo procedurë prokurimi fillon me kërkesën dhe në vijim të kërkesave është ngritur ky grup pune, sa i përket pretendimit të znj.Xh. se në kto grupe pune për tenderat e SRD duhet të marri pjesë gjithë punonjësit dhe jo vetëm një pjesë e administratës është sugjeruar që të krijohet një tabelë e planifikimit vjetor për grupet e punës që do angazhohen në prokurimet publike, gjithashtu në këtë relacion shpejgohet se sektori i prokurimeve nuk ka tagër të kryejë trajnime. Përsa i përket përbërjes së grupit është krijuar njësia e atillë që të përmbajë dy mjekë dhe një ekonomist. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallit brenda një kohe të shkurtër ka ardhur si rezultat i nevojës së ngutshme që ka institucioni për këtë bar, gjithashtu çelja e elementit të rregjistrimit bëhet vetëm pas llogaritjes së vlerës së kontratës që prokurohet dhe përsa kohë buxheti i SRD nuk është miratuar blerja e oksigjenit do kryhet me fonde nga buxheti sic citohet edhe në shkresën e MSHMS.

Me shkresën nr.171/6, datë 1.02.2019 titullari i AK ka ngritur grupin për përgatitjen e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD” me përbërje Sh. F., A. D., G. K., Gj. Q., M. Xh.

Me shkresën nr.171/6, datë 05.02.2019 grupi për përgatitjen e specifikimeve teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD”, ka bërë specifikimet teknike , kërkesat e veçanta teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD” me fond limit 6,085,206 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.597, datë 21.03.2019 është ngritur urdhri i prokurimit nga titullarja e AK për përcaktimin e njësisë së prokurimit , llojit të procedurës “Kërkesë për Propozim” me përbërje: M. L., E. R., G. K. , **31 ditë më vonë** nga përgatitja e specifikimeve teknike ,kërkesat e veçanta teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të kontratës për prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD”, **ndërkohë nevoja urgjente për oksigjen lëng dhe gaz është njoftuar që në datë 09.01.2019.**

Me procesverbalin nr.597/1, datë 21.03.2019 njësia e prokurimit ka hartuar DST.Me shkresën nr.597/2, datë 21.03.2019 është ngritur urdhri nga titullarja e AK për përcaktimin e KVO me përbërje A. M., K. S., N. M. Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr.597/3, në datën 21.03.2019.

AK ka ftuar në sistemin e APP , 6 operatorë për tu paraqitur në prokurimin “Blerje oksigjen lëng dhe gaz për SRD”, data 04.04.2019, ora 12.30.

Më datën 26.03.2019 nga APP ka ardhur një email drejtuar Drejtorisë së SRD ku kërkohet ndër të tjera ndryshimi i DST-ve duke analizuar shkaqet e anulimit të kësaj procedure dy herë të njëpasnjëshme dhe korrigjimin e DST-ve për të rritur konkurrencën.

Me urdhrin nr.597/5, datë 28.03.2019 , titullarja e AK ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit të marrë në shqyrtim sugjerimet e APP dhe afati për shqyrtimin e tyre data 28.03.2019. Me relacionin nr.597/6, datë 28.03.2019 Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimet në DST.

Me urdhrin nr.597/7, datë 28.03.2019 , titullarja e AK i ka hequr pezullimin procedurës dhe ka urdhëruar KVO për vazhdimin e procedurës së prokurimit më datë 09.04.2019,ora 12.30.

Zhvillimi i procedurës së tenderit

Me procesverbalin nr.597/8, datë 09.04.2019, ora 12.30 nga KVO është hapur procedura me objekt “Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019”, ku janë konstatuar se janë paraqitur dy operatorë ekonomikë:

1. E. S. me ofertë 0 lekë
2. H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH

Me procesverbalin nr.597/9, datë 12.04.2019 nga KVO është bërë vlerësimi i operatorëve pjesëmarrës në tender nga ku ka rezultuar se :

1. E. S. me ofertë 0 lekë ka paraqitur vetëm QKR historike dhe asnjë dokumentacion tjetër.

2. H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH ka paraqitur setin e dokumentacionit sipas përcaktimeve të DST-ve.

Sa më sipër KVO e ka vlerësuar bashkimin e operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH si operatori që përmbush kushtet për tu kualifikuar.

Me raportin përmbledhës nr.597/10, datë 19.04.2019 KVO i ka paraqitur Titullares së AK , vlerësimin e operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe ka kërkuar miratimin e kualifikimit të bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH si operatori që përmbush kushtet për tu kualifikuar.

Me shkresën nr.597/11, datë 24.04.2019 , sektori i prokurimeve SRD i ka drejtuar bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS, njoftimin e fituesit.

Me shkresën nr.597/12, datë 25.04.2019 , bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS, ka sjellë dokumentacionin justifikues për “Blerje oksigjen leng për SRD për nevojat e vitit 2019”.

Lidhja , likuidimi dhe zbatimi i kontratës

Furnizimi i SRD me oksigjen *ka filluar përpara përgatitjes dhe zhvillimit të tenderit, pa asnjë procedurë në kundërshtim me LPP*, përkatësisht nga operatori “M. A” (në cilësinë e shitësit por edhe të furnizuesit të SRD me oksigjen të kontratës së mëparshme nr.1198/8 datë 11.05.2018 për një afat 12 muaj të lidhur me SRD) me anë të procesverbaleve ku deklarohet si furnizues dhe huadhënës i oksigjenit duke vënë si kusht që pagesa do të kryhet menjëherë kur SRD t’i akordohet fondi në buxhetin e tij për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e këtij malli konkretisht operatori “M. A” në cilësinë e shitësit në datën 25.01.2019 ka furnizuar SRD me 3558 Litra, në datën 1.02.2018 ka furnizuar SRD me 4233 litra, në datën 07.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 3742 litra, në datën 14.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 4180 Litra, në datën 21.02.2019 2018 nuk është e përcaktuar me sa litra oksigjen është furnizuar SRD, në datën 27.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 3908 litra, në datën 06.03.2019 ka furnizuar SRD me 4268 litra, në datën 13.03.2019 ka furnizuar SRD me 3943 litra, në datën 20.03.2019 ka furnizuar SRD me 3566 litra, në datën 27.03.2019 ka furnizuar SRD me 3715 litra, në datën 03.04.2019 ka furnizuar SRD me 3995 Litra, në datën 10.04.2019 ka furnizuar SRD me 3750 Litra, në total 47,073 litra oksigjen.

Referuar dokumentacionit që ju vu në dispozicion grupit të auditimit mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratës për furnizimin e SRD me oksigjen , u konstatua se në lidhjen e dokumentacionit të likuidimit të operatorit fitues ka 12 procesverbale furnizimi me oksigjen të mbajtura midis operatorit “M. A” në cilësinë e shitësit por jo të operatorit fitues që sipas tenderit të zhvilluar në datën 19.04.2019 është shpallur bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë **6,085,206 lekë pa TVSH.**

Kontrata me nr.597/14 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS është lidhur më datë 30.04.2019 me afat lëvrimi 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, *pra pas furnizimit të Spitalit Rajonal Durrës me oksigjen, pra rreth 111 ditë kalendarike pas konstatimeve të gjëndjes së emergjencës së konstatuar që në datën 09.01.2019 nga procesverbalet e oksigjenistëve të SRD.*

SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.94/2, datë 02.05.2019 për 9000 litra oksigjen në vlerën 1,217,041 lekë

SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.95/1, datë 03.05.2019 për 8700 litra oksigjen në vlerën 1,176,473 lekë

SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.96/1, datë 06.05.2019 për 9800 litra oksigjen në vlerën 1,325,222 lekë

SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.97/1, datë 08.05.2019 për 8400 litra oksigjen në vlerën 1,135,905 lekë

SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.99, datë 17.05.2019 për 9100 litra oksigjen në vlerën 1,230,563 lekë.

Me dokumentin nr.967, datë 20.05.2019 është nënshkruar marrëveshje për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive leng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e SRD midis Drejtorit të SRD, operatori

“M. A.” sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k . Subjekti bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k shlyen detyrimin vetëm për sasinë 45,000 litra oksigjen lëng dhe mbeten për likuidim edhe 2073 litra. Sasia në litra e furnizuar nga GTS sh.p.k për SRD është 8830 në total.

Përsa më lart SRD i gjendur përpara faktit se kishte nevojë për furnizimin me oksigjen që në relacionet e oksigjenistëve të SRD të datës 09.01.2019 ndërkohë ka nisur me datë 25.01.2019 furnizimin e SRD nga operatorin “M. A.” sh.p.k pa pasur një shtesë kontrate nga kontrata e mëparshme me këtë operator, njëkohësisht ka iniciuar procedurë prokurimi për furnizimin e SRD me oksigjen 33 ditë pas relacionit të parë nga oksigjenistët e SRD mbi nevojën urgjente për oksigjen.

Nga grupi i monitorimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal apo relacion periodik për realizimin e kontratës me nr.597/14 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS të lidhur më datë 30.04.2019 me afat lëvrimi 3 muaj dhe asnjë detaj mbi hapat që ka ndërmarrë SRD për problematikat e mësipërme dhe as rakordim me njësinë e prokurimit mbi iniciimin njëkohësisht të procedurës së prokurimit kur furnizimi është kryer nga një operator tjetër pa pasur asnjë kontratë në kundërshtim me LPP, gjatë periudhës janar-maj 2019.

Gjithashtu pas furnizimit të SRD me oksigjen, lidhja e marrëveshjes për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunksionimin e SRD midis Drejtorit të SRD nga operatori “M. A.” sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k me nr.967, datë 22.05.2019, nuk është e parashikuar në kontratën e lidhur me nr.597/14, datë 30.04.2019 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k. dhe nuk parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik.

Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor znj.N. J., njësia e prokurimit M. L., E. R., G. K. dhe grupi i monitorimit të kontratës E. P., M. M., M. Xh. për mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen gjithashtu për dublim procedurash dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik.Përsa më lart është mbajtur aktkonstatimi nr.5 , datë 30.04.2021

2.Të dhëna mbi procedurën “e hapur” me objekt: **“Blerje oksigjen lëng, omeprazol, human tetanus immunoglobulin ndare ne 3 lote per Spitalin Rajonal Durres për vitin 2020”** – marrëveshje kuadër me disa operatore ekonomike (nje operator ekonomik te vetem fitues per secilin lot), ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj” me REF -48337-01-28-2020 , me fond limit **37,666,200 lekë pa Tvsh:**

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoritetit kontraktor Dr. N. J., nr. 127/4 prot, datë 28.01.2020	Ngritur me urdhrin Nr.127/5 prot, datë 28.01.2020 me perberje:	Ngritur me urdhrin 127/4 prot, datë 28.01.2020 me perberje:
Vlera e përlogaritur e pritshme e kontratave qe do te lidhen gjate marreveshjes kuader ne total 37,666,200 lekë pa Tvsh. Loti 1 me fond limit 28,396,200 leke pa tvsh;	1- A. K. 2- M. M. 3- L. M.	1- M. L. 2- N. P. 3- E. R.
Procedura e llojit “E Hapur”, prokurim me mjete elektronike –mallra “marrëveshje kuadër me disa operatore ekonomike (nje o.e te vetem fitues per secilin lot) – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara”-me afat 12 muaj. Burim Financimi “Buxheti i Shtetit”.		Komisioni për përlogaritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr.127/1 prot, datë 20.01.2020 me perberje:
Operatori ekonomik fitues, 1 – Ox.- “GTS” Shpk me NIPT J6...15B me oferte totale 28,396,200 Lek pa TVSH;		1- G. K. 2- Sh. F. 3- A. D. 4- N. P. 5- M. Xh.

Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr. 588/2 prot, datë 17.03.2020 per LOTIN 1-OX.	Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr.127/1 prot, datë 20.01.2020 me perberje: 1- G. K. 2- Sh. F. 3- A. D. 4- N. P. 5- M. Xh.	Tenderi i zhvilluar me dt. 02.03.2020, ora 12:00.
Operatori fitues : Loti 1 – Ox.- “GTS” Shpk me NIPT J61...5B Kontratë MK Nr. 588/7 prot, datë 24.03.2020, me cmim 28,396,200 Lek pa TVSH.	Ofertat e Paraqitura në Tender sipas Raportit të Vleresimit nr. 588 prot., date 10.03.2020: 1 - Ox.- “GTS” Shpk me NIPT J61...15B me oferte totale 28,396,200 Lek pa TVSH.	Operatorët e kualifikuar sipas Raportit të Përmbledhës me nr. 588/2 prot, datë 17.03.2020: 1 - Ox.- “GTS” Shpk me NIPT J61...5B me oferte totale 28,396,200 Lek pa TVSH.
<ul style="list-style-type: none"> • Ankimim/ nese ka : PO. • Përgjigje e ankesës nga AK: ankesa nuk qëndron për Lotin 3 Human Tetanus immunoglobulin. • Përgjigje e ankesës nese ka nga APP dhe KPP nr, dat nr, datë 		
Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratave ngritur me urdhrin Loti 1-Ox. nr.588/8 prot, datë 24.03.2020 Komisioni i monitorimit të kontratës: 1- N. M. 2- G. S. 3- Z. S.	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik: Buletini nr.15 date 24.03.2020.	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP: Buletini nr.19, date 14.04.2020.

Përgatitja e dokumenteve të tenderit :

Nga auditimi i procedurës : **“Blerje oksigjen lëng, omeprazol, human tetanus immunoglobulin ndare në 3 lote për Spitalin Rajonal Durres 2020”** – marrëveshje kuadër me disa operatore ekonomike (një operator ekonomik të vetëm fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj” me REF -48337-01-28-2020 , me fond limit 37,666,200 lekë pa Tvsh i dosjes fizike dhe në sistemin e APP, është konstatuar:

Me kërkesën nr.1875, datë 09.10.2019 nga shefja e farmacisë drejtuar Titullares së Autoritetit Kontraktor, vihet në dijeni mungesa e omeprazolit , medikament për stomakun.

Me shkresën nr.2033, datë 24.12.2019 nga SRD drejtuar MSHMS , vihet në dijeni mungesa e Anti-tetanus immunoglobulin, , medikament për tetanozin.

Me shkresën nr.2079/1, datë 24.12.2019 nga SRD drejtuar MSHMS , vihet në dijeni mungesa e omeprazolit , medikament për stomakun.

Me shkresën nr.34, datë 08.01.2020 nga SRD drejtuar MSHMS, vihet në dijeni mungesa e oksigjenit lëng dhe kërkesa për të prokuruar 210,000 litra prashikim vjetor për vitin 2020 nga SRD meqë MSHMS do kryejë prokurimin e përqëndruar për këtë bar.

Me shkresën nr.194/1, datë 16.01.2020 nga MSHMS drejtuar SRD , i delegohet këtij të fundit kryerja e procedurës së prokurimit për barnat si më sipër dhe kërkesa e MSHMS për informacion pas zhvillimit të procedurës.

Sipas informacionit datë 17.01.2020 nga shefja e farmacisë gjendja e barnave omeprazolit , medikament për stomakun dhe Anti-tetanus immunoglobulin, , medikament për tetanozin është 0.

Referuar procesverbalit nga grupi i punës për monitorimin e kontratës së mëparshme të oksigjenit nr.1048/3, datë 7.01.2020 është llogaritur konsumi mujor deri në 31.12.2019 ka qenë 17,602 litra.

Me urdhrin e brendshëm nr.127, datë 20.01.2020, titullarja e AK ka përcaktuar strukturën për përgatitjen e specifikimeve teknike me perberje:G. K.,Sh. F., A. D., N. P., M. Xh..

Me relacionin nr.127/2, datë 24.01.2020, grupi i përgatitjes së specifikimeve teknike i ka dërguar specifikimet ,titullarit të AK.

Me relacionin nr.127/3,datë 24.01.2020 anëtarja e grupit të specifikimeve teknike A. D. ka sjellë specifikimet teknike vetëm për zërin e oksigjenit me emailin e datës 17 dhe 24 Janar 2020.

Me urdhrin nr.127/4, datë 28.01.2020 , titullarja e AK ka ngritur njësinë e prokurimit me përbërje M. L.,N. P.,E. R..

Me urdhrin nr.127/6, datë 28.01.2020 , titullarja e AK ka ngritur KVO me përbërje A. K.,M. M.,L. M.. Me relacionin nr.127/6, datë 28.01.2020 , njësia e prokurimit ka hartuar DST.

Me shkresën nr.127/7, është kryer njoftimi i kontratës në cilën përcaktohet objekti i kontratës në 3 lote ku oksigjeni lëng afati kohor për dorëzimin e ofertave është përcaktuar data 21.02.2020 ora 12.00.

Me emailin nr.127/8, datë 13.2.2020 nga APP drejtuar SRD është rekomanduar amendimi i DST-ve në respektim të legjislacionit të prokurimit publik.

Me urdhrin nr.127/9, datë 12.02.2020 ,titullari i AK ka ngritur njësinë e posaçme të marrë në shqyrtim sugjerimet e APP-së.

Me relacionin nr.127/10, datë 14.02.2020 njësia e posaçme ka dërguar ndryshimet e specifikimeve të DST-ve.

Me relacionin nr.127/11, datë 14.02.2020, njësia e posaçme ka bërë ndryshimet e specifikimeve të DST-ve, me shtojcën nr.1 në DST.

Titullari i AK me urdhrin nr.127/12, datë 17.02.2020 ka hequr pezullimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit duke ndryshuar DST-të dhe duke përcaktuar zhvillimin e procedurës në datë 26.02.2020 në ora 12.00.

Komisioni i specifikimeve teknike me relacionin nr.493, datë 25.02.2020 ka rimarrë në shqyrtim sugjerimet e APP dhe ka bërë ndryshime mbi kërkesat për lotin 1 për oksigjenin, për kapacitetin teknik.

Me urdhrin nr.493/1, datë 25.02.2020 , titullari i AK ka marrë parasysh relacionin nr.493, e Komisionit të specifikimeve teknike datë 25.02.2020 i cili ka rimarrë në shqyrtim sugjerimet e APP dhe ka bërë ndryshime mbi kërkesat për lotin 1 për oksigjenin, për kapacitetin teknik.

Me relacionin nr.493/2, datë 25.02.2020 njësia e prokurimit ka bërë shtojcën nr.2 të DST-ve duke reflektuar relacionin nr.493, e Komisionit të specifikimeve teknike datë 25.02.2020 i cili ka rimarrë në shqyrtim sugjerimet e APP dhe ka bërë ndryshime mbi kërkesat për lotin 1 për oksigjenin, për kapacitetin teknik.

Titullari i AK me urdhrin nr.493/3, datë 25.02.2020 ka hequr pezullimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit duke ndryshuar DST-të dhe duke përcaktuar zhvillimin e procedurës në datë 2.03.2020 në ora 12.00.

Zhvillimi i procedurës së tenderit

Me shkresën nr.493/4, datë 28.12.2020 drejtuar Titullares së AK, KVO ka kërkuar shtyrjen e afatit të tenderit pa asnjë arsye.

Me shkresën nr.493/6, datë 06.03.2020 KVO ka bërë një kërkesë për verifikimin e të dhënave të dhënave të operatorit ekonomik GTS sh.p.k që sipas KVO është paraqitur për të marrë pjesë në tender në datë 02.03.2020.

Nga KVO nuk ka procesverbal për hapjen e tenderit në kundërshtim me VKM nr.914 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Me shkresën nr.493/7, datë 06.03.2020, nga njësia e prokurimit publik ka ardhur përgjigja për verifikimin e të dhënave të dhënave të operatorit ekonomik GTS sh.p.k, duke deklaruar që rezultoni i padënuar.

Me procesverbalin nr.588, datë 10.03.2020 , KVO ka vlerësuar se pas hapjes së procedurës për lotin nr.1 Ox. është paraqitur operatorit ekonomik GTS sh.p.k me vlerë 28,396,200 lekë për të cilin KVO ka vlerësuar se i plotëson kriteret e DST-ve.

Me raportin përmbledhës nr.588/2, datë 17.03.2020, KVO i ka drejtuar titullarit të AK për miratim ofertën e operatorit ekonomik GTS sh.p.k me vlerë 28,396,200 lekë për të cilin KVO ka vlerësuar se i plotëson kriteret e DST-ve.

Me shkresën nr.588/4 ,datë 18.03.2020 titullari i AK ka shpallur njoftimin e marreveshjes kuadër

për operatorin ekonomik GTS sh.p.k me vlerë 28,396,200 lekë për të cilin KVO ka vlerësuar se i plotëson kriteret e DST-ve.

Me shkresën nr.588/5, datë 24.03.2020, operatori ekonomik GTS sh.p.k ka sjellë pranë SRD dokumentet e tenderit.

Me shkresën nr.588/6, datë 24.03.2020, SRD ka mbajtur procesverbal me operatori ekonomik GTS sh.p.k për dorëzimin e dokumenteve të tenderit.

Me shkresën nr.588/7, datë 24.03.2020 është lidhur marrëveshja kuadër midis operatori ekonomik GTS sh.p.k dhe SRD me vlerë 28,396,200 lekë për periudhë lëvrimi **12 muaj** nga data e nënshkrimit.

Me urdhrin nr.588/7, datë 24.03.2020 titullari i AK ka përcaktuar njësinë e monitorimit të kontratës me përbërje N. M.,G. S.,Z. S..

Lidhja , likuidimi dhe zbatimi i kontratës

Njësia e monitorimit të kontratës me përbërje N. M.,G. S.,Z. S. me informacionin nr.647, datë 25.03.2020 drejtuar titullares së AK ka përcaktuar monitorimit e kontratës sipas DST-ve dhe Marrëveshjes Kuadër. Me ftesën nr.647/1, datë 25.03.2020 nga njësia e prokurimit është ftuar operatori ekonomik GTS sh.p.k për të lidhur marrëveshje kuadër me SRD për lëvrimin e oksigjenit lëng me sasi 210, 000 litra për 12 muaj në vlerën 28,396,200 lekë.

Kontrata me operatorin GTS sh.p.k nr.647/3, datë 25.03.2020 për periudhë lëvrimi **12 muaj** nga data e nënshkrimit. Hyrja e mallit në farmaci është bërë nga data 26.03.2020 me faturën hyrëse të mallit me nr.142 deri në datën 23.11.2020 me faturën hyrëse nr.483, pra për një periudhë **169 ditë pune ose 243 ditë kalendarike**, ndërkohë sipas kontratës lëvrimi i mallit duhet të vazhonte deri në datë **25.03.2021** ose 12 muaj sipas kontratës, ndërkohe malli oksigjen lëng është konsumuar **4 muaj para përfundimit të afatit të kontratës**.

SRD ka likuiduar subjektin GTS sh.p.k për një periudhë nga data 29.04.2020 deri në datën 30.12.2020, për çmimin total të kontratës me vlerë **28,396,200 me TVSH.Me shkresën nr.2240/1, datë 29.12.2020 titullari i SRD i ka drejtuar operatorit GTS sh.p.k, vërtetim realizim kontrate me sukses sipas vlerës së realizimit ndërkohe malli oksigjen lëng është konsumuar 4 muaj para përfundimit të afatit të kontratës.**

Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor znj.N. J. , njësia e prokurimit M. L., N. P., E. R. dhe grupi i monitorimit të kontratës N. M., G. S., Z. S. për mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik. Përsa më lart është mbajtur aktkonstatimi nr.6 , datë 30.04.2021

3. Procedura “Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)”, viti 2020

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoritetit kontraktor znj N. J. Nr.1472/4, datë 24.09.2020	Ngritur me urdhrin Nr.1472/5, datë 24.09.2020	Ngritur me urdhrin Nr.1472/4, datë 24.09.2020
Vlera e përllorarit e kontratës 3,198,000 lekë pa Tvsh.		4- E. R. 5- Z. K. 6- J. I.
Procedura e llojit. Kerkese per Propozim, prokurim me mjete elektronike –mallra Burim Financimi, Te ardhurat dytesore	4- G. K. 5- E. K. 6- A. I.	Komisioni për përlloraritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr.1472/2, datë 14.08.2020
Operatori ekonomik fitues, H. K. shpk me vlerë oferte 2,600,000 lekë pa Tvsh		1- A. F. 2- J. I. 3- N. M.
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr.1675/5, datë 19.10.2020.	Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr.1472/2, datë 14.08.2020.	Tenderi i zhvilluar me dt.05/10/2020ora 12:00

	4- A. F. 5- J. I. 6- N. M.	
Operatori fitues H. K. shpk, Kontratë Nr.1675/8 datë 28.10.2020 me vlerë oferte 2,600,000 lekë pa Tvsh	Ofertat e Paraqitura në Tender 1.K.-ashensor shpk 2,600,000 leke. 2.H. K. 2,600,000 leke. 3.S.-K. shpk 3,038,100 leke. 4.F. shpk 3,135,000 leke.	Kualifikuar operatorët :09.10.2020
Ankimim/ nese ka :JO		
Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës ngritur me urdhrin 1675/9, datë 28.10.2020. 4- A. F. 5- N. M. 6- R. Ç.	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik datë Nr.91, date 26.10.2020	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP datë Nr.94, date 02/11/2020

Përgatitja e dokumenteve të tenderit

Nga verifikimi i dosjes fizike dhe auditimi i sistemit të APP për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)”, viti 2020 u konstatua:

Me kërkesën nr.1982, datë 29.10.2019 nga Dega Teknike e Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Drejtorit të SRD dhe Drejtorit Ekonomik është kërkuar furnizimi me një ashensor për godinën e hotelerisë (godina katër katëshe) të SRD.

Me shkresën nr.2237, datë 11.12.2019 Drejtori i SRD i ka kërkuar MSHMS miratimin e shpenzimeve kapitale nga të ardhurat dytësore për vitin 2020 në vlerën 3,840,000 lekë sipas kërkesës nr.1982, datë 29.10.2019 nga Dega Teknike e Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Drejtorit të SRD. Bordi Drejtues i SRD me vendimin nr.19, datë 10.12.2019 ka miratuar shpenzimin për prokurimin e furnizimit me një ashensor për godinën e hotelerisë (godina katër katëshe) të SRD.

MSHMS me shkresën nr.50/222, datë 19.12.2019 ka miratuar shpenzimin për prokurimin e furnizimit me një ashensor për godinën e hotelerisë (godina katër katëshe) të SRD, për vitin 2020.

Me urdhrin nr.2326, datë 27.12.2019 , Titullarja e Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar komisionin për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje A. F., J. I., N. M.

Me informacionin nr.1472/2, datë 14.08.2020 që sektori i prokurimeve i ka drejtuar grupit të specifikimeve teknike i ka bërë me dije se procedura e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godina katër katëshe) është anuluar 3 herë. Për efekt të realizimit të kësaj procedure është kërkuar konfirmimi i nevojës për ashensor të ri dhe rishikimi i specifikimeve teknike dhe fondi limit.

Me shkresën nr.1472/3, datë 11.09.2020, komisioni për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje A. F., J. I., N. M. ka hartuar specifikimet teknike dhe referuar relacionit me analizën dhe studimin e tre ofertave bashkelidhur ka përcaktuar fondin limit 3,198,000 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.1472/4, datë 24.09.2020 , titullarja e Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me fond limit 3,198,000 lekë pa TVSH ku ka përcaktuar llojin e procedurës “Kërkesë për Propozim” dhe ka përcaktuar anëtarët e njësisë së prokurimit me përbërje : E. R., Z. K., J. I.

Me shkresën nr.1472/5, datë 24.09.2020 , titullarja e Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe ka përcaktuar anëtarët e komisionit me përbërje : G. K., E. K.,A. I.

Me shkresën nr.1675, datë 24.09.2020 është hartuar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit nga anëtarët e njësisë së prokurimit me përbërje : E. R., Z. K., J. I.

Me shkresën nr. 1472/6, datë 24.09.2020 titullarja e Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë njoftimin e kontratës duke e publikuar në buletin e APP nr.77, datë 28.09.2020, ku përcaktohet data e zhvillimit të tenderit 05.10.2020.

Më datën 28.09.2020 Autoritet Kontraktor ka kryer njoftimin e pesë operatorëve në sistemin e APP-së për pjesëmarrjen në tenderin e datës 05.10.2020.

Zhvillimi i procedurës së tenderit

Referuar procesverbalit nr.1675/1, datë 05.10.2020 ora 12.00 u hap procedura e tenderit nga anëtarët e KVO dhe u konstatua se në sistemin e APP ishin paraqitur 4 operatorë ekonomikë:

1. Kl.-a shpk 2,600,000 leke pa tvsh
2. H. K. 2,600,000 leke pa tvsh
3. S.-K shpk 3,038,100 leke pa tvsh
4. F. shpk 3,135,000 leke pa tvsh

Me shkresën nr.1675/2, datë 06.10.2020 , KVO i ka drejtuar sektorit të prokurimeve një kërkesë për verifikimin e të dhënave konkretisht gjëndjen gjyqësore të pjesëmarrësve në tender, me qëllim vlerësimin e kriterit përkatës për kualifikim.

Me shkresën nr.1675/3, datë 06.10.2020 sektori i prokurimit i ka kthyer përgjigje KVO duke dhënë informacion mbi gjëndjen gjyqësore të pjesëmarrësve në tender referuar rregjistrin elektronik përveç një pjesëmarrësi duke shpjeguar se ky pjesëmarrës ishte shtetas i huaj.

Me procesverbalin nr.1675/4, datë 09.10.2020, KVO ka vlerësuar pjesëmarrësit në tenderin e zhvilluar datë 05.10.2020 ora 12.00 dhe ka renditur arsyet për kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve pjesëmarrës konkretisht:

1. Kl.-a shpk me ofertë 2,600,000 leke pa tvsh : skualifikuar për arsye mospërmbushje të kriterëve të specifikimeve teknike gjithashtu përfaqësuesi i operatorit ekonomik rezultoi në dënues sipas rregjistrin të gjëndjes gjyqësore referuar dokumentacionit në dosje.
2. H. K. me ofertë 2,600,000 leke pa tvsh : Kualifikuar
3. S.-K. shpk me ofertë 3,038,100 leke pa tvsh : skualifikuar për arsye mospërmbushje të kriterëve të specifikimeve teknike
4. F. shpk me ofertë 3,135,000 leke pa tvsh : skualifikuar për arsye mospërmbushje të kriterëve të specifikimeve teknike

Përsa më lart referuar gjëndjes gjyqësore të operatorit ekonomik H. K. me ofertë 2,600,000 lekë pa tvsh, grupi i auditimit konstaton se me shkresën nr.1675/3, datë 06.10.2020 sektori i prokurimit i ka kthyer përgjigje KVO duke dhënë informacion mbi gjëndjen gjyqësore të pjesëmarrësve në tender referuar rregjistrin elektronik përveç një pjesëmarrësi duke shpjeguar se ky pjesëmarrës ishte shtetas i huaj dhe konkretisht për shtetasin H. Y. një nga përfaqësuesit e operatorit ekonomik H. K. sh.p.k nuk ka dhënë informacion duke shpjeguar se ky pjesëmarrës ishte shtetas i huaj dhe ska të dhëna për gjëndjen gjyqësore të tij në rregjistrin Elektronik të Gjëndjes Gjyqësore, ndërkohë KVO e ka vlerësuar si të plotë informacionin pavarësisht informacionit nga sektori i prokurimit me shkresën nr.1675/3, datë 06.10.2020, në të cilën është shpjeguar se ky pjesëmarrës ishte shtetas i huaj dhe ska të dhëna për gjëndjen gjyqësore të tij. KVO e ka vlerësuar ofertën e operatorit H. K. sh.p.k me ofertë 2,600,000 lekë pa tvsh si oferta që plotëson kriteret sipas DST.

KVO ka paraqitur raportin përmbledhës me nr.1675/5, datë 19.10.2020 titullarit të AK duke klasifikuar operatorët pjesëmarrës dhe duke shpallur fitues operatorin H. K. sh.p.k me ofertë 2,600,000 lekë pa tvsh si oferta që plotëson kriteret sipas DST.

Me shkresën nr.1675/6, datë 19.10.2020, titullari i AK ka miratuar vendimin e KVO duke shpallur fitues operatorin H. K. sh.p.k me ofertë 2,600,000 leke pa tvsh si oferta që plotëson kriteret sipas DST.

Me shkresën nr.1675/7, datë 19.10.2020 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë formularin e njoftimit të fituesit operatorin H. K. sh.p.k me ofertë 2,600,000 leke pa tvsh si oferta që plotëson kriteret sipas DST, shpallur në APP në buletin nr.91, datë 26.10.2020.

Me procesverbalin nr.1847, datë 23.10.2020, operatori fitues H. K. sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin pranë SRD.

KVO me procesverbalin nr.1847/1, datë 24.10.2020 ka inventarizuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori fitues H. K. sh.p.k pranë SRD.

Lidhja, likuidimi dhe zbatimi i kontratës

Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 leke pa tvsh me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.

Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për

ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje : A. F., N. M., R. Ç..

Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, titullarja e AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletin e APP nr.94, datë 2.11.2020.

Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.

Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.

Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje:A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.

Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit ***“Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelarisë (godinë 4 katëshe)”***, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.

Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021 , me faturën nr.150, furnitori “Hy. Kl.” ka sjellë vlerën e prokurimit për likujdim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kyer akoma likujdimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t'i mbahen operatorit ekonomik “H. K.” sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se “Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes”.

Ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t'i zbresë faturës së likujdimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës është 661,440 lekë . Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit **661,440 lekë** lekë përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k.Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës A. F., N. M., R. Ç. Përsa më lart është mbajtur aktkonstatimi nr.7 , datë 30.04.2021

4. Të dhëna mbi procedurën “Kërkese për Propozim” me objekt “Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore me dy lote per Spitalin Rajonal Durrës” – marrëveshje kuader, me nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj, me fond limit 7,790,000 lekë pa Tvsh, per nevojat 2019, me REF – 95733-11-23-2018:

Të dhëna mbi tenderin Komisioni i vlerësimit të ofertave Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoritetit kontraktor Dr. N. J., Nr. 2650/5 prot, date 23.11.2018.
Ngritur me urdhrin Nr.2650/8 prot, date 23.11.2018:

- 1-G. K.
- 2-H. P.
- 3-B. K.

Ngritur me urdhrin Nr. 2650/5 prot, date 23.11.2018:

1-V. C.

2-O. G.

3-A. H.

Me Urdherin Nr. 194/6 prot, date 13.02.2019 ndryshon njesia prokurimit si me poshte:

1-V. C.

2-E. R.

3-A. H.

Me Urdherin Nr. 464/5 prot, date 25.03.2019 ndryshon njesia prokurimit si me poshte:

1-V. C.

2-E. R.

3-M. L.

Vlera e përllogaritur e kontratës -7.790.000 Lek pa Tvsh.

Procedura e llojit “Kerkese per Propozim” me objekt “Transport dhe asgjesim i mbetjeve te rrezikshme spitalore me dy lote per Spitalin Rajonal Durres” – marrveshje kuader, me nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj, me fond limit 7,790,000 lekë pa Tvsh, per nevojat 2019”

Burim Financimi “Te ardhura dytesore”.

Komisioni për përllogaritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr. 2650/2 prot, date 05.11.2018

1-A. D.

2-R. C.

3-L. S.

Operatori ekonomik fitues:

- Per Lotin 1 fitues, OE “M.-T” sh.p.k me vlerë oferte 6,426,000 lekë pa Tvsh ;

- Per Lotin 2, fitues OE “M.-T” sh.p.k me vlerë oferte 1,323,000 lekë pa Tvsh ;

Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr. 849/1 prot, date 26.04.2019. Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr. 2650/2 prot, dt 05.11.2018.

1-A. D.

2-R. C.

3-L. S.

Tenderi i zhvilluar me dt. 11.03.2019, ora 12:00 me mjete elektronike

Operatori fitues “M.-T.” shpk

Kontratë 1, AK Nr. 849/10 prot, datë 17.05.2020, per Lotin 1 dhe Lotin 2 me afat deri në 31.08.2019; për vlerën 3,870,720 lekë pa tvsh me afat deri në 31.08.2019;

Kontrata nr.1616/5, datë 06.09.2019 me vlerë 2,326,968 lekë me TVSH

Kontrata nr.1928/5, datë 05.12.2019 me vlerë 2.326,968 lekë me TVSH

Ofertat e Paraqitura në Tender:

Per Lotin 1

1- OE “E.-R.” shpk me oferte ekonomike 6.460.000 Lek pa TVSH;

2- OE “M.-T” shpk me oferte ekonomike 6,426,000 Lek pa TVSH;

3- OE “P.-M.” shpk me oferte ekonomike 5,000,000 Lek pa TVSH;

4- OE “V.A.L.E R.” shpk me oferte ekonomike 4,930,000 Lek pa TVSH;

Per Lotin 2

1- OE “M.-T” shpk me oferte ekonomike 1,323,000 Lek pa TVSH;

2- OE “P.-M.” shpk me oferte ekonomike 1,330,000 Lek pa TVSH;

Kualifikuar operatorët :

- Per Lotin 1 fitues, OE “M.-T” sh.p.k me vlerë oferte 6,426,000 lekë pa Tvsh

- Per Lotin 2, fitues OE “M.-T” sh.p.k me vlerë oferte 1,323,000 lekë pa Tvsh

Ankimim/ nese ka: Janë paraqitur ankesat:

1-Ankesa nr.2859 prot, date 03.12.2018 nga OE “V.A.L.E R.” shpk;

2-Ankesa nr.2957 prot, date 17.12.2018 nga OE “V.A.L.E R.” shpk per KPP;

3-Ankesa nr.421 prot, date 25.02.2019 nga OE "E.-R." Shpk;

4-Ankesa nr.605 prot, date 25.03.2019 nga OE "P.-M." shpk;

Pergjigje e ankeses nga AK:

1-Kthim Pergjigje Nr. 2859/3 prot, date 05.12.2018;

2-Kthim Pergjigje nr.421/3 prot, date 28.02.2019

3-Kthim Pergjigje Nr. 605/9 prot, date 12.04.2019

Pergjigje e ankeses nese ka nga APP dhe KPP :

1-Vendimi 28/2019 date 21.01.2019 i KPP

2- Vendimi 28/3/2018 date 07.02.2019 i KPP

3- Vendimi nr.91/2019 date 18.02.2019 i KPP

Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës ngritur me urdhrin nr. 849/8 prot, date 15.05.2019

1-A. D.

2-R. C.

3-L. S.

Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik: Buletini nr.19, date 13.05.2019

Përgatitja e dokumenteve të tenderit

Me kërkesën nr.2650, datë 25.10.2018 nga sektori i shërbimeve mjedisore të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Drejtorisë Ekonomike të Spitalit Rajonal Durrës, është kërkuar iniciimi i procedurës me objekt "Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme për SRD-në" për vitin 2019, me arsyetimin e përfundimit të kontratës të mëparshme.

Me urdhrin e brendshëm nr.2650/2, datë 5.11.2018, Titullarja e SRD ka ngritur njësinë e posaçme për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës me përbërje A. D., R. C., L. S., në po të njëjtën datë grupi për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës ka nënshkruar deklaratat për konfliktin e interesit.Me shkresën nr.2736, datë 07.11.2018 SRD i ka dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vazhdim MSHMS), kërkesë për miratimin e prokurimit të Marrëveshjes Kuadër për disa shërbime në rastin konkret procedurën me objekt "Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme për SRD-në" për vitin 2019.

APP i ka dërguar udhëzim SRD me emailin e datës 14.11.2018, protokolluar në SRD me nr.2774, datë 14.11.2018 për marrjen në konsideratë dhe procedimin konform tij për përmbushjen e nevojave për mallra, shërbime për vitin 2019 për vijueshmërinë e përmbushjes së aktiviteteve spitalore.Me shkresën nr.2650/3, datë 15.11.2018 drejtuar sektorit të prokurimeve, grupi për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës ka përgatitur relacionin për specifikimet teknike dhe fondin limit ku referuar kontratës së mëparshme ka përcaktuar fondin limit Loti 1 : 6,460,000 lekë pa tvsh dhe Loti : 2, 1,330,000 leke pa tvsh ndërsa në total 7,790,000 lekë pa tvsh.Me vendimin qarkullues nr.43, datë 22.11.2018, Bordi i Spitalit ka miratuar fondin për shpenzimin nga të ardhurat dytësore të vitit 2019 për prokurimin e shërbimit "Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme për SRD-në" për vitin 2019. Me shkresën nr.2650/5, datë 23.11.2018, Titullarja e SRD ka nxjerrë urdhrin e prokurimit dhe ka përcaktuar njësinë e prokurimit me përbërje: V. C., E. R., M. L. i cili ka ndryshuar me urdhrin nr. 194/6 prot, date 13.02.2019 në përbërje: V. C., E. R., A. H., dhe me urdhrin nr. 464/5 prot, datë 25.03.2019 në përbërje:V. C., E. R., M. L..

Me shkresën nr.2650/6, datë 23.11.2018 titullarja e AK ka dërguar në APP njoftimin e kontratës në të cilën është përcaktuar lloji i procedurës "Kërkesë me Propozim" me dy lote, kohëzgjatja e kontratës 12 muaj dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave data 7.12.2018 me fond limit 7,790,000 lekë pa tvsh.Me shkresën nr.2650/7, datë 23.11.2018 njësia e prokurimit ka hartuar dokumentet e tenderit. Me urdhrin nr.2650/8, datë 23.11.2018 Titullari i SRD ka ngritur KVO me përbërje G. K., H. P., B. K..Me njoftimin e datës 26.11.2018 , që Autoriteti Kontraktor ka hedhur në sistemin e APP-së, ka ftuar 6 operatorë ekonomikë për të paraqitur ofertën. Me njoftimin e datës 27.11.2018 , APP i ka sugjeruar SRD, amendimin dhe ndryshimin e DST-ve të procedurës me objekt "Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme për SRD-në" për vitin 2019, tek pikat

e kritereve të specifikimeve teknike që duhet të plotësojë operatori fitues.Me shkresën nr. 2650/10,datë 27.11.2018 , Titullari e SRD ka autorizuar grupin e specifikimeve teknike të marrë në shqyrtim sugjerimet e APP-së të ardhur me email datë 27.11.2018. Me shkresën nr.2868, datë 3.12.2018 grupi i specifikimeve teknike ka marrë në konsideratë sugjerimet e APP-së. Me praktikën nr.2859, datë 3.12.2018 , operatori ekonomik “V.A.L.E” sh.p.k ka sjellë ankesë drejtuar Autoritetit Kontraktor mbi ndryshimin e kritereve të kualifikimit të DST-ve duke i konsideruar të padrejta. Me shkresën nr.2859/1, datë 3.12.2018 Nëndrejtori i Autoritetit Kontraktor në mungesë dhe me porosi të Titullares së AK ka autorizuar Komisionin e Posaçëm për Shqyrtimin e Ankesës dhe ka urdhëruar pezullimin e procedurës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, sipas parashikimeve të LPP. Me shkresën nr.2859/3, datë 05.12.2018 , Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “V.A.L.E” sh.p.k duke i shpjeguar arsyet e mosmarrjes parasysh pikës 1 të ankesës dhe marrjen në konsideratë të pikës 2 të ankesës. Me praktikë nr.2359/4, datë 17.12.2018 Autoriteti Kontraktor ka bërë një shtojcë në DST-në kriteret për kapacitetin teknik per lotin 1 dhe lotin 2 , ndërsa data për dorëzimin e ofertave është shtyrë në 24.12.2018. Me praktikë nr.2859/5, datë 17.12.2018 , Nëndrejtori i Autoritetit Kontraktor në mungesë dhe me porosi të Titullares së AK ka hequr pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ka urdhëruar vazhdimin e saj. Me praktikën nr.2957, datë 17.12.2018 , operatori ekonomik “V.A.L.E” sh.p.k i ka dërguar ankesë KPP mbi ndryshimin e kritereve të kualifikimit të DST-ve duke i konsideruar të padrejta. Me shkresën nr.2957/1, datë 17.12.2018 Nëndrejtori i Autoritetit Kontraktor në mungesë dhe me porosi të Titullares së AK ka autorizuar Komisionin e Posaçëm për Shqyrtimin e Ankesës dhe ka urdhëruar pezullimin e procedurës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, sipas parashikimeve të LPP. KPP me vendimin nr.1884/1, datë 18.12.2018, protokolluar në SRD me shkresën nr.2957/2, datë 21.12.2018 ka urdhëruar AK për pezullimin e procedurës dhe marrjen në shqyrtim të ankesës së operatorit “V.A.L.E” sh.p.k. Me shkresën nr.2957/3, datë 21.12.2018 , Autoriteti Kontraktor i ka dërguar informacion KPP në lidhje me procedurën. KPP me praktikën 194, datë 23.01.2019 i ka dërguar APP, informacion në zbatim të vendimit nr.1884/1, datë 18.12.2018. Me urdhrin nr.194/1, datë 24.01.2019 , titullarja e Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar grupin e specifikimeve teknike t’i rivlerësojë ato dhe të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës. Me shkresën nr.194/2, datë 25.01.2019 grupi i specifikimeve teknike ka marrë në konsideratë urdhrin e titullares se AK dhe ka bërë ndryshimet në DST. Me shkresën nr.194/3, datë 29.01.2019, Autoriteti Kontraktor i ka dërguar informacion KPP në lidhje me ndryshimet e DST-ve. Me shkresën nr.194/4, datë 6.02.2019, Autoriteti Kontraktor i ka bërë kërkesë KPP për vijimin e procedurës.

KPP me vendimin nr.194/5,datë 12.02.2019 ka hequr pezullimin dhe ka lejuar AK të vazhdojë me procedurën.Titullarja e AK me shkresën nr.194/6, datë 13.02.2019 ka ndryshuar njësinë e prokurimit me përbërje : V. C. ,E. R., A. H..

Me shkresën nr.194/7, datë 13.02.2019 Autoriteti Kontraktor ka bërë një shtojcë në DST për ndryshimet në kapacitetin teknik.

Me shkresën nr.194/8 , datë 194/8 , datë 13.02.2019 AK i ka dërguar KPP , informacion në zbatim të vendimit nr.28.03.2018 me datë 07.02.2019.Me vendimin nr.91/2019, KPP ka hequr pezullimin dhe ka lejuar AK të vazhdojë me procedurën.Me praktikën nr.421, datë 25.02.2019 , operatori “E. R.” sh.p.k ka bërë ankesë me kërkesën për ndryshimin e DST-ve.

Me urdhrin nr.421/1, datë 26.02.2019 , Titullarja e AK ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesave përse më lart. Me relacionin nr.421/2, datë 28.02.2019 Komisionin i Shqyrtimit të Ankesave, ka marrë parasysh ankesën e operatorit “E. R.” sh.p.k.

Me shkresën nr.421/3, datë 28.02.2019 Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit “E. R.” sh.p.k.Me shkresën nr.421/4, datë 28.02.2019 Autoriteti Kontraktor ka bërë një shtojcë në DST për ndryshimet në kapacitetin teknik dhe hapja e procedurës është shtyrë më datë 11.03.2019.Titullarja e AK me urdhrin nr.464,datë 28.02.2019 ka hequr pezullimin dhe ka urdhëruar vazhdimin e procedurës.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit

KVO me procesverbalin nr.464/1, datë 11.03.2019 ka mbajtur procesverbalin e paraqitjes së mostrave (kampionëve) dhe ka shpjeguar se në datë 11.03.2019 ora 12.00 janë paraqitur pranë sekretarisë së SRD dy operatorë M.-T. sh.p.k dhe P. M. të cilët kanë sjellë mostrat (kampionët) sipas kushteve të veçanta të kualifikimit.

Me procesverbalin nr.464/2, datë 11.03.2019 është hapur procedura dhe KVO konstatoi se për lotin 1 janë paraqitur 4 operatorë me ofertat si më poshtë, ndërsa për lotin 2 ofertat si më poshtë :

Për Lotin 1

- 1- OE "E.-R." shpk me ofertë ekonomike 6.460.000 Lekë pa TVSH;
- 2- OE "M.-T" shpk me ofertë ekonomike 6,426,000 Lekë pa TVSH;
- 3- OE "P.-M." shpk me ofertë ekonomike 5,000,000 Lekë pa TVSH;
- 4- OE "V.A.L.E R." shpk me ofertë ekonomike 4,930,000 Lekë pa TVSH;

Per Lotin 2

- 1- OE "M.-T" shpk me ofertë ekonomike 1,323,000 Lekë pa TVSH;
- 2- OE "P.-M." shpk me ofertë ekonomike 1,330,000 Lekë pa TVSH;

Pas hapjes se procedures, komisioni konstatoi se per Lotin 1 (nje) jane paraqitur 4 (kater) operatore ekonomike te renditur si me poshtë.

Loti 1: Transport dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme spitalore, KODI: 180101; 180103

1.Operatori ekonomik E. – R., me Nipt L6...09B me oferte pa tvsh 6.460.000,00 leke

2.Operatori ekonomik M, me Nipt J71...04W , me oferte pa tvsh 6,426,000.00 leke

3.Operatori ekonomik P. - M., me Nipt L71...07M,me oferte pa tvsh 5.000.000 leke

Në këto kushte, bazuar në VKM nr. 1 dt. 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, kreu 7, pika 1, paragrafi a, Komisioni i Vleresimit te Ofertave vendosi që:

Nëpërmjet raportit Përmbledhës të shpallë fitues Per Lotin nr. 1 dhe nr. 2 operatorin ekonomik "M.-T" Sh.p.k., Nipt J715...W, dhe i propozon titullarit miratimin e këtij vendimi.

Me shkresën nr.849/2, datë 6.05.2019 është njoftuar fituesi i procedurës operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH.Me shkresë nr.849/6, dat 09.05.2019, operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH ka sjellë dokumentet e ofertes fituese.

Autoriteti Kontraktor ka lidhur draft kontratë me operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH me shkresën nr.849/7, datë 14.05.2019. Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratë me operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH, Kontrata nr.849/11 datë 20 Maj 2019 me vlerë 4,644,864 lekë me TVSH me afat deri ne 31.08.2019. Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratë me operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH, Kontrata nr.1616/5, datë 06.09.2019 me vlerë 2,326,968 lekë me TVSH me afat deri ne 30.11.2019.

Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratë me operatori "M." me ofertë 6,426,000 lekë pa TVSH, Kontrata nr.1928/5, datë 05.12.2019 me vlerë 2.326,968 lekë me TVSH me afat deri ne perfundim te sasive.

Likuidimi i kontratës.

Kontrata nr.849/11 datë 20 Maj 2019 me vlerë 4,644,864 lekë me TVSH

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.209, datë 31.05.2019 për vlerën 2,109, 103.92 lekë me TVSH tek Credins Bank me datë 02.07.2019

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.217, datë 29.06.2019 për vlerën 698,725.44 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 06.08.2019

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.453, datë 31.07.2019 për vlerën 787,313.52 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 19.08.2019

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.234, datë 31.08.2019 për vlerën 1,045,665.52 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 18.09.2019

Kontrata nr.1616/5, datë 06.09.2019 me vlerë 2,326,968 lekë me TVSH

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.240, datë 30.09.2019 për vlerën 728,526.96 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 08.10.2019;

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.249, datë 1.11.2019 për vlerën 831,539.52 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 10.12.2019;

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.719, datë 28.11.2019 për vlerën 766, 901.52 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 17.12.2019;

Kontrata nr.1928/5, datë 05.12.2019 me vlerë 2.326,968 lekë me TVSH

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.1023, datë 30.12.2019 për vlerën 660,668.4 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 17.01.2020;

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.2, datë 31.1.2020 për vlerën 760,052.76 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 02.03.2020;

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.8, datë 28.02.2020 për vlerën 714,465.36 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 27.04.2020;

SRD ka likujduar operatorin M. sh.p.k me faturën nr.221, datë 28.04.2020 për vlerën 191,646 lekë me TVSH tek Ax Bank me datë 26.08.2020;

Përsa më sipër referuar planifikimit, zhvillimit dhe likujdimet të procedurës grupi i auditimit konstaton që procedura është shtrirë në kohë për një periudhë të gjatë për arsye objektive dhe subjektive duke pasur parasysh iniciimin e procedurës që në tetor të vitit 2018 dhe lidhjen e Kontratave në maj 2019. Përsa më lart është mbajtur aktkonstatimi nr.8, datë 30.04.2021

5. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës – 2 lote”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, 2 lote”		
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. *Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,*
2. *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,*
3. *Kontrata nr. 520/2, datë 13.03.2019 e lidhur midis Shp. shpk dhe SRD me vlerë 1,352,068 lekë pa TVSH, me afat deri në 31.12.2019.*

Për sa më sipër mban përgjegjësi: A. D., përgjegjëse e sektorit të mjedisit, B. K., specialiste e sektorit të shërbimeve mjedisore, G. Q., ekonomiste.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstaimi nr. 18, date 30.04.2021. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni (A. D., B. K., G. Q.) me shkresën nr.1623 datë 23/09/2021 (protokolluar në KLSH me nr.184/6 datë 24.09.2021) ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

- Grupi i ngritur me Urdhrin e Brendshëm të Drejtorit nr. 2650/1, datë 05.11.2018 me objekt përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për objektin e prokurimit: "Shërbimi i evadimit të mbetjeve", kemi zbatuar Urdhrin e Drejtorit.
- Grupi ka dorëzuar në sekretari detyrën e ngarkuar dhe duke u gjendur në kushtet që spitali ska peshore e ka parashikuar me volume.
- Grupi ka monitoruar kontratën bazuar mbi volumin e thasëve të mbetjeve duke ngjeshur mbetjet dhe në rastet që është e pamundur i kanë lenë si janë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Konstatimi i grupit të auditimit është pranuar nga ana juaj dhe është marr në konsideratë për kontratën e rradhës, pretendimet e ngritura nga ana juaj janë thjesht justifikim i vendimit të marr por jo të bazuara në argumentim ligjor. Observacioni nuk merret në konsideratë.

9- Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri 2019”, me këto të dhëna:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoritetit kontraktor Dr. N. J., nr. 1031/4 prot, datë 07/06/2019	Ngritur me urdhrin Nr.1031/6 prot, datë 07.06.2019:	Ngritur me urdhrin Nr.1031/4 prot, datë 07.06.2019
Vlera e përlogaritur e kontratës 11,207,182 lekë pa Tvsh.	1- G. K. 2-E. K. 3-A. F.	1-E. R. 2-I. F. 3-I. H.
Procedura e llojit “e hapur”, prokurim me mjete elektronike – Burim Financimi “Buxheti”.		Komisioni për përlogaritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr.451/8 prot, datë 07.07.2020 1- I. D. 2- H. P. 3- L. S. 4- V. Gj. 5- E. K.
Operatori ekonomik fitues, “H. & L.” sh.p.k me vlerë oferte 11’207’000 lekë pa Tvsh		
Raporti përmbledhës me nr. 1328/2 prot, datë 16.07.2019 i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me Vendim miratimin nr. 1328/3 prot, datë 16.07.2019.	Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr.451/8 prot, datë 07.07.2020 1- I. D. 2- H. P. 3- L. S. 4- V. Gj. 5- E. K.	Tenderi i zhvilluar me dt. 08.07.2019, ora 12:00
Operatori fitues “H. & L.” sh.p.k Kontratë Nr.1328/7 prot, date 17.07.2019, me vlerë oferte 11.207.000 lekë pa Tvsh	Ofertat e Paraqitura në Tender: 1-OE “H. & L.” sh.p.k me oferte 11.207.000 lekë pa Tvsh	Kualifikuar operatorët : OE “H. & L.” sh.p.k me oferte 11.207.000 lekë pa Tvsh
Ankimim/ nese ka: Po Ankesa Nr. 1137 prot, date 12.06.2019 nga OE Pergjigje e ankeses nga AK: 1- Kthim Pergjigje Nr. Relacioni nr. 1137/2 prot, date 13.06.2019 dhe shkresa Nr. 1137/3 prot, date 13.06.2019 Pergjigje e ankeses nese ka nga APP dhe KPP nr, dat nr, datë		
Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës ngritur me urdhrin nr.1328/8 prot, datë 17.07.2019: 1-H. P. 2-I. D. 3-E. K. 4-V. Gj. 5-L. S.	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik: Buletini nr.29 date 22.07.2019	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP : Buletini nr. 29 date 22.07.2019

Në bazë të Informacionit nr. 93, datë 16.05.2019 Qendra Kombëtare Teknike Bio-mjeksore konstatohet se skaneri ka difekt dhe se nuk mund të gjendjet saktësisht difekti dhe sygjeron kontaktimin me prodhuesin.

Kompania e autorizuar nga prodhuesi ka identifikuar problematikën e skanerit dhe me emailin e datës 20.05.2019 ka përcjell informacionin.

Me shkresën nr. 936/1, datë 20.05.2019, Drejtor i SRD ka përcjell kërkesën për fonde Ministrisë së Shëndetësisë.

Kompania e autorizuar nga prodhuesi ka kryer diagnostikimin e difektit dhe ofertën teknike dhe me emailin datë 27.05.2019 i ka përcjell në SRD.

Realacioni teknik i Shefit të Shërbimit të Imazherisë në SRD datë 28.05.2019

Urdhri i Brendshëm nr. 1031/1, datë 28.05.2019 “Mbi ngritjen e njësisë së posacme për përgatitjen

e specifikimeve”

Me shkresën nr. 9813/1, datë 06.06.2019 MSHMS ka akorduar fondet për prokurim.

Relacion nr. 1081/3, datë 06.06.2019 “Dërgim kërkesë dhe specifikimet teknike për “Funizim vendosje llampe rotgenit” i grupit të punës. Nuk është e dokumentuar mënyra e komunikimit me operatorët pasi është përzgjedhur mënyra e përllogaritjes me studim tregu.

Grupi i punës ka vendosur edhe kriteret teknike të cilat nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II, në të cilin citohet se;

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre....

Me Urdhrin e brendshëm nr. 1096, datë 06.06.2019 është ndryshuar regjistri i parashikimit.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1031/4 prot., datë 07.06.2019 ka nisur procedura e prokurimit.

Me procesverbalin nr. 1031/5, datë 07.06.2019 janë hartuar DST nga NJP, specifikimet dhe kriteret janë vendosur nga grupi i punës i ngjitur për këtë qëllim. Fondi limit është hartuar mbi bazën e studimit të tregut.

Me Urdhrin nr. 1031/6, datë 07.06.2019 është ngritur grupi i komisionit të vlerësimit të ofertave.

Njoftimi i kontratës nr. 1031/7, datë 07.06.2019

Publikimi në Buletinin nr. 24, datë 17.06.2019.

Me emailin e datës 10.06.2019 APP ka sygjerruar ndryshimin e kriterëve për kualifikim pasi nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, konkretisht, pika 1 të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni nr. 27 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të KM “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar konkretisht:

- Në lidhje me periudhën e sigurimit të stafit nga 16 muaj në maksimalisht 12 muaj ose të argumentojë pse duhet të periudha 16 muaj.

- Të specifikohet lloji i inxhinier ose teknik në stafin e vet të trajnuar për aparatura mjekësore.

- Autorizim nga firma prodhuese për mirëmbajtjet e pajisjeve ndërkohë që përjashton mundësinë e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar prej prodhuesit.

Me Urdhrin nr. 1031/8, datë 12.06.2019 është pezulluar procedura e prokurimit për të shqyrtuar sygjerimet e APP.

Nga operatori ekonomik H. & L. shpk ka paraqitur ankesën datë 12.06.2019 në lidhje me mos vendosjen e specifikimit që pjesët e hequra nga skaneri do të kthehen prodhuesit pasi ofertën e dhënë operatori e ka bazuar mbi këtë specifikim.

Urdhër i Brendshëm nr. 1137/1, datë 12.06.2019 “Për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave” i përbërë nga:

1. G. K.

2. A. M.

3. B. B.

Realacioni nr. 1137/2, datë 13.06.2019 “Realacion mbi shqyrtimin e ankesës” duke marr në konsideratë ankesën e paraqitur.

Me shkresën nr. 1137/3, datë 13.06.2019 “Kthim përgjigje mbi ankesën”

Me shkresën nr. 1031/10, datë 17.06.2019 “Dërgim specifikimesh sipas sugjerimeve të APP-së në lidhje me procedurën e hapur “Furnizim vendosje llampe e Rongenit dhe Konverter për Ct Scanner për Spitalin Rajonal Durrës” i janë dërguar titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Në datën 17.06.2016, Njesia e Prokurimit ka hartuar edhe hedhur shtojcën nr. 1031/11, datë 17.06.2019.

Me urdhërin nr. 1031/12, datë 17.06.2019 “Për heqjen e pezullimit” për vijimin e procedurës së prokurimit.

Në datën 08.07.2019, është hapur procedura e prokurimit me procesverbalin nr. 1031/13, datë 08.07.2019.

Me hapjen e procedurës është konstatua se pjesëmarrjes në procedurë të një operator:

“He. & Li.” me Nipt L...11L ofertë ekonomike 11,207,000 lekë pa TVSH

Me kërkesën nr. 1031/14, datë 08.07.2019 NJP ka kërkuar vlerifikimin e të dhënave

Me shkresën nr. 1328, datë 08.07.2019, sektori i prokurimeve ka përcjell informacionin NJP mbi gjendjen gjyqësore të operatorët ekonomik.

KVO pasi ka vlerësuar dokumentacionin e operatorit ekonomik ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 1328/1, datë 08.07.2019.

Është hartuar raporti përmbledhës nr. 1328/2, datë 16.07.2019 i cili është miratuar me Vendimin nr. 1328/3, datë 16.07.2019.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 1328/4, datë 16.07.2019.

Buletini i APP nr. 29, datë 22.07.2019 është publikuar njoftimi i fituesit.

Me OE "He. & Li." është lidhur kontrata nr. 1328/7, datë 17.07.2019 me vlerë 11,207,000 lekë pa TVSH me afat zbatimi 7 ditë.

Njoftim i kontratës së nënshkruar nr. 1328/9, datë 18.7.2019.

Zbatimi i kontratës

Me Urdhrin nr. 1328/8, datë 17.07.2019, është ngritur grupi i monitorimit të kontratës:

1. H. P.
2. I. D.
3. E. K.
4. V. Gj.
5. L. S.

Mallrat kanë ardhur shoqëruar me Faturën nr. 8237215, datë 18.07.2019 me vlerë 13,448,400 lekë me TVSH.

Procesverbali i Pranimit pa datë ku komisioni shprehet se pjesët janë vendosur në Skaner dhe pas vendosjes Skanderi u kikhthe në gjendje pune të plotë.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm me Urdhër Shpenzimin nr. 3, datë 02.08.2019 është kryer pagesa në vlerën 13.448,400 lekë

Relacioni i ekzekutimit të kontratës nr. 1851, datë 04.10.2019 i Komisioni i Marrjes në Dorëzim shprehet se kontrata është realizuar në kohë dhe cilësi.

Me kryerjen e pagesës në vlerë të plotë (100% të vlerës) institucioni nuk ka siguruar garancinë prej 1 viti të pjesëve të blera të skanerit në kundërshtim me specifikimet teknike të Kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019.

Autorizimi i pagesës së mësipërme është kryer nga I. V. me detyrë kontabiliste dhe G. K., me detyrë ish Nen Drejtor Ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
3. Kontrata nr. 1328/7, datë 17.07.2019.

Për sa më sipër mban përgjegjësi:

1. I. D. në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike
2. H. P. në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike
3. L. S. në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike
4. V. Gj. në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike (ka refuzuar firmën me Shkresën nr. 1100, datë 07.06.2019)
5. E. K. në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike
6. I. V., kontabiliste
7. G. K., me detyrë Nen Drejtor Ekonomik.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstaimi nr. 19, date 30.04.2021.

10- Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje protoksid azoti per SRD per nevojat e vitit 2020”, me këto të dhëna:

Të dhëna mbi procedurën “Blerje protoksid azoti per SRD per nevojat e vitit 2020”.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor znj N. J. Nr.968, datë 01.06.2020	Ngritur me urdhrin Nr.968/1, datë 01.06.2020	Ngritur me urdhrin Nr.968, datë 01.06.2020
Vlera e përlogaritur e kontratës 4,568,400 lekë pa Tvsh.		M. L. E. R. N. P..
Procedura e llojit. Kerkese per Propozim/Marreveshje Kuader/, prokurim me mjete elektronike –mallra “”	G. K. A. Xh. G. S.	Komisioni për përlogaritjen e fondit limit ngritur me urdhrin Nr.702, datë 07.04.2020
Burim Financimi, Te ardhurat dytesore		B. M. B. S. E. C.
Operatori ekonomik fitues, V. Z&D shpk me vlerë oferte 4,568,400 lekë pa Tvsh		
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor me nr.968/8, datë 23.06.2020.	Urdhër për ngritjen e strukturës për përgatitjen e specifikimeve teknike ngritur me urdhrin Nr.702, datë 07.04.2020. B. M. - B. S. - E. C.	Tenderi i zhvilluar me dt.12/06/2020ora 11:00
Operatori fitues V. Z&D shpk, Kontratë Nr.1292/2 datë 22.07.2020 me vlerë oferte 4,568,400 lekë pa Tvsh	Ofertat e Paraqitura në Tender 1. V. Z&D shpk 4,568,400 leke.	Kualifikuar operatorët :16.06.2020
Ankimim/ nese ka :JO Pergjigje e ankeses nga AK: Pergjigje e ankeses nese ka nga APP dhe KPP nr, dat nr, datë		
Urdhër për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës ngritur me urdhrin 1292/4, datë 24.09.2020. B. S. A. Xh. B. K.	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik datë Nr.39, date 29.06.2020	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP datë Nr.53, date 10/08/2020

Delegim procedure nga MSHMS nr. 5288, datë 07.11.2019

Urdhër për delegim kërkesash për hartimin e buxhetit 2020 nr. 2062/1, datë 19.11.2019

Kërkesë datë 21.11.2019 e Shefit të Anestezisë – Reanimacionit Dr. B. M., sasia 6480 kg për 12 muaj.

Kërkesë nr. 2062/2, datë 22.11.2019 e Shef I Farmacisë N. P.

Vendimi Qarkullues nr. 01, datë 17.01.2020, miratim i regjistrit të parashikimeve të prokurimeve.

Urdhër nr. 702, datë 07.04.2020, për ngritjen e komisionit të posacëm për rishikimin e specifikimeve teknike, kërkesat e veçanta teknike për kualifikim dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës.

Komisioni i përbërë nga:

1. B. M.
2. B. S.
3. E. C.

Me shkresën nr. 702/1, datë 14.04.2020 komisioni ka hartuar specifikimet teknike, ka përlogaritur fondin limit bazuar në kontratën e mëparshme si dhe ka haruar kriteret e vecanta për kualifikim Grupi i punës ka vendosur edhe kriteret teknike të cilat nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II, në të cilin citohet se;

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre....

Urdhër I Prokurimit nr. 968, datë 01.06.2020, me fond limit 4,568,400 lekë

Urdhër për ngritjen e KVO nr. 968/1, datë 01.06.2020

Procesverbal nr.968/2, datë 01.06.2020 “Mbi hartimin e doumenttave standarde të tenderit”

Ftesa e 5 OE në system

DST

NJoftim i kontratës nr.968/3, datë 01.06.2020

Buletini nr. 34, datë 08.06.2020

Procesverbal hapje nr. 968/4, datë 12.06.2020 ka marr pjesë vetëm një operatorë “Vital Z &D”

Kërkesë për verifikim e të dhënave nr. 968/5, datë 12.06.2020

Kthim përgjigje nr. 968/6, datë 15.06.2020, jo të dënuar.

Procesverbali i vlerësimit nr. 968/7, datë 16.06.2020, ku është kualifikuar OE “Vital Z&D”

Raport Përmbledhës nr. 968/8, datë 23.06.2020, miratimi nga titullari I AK datë 24.06.2020.

Vendim miratimi nr. 968/9, datë 24.06.2020.

Formulari i Njoftimit të OE fitues nr. 968/10, datë 24.06.2020

Buletini nr. 39, datë 29.06.2020

Draft Marrëveshje Kuadër nr. 968/13, datë 03.07.2020 e lidhur midis OE “Vi. Z & D” dhe Titullarit të AK.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,

2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. B. M.
2. B. S.
3. E. C.

Për sa më sipër ë shtë mbajtur Akt Konstaimi nr. 21, date 30.04.2021

Nga auditimi i procedurave të prokurimit dhe kontratave të lidhura për periudhën 1.01.2019-31.01.2021 Spitali Rajonal Durrës ,grupi i auditimit auditori **11** procedura prokurimi në vlerën e kontratave 90,423,032 lekë dhe në vijim ka konstatuar këto mospërputhje (problematika) me kuadrin rregullator përkatës:

2.5.1. Titulli i Gjetjes : Mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen nga Titullari i SRD-së dhe strukturat e ngarkuara me prokurimin e këtij malli, në Spitalin Rajonal Durrës **për vitin 2019 dhe për vitin 2020.**

Situata:1. Për vitin 2019 furnizimi i SRD me oksigjen *ka filluar përpara përgatitjes dhe zhvillimit të tenderit, pa asnjë procedurë në kundërshtim me LPP*, përkatësisht nga operatori “M. A” (në cilësinë e shitësit por edhe të furnizuesit të SRD me oksigjen të kontratës së mëparshme nr.1198/8 datë 11.05.2018 për një afat 12 muaj të lidhur me SRD) me anë të procesverbaleve ku deklarohet si furnizues dhe huadhënës i oksigjenit duke vënë si kusht që pagesa do të kryhet menjëherë kur SRD t’i akordohet fondi në buxhetin e tij për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e këtij malli konkretisht operatori “M. A” në cilësinë e shitësit në datën 25.01.2019 ka furnizuar SRD me 3558 Litra, në datën 1.02.2018 ka furnizuar SRD me 4233 litra, në datën 07.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 3742 litra, në datën 14.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 4180 Litra, në datën 21.02.2019 2018 nuk është e përcaktuar me sa litra oksigjen është furnizuar SRD, në datën 27.02.2019 2018 ka furnizuar SRD me 3908 litra, në datën 06.03.2019 ka furnizuar SRD me 4268 litra, në datën 13.03.2019 ka furnizuar SRD me 3943 litra, në datën 20.03.2019 ka furnizuar SRD me 3566 litra, në datën 27.03.2019 ka furnizuar SRD me 3715 litra, në datën 03.04.2019 ka furnizuar SRD me 3995 Litra, në datën

10.04.2019 ka furnizuar SRD me 3750 Litra, në total 47,073 litra oksigjen.Referuar dokumentacionit që ju vu në dispozicion grupit të auditimit mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratës për furnizimin e SRD me oksigjen , u konstatua se në lidhjen e dokumentacionit të likujdimit të operatorit fitues ka 12 procesverbale furnizimi me oksigjen të mbajtura midis operatorit “M. A” në cilësinë e shitësit por jo të operatorit fitues që sipas tenderit të zhvilluar në datën 19.04.2019 është shpallur bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH.

Kontrata me nr.597/14 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve He. & An. sh.p.k dhe GTS është lidhur më datë 30.04.2019 me afat lëvrimi 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, pra pas furnizimit të Spitalit Rajonal Durrës me oksigjen, *pra rreth 111 ditë kalendarike pas konstatimeve të gjëndjes së emergjencës së konstatuar që në datën 09.01.2019 nga procesverbalet e oksigjenistëve të SRD.* SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.94/2, datë 02.05.2019 për 9000 litra oksigjen në vlerën 1,217,041 lekë.SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.95/1, datë 03.05.2019 për 8700 litra oksigjen në vlerën 1,176,473 lekë. SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.96/1, datë 06.05.2019 për 9800 litra oksigjen në vlerën 1,325,222 lekë. SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.97/1, datë 08.05.2019 për 8400 litra oksigjen në vlerën 1,135,905 lekë. SRD ka likujduar subjektin H. & A. sh.p.k me faturën nr.99, datë 17.05.2019 për 9100 litra oksigjen në vlerën 1,230,563 lekë.

Me dokumentin nr.967, datë 20.05.2019 është nënshkruar marrëveshje për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e SRD midis Drejtorit të SRD, operatori “M. A.” sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k. Subjekti bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k shlyen detyrimin vetëm për sasinë 45,000 litra oksigjen lëng dhe mbeten për likujdim edhe 2073 litra. Sasia në litra e furnizuar nga GTS sh.p.k për SRD është 8830 në total.

Përsa më lart SRD i gjendur përpara faktit se kishte nevojë për furnizimin me oksigjen që në relacionet e oksigjenistëve të SRD të datës 09.01.2019 ndërkohë ka nisur me datë 25.01.2019 furnizimin e SRD nga operatorin “M. A” sh.p.k *pa pasur një shtesë kontrate nga kontrata e mëparshme me këtë operator, njëkohësisht ka iniciuar procedurë prokurimi për furnizimin e SRD me oksigjen 33 ditë pas relacionit të parë nga oksigjenistët e SRD mbi nevojën urgjente për oksigjen.*

Nga grupi i monitorimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal apo relacion periodik për realizimin e kontratës me nr.597/14 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS të lidhur më datë 30.04.2019 me afat lëvrimi 3 muaj dhe asnjë detaj mbi hapat që ka ndërmarrë SRD për problematikat e mësipërme dhe as rakordim me njësinë e prokurimit mbi iniciimin njëkohësisht të procedurës së prokurimit kur furnizimi është kryer nga një operator tjetër pa pasur asnjë kontratë në kundërshtim me LPP, gjatë periudhës **janar-maj 2019**. Gjithashtu **pas furnizimit të SRD me oksigjen**, lidhja e marrëveshjes për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e SRD midis Drejtorit të SRD nga operatori “M. A” sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k me nr.967, datë 22.05.2019, *nuk është e parashikuar në kontratën e lidhur me nr.597/14, datë 30.04.2019 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k. dhe nuk parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik.*

Për shkëljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor, njësia e prokurimit dhe grupi i monitorimit të kontratës për mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen gjithashtu për dublim procedurash dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik.

Situata: 2. Me shkresën nr.34, datë 08.01.2020 nga SRD drejtuar MSHMS, vihet në dijeni mungesa e oksigjenit lëng dhe kërkesa për të prokuruar 210,000 litra prashikim vjetor **për vitin**

2020 nga SRD meqë MSHMS do kryejë prokurimin e përqëndruar për këtë bar.

Me shkresën nr.194/1, datë 16.01.2020 nga MSHMS drejtuar SRD , i delegohet këtij të fundit kryerja e procedurës së prokurimit për barnat si më sipër dhe kërkesa e MSHMS për informacion pas zhvillimit të procedurës.Me shkresën nr.588/4 ,datë 18.03.2020 titullari i AK ka shpallur njoftimin e marreveshjes kuadër për operatorin ekonomik GTS sh.p.k me vlerë 28,396,200 lekë për të cilin KVO ka vlerësuar se i plotëson kriteret e DST-ve.Me shkresën nr.588/5, datë 24.03.2020, operatori ekonomik GTS sh.p.k ka sjellë pranë SRD dokumentet e tenderit.Me shkresën nr.588/6, datë 24.03.2020, SRD ka mbajtur procesverbal me operatorin ekonomik GTS sh.p.k për dorëzimin e dokumenteve të tenderit. Me shkresën nr.588/7, datë 24.03.2020 është lidhur marrëveshja kuadër midis operatorit ekonomik GTS sh.p.k dhe SRD me vlerë 28,396,200 lekë për periudhë lëvrimi **12 muaj** nga data e nënshkrimit.

Kontrata me operatorin GTS sh.p.k nr.647/3, datë 25.03.2020 për periudhë lëvrimi **12 muaj** nga data e nënshkrimit. Hyrja e mallit në farmaci është bërë nga data 26.03.2020 me faturën hyrëse të mallit me nr.142 deri në datën 23.11.2020 me faturën hyrëse nr.483, pra për një periudhë **169 ditë pune** ose **243 ditë kalendarike**, ndërkohë sipas kontratës lëvrimi i mallit duhet të vazhdojë deri në datë **25.03.2021** ose 12 muaj sipas kontratës, ndërkohe malli oksigjen lëng është konsumuar **4 muaj para përfundimit të afatit të kontratës**.

SRD ka likujduar subjektin GTS sh.p.k për një periudhë nga data 29.04.2020 deri në datën 30.12.2020, për çmimin total të kontratës me vlerë **28,396,200 me TVSH**. Me shkresën nr.2240/1, datë 29.12.2020 titullari i SRD i ka drejtuar operatorit GTS sh.p.k, vërtetim realizim kontrate me sukses sipas vlerës së realizimit ndërkohe malli oksigjen lëng është konsumuar 4 muaj para përfundimit të afatit të kontratës.

Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor, Njësia e prokurimit dhe Grupi i monitorimit të kontratës për mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik.

Kriteri: Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 “parimet e përzgjedhjes”, pika b) transparencë në procedurat e prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Dublim procedurash dhe mos marrje masash për organizimin e tyre sipas rregullave, kriterëve dhe parimeve të konkurrencës që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik.

Shkaku: Mos argumentim dhe mosmarrje masash për zhvillimin në kohë dhe sipas rregullave të prokurimit publik, i procedurës për blerjen e oksigjenit për nevojat e SRD-së, për vitin 2019 dhe vitin 2020.

Rëndësia: e Lartë

2.5.1. 1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në raport me planifikimet, nevojat dhe realizimet e kontratave të oksigjenit të analizojë dhe të identifikojë nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me këtë proces, kronologjinë e gjendjes reale të këtij malli në magazinat e SRD-së, shpërndarjen e tij dhe shmangjen e procedurave që nuk sanksionohen në kontratat e lidhura me operatorët fitues të tenderit.

2.5.1. 2 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në SRD, të marrë masa që të organizojë strukturat që ka ngarkuar me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në Spitalin Rajonal Durrës, për të ndjekur trajnimet që organizohen nga Agjencia e Prokurimit Publik, në mënyrë që të shmangë parregullsitë në procedurat e prokurimit në të ardhmen.

Afati: Në vijimësi

2.5.2 Titulli i Gjetjes: Dorëzim i mallit (“Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinën e hotelerise (godine 4 katëshe) të SRD”, për vitin 2020 pas **53 ditëve** kalendarike ose **35 ditë pune me vonesë** në Spitalin Rajonal Durrës.

Për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinën e hotelerise (godine 4 kateshe)”, viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 leke pa tvsh me afat

realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.

Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç. Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, titullarja e AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletin e APP nr.94, datë 2.11.2020.

Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.

Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.

Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.

Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit ***“Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)”***, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.

Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021 , me faturën nr.150, furnitori “Hy. Kl.” ka sjellë vlerën e prokurimit për likuidim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kyer akoma likuidimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t’i mbahen operatorit ekonomik “H. K.” sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se “Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes”.

Ashensori është dorëzuar në SRD pas **53 ditëve kalendarike** ose **35 ditë pune me vonesë**, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t’i zbresë faturës së likuidimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës **është 661,440 lekë**.

Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet.Për pasojë vlera e penalitetit **661,440 lekë** lekë përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës A. F., N. M., R. Ç.

Kriteri: Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të Kontratës”; nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”.

Ndikimi/Efekti: Moszbatim i kushteve të kontratës nga operatori fitues i tenderit, për shkak të vonesave në dorëzimin e mallit.

Shkaku: Mosmarrje masash nga Grupi për Monitorimin e Kontratës për dëmshpërblimin e penaliteteve si pasojë e vonesave në dorëzimin e mallit nga operatori fitues i tenderit.

Rëndësia: e Lartë

2.5.3.1 Rekomandimi: Strukturat përkatëse të SRD-së të ngarkuara me monitorimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratave të prokurimeve të marrin masa që në të ardhmen të raportojnë në kohë vonesat mbi dorëzimin e mallit/shërbimit apo punëve publike dhe arsyet mbi këto vonesa duke mbajtur procesverbale dhe raporte me operatorët fitues të këtyre procedurave duke i parashtruar detyrimet që rrjedhin nga kontratat përkatëse dhe penalitetet nëse nuk përmbushin kushtet e kontratave.

2.5.3.2 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **661,440 lekë** lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k.

Afati: Në vijimësi

1.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me atkonstatimin nr.5 dhe nr.6, datë 30.04.2021, njësia e prokurimit pretendon se nevoja dhe kërkesa e SRD për oksigjen është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik fitues të kontratës pavarësisht përfundimit para afatit 12 muaj të kontratës së lidhur sipas marrëveshjes kuadër e cila quhet e ezauruar sipas sasive të përcaktuara në marrëveshjen kuadër edhe pse ka mbaruar 4 muaj para afatit 12 muaj, gjithashtu njësia e prokurimit pretendon se nuk duhet anashkaluar vështirësia e SRD për shkak të fluksit të pacientëve me COVID-19 dhe nevojës së tyre të shtuar për oksigjen.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me atkonstatimin nr.6, datë 30.04.2021 nga njësia e prokurimit për procedurën “Blerje oksigjen leng, omeprazol, human tetanus immunoglobulin ndare ne 3 lote per Spitalin Rajonal Durres për vitin 2020”, ju sqarojmë se : referuar dokumentacionit bashkëlidhur që keni paraqitur (për parantezë grupi i auditimit i ka shqyrtuar dokumentacionet bashkëlidhur edhe gjatë periudhës objekt auditimi madje ndryshe nga sa ju pretendoni ka komunikuar me gjithë strukturat që janë ngarkuar për organizimin, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e procedurës), ju si njësi e prokurimit të procedurës shpreheni se nevoja dhe kërkesa e SRD për oksigjen është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik fitues të kontratës pavarësisht përfundimit para afatit 12 muaj të kontratës së lidhur sipas marrëveshjes kuadër e cila quhet e ezauruar sipas sasive të përcaktuara në marrëveshjen kuadër edhe pse ka mbaruar 4 muaj para afatit 12 muaj, gjithashtu njësia e prokurimit pretendon se nuk duhet anashkaluar vështirësia e SRD për shkak të fluksit të pacientëve me COVID-19 dhe nevojës së tyre të shtuar për oksigjen. Grupi i auditimit vëren se pavarësisht kontratës së lidhur Nr. 588/7 prot, datë 24.03.2020, me cmim 28,396,200 Lek pa TVSH, me afat lëvrimi 12 muaj , sipas grupit të monitorimit të kontratës, grupi i auditimit është vënë në dijeni se Autoriteti Kontraktor për ditët kalendarike në të cilat Spitali Rajonal Durrës ka pasur emergjencë në furnizimin me oksigjen, është furnizuar me aktmarrëveshjen e mirëkuptimit nr.588/9, datë 25.03.2020.

Grupi i auditimit ju sqaron se referuar relacioneve bashkëlidhur që u dërguan në observacione nga grupi i monitorimit të kontratës, për monitorimin dhe evidentimin e situatës sipas nevojave dhe furnizimit të oksigjenit për Spitalin Rajonal Durrës për nevojat e vitit 2020, drejtuar titullarit të Autoritetit Kontraktor, konstatohet se lidhja e marrëveshjes për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasie lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e SRD midis midis Drejtorit të SRD dhe operatorit ekonomik GTS sh.p.k, aktmarrëveshjen e mirëkuptimit nr.588/9, datë 25.03.2020, nuk parashikohet në kontratë, gjithashtu nuk parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik. Gjithashtu mosevidentimi dhe mosrakordimi i strukturave për situatën emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kritereve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik, **ka sjellë dublim procedurash të panevojshme duke e trajtuar furnizimin e oksigjenit si blerje e drejtpërdrejtë pa procedurë prokurimi. Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret parasysh.**

2.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me atkonstatimin nr.6, datë 30.04.2021, nga Titullarja e Autoritetit Kontraktor pretendohet se nevoja dhe kërkesa e SRD për oksigjen është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik fitues të kontratës pavarësisht përfundimit para afatit 12 muaj të kontratës së lidhur sipas marrëveshjes kuadër e cila quhet e ezauruar sipas sasive të përcaktuara në marrëveshjen kuadër edhe pse ka mbaruar 4 muaj para afatit 12 muaj, gjithashtu njësia e prokurimit pretendon se nuk duhet anashkaluar vështirësia e SRD për shkak të fluksit të pacientëve me COVID-19 dhe nevojës së tyre të shtuar për oksigjen.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me atkonstatimin nr.6, datë 30.04.2021 nga titullarja e Autoritetit Kontraktor për procedurën “Blerje oksigjen leng, omeprazol, human tetanus immunoglobulin ndare ne 3 lote per Spitalin Rajonal Durres për vitin 2020” ju sqarojmë se : referuar dokumentacionit bashkëlidhur që keni paraqitur (për parantezë grupi i auditimit i ka shqyrtuar dokumentacionet bashkëlidhur edhe gjatë periudhës objekt auditimi), ju si titullare e Autoritetit Kontraktor shpreheni se nevoja dhe kërkesa e SRD për oksigjen është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik fitues të kontratës pavarësisht përfundimit para afatit 12 muaj të kontratës së lidhur sipas marrëveshjes kuadër e cila quhet e ezauruar sipas sasive të përcaktuara në marrëveshjen kuadër edhe pse ka mbaruar 4 muaj para afatit 12 muaj, gjithashtu titullarja e Autoritetit Kontraktor pretendon se nuk duhet anashkaluar vështirësia e SRD për shkak të fluksit të pacientëve me COVID-19 dhe nevojës së tyre të shtuar për oksigjen. Grupi i auditimit vëren se pavarësisht kontratës së lidhur Nr. 588/7 prot, datë 24.03.2020, me cmim 28,396,200 Lek pa TVSH, me afat lëvrimit 12 muaj , referuar observacionit të grupit të monitorimit të kontratës, grupi i auditimit është vënë në dijeni se Autoriteti Kontraktor për ditët kalendarike në të cilat Spitali Rajonal Durrës ka pasur emergjencë në furnizimin me oksigjen, është furnizuar me aktmarrëveshjen e mirëkuptimit nr.588/9, datë 25.03.2020.

Grupi i auditimit ju sqaron se referuar relacioneve bashkëlidhur që u dërguan në observacione nga grupi i monitorimit të kontratës, për monitorimin dhe evidentimin e situatës sipas nevojave dhe furnizimit të oksigjenit për Spitalin Rajonal Durrës për nevojat e vitit 2020, drejtuar titullarit të Autoritetit Kontraktor, konstatohet se lidhja e marrëveshjes për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e SRD midis midis Drejtorit të SRD dhe operatorit ekonomik GTS sh.p.k, aktmarrëveshjen e mirëkuptimit nr.588/9, datë 25.03.2020, nuk parashikohet në kontratë, gjithashtu nuk parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik. Gjithashtu mosevidentimi dhe mosrakordimi i strukturave për situatën emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik , ka sjellë dublim procedurash të panevojshme duke e trajtuar furnizimin e oksigjenit si blerje e drejtpërdrejtë pa procedurë prokurimi. Përsa më sipër observacioni juaj nuk merret parasysh.

5.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021 , lidhur me atkonstatimin nr.6, datë 30.04.2021, nga Titullarja e AK dhe njësia e prokurimit për procedurën “Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019” pretendohet dhe shprehet se procedura është nisur sipas afateve por për shkak të organizimit të brendshëm të Sektorit të Prokurimeve të SRD dokumentacioni i anulimit të procedurës së mëparshme nuk ju vu në dispozicion grupit të auditimit dhe pas anulimit titullari i AK ka vazhduar me nxjerrjen e urdhrin të ri të prokurimit nr.597, datë 21.03.2019, pra sipas Titullares së AK dhe njësia e prokurimit për procedurën “Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019”, nuk ka pasur vonesa në vlerësimin e nevojës urgjente për oksigjen.

Ndërsa nga Titullarja e AK dhe njësia e prokurimit për procedurën “Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019” pretendohet se marrëveshjen për njohjen dhe zgjidhjen me

mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunksionimin e SRD midis Drejtorit të SRD nga operatori "M. A" sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k me nr.967, datë 22.05.2019 është lidhur sepse është menduar si borxh dhe pa efekte financiare.

Oëndrimi i grupit të auditimit:1. Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me atkonstatimin nr.6, datë 30.04.2021, nga Titullarja e AK dhe njësia e prokurimit për procedurën "Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019" pretendohet dhe shprehet se procedura është nisur sipas afateve por për shkak të organizimit të brendshëm të Sektorit të Prokurimeve të SRD dokumentacioni i anulimit të procedurës së mëparshme nuk ju vu në dispozicion grupit të auditimit dhe pas anulimit titullari i AK ka vazhduar me nxjerrjen e urdhrat të ri të prokurimit nr.597, datë 21.03.2019, pra sipas Titullares së AK dhe njësia e prokurimit për procedurën "Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019", nuk ka pasur vonesa në vlerësimin e nevojës urgjente për oksigjen. Përsa më sipër grupi i auditimit sqaron se ka shqyrtuar dhe verifikuar çdo dokumentacion të vënë në dispozicion dhe referuar dokumentacionit që ka paraqitur në observacion Titullarja e AK dhe njësia e prokurimit për procedurën "Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019" **ju sqarojmë se nevoja për oksigjen nga pavionet e SRD referuar dokumentacionit në dosje daton që në Nëntor të vitit 2018.**

Anullimi i procedurës në sistem ka ardhur si pasojë e parregullsisë së hedhjes së saj në sistemin e APP-së nga vetë Autoriteti Kontraktor, e shprehur kjo në maillet që keni bashkëlidhur në observacionet tuaja drejtuar Grupit të Auditimit. Në rastet e urgjencës për prokurimin e një malli aq më tepër në rastin e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, Ligji për Prokurimin Publik njeh edhe nocionin e shtesës 20 % të kontratave të mëparshme ose ekzistuese ose Negocimin pa Shpallje, duke e relatuar sipas nevojave urgjente që ka Autoriteti Kontraktor. Fakti se nga nevoja urgjente e SRD deri në prokurimin e mallit oksigjen kanë kaluar **5 muaj** nuk përkon me mendimin e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe vlerësimin e nevojës urgjente të SRD-së për oksigjen.

2.Ndërsa nga Titullarja e AK dhe njësia e prokurimit për procedurën "Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019" pretendohet se marrëveshjen për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunksionimin e SRD midis Drejtorit të SRD nga operatori "M. A" sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k me nr.967, datë 22.05.2019 është lidhur sepse është menduar si borxh dhe pa efekte financiare, grupi i auditimit përsa më sipër **ju sqaron se** nga grupi i monitorimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal apo relacion periodik për realizimin e kontratës me nr.597/14 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS të lidhur më datë 30.04.2019 me afat lëvrimi 3 muaj dhe asnjë detaj mbi hapat që ka ndërmarë SRD për problematikat e mësipërme dhe as rakordim me njësinë e prokurimit mbi inicimin njëkohësisht të procedurës së prokurimit kur furnizimi është kryer nga një operator tjetër pa pasur asnjë kontratë në kundërshtim me LPP, gjatë periudhës **Janar-Maj 2019.** Gjithashtu pas furnizimit të SRD me oksigjen, lidhja e marrëveshjes për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga nga e SRD të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunksionimin e SRD midis Drejtorit të SRD nga operatori "M. A" sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k me nr.967, datë 22.05.2019, nuk është e parashikuar në kontratën e lidhur me nr.597/14, datë 30.04.2019 midis SRD dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k. dhe nuk parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik. Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor, njësia e prokurimit dhe grupi i monitorimit të kontratës për mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen gjithashtu për dublim procedurash dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kritereve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik. Përsa më sipër, observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të pasqyrohet në raportin e auditimit.

1.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë

1.10.2021, lidhur me shlyerjen e detyrimeve nga operatori "H. K." sipas ditarit të furnitorit dhe urdhër transfertës nr.156, datë 14.05.2021 i është likujduar operatorit "H. K." 2,302,560 lekë nga Spitali Rajonal Durrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021 lidhur me shlyerjen e detyrimeve nga operatori "H. K." sipas urdhër transfertës nr.156, datë 14.05.2021 i është likujduar operatorit "H. K." në vlerën 2,302,560 lekë nga Spitali Rajonal Durrës. Grupi i auditimit konstaton se nuk rakordon ditari i furnitorit me likujdimin që i është bërë operatorit dhe mbajtja e vlerës së penaltetit ndaj operatorit fitues së tenderit për vonesat në sjelljen e mallit në SRD sepse në ditarin e furnitorit i datës 25.09.2021 pagesa që i është bërë operatorit "H. K." është 2,964,000 lekë ndërsa sipas urdhër transfertës nr.156, datë 14.05.2021 i është likujduar operatorit "H. K." në vlerën 2,302,560 lekë. Në ditarin e furnitorit rezulton gjendja e një vlere me minus 156,000 lekë që nuk shpjegohet, pra nuk ka një analizë të mbajtjes së penaltetit dhe rakordim zyrtar të detyrimeve me furnitorin. Për arsyet e mësipërme observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në raportin përfundimtar të auditimit.

2.5.4 Titulli i Gjetjes: Mos argumentim i kriterëve dhe specifikimeve teknike në procedurat e prokurimit

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstauan mangësi në lidhje me argumentimin teknike dhe ligjor të specifikimeve teknike, si dhe të dokumentimin e tyre në procesverbalin e mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, konkretisht:

"Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2020 – 2 lote", me fond limit 1,689,000 lekë, kanë marrë pjesë 2-4 operator për çdo lot

"Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2019 – 6 lote", me fond limit 9,264,000 lekë, kanë marrë pjesë në 6 lote i njëjti operator

"Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës viti 2020 – 7 lote", me fond limit 10,500,000 lekë, kanë marrë pjesë 1 – 2 operatorë në çdo lot

"Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës" viti 2019, me fond limit 1,444,930 lekë, kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik

"Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri viti 2019", me fond limit 11,207,182 lekë ka marrë pjesë vetë një operator ekonomik

"Blerje protoksid azoti për SRD për nevojat e vitit 2020" me fond limit 4,568,400 lekë ka marrë pjesë 1 operator ekonomik

Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se vendosja e kriterëve të pa argumentaura ligjrisht dhe teknikisht ka sjell uljen e konkurrencës dhe paraqitjen e ofertës nga vetëm një operator i cili kishte ofertën më të ulët gjatë fazës së studimit të tregut (përlllogaritja e fondit limit) dhe oferta e ofruar nga ky operator është në kufirin e fondit limit. Në kundërshtim me neni 61, pika 2, paragrafi II e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 20 "Mosdiskriminimi" i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi II, në të cilin citohet se;

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre....

Nenin 20 "Mosdiskriminimi" i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik"

"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre."

Ndikimi/Efekti: Mungesë transparence mbi kriteret teknike dhe specifikimet si dhe mundësi për konfuzion dhe paqartësi tek OE.

Shkaku: Mosargumentim i specifikimeve teknike të vendosura në lidhje me mallrat objekt i

kontratës, si dhe kriteret teknike që duhet të plotësojnë OE pjesëmarrës në procedure.

Rëndësia: e lartë

2.5.4.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marri masa që grupet e ngritura për hartimin e specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentojnë ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura në procedurat e prokurimit duke shmangur konfuzion, ankesa gjatë procedurës së prokurimit, rritjen e konkurrencës si dhe tejzgjatje të procedurave.

Afati: në vijimësi

Për sa më sipër mban përgjegjësi:

Për procedurën “*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2020 – 2 lote*”: E. M., shefe e Laboratorit Biokimik, S. K., Laboratori i Anatomisë Patologjike, A. I., ekonomiste, D. M., Laboratori i Mikrobiologjisë, B. S., Farmaciste

Për procedurën “*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës*”: viti 2019 – 6 lote”, M. K., shefe e Laboratorit Biokimik, S. K., Laboratori i Anatomisë Patologjike, F. I., ekonomiste, D. M., Laboratori i Mikrobiologjisë, A. M., Farmaciste

Për procedurën “*Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës viti 2020 – 7 lote*”: E. M., shefe e Laboratorit Biokimik, S. K., Laboratori i Anatomisë Patologjike, A. I., ekonomiste, D. M., Laboratori i Mikrobiologjisë, B. S., Farmaciste

Për procedurën “*Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës*”: viti 2019 A. D., përgjegjëse e sektorit të mjedisit, B. K., specialiste e sektorit të shërbimeve mjedisore, G. Q., ekonomiste. Për procedurën “*Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri viti 2019*”: I. D., H. P., L. S., E. K.. Për procedurën “*Blerje protoksid azoti për SRD për nevojat e vitit 2020*”: B. M., B. S., E. C..

2.5.5.1 Titulli i Gjetjes : Marrja në dorëzim e mallrave jo sipas specifikimeve teknike

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të funizimit u konstatua se në 2 raste grupet e marrjes në dorëzim nuk kanë verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave të marrë në dorëzim, konkretisht:

- Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD të përfaqësuar nga G. K. (në mungesë me porosi) dhe z. B. C., administrator i G. shpk, në asnjë rast grupi i marrjes në dorëzim nuk ka dokumentuar verifikimin e kite/reagenteve në lidhje me origjinën e mallrave dhe kompanisë prodhuese në përputhje me kërkesat e kontratave të lidhura.

Si dhe grupi i marrjes në dorëzim ka pranuar kite dhe reagente jo sipas afatit të skadencës të specifikuar në kontratë në vlerën 1,223,100 lekë me TVSH, që janë në kundërshtim me specifikimet teknike të Ankesit nr. 1 të Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019.

- Nga auditimi i zbatimit të Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 me 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5 rezulton se deri në fund të periudhës objekt auditimi janë marrë në dorëzim kite dhe reagente në vlerë 1,794,360 lekë për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës.

Kriteri: Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD të përfaqësuar nga G. K. (në mungesë me porosi) dhe z. B. C., administrator i G. shpk, Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5.

Ndikimi/Efekti: Mos sigurimi i mallrave me origjinën e kërkuar dhe jo sipas jetëgjatësisë së kërkuar me efekt në përdorimin e tyre.

Shkaku: Marrja në dorëzim e mallrave jo sipas specifikimeve teknike

Rëndësia: i lartë

2.5.5.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës dhe Grupet e Marrjes në Dorëzim të marrin masa që të verifikojnë plotësimin e të gjitha kriterëve dhe të shprehen në mënyrë eksplicite në procesverbalet e hartuara për këtë qëllim.

Spitali Rajonal Durrës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për pranimin e mallrave jo sipas specifikimeve teknike në vlerën 1,223,100 lekë me TVSH dhe mos shprehjen e plotësimin të

kritereve në vlerën 1,794,360 lekë për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës.

Afati: në vijimësi

Për sa më sipër mban përgjegjësi:

Marrëveshje kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD të përfaqësuar nga G. K. (në mungesë me porosi) dhe z. B. C., administrator i G. shpk. Grupi i marrjes në dorëzim është caktuar me urdhërin nr. 1494/6, datë 07.08.2019, i përbërë nga:

1. M. K.
2. S. K.
3. F. I.
4. D. M.
5. A. M.

Marrëveshja Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5. Me Urdhrin nr. 1535/2, datë 08.09.2020 është ngritur komisioni i planifikimit të kontratave të funizimit

1. E. M., shefe e Laboratorit Biokimik
2. S. K., Laboratori i Anatomisë Patologjike
3. A. I., ekonomiste
4. D. M., Laboratori i Mikrobiologjisë
5. B. S., Farmaciste

2.5.5.2 Titulli i Gjetjes: Mos sigurimi i periudhës së garancisë së jetëgjatësisë së mallrat të prokuruar sipas specifikimeve teknike

Situaata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019 me objekt “*Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri 2019*” me garanci 1 vit për pjesët e blera, lidhur me OE “He. & Li.” me vlerë 11,207,000 lekë pa TVSH me afat zbatimi 7 ditë, u konstaua se:

Mallrat kanë ardhur shoqëruar me Faturën nr. 8237215, datë 18.07.2019 me vlerë 13,448,400 lekë me TVSH.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm me Urdhër Shpenzimin nr. 3, datë 02.08.2019 është kryer pagesa në vlerën 13.448,400 lekë

Relacioni i ekzekutimit të kontratës nr. 1851, datë 04.10.2019 i komisioni i marrjes në dorëzim shprehet se kontrata është realizuar në kohë dhe cilësi.

Me kryerjen e pagesës në vlerë të plotë (100% të vlerës) institucioni nuk ka siguruar garancinë prej 1 viti të pjesëve të blera të skanerit në kundërshtim me specifikimet teknike të Kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019.

Kriteri: specifikimet teknike të Kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019.

Ndikimi/Efekti: Mos sigurimi i mbrojtjes së Spitalit në rastin e difektit të mallit brenda periudhës së garancisë

Shkaku: Kryerja e pagesës së plotë pa përfunduar garancia e mallit

Rëndësia: e lartë

2.5.5.2 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, Grupet e Monitorimit të Kontratës dhe Sektori i Financës të marrin masa që në të ardhmen të mos kryejnë pagesa të plota të vlerave të kontratave kur në specifikimet e kontratave përfshihet periudhë garancie duke siguruar mbrojtje të Spitalit në rastet e defekteve brenda periudhës së garancisë.

Afati: në vijimësi

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi

Me Urdhrin nr. 1328/8, datë 17.07.2019, është ngritur grupi i monitorimit të kontratës:

1. H. P.
2. I. D.
3. E. K.
4. V. Gj. (nuk ka firmosur)
5. L. S.

Autorizimi i pagesës së mësipërme është kryer nga I. V. me detyrë kontabiliste dhe G. K., me detyrë ish Nen Drejtor Ekonomik.

2.5.5.3 Titulli i Gjetjes: Skualifikim i OE me ofertë ekonomisht më të ulët.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës” për vitin 2019, me fond limit 1,608,029 lekë konstatohet se KVO ka skualifikuar OE A. P. me ofertë 1,188,000 lekë pasi ka paraqitur ofertë vetëm për një nga zërat e kërkuar dhe jo për shërbimin e “Transport dhe evadim dysheke” si dhe OE Fj. – 2006 me ofertë 1,240,050 lekë është skualifikuar pasi ka ofruar më shumë se sasia e kërkuar

Nr.	Emërtim	Sasia	Cmimi/njësi	Cmimi total
1	Transport dhe evadim i mbetjeve urbane	2409	450	1,084,050
2	Transport dhe evadim dysheke	130	1200	156,000
Totali pa TVSH				1,240,050
Totali me TVSH				1,488,060

Sasia e kërkuar është 2079 m³

Operatori i F.-2006 është skualifikuar pasi ka ofertuar më shumë njësi si edhe shumatore e çmimit për njësi është më i madh por realisht zëri “Transport dhe evadim dysheku” është fiks në sasi dhe nuk është objekt ndryshim sasi në marrëveshjen kuadër. Zëri që është objekt ndryshimi sasi është “Transport dhe evadim i mbetjeve urbane” dhe cmimi për njësi i cili duhet të krahasuar. Gjithashtu kriteri i vlerësimit në DST është “cmimi më i ulët” dhe jo “cmimi më i ulët për njësi”. Baza për vlerësim nga KVO janë kriteret dhe metodat e përshkruara në DST.

KVO nuk ka komunikuar apo kërkuar shpjegime nga OE duke qenë se oferta e paraqitur është ekonomisht më e favorshme dhe nga një rillogaritje e ofertës duke ulur sasinë e kërkuar oferta është 1,091,550 lekë ose 353,380 lekë më pak se OE i shpallur fitues.

Kriteri: Neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” i Vendimit të KM nr. 941, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”

Neni 1 “Objekti dhe qëllimi” Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

2. *Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*

2. *Qëllimi i këtij ligji është:*

a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*

b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*

dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) *mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*

b) *transparencë në procedurat e prokurimit;*

c) *barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.*

Ndikimi/Efekti: shpenzim jo efektiv në vlerën **353,380 lekë.**

Shkaku: skualifikim i padrejtë

Rëndësia: i lartë

2.5.5.3 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, komisionet e vlerësimit të ofertave të marrin masa që rast pas rasti të shqyrtojnë dhe vlerësojnë me përgjegjësi duke kërkuar shpjegime nga OE në rastet kur e gjykojnë të nevojshme dhe ofertat janë ekonomikisht të favorshme për institucionin dhe eliminimin e shpenzimeve jo efektive.

Afati: në vijimësi

2.5.5.4 Titulli i Gjetjes: Ndryshimi i njësisë matëse të mbejtjeve urbane

Sitauata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së “Shërbim i evadimit të mbejtjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës” konstatohet se grupi i monitorimi i kontratës kryen matjen e mbejtjeve me volum të cilat grumbullohen në cdo pavion me thasë mbejtjesh urbane të siguruara nga kontraktori (thasë 50 litra), dhe mbushja e tyre meret e mirëqenë pa siguruar ngjeshjen e mbejtjeve dhe eliminuar volumet e krijuara midis mbejtjeve apo edhe brenda mbejtjeve (kuti, bidona, etj.), sipas deklaratës verbale të grupit të monitorimit matja e thasëve dhe mbushjes së tyre bëhet me sy.

Kriteri: Në raportet e INSAT njësia matëse e mbejtjeve urbane është ton (pra nën njësi matjeve kg) duke e bërë më të matshme dhe objektive.

Ndikimi/Efekti: Monitorim jo i saktë i kontratës

Shkaku: Njësia matëse vëllimi

Rëndësia: e lartë

2.5.5.4 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës si dhe grupet e ngritura për hartimin e specifikimeve teknike të marrin masa që në kontratat e evadimit të mbejtjeve urbane të ndryshojnë mënyrën e matjes nga volum (subjektive) në peshë duke shmangur subjektivizmin në matjen e tyre gjatë zbatimit të kontratës.

Afati: në vijimësi

3. 6. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.)

Gjendja e bankave në fillim dhe fund viti për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2020, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në tabelën si më poshtë:

Lekë

Viti 2019		
Banka	Gjendja 01.01.2019	Gjendja 31.12.2019
A. Bankë	12,771,432.59	34,079.81
R. Bankë	692,845.53	129,364.33
C. Bankë	142,330.44	5,193,732.55
Viti 2020		
Banka	Gjendja 01.01.2020	Gjendja 31.12.2020
A. Bankë	34,179.81	8,922,446.26
R. Bankë	129,364.53	624,010.58
C. Bankë	5,193,732.55	742,645.05

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

Arkëtimet për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2021, sipas veprimeve të kryera me arkë dhe bankë, pasqyruar në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Lekë

Viti	Arkëtimet nga pavionet (veprime me arkë)	Arkëtimet nga ambientet me qira (veprimet me bankë)	Totali i arkëtimeve
2019	47,290,000	3,700,000	50,990,000
2020	42,558,000	3,128,000	46,088,000
Janar 2021	3,973,550	169,600	4,143,150
Totali	93,821,550	6,997,600	101,221,150

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

2.6.1. Titulli i gjetjes: Barna dhe kite reagent të marra jashtë afateve të skadencës.

Situata: a) Në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, midis SRD dhe OE “M.” SHPK është lidhur kontrata nr. 2079/5 prot., datë 18.09.2018, për procedurën “B11-Blerje barna anestezi renimacion dhe sistem kardiovaskular” me fond limit 104,040 lekë pa TVSH e ndarë në 37-lote.

- Për Lot 2 “Adrenalin me sasi 1275 Flakon/Ampule” me vlerë 52,020 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 1178 prot., datë 30.04.2018, të Drejtorit të SRD është ngritur komisioni për monitorimin dhe marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave për kontratën i përbërë nga A. M. kryetare e komisionit A. B. anëtar dhe G. S. anëtare. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 260527446, datë 14.11.2018, në vlerën 36,393 lekë.

Nga komisioni i sipërpërmendur më datë 14.11.2018, është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim së mallrave ku konstatohet se, afati i skadimit të Barnave (Adrenalinë në vlerën 36,393 lekë) është 8.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (9.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 385, datë 14.11.2018. Likuidimi është kryer sipas transaksionit më datë 25.03.2019, në A. Bankë. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe të lidhur midis SRD dhe OE “M.” SHPK nr. 2079/5 prot., datë 18.09.2018, Aneksi 2 (sipas DST ref. Shtojca 10), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: **“Specifikimet Teknike”, Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ose/jo më pak se një vit nga data e lëvrimit të mallit.**

Të dhënat e detajuara të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Kodi	Përshkrimi	Fletë-hyrje në magazinë	Seria	Data skadence	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH në lekë	Afati i skadencës
000000112	Adrenalinë prof 0.1%-1ml x 10amp	14.11.2018	1801	30.07.2019	AMP	892	40.80	36,393	8.5 muaj
TOTALI								36,393	

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

b) Në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, midis SRD dhe OE “M.” SHPK është lidhur Kontrata nr. 2079/6 prot., datë 18.09.2018, për procedurën “Blerje barna sistemi nervor” me fond limit në vlerën 1,407,888 lekë pa TVSH e ndarë në 32-lote.

- Për Lot 1 “Morphine me sasi 1750 Flakon/Ampule” me vlerë 302,400 lekë pa TVSH.

- Për Lot 10 “Pethidine hydrochloride me sasi 340 Flakon/Ampule” me vlerë 49,572 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 1178 prot., datë 30.04.2018, të Drejtorit të SRD është ngritur komisioni për monitorimin dhe marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave për kontratën, i përbërë nga A. M. kryetare e komisionit, A. B. anëtar dhe G. S. anëtare. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 260527445, datë 14.11.2018, në vlerën 246,380.40 lekë.

Nga komisioni i sipërpërmendur më datë 14.11.2018, është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim së mallrave ku konstatohet se, afati i skadimit të Barnave (Morfine 10mg/1mlx10amp në vlerë 211,680 lekë) është 9.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (10.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 387, datë 14.11.2018. Likuidimi është kryer sipas transaksionit më datë 25.03.2019, në A. Bankë. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe të lidhur midis SRD dhe OE “M.” SHPK nr. 2079/6 prot., datë 18.09.2019, Aneksi 2 (sipas DST ref. Shtojca 10), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: **“Specifikimet Teknike”, Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ose/jo më pak se një vit nga data e lëvrimit të mallit.**

Të dhënat e detajuara të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Kodi	Përshkrimi	Fletë-hyrje në magazinë	Seria	Data skadence	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH në lekë	Afati i skadencës
238/347	Petidina cloridrato 100mg/2ml monico	14.11.2018	CA110	30.03.2020	AMP	238	145.80	34,700	15 muaj
236/105	Morfine 10mg/1ml x 10amp	14.11.2018	1702	30.08.2019	AMP	1,225	172.80	211,680	9.5 muaj
TOTALI								246,380	

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

c) Në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, midis SRD dhe OE "G." SHPK është lidhur Kontrata e Furnizimit nr. 2308/7 prot., datë 04.10.2018, për procedurën "Blerje kite Reagent (teste) për analizën e astrupogrames dhe elektroliteve" me fond limit në vlerën 768,000 lekë pa TVSH. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 6498, datë 15.11.2018, në vlerën 364,875 lekë. Në procesverbalin e datës 15.11.2018, e mbajtur për marrjen në dorëzim të mallrave nga A. M., A. B. dhe M. K., nuk specifikohet urdhri për ngritjen e këtij komisioni. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave konstatohet se, afati i skadimit të Kiteve (Kartixhe Ph PO2PCO2 në vlerën 364,875 lekë) është më pak se 12 muaj. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 392, datë 15.11.2018. Likuidimi është kryer sipas transaksionit më datë 26.02.2019, në A. Bankë. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK nr. 2308/7 prot., datë 04.10.2018, Aneksi 2 (sipas DST), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *Specifikimet teknike: Blerje kite dhe reagent (teste) për analizën e astrupogramues dhe elektroliteve. Reagentet të kenë datë skadence jo më të vogël se 1 vit. Të ketë të bashkëngjitur katalogun shoqërues të funksionimit të aparatit.*

Të dhënat e detajuara të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Kodi	Përshkrimi	Fletë-hyrje në magazinë	Data skadence	Seria	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH në lekë	Afati i skadencës
6526	Kartixhe Ph PO2PCO2	15.11.2018	30.04.2019	181029	Teste	1,400	260.63	364,875	6 muaj
TOTALI								364,875	

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

d) Në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, midis SRD dhe OE "G." SHPK është lidhur Kontrata e Furnizimit nr. 1836/6 prot., datë 01.08.2018, për procedurën "Blerje kite dhe reagent për SRD" me fond limit në vlerën 9,999,999.60 lekë pa TVSH.

- Për Lot 8 "Kite reagent për mikrobilologji (antibiotik)" me fond limit në vlerën 855,710 lekë pa TVSH. Me urdhrin nr. 1862 prot., datë 02.10.2018, të Drejtorit të SRD është ngritur komisioni për monitorimin dhe marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave për kontratën, i përbërë nga A. M. kryetare e komisionit, M. K. anëtare, G. S. anëtare. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 7310, datë 28.12.2018, në vlerën 66,552 lekë. Nga komisioni i sipërpërmendur më datë 28.12.2018, është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim së mallrave ku konstatohet se, afati i skadimit të Kiteve (Blood-Agrar në vlerën 36,000 lekë dhe X.L.D. Agrar në vlerën 30,552 lekë) të marra në dorëzim është më pak se 24 muaj. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 443, datë 28.12.2018. Likuidimi është kryer sipas transaksionit më datë 26.02.2019, në A. Bankë. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK nr. 1836/6 prot., datë 01.08.2018, Aneksi 2, (sipas DST), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *Specifikimet teknike Loti 8: Për këtë lot teste duhet të jenë teste card me datë skadence më shumë ose = me dy vjet nga koha e dorëzimit. Të gjitha disqet duhet të jenë me datë skadence jo më të vogël se dy vite nga data e mbylljes së kontratës dhe të kenë paketim të posaçëm conform EU. Ready Culture media 55 mm contact plates. Të gjithë flakonët duhet të jenë me datë skadence më të madhe ose = me 2 vjet. Malli i furnizuar duhet t'i përgjigjet specifikimeve teknike dhe cilësore të përcaktuara.*

Të dhënat e detajuara të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Kodi	Përshkrimi	Fletë-hyrje në magazinë	Data skadence	Seria	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH në lekë	Afati i skadencës
10142	Blood-Agrar	28.12.2018	28.02.2019	112618078	Copë	300	100	36,000	2 muaj
402570	X.L.D. Agrar	28.12.2018	30.09.2019	092118042	Flakon	38	670	30,552	9 muaj
TOTALI								66,552	

Burimi i të dhënave: SRD/Përpunoi Grupi i Auditimit

Për sa më sipër, nga SRD janë marrë në dorëzim barna dhe kite reagente në vlerën totale 679,500 lekë (barna në vlerën 248,073 lekë + kite reagent në vlerën 431,427 lekë) jashtë afateve të skadencës referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratat dypalëshe të lidhura me OE. **Vlera 679,500 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.**

Kriteri: Kontratat e lidhura midis palëve.

Shkaku: Marrja në dorëzim e barna dhe kite reagentëve jo sipas afateve të skadencës të përcaktuara në specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë.

Ndikimi/Efekti: Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 679,500 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.1.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD, të analizojnë efektin negativ financiar në vlerën 679,500 lekë si dhe të marrin masa për të ngritur një grup pune për verifikimin nëpërmjet sistemit të fletëdaljeve nga Farmacia e Spitalit, sasinë e medikamenteve të konsumuara brenda afatit të skadencës referuar kontratave të sipërpërmendura. Në rast evidentimi të sasisë së mbetur të skaduar nga këto medikamente, të llogaritet vlera e tyre dhe t'i kërkohet operatorëve ekonomikë sipas kontratave përkatëse si dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës për pranimin e mallit jashtë kushteve kontraktuale. Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, të zbatohen me përpikëmeri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: znj. A. M., z. A. B., znj. G. S. dhe znj. M. K. në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave.

2.6.2. Titulli i gjetjes: Kamatëvonesa të akumuluar si pasojë e mos likuidimit në kohë të pagesave për faturat e konsumit të ujit.

Situata: Për periudhën objekt auditimi për sa i përket furnizimit me ujë të vet institucionit, SRD operon nëpërmjet dy kontratave të lidhura me UKD SHA konkretisht, kontrata nr. 1527002 dhe kontrata nr. 1088586. Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për 61 transaksionet e kësaj periudhe (2019-2020) në vlerën 31,399,200 lekë rezultojnë kamatëvonesa të akumuluar të mbartura para periudhës objekt auditimi të cilat lindin detyrimin në vlerën 380,114 lekë ndaj UKD si pasojë e mos likuidimit në kohë të faturave për konsumin e ujit. Shlyerja e detyrimeve në vlerën **380,114 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit, do të sjellë efekt negativ financiar.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv" i ndryshuar, neni 1. (Të dhënat e detajuara janë pasqyruar në aneksin e Raportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002, "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv" i ndryshuar, neni 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite: "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv".

Shkaku: Vonesa në likuidimin e pagesave të faturave për konsumin e ujit.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar në vlerën 380,114 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.2.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet vlera 380,114 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, si detyrime të mbartura. Të evidentohen përgjegjësit dhe të merret vendimi përkatës. Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, është e domosdoshme

marrja e masave urgjente për korigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

2.6.3. Titulli i gjetjes: Përfitimi i shërbimeve pa kontratë dhe pa procedurë prokurimi.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për një rast të përfitimit të shërbimit nga OE “Albtelecom”, për të cilën nuk është përfitur nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimit publik” i ndryshuar, neni 4. SRD për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 21.11.2019, ka përfitur shërbim nga OE “Albtelecom” për përdorimin e telefonave fiks. Në total për këtë shërbim SRD i ka paguar vlerën 211,590 lekë OE “Albtelecom”. Për këtë shërbim nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Paga për këtë shërbim kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik. **Vlera 211,590 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me economicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.**

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite: “Fusha e zbatimit, ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij ligji 12”.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Ndikimi/Efekti: Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 211,590 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.3.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për kontratat e lidhura pa i'u nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet të fondeve publike siç është ai i rastit të mësipërm në vlerën 211,590 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: znj. N. J. me detyrë Drejtor i Spitalit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. I. V. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.6.4. Titulli i gjetjes: Nuk është bërë zbritje e garancisë së punimeve.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për procedurën “Punime hidroizolim terrace për godinën e Kirurgjisë së SRD” me fond limit 8,679,321 lekë pa TVSH, më datë 29.06.2018, është shpallur fitues OE “M.” SHPK me fond limit 5,034,331 lekë pa TVSH. Midis SRD dhe OE “M.” SHPK është lidhur kontrata dypalëshe nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018. Më datë 02.10.2018, nga OE është mbajtur situacioni përfundimtar i punimeve si më poshtë:

Nr.	Nr. analizës	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera në lekë
I		Kirurgjia				
		Punime prishje				
1	2/209	Çmontim ulluqe llamarine	ml	282	30	8,460
2	2/197	Heqje shtresë katrama+lesh guri	m ²	1,695.75	120	203,490
3	2.37/1b	Transport mbeturinash 10 km	m ³	166.50	350	58,275
		Shuma 1				270,225
		Punime Shtresash				
1	2/200	Shtresë llustre e lehtësuar për pjerrësi	m ²	1696.75	450	763,537.5
2	2/239.a	Shtresë termoizoluese polistreroli t=5cm	m ²	1696.75	676	1,147,003
3	Analizë	Shtresë gjeotekstil 200gr/m ²	m ²	1696.75	180	305,415
4	Analizë	Shtresë hidroizoluese membrane PVC	m ²	1899.63	1,250	2,374,537.5
5	Analizë	F.V. shkarkues PVC	copë	12	2,500	30,000
6	Analizë	F.V. airues PVC	copë	39	1,134	44,226
		Shuma 2				4,664,719
		Shuma 1-2				4,934,944

	TVSH 20%				986,989
	Totali				5,921,933
	Zbritet 5% garanci punimesh				296,097
	Shuma për likuidim				5,625,836

OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 94, datë 02.10.2018, në vlerën 5,921,933 lekë me TVSH, likuiduar me transaksionin më datë 24.01.2019, në A. Bankë. Nga auditimi i dokumentacionit justifikues bankar konstatohet se, nga SRD nuk është bërë zbritje garancia në masën 5% në vlerën 296,097 lekë por likuidimi është kryer për të gjithë vlerën e faturës tatimore dhe kontratës duke shkëputur marrëdhëniet kontraktuale me OE “M.” SHPK duke tejkaluar angazhimet e kontratës dypalëshe ku përcakton se pagesa e garancisë duhet të kryhet pasi të përfundojë afati prej 24 muaj i garancisë për mbulimin të defekteve. **Vlera 296,097 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe krijon risk të lartë për garantimin e defekteve të punimeve brenda periudhës së garancisë.**

Kriteri: Kontrata dypalëshe lidhur midis SRD dhe OE “M.” SHPK nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018, neni 14.1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Ekzekutimi i punimeve”, Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidh atë dhe duhet t’i mbarojë punët brenda afatit të mbarimit. Afati i ekzekutimit të kontratës do të jetë 1 (një) muaj si në dokumentat e tenderit. Grafiku i punimeve: Afati për ekzekutimin e kontratës do të jetë 1 muaj. Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet, nga data e dorëzimit të punimeve”.

Shkaku: Nuk është mbajtur vlera e 5% të garancisë.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar në shumën 296,097 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.4.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD të analizohet efekti negativ financiar në vlerën 296,097 lekë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos mbajtjen e garancisë së punimeve për procedurën e prokurimit “Punime hidroizolimi tarrace për godinën e Kirurgjisë së SRD”, si dhe është e domosdoshme marrja e masave urgjente për evidentimin dhe korrigjimin e të gjitha praktikave, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen referuar akteve ligjore në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: znj. I. V. në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Financës.

2.6.5. Titulli i gjetjes: Pagesë siguracionesh për automjete të cilat nuk janë në gjendje pune.

Situata: Me shkresën nr. 571/5 prot., datë 30.04.2020, titullari i SRD ka urdhëruar KPVV për zhvillimin e procedurës “Sigurim automjeteve” me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 571/8 prot., datë 05.05.2020, është shpallur fitues OE “Ans.” me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 187, datë 05.05.2020, në vlerën 259,500 lekë. Bashkëngjitur dokumentacionit justifikues të bankës ndodhen edhe siguracionet e automjeteve.

Të dhënat e detajuara të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Nr	Tipi i automjetit	Sasia	Viti i prodhimit	Data Skadencës	Targa	Nr. Shasisë	Fatura e siguracioneve	Vlera e faturave në lekë me TVSH
1	MB CDI MODEL 211	1	2005	21.10.2020	AA .. MM	WDB90...780536	nr. 89, datë 05.05.2020	27,500
2	MB CDI MODEL 211	1	2005	21.10.2020	DR .. D	WDB902...R781050	nr. 90, datë 05.05.2020	27,500
3	MB CDI MODEL 211	1	2005	19.10.2020	DR .. D	WDB90...R771628	nr. 91, datë 05.05.2020	27,500
4	Volkswagen CRAFTER	1	2011	18.10.2020	AA .. AR	WV1ZZZ...23068	nr. 92, datë 05.05.2020	27,500
5	Volkswagen CRAFTER	1	2014	15.04.2020	AA .. KV	WV1ZZZ2...571	nr. 94, datë 05.05.2020	27,500
6	FORD TRANSIT	1	2018	12.12.2020	AA .. VU	WF0XXX...04	nr. 95, datë 05.05.2020	27,500
7	FORD TRANSIT	1	2018	12.12.2020	AA .. VU	WF0X...50	nr. 97, datë 05.05.2020	27,500
8	FORD TRANSIT	1	2018	12.12.2020	AA .. VU	WF0XX...01	nr. 98, datë 05.05.2020	27,500
9	Volkswagen Transporter	1	2006	15.04.2020	AA .. XG	WV2ZZZ...7	nr. 99, datë 05.05.2020	27,500
AUTOMJETE NDIHMESE								
10	FORD FOCUS	1	2005	15.04.2020	DR .. F	WF05XXG...401	nr. 100, datë 05.05.2020	12,000

Ky shpenzim është likuiduar më datë 10.08.2020, datë 17.11.2020, dhe datë 18.12.2020, në A. Bankë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

- Më datë 29.05.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6.. D, nga z. L. Z. me detyrë shofer, z. M. Gj. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.

- Më datë 25.06.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..1 D, nga z. G. D. Z. me detyrë shofer, z. H. O. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.

- Referuar procesverbaleve të përmendura më sipër, është mbajtur aktverifikimi nr. 712 prot., datë 23.04.2021, ku është konstatuar se të dy automjetet nuk janë në gjendje pune, ku bashkëlidhur këtij aktverifikimi ndodhen dhe fotografitë përkatëse për secilin automjet.

- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6... D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 23, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.

- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6... D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 22, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.

- Për të dy automjetet përgjatë vitit 2020, nuk është tërhequr karburant.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, për Autoambulancën MB CDI Model 211 DR ..79 D, dhe Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR 6... D, nga SRD janë paguar siguracione në vlerë totale 55,000 lekë ndërkohë që të dy automjetet nuk janë në gjendje pune që prej muajve respektive Maj dhe Qershor të vitit 2019. **Vlera 55,000 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.**

Kriteri: Siguracione të paguara për automjetet të cilat nuk janë në gjendje pune dhe Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.07.2011" neni 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim".

Shkaku: Nuk është kryer një analizë e detajuar në lidhje për automjetet të cilat disponon në pronësi SRD, konkretisht për automjetet që janë në gjendje pune dhe jo funksionale.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik në vlerën 55,000 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.5.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet kjo situatë duke nxjerrë përgjegjësitë respektive dhe të merret vendimi përkatës, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 55,000 lekë.

Pretendimi i subjektit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga z. G. K., z. N. M. dhe z. A. Xh. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1626 prot., datë 24.09.2021, protokolluar në KLSH me nr.

132/7 prot., datë 27.09.2021, në lidhje mbi gjetjet dhe rekomandimet mbi pikën nr. 2.6, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Për sa i përket gjetjes suaj, ju sqarojmë se:

1. Sigurimi i automjeteve është i detyrueshëm, në respektim të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në Sektorin e Transportit", ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.07.2011, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009"; si dhe nga vetë rëndësia që kanë AUTOAMBULANCAT për mbarvajtjen e shërbimit SPITALOR.

2. Planifikimi i kërkesës sonë është bërë në respektim të buxhetit të miratuar me Vendimin nr. 10, datë 27.03.2020, të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2020", ku vlera e miratuar e siguracioneve për vitin 2020 është 300,000 lekë (bashkëngjitur vendimi ku është evidentuar vlera e miratuar për zërin 6023300- Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit);

3. Ndër të tjera, vlera prej 300,000 lekë është e miratuar edhe në Vendimin nr. 9, datë 27.03.2020, të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës "Për miratimin e regjistrimit të parashikimeve për vitin 2020".

4. Në momentin e kryerjes së kërkesës sonë të datës 28.04.2020, automjetet që ju konstatojnë kanë qenë parashikuar për tu riparuar, procedurë e cila zhvillohet nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (bashkëlidhur kërkesa e Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara).

5. Procedura e riparimit të automjeteve nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara u anulua gjatë vitit 2020, pasi ishte lidhur kontrata e siguracioneve;

6. Përveç se të parashikuara për tu riparuar, autoambulancat e konstatuara kanë qenë në inventarin e Spitalit Rajonal Durrës, dhe nuk kanë qenë të dala jashtë përdorimit, dhe si të tilla nuk mund të lihen të pa siguruara.

Ndër të tjera, përveç argumentave tona, shkelja juaj nuk është e bazuar në asnjë bazë apo dispozitë ligjore në fuqi.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit

- Grupi i Auditimit nuk është shprehur në asnjë rast se, ky shpenzim nuk ka qenë i planifikuar në Buxhetin e vitit 2020.

- Problematika është trajtuar i referohet procedurës së prokurimit me vlerë të vogël "Siguracione automjetesh", ku dy prej tyre nuk janë në gjendje pune që prej vitit 2019, gjë e cila konfirmohet edhe nga Ju sipas procesverbaleve të mbajtura për konstatim defekti, konsumi i naftës i tërhequr për këto automjete dhe aktverifikimi i mbajtur me nr. 712 prot., datë 23.04.2021.

- Për sa i përket references ligjore është mirë e përcaktuar në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.07.2011" neni 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim".

- Pra për sa trajtuar në referencën ligjore, është kushtëzuese për aq kohë sa automjeti është në qarkullim, ndërkohë të dy autoambulancat nuk kanë qenë në gjendje pune prej 1 viti.

- Nga grupi i auditimit nuk mund të merret në konsideratë fakti që është anuluar procedura e riparimit të autoambulancave dhe për këtë arsye ka ndodhur kjo situatë, por theksojmë se në kërkesën për nisjen e procedurës "Sigurim automjetesh" janë vendosur të gjitha autoambulancat për t'u bërë siguracionin dhe nuk citohet pjesa që dy prej tyre nuk janë në gjendje pune. **Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

2.6.6. Titulli i gjetjes: Mos parashikimi në kontratë i detyrimeve kontraktuale për pagesat për konsumin e energjisë elektrike dhe ujit.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës në lidhje me arkëtimet konstatohet se, midis SRD dhe OE "Shp." SHPK është lidhur kontrata nr. 4371, datë 29.08.2019, për dhënie me qira të sipërfaqes prej 62 m² për ushtrimin e aktivitetit "Mencë" në shërbim të

punonjësve/pacientëve dhe qytetarëve për shërbimet spitalore. Për këtë kontratë OE ka paguar detyrimin mbi konsumin e energjisë elektrike dhe ujit konkretisht:

- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE "Shp." SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e energjisë elektrike në vlerën 611,320 lekë.

- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE "Shp." SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e ujit në vlerën 206,120 lekë.

Për kryerjen e këtyre veprimeve si dokumentacion justifikues shërbejnë procesverbalet e mbajtura nga përfaqësuesi inxhinier z. E. P. me përfaqësuesit e OE, për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe ujit.

Procesverbalet e mbajtura sipas muajve respektive i referohen matësit të vendosur për konsumin e energjisë elektrike dhe pagesës afrofe për konsumin e ujit. Në të dy rastet nuk disponohet asnjë urdhër apo procesverbal për vendosjen e matësit dhe caktimit të tarifës afrofe për pagesën e ujit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, deri në fund të periudhës objekt auditimi matësi i energjisë elektrike nuk është i kolauduar nga OSHEE SHA, por konsumi i saj regjistrohen në linjën kryesore të energjisë të Spitalit. Kjo situatë vjen si pasojë se në kontratën e qiradhënies nuk janë përcaktuar detyrimet kontraktuale midis palëve të cilat lindin për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit. Nga pjesa menaxheriale e SRD nuk janë marrë masat e nevojshme për ndarjen nga linja kryesore e Spitalit të matësit për energjinë elektrike si dhe vendosjen e një matësi për konsumin e ujit, ku të lidhen kontratat respektive me OSHEE SHA për energjinë dhe UKD SHA për ujin, dhe mbi bazën e këtyre faturave të kryen pagesat respektive nga OE.

Kriteri: Në kontratën e lidhur midis palëve nuk janë përcaktuar angazhimet lidhur me detyrimet kontraktuale për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit.

Shkaku: Nga SRD nuk janë marrë masa për amendimin e kontratës dypalëshe.

Ndikimi/Efekti: Risk i lartë për mos pasqyrimin real për detyrimet për pagesën e konsumit të energjisë elektrike.

Rëndësia: E lartë.

2.6.6.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Sektori Juridik, të marrin masa për kryerjen e amendimit të kontratës nr. 4371, datë 29.08.2019, të lidhur midis SRD dhe OE "Shp." SHPK për dhënien me qira të sipërfaqes prej 62 m² për ushtrimin e aktivitetit "Mencë", duke përcaktuar në të edhe detyrimet për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit sipas përcaktimeve të eneteve rregullator përkatës.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Spitalit në cilësinë e nëpunësit autorizues, Njësia e monitorimit të ujit dhe energjisë sipas urdhrit nr. 3, datë 27.01.2019, dhe Sektori Juridik.

Pretendimi i subjektit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga znj. N. J. me detyrë Drejtor i Spitalit Rajonal Durrës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 184/6 prot., datë 24.09.2021, dhe shkresën nr. 1629/4 prot., datë 24.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 132/7 prot., datë 27.09.2021, në lidhje mbi gjetjet dhe rekomandimet mbi pikën nr. 2.6, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

I - Akt konstatimi me nr. 2, datë 30.04.2021, rregjistruar me tonën me nr. 742 prot., datë 30.04.2021, ku është konstatuar pika 6. Parregullsi në procedurën e ndjekur mbi arkëtimet "Në të dyja rastet nuk disponohet asnjë urdhër apo procesverbal për vendosjen e matësit dhe përcaktimit të tarifës së pagesës së ujit".

Deri në fund të periudhës objekt auditimi matësi i energjisë elektrike nuk është i kolauduar nga OSHEE Sh.a, por konsumi i saj regjistrohet në linjën kryesore të SRD.

Kjo situatë vjen si pasojë se në kontratën e qirashënies nuk janë të përcaktuara detyrimet kontraktuale midis palëve të cilat lindin për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit.

Si dhe, nga SRD nuk janë marrë masat e nevojshme për ndarjen nga linja kryesore të matësit për

energjinë elektrike si dhe vendosjen e një matësi dhe UKD Sh.a për ujin, dhe mbi bazën e këtyre faturave të kryhet arkëtimet respektive nga OE.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Spitalit, Grupi i Monitorimit të Kontratës, Sektori Juridik sipas periudha respektive.

Ju sqarojmë se:

Në lidhje me përgjegjësinë e Drejtorit të Spitalit, në gjetjen e mësipërme theksoj se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi titullari i Spitalit Rajonal Durrës, për faktin sepse detyra e titullarit është të drejtoj dhe menaxhoj aktivitetin e institucionit, të ngrej grupi monitorimi të kontratave, nxjerr urdhërat e brendshëm duke përcaktuar personat përgjegjës, grupet e punës, strukturat organike përgjegjëse, detyrat konkrete, sektorët dhe afatet e kryerjes së detyrave të lëna. Në të gjitha rastet nga ana ime, si titullare, janë marrë të gjitha masat për organizimin e punëve duke u nxjerr urdhërat në kohën e duhur dhe për mbikëqyrjen e të gjithë procesit të punës. Në lidhje me konstatimin tuaj ju informoj se, konstatimi i grupit të auditimit për përgjegjësinë e titullarit se në kontratën e qira-dhënies nuk janë përcaktuar detyrimet kontraktuale, nuk qëndron pasi është detyrë e Sektorit Juridik hartimi dhe konceptimi i kontratave të qirasë në përputhje me bazën ligjore në fuqi konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Ato janë të lidhura me subjektet të ndryshme tregtare private, për përdorimin e ambienteve të SRD, që lidhen dhe nënshkruhen sipas të gjithave përcaktimeve me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Ky akt nënligjor, përcakton të detajuara dokumentacionin që duhet të paraqesi subjekti qiramarrës, procedurën që ndjek institucioni publik për përgatitjen dhe nënshkrimin e kontratës, ashtu edhe draftin e kontratës TIP që duhet të përdoret nga njësi publike.

Në rastin konkret, kontrata me nr. 4371, datë 29.08.2019, e nënshkruar ndërmjet SRD-së dhe subjektit “Shp.” SHPK, është realizuar sipas draftit TIP të kontratës së qirasë që i bashkëlidhet VKM nr. 421, datë 12.06.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, pika 5.15, e “nenit 5, të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” të kësaj kontrate ka të përcaktuar “Në ngarkim të “qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Bazuar në këtë detyrim kontraktori, subjekti qiramarrës, ka likuiduar të gjitha detyrimet që janë ngarkuar nga ana e autoritetit kontraktor, sipas faturave përkatëse.

Për sa i përket mënyrës se si përcakton detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin, për këtë subjekt, mund të sqarojmë se nga ana e Drejtorisë së SRD është nxjerrë urdhëri: Për ngritjen e njësisë monitoruese për ujin dhe energjinë elektrike dhe ai me nr. 3, datë 07.01.2019, dhe nr. 49 prot., datë 07.01.2019, urdhëri nr. 4, datë 07.01.2019, Për ngritjen e njësisë monitoruese për kontratat e qirasë dhe nr. 41 prot., datë 09.01.2020, urdhëra këto të cilat kanë të përcaktuar si SRD dhe subjekti si dhe monitorimin e ekzekutimit të kontratave të qirasë.

Nga ana e këtyre grupeve janë përgatitur dhe dorëzuar Relacionet përkatëse me nr. 4 prot., datë 03.01.2019, dhe nr. 2077 prot., datë 11.11.2019, siaps të cilave vihet re qartë se për subjektin “Shp.” SHPK deklarohet se nuk ka detyrime të palikuiduara.

Gjithashtu, në kontratën e qirasë me nr. 1801/2 prot., datë 01.08.2018, e lidhur me subjektin “Shp.” SHPK për sipërfaqen 62 m², në pikat 6, 7, të nenit 3, është përfshirë mënyra dhe dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e detyrimeve për energjinë elektrike dhe ujin.

Konkretisht në pikat 6 dhe 7 të kontratës është përcaktuar:

6. Për shpenzimet e energjisë dhe ujit qiramarrësi duhet të vendosë matës elektrikë dhe matës uji të kolauduar pranë neteve përkatëse.

7. Matësat, si për ujin edhe për energjinë elektrike, do të kontrollohen nga struktura përgjegjëse të Spitalit Rajonal Durrës do të përpilojë një procesverbal i cili do të shërbejë si faturë për qiramarrësin. Me kopjen e këtij proces-verbali qiramarrësi do të bëjë derdhjen e shumës në arkën

e qiradhënësit. PAGESA duhet të kryhet brenda fundit të muajit, pra kjo është detyrë e grupit, ngritja e të cilit është detyrë e titullarit, gjë e cila është bërë.

Duhet të theksoj se institucioni ka nëndrejtor të shërbimeve administrative. Është detyrë e tij “drejtimi dhe kontrolli i të gjithë veprimtarisë ekonomike- financiare të institucionit duke mbajtur përgjegjësi për funksionin e saj, sipas legjislacionit në fuqi (rregullore e SRD, bashkëngjitur)”.

Gjithashtu, nuk është detyra e titullarit të marri në dorëzim sipas kontratave respektive duhet të pranohet sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës. Kjo është përgjegjësi e grupeve të marrjes në dorëzim apo atyre të monitorimit, të nisur nga Titullari dhe kontrolluar nga Nëndrejtori i shërbimeve administrative (rregullore e SRD, bashkëngjitur).

Në këtë rast përgjegjësia e titullarit do të ishte nëse sipas legjislacionit në fuqi nuk do të kishte ngritur grupet dhe komisionet për marrjen në dorëzim të mallrave. Ndërkohë janë marrë të gjitha masat nga ana ime.

E kam theksuar në observacionin nr. 11, që sipas Ligjit nr. 10296, datë 21.12.2011, të Menaxhimit Financiar që:

- Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifikave dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe njerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi. Përgjegjësia e Nëpunësve Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike.

- Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësitë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh në rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivitetet e njësisë.

- Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësive që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre dhe japin llogari në linjë hierarkike deri tek Nëpunësi Autorizues i njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Për sa më sipër, nga ana e Sektorit Juridik, sipas periudha ërkatëse, janë marrë të gjitha masat ecurinë normale të aktivitetit të SRD nga ana e titullarit të institucionit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në asnjë rast Grupi i Auditimit nuk është shprehur për detyrimet kontraktuale të cilat lindin nga kontrata e vitit 2018, por i referohet kontratës së vitit 2019 të nënshkruar nga Drejtori i Spitalit Durrës dhe subjektit “Shp.” SHPK, si dhe në asnjë rast nuk jemi shprehur që ky subjekt është debitor ndaj SRD-së.

Kontrata e vitit 2018, nuk është paraqitur në këtë observacion për të cilën i referoheni edhe argumentit ligjor të kësaj kontrate, edhe pse ajo ka humbur fuqinë juridike.

Përgjegjësia vijon nga pjesa e strukturave menaxheriale dhe deri tek sektori i cili harton kontratat, ku nxirret urdhër për monitorimin e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit për matësit të cilët nuk janë kolauduar dhe për një veprim i cili nuk është i parashikuar në kontratën midis palëve dhe bie në kundërshtim me legjislacionin specifik të enteve rregullatore të energjisë dhe ujit, arsye për të cilën është ngarkuar me përgjegjësi edhe Drejtori i Spitalit.

Problematika kryesore është mbi vërtetësinë mbi të cilën matësi i energjisë elektrike regjistron konsumin në kushtet ku është i pakolauduar. Për sa i përket tarifës së konsumit të ujit po nga ky subjekt nga SRD nuk pasqyrohet situata ku i referohet një argumenti ligjor në të cilën përcaktohet kjo tarifë.

Nga SRD është kryer një veprim financiar (arkëtim) për të cilën nuk është parashikuar në kontratë.

Jemi referuar dokumentacionit justifikues të shoqëruar me procesverbal sipas muajve respektiv, për një produkt tregtar (uji dhe energji) për të cilën nuk ka autorizim ligjor për ta shitur në treg.

Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga znj. V. Gj. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1631 prot., datë 24.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 132/7 prot., datë 27.09.2021, në lidhje mbi gjetjet dhe rekomandimet mbi pikën nr. 2.6, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Masa organizative:

17.1. Rekomandim: Nga Drejtori i Sektorit Juridik të marrin masa për kryerjen e amendimit të kontratës me nr. 4371, datë 29.08.2021, të lidhur midis SRD dhe OE "Shp." SHPK për dhënien me qira të sipërfaqes 62 metra² për ushtrimin e aktivitetit "Mencë" duke përcaktuar në të edhe detyrimet për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit sipas përcaktimeve të enteve rregullator përkatës.

Në lidhje me këtë rekomandim, ju sqaroj se për shka të gjendjes së jashtëzakonshme që po kalon vendi ynë pandemi COVID 16 Subjekti "Shp." SHPK e ka përfunduar kontratën e qirasë me Spitalin Rajonal Durrës më datë 28.08.2020. Ky ambient shfrytëzohet për Shërbimin e Mikrobiologjisë si dhe kabinet për marrjen e Tamponit për një organizim sa më të mirë të punës në Spitalin Rajonal Durrës.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i Auditimit në këtë gjetje është referuar periudhës objekt auditimi, dhe jo pas kësaj periudhe. Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

2.6.7. Titulli i gjetjes: Parregullsi mbi veprimet e kryera me arkë dhe bankë.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:

- Në 10 raste kryesisht përgjatë vitit 2019, mungojnë kërkesës/transaksionit për likuidimin e pagesave për shpenzimet e kryera ndaj operatorëve ekonomikë.
- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli.
- Në 20 raste për vitet 2019 dhe 2020, nuk është bërë regjistrimi i saktë i skadencave së barnave dhe kite reagentëve në farmacinë e institucionit, kjo situatë vërtetohet nga rakordimet midis regjistrimeve sipas fletë-hyrjeve në magazinën e farmacisë, faturave tatimore dhe certifikatave të analizës së mallrave.
- Për 40 raste (transaksione) në vlerën 113,316,417 lekë për vitet 2019 dhe 2020, nga ana e SRD ka vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë (në pagesave të caktuara pjesore ka vonesa nga ana e SRD deri në 3-4 muaj në likuidimin e tyre) duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive si dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 48/2041, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare". Mos likuidimi në kohë i pagesave ndaj operatorëve ekonomik ekspozon SRD ndaj penalteteve të mundshme.
- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, në setin e dokumentacionit justifikues së bankës bashkëngjitur nuk ndodhet urdhri për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.
- Në gjitha raste për vitet 2019 dhe 2020, për sa i përket kontratave të lidhura për barnat, kite reagentëve, medikamenteve, bashkëngjitur dokumentacionit justifikues nuk ndodhet relacioni shpjegues ku duhet të evidentojë kronologjinë për likuidimet e kryera sipas pagesave të faturave pjesore referuar kontratave respektive të sipërpërmendura.
- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 për kontratat e barnave, kite reagentëve dhe medikamenteve, për sa i përket likuidimit të faturave pjesore seti i dokumentacionit justifikues nuk është i sistemuar sipas çdo kontrate respektive, por bashkëngjitur likuidimit ndodhen fatura pjesore për kontrata të ndryshme të cilat i përkasin të njëjtit operator ekonomikë.
- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 në setin e dokumentacionit justifikues të bankës nuk janë bashkëngjitur certifikatat e analizave të barnave, të cilat gjendeshin në farmacinë e institucionit.

Kriteri: Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare" neni 4, neni 6, gërma a, Udhëzimi në 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 37 dhe pika 54, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

Pika 37: “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”.

Pika 54: “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletë-hyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve investimeve, fletë-hyrjen origjinale, procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, etj.”.

- Neni 4: “Pagesë me vonesë” është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e sipërmarrjes tregtare dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji”.

- Neni 6: “Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme”.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i rrjedhës dokumentare mbi mbajtjen e dokumentacionit justifikues së bankës, risqe për krijimin e penaliteteve të mundshme, si dhe të ardhura të pa arkëtuara.

Rëndësia: E lartë.

2.6.7.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për pasqyrimin e të gjithë kronologjisë, regjistrimin në magazinë, plotësimin dhe sistemimin e dokumentacionit justifikues për kontratat e barnave, medikamenteve dhe kite reagentëve referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

2.6.7.2. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe respektive si dhe referuar afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare”, duke shmangur penalitet e mundshme.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Sektori i Financës sipas periudhës respektive.

2.6.8. Titulli i gjetjes: Mos kryerje kontrolli për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit.

Situata: Për vitet 2019-2020, nga Sektori Teknik (zyrë e cila merret me ndjekjen e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit etj..) për automjetet që disponon SRD nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Tërheqja e karburantit për automjetet e SRD kryhet nëpërmjet kartave akses në pikat e OE “Kas.” referuar kontratës të lidhur me këtë operator. Karburanti ngarkohet në sistem ku Sektori i Financës jep autorizimin sipas fletë-daljeve në sistemin elektronik, ku pas tërheqjes të karburantit nga secili automjet, OE lëshon kuponin tatimore ku në të përcaktohet edhe targa e automjetit i cili është furnizuar me karburant, e cila i bashkëngjitet fletë-udhëtimit dhe autorizimet respektive për lëvizjen e automjeteve. Në kushtet kur në fletë udhëtimit nuk është e përcaktuar kilometrazhi në fillim të lëvizjes së automjetit dhe kilometrazhi në fund të lëvizjes sipas autorizimeve/fletë udhëtime përkatëse, nga grupi i auditimit u mbajt aktverifikimi me nr. 712 prot., datë 23.04.2021, për verifikimin faktik të kilometrazheve

për shtatë autoambulancat që disponon SRD. Për sa i përket evidentimit të kilometrave janë kryer rakordimet midis kolaudime/kontrollove teknike të automjeteve sipas datave respektive ku është evidentuar odometri/kilometrazhi dhe gjendjes fakt të datës për të cilën është kryer aktverifikimi. Normativat mbi harxhimin e karburantit për automjetet e SRD për vitet 2019-2021, janë miratuar sipas vendimeve të Bordit Drejtues të SRD si më poshtë:

- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 5, datë 13.03.2019.
- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 5, datë 27.03.2020.
- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 4, datë 15.02.2021.

Automjetet	Targa	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Mesatare e të tre viteve
MB CDI Model 211	AA..MM		11	10	10.5
Volkswagen Crafter	AA..AR		13.5	13	13
Volkswagen Crafter	AA..KV		13	13	13
Ford Transit	AA..VU		11.5	11.5	11.5
Ford Transit	AA..VU	11.5	11.5	12.5	11.5
Ford Transit	AA..VU		11.5	12	11.5
Transporter	AA..XG		12	12	12

Automjetet	Targa	Datat e kolaudimit	Data e verifikimit fakt në terren 23.04.2021	KM sipas datave të kolaudimit	KM sipas datës së verifikimit në terren	KM e përshkruara
MB CDI Model 211	AA..MM	24.12.2020	23.04.2021	373141	383914	10773
Volkswagen Crafter	AA..AR	01.07.2020	23.04.2021	269299	292423	23124
Volkswagen Crafter	AA..KV	24.12.2020	23.04.2021	169936	180946	11007
Ford Transit	AA..VU	15.02.2020	23.04.2021	51512	65027	13515
Ford Transit	AA..VU	08.02.2019	23.04.2021	94	113007	112913
Ford Transit	AA..VU	14.02.2020	23.04.2021	46629	112565	65936
Transporter	AA..XG	18.12.2020	23.04.2021	410191	416859	6668

Automjetet	Targa	Gjendja në fillim Karburantit/litra	Periudha e tërheqjes së e karburantit	Sasia e karburantit në litra e tërhequr sipas kartave	Konsumi i karburantit në litra	Gjendja e karburantit në litra më datë 23.04.2021	Vlera e karburantit të konsumuar në lekë	Çmimi për litër mesatari sht në lekë
MB CDI Model 211	AA..MM	70.06	24.12.2020-23.04.2021	1350	1246	174.05	190,048	152.5
Volkswagen Crafter	AA..AR	98.36	01.07.2020-23.04.2021	2950	2815.72	232.63	438,302	155.7
Volkswagen Crafter	AA..KV	300.12	24.12.2020-23.04.2021	1400	1462.70	237.42	222,997	152.5
Ford Transit	AA..VU	272.48	15.02.2020-23.04.2021	1500	1557	215.45	253,572	162.8
Ford Transit	AA..VU	0	08.02.2019-23.04.2021	14550	14372	178	2,378,336	165.4
Ford Transit	AA..VU	507.99	14.02.2020-23.04.2021	7300	7630.07	177.92	1,187,276	155.6
Transporter	AA..XG	0.35	18.12.2020-23.04.2021	900	857	43.34	130,180	148.7
Totali		1,249.36		29,950	29,940.49	1,258.81	4,782,711	

Automjetet	Targat e automjeteve	Periudha e audituar	Përlogaritja e konsumit të karburantit në litra	Konsumi në litra	Sasia e tërhequr në litra	Diferenca në litra	Çmimi për litër	Diferenca në vlerë/lekë
MB CDI Model 211	AA..MM	24.12.2020-23.04.2021	10773*10.5normativa/100km = 1131	1131	1246	- 115	152.5	- 14,432.5
Volkswagen Crafter	AA..AR	01.07.2020-23.04.2021	23124*13normative/100km = 3006	3006	2815	+ 191	155.7	+ 29,738.7
Volkswagen Crafter	AA..KV	24.12.2020-23.04.2021	11007*13normative/100km = 1430	1430	1462	- 32	152.5	- 4,880
Ford Transit	AA..VU	15.02.2020-23.04.2021	13515*11.5normative/100km = 1554	1554	1557	- 3	162.8	- 488.4
Ford Transit	AA..VU	08.02.2019-23.04.2021	112913*11.5normativa/100km = 12984	12984	14372	- 1388	165.4	- 229,575.2
Ford Transit	AA..VU	14.02.2020-23.04.2021	65936*11.5normativa/100km = 7582	7582	7630	- 48	155.6	- 7,468.6
Transporter	AA..XG	18.12.2020-23.04.2021	6668*12normativa/100km = 800	800	857	- 57	148.7	- 8,475.9
Totali				28487	29939	- 1452		- 235,581.9

Për sa trajtuar më sipër në varësi të konsumit të karburantit, sasia e tërhequr nuk përputhet me

kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Nga verifikimi dhe përlllogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, janë tërhequr më tepër 1452 litra/naftë në vlerën 235,581.90 lekë, të cilat nuk janë plotësuar me dokumentacion justifikues. **Vlera 235,581 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.** Nga ana menaxheriale e administrimit të SRD, Drejtori i Spitalit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Përgjegjësit të Sektorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, Sektori Teknik, pjesa menaxheriale e caktuar për menaxhimin e aktiveve nuk janë marra masat për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të SRD, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit.

Theksojmë se: Kjo problematikë është konstatuar edhe nga Auditimi i kryer nga FSDKSH Tiranë. Referuar Raportit Përfundimtar të FSDKSH Tiranë dërguar në SRD me shkresën përcjellëse nr. 1404/7 prot., datë 06.07.2020, protokolluar në SRD me nr. 445/12 prot., datë 09.07.2020. Për vitin 2019, për 6 Autoambulanca të cilat disponon SRD janë konsumuar 1530.5 litra/naftë më shumë nga duhej të konsumohej sipas normativa të miratuara në vlerën 265,509 lekë. Për sa i përket vitit 2020-deri më 31.01.2021, fund i periudhës objekt auditimi është trajtuar nga grupi i auditimit sipas kolaudimeve/kontrolleve teknike të automjeteve dhe datës së verifikimit në terren 23.04.2021.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 5-10, pika 35, pika 36, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: 5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

6. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

7. Nëpunësit Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre dhe japin llogari në linje hierarkike deri tek Nëpunësi Autorizues i njësisë publike.

8. Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike dhe jep llogari tek Titullari për mënyrën e funksionimit të tyre.

9. Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësisë publike kanë detyrimin që:

a. të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim shkaktareve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve;

b. të marrin masa konkrete për trajtimin e riskut lidhur me aktivet sipas kapitullit II të këtij udhëzimi, dhe zhdëmtimin deri në nivelin e përgjegjësisë së deleguar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike sipas paragrafit 6 të këtij udhëzimi;

c. të propozojnë në linje hierarkike deri tek Titullari masa lidhur me trajtimin e mëtejshëm të aktivitetit të dëmtuar, masa administrative ndaj shkaktarëve deri në ndjekjen penale të tyre.

10. Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.

19. "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e

dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumenta autorizues-janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumenta vërtetues-vërtetojnë kryejnë në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit-janë dokumentat përmbledhës ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Shkak: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mos mbajtjes të kartelave përkatëse të automjeteve dhe moskryerjes së kontrollove periodike mbi konsumin e karburantit.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar në shumën 235,581 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.8.1. Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, Sektori i Financës, Sektori Teknik, të marrë masa, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij.

2.6.8.2. Rekomandimi: Nga Sektori Teknik të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

***Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:** Pjesa menaxheriale, znj. N. J. me detyrë Drejtor i Spitalit në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. I. V. dhe znj. Dh. K. me detyrë Përgjegjëse në Sektorin e Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive, z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Teknik dhe z. B. J. me detyrë Koordinator i Urgjencës.*

2.6.9. Titulli i gjetjes: Nuk është bërë zbritje taksa e markimit për karburantit në likuidimin e pagesave pjesore.

Situata: Duke u bazuar dhe në problematikën e trajtuar nga auditimi i kryer në vitin 2019 nga FSDKSH Tiranë konstatohet se, nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës për vitin 2020 për 25 transaksione në vlerën totale 18,131,495.16 lekë referuar kontratës për furnizimin me karburant naftë me bot dhe me kartë elektronike, SRD ka paguar në llogari të operatorëve ekonomikë “K.” SHPK dhe “K.” SHA vlerën e taksës së markimit (0.614 lekë/litër) në vlerën 69,295 lekë e cila nuk parashikohet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 200, datë 13.03.2013, “Për miratimin e kontratës...”, VKM nr. 498, datë 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” pika 1.3, pika 4.1, gërma b. **Vlera totale 69,295 lekë përbën dëm ekonomik për SRD dhe Buxhetin e Shtetit** vlerë e cila është përfituar padrejtësisht respektivisht nga OE “K.” SHPK në vlerën 53,869 lekë dhe OE “K.” SHA në vlerën 15,425 lekë.

Theksojmë se: Referuar rekomandimeve të dhëna nga FSDKSH rezulton se për vitin 2018-2019 SRD ka paguar për llogari të furnitorëve (K. SHA, K. SHPK dhe “R-E” SHPK) vlerën e taksës së markimit për blerjen e karburantit dhe lëndës djegëse (gazoil dhe solar) në shumën 206,047 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 200, datë 13.03.2013, “Për miratimin e kontratës...” dhe VKM nr. 498, datë 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”

shpenzimet të cilat nuk duhet të faturohen nga furnitorët.

Kriteri: Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, VKM nr. 498, datë 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” pika 1.3, pika 4.1, gërma b.

Shkaku: Nuk është përlllogaritur zbritja e taksës e markimit, sipas faturave pjesore.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik në vlerën 69,225 lekë.

Rëndësia: E lartë.

2.6.9.1. Rekomandimi: SRD të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **69,295 lekë** si përfitim i padrejtë nga operatorët ekonomikë, konkretisht shuma 53,869 lekë nga OE “K.” SHPK dhe shuma 15,425 lekë nga OE “K.” SHA.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: znj. I. V. dhe znj. Dh. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës sipas periudhave respektive.

2.6.10. Titulli i gjetjes: Copëzim i fondeve lidhur me prokurimet me vlera të vogla.

Situata: Nga verifikimi i mallrave e shërbimeve të prokuruar dhe kategorizimi i tyre rezultoi se, për të njëjtin grup mallrash, është tejkaluar limiti ligjor prej 800,000 lekë, si më poshtë:

- Për vitin 2019, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 1,420,435 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Blerje tonera” me fond limit 716,666 lekë pa TVSH, “Blerje letër + kancelari” me fond limit 666,666 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 345,641 lekë pa TVSH duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.

- Për vitin 2020, janë realizuar 4 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 2,086,628 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Blerje letër” fond limit 557,668 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 221,660 lekë pa TVSH, “Blerje tonera” me fond limit 507,300 lekë pa TVSH, duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.

- Për vitin 2020, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit në shumën 801,120 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Shërbime riparimi për automjete” me fond limit 692,700 lekë pa TVSH, “Shërbime riparimi për automjete” me fond limit 100,000 lekë pa TVSH, “Frena dhe pjesë të frenave” me fond limit 98,500 lekë pa TVSH.

- Për vitet 2019 dhe 2020, të gjitha praktikat e dosjeve të prokurimit me vlerë të vogla nuk janë të arkivuara në protokollin e institucionit por ndodheshin në Zyrën e Prokurimit si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli.

Theksojmë se: Parregullsitë të konstatuara edhe nga Auditimi i ushtruar nga FSDKSH, si më poshtë:

Në likuidimin e siguracioneve për 10 (dhjetë) ambulancat, TPL më datë 24.05.2019, në C. Bankë konstatohet se, vetëm për tre mjete janë për t’u paguar në këtë datë, kurse katër mjetet e tjera u mbaron siguracioni në muajin tetor të vitit 2019 dhe tre mjetetve të tjera u mbaron në muajin Dhjetor të vitit 2019.

Në 2 (dy) raste janë vendosur kritere diskriminimi së specifikimet teknike për procedurat me vlera të vogla, konkretisht:

a) Për procedurën “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit Ambulanca 2019”, referuar të dhënave të pasqyruara nga auditimi i FSDKSH diskriminimi për procedurë, pra shkualifikimi i OE, diferencën midis EO të parë dhe të dytë vlera 67,400 lekë përbën dëm ekonomik.

b) Për procedurën “Blerje pjesësh për sistemin e kondicionimit, ventilimit, pompave të qarkullimit të ujit 2019”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, pika c, neni 23, pika 2.

KVO në ftesën për ofertë drejtuar OE në një rast nuk ka përcaktuar grafikun e shërbimit të objektit të prokurimit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël” i ndryshuar, pika 7.

Në procedurën “Blerje materiale shërbimin e kirurgjisë Oro-Maksiofaciale 2019” nuk rezulton të

ketë procesverbal apo aktkonstatim nga persona të fushës apo të kualifikuar për përcaktimin e arsyes së mosfunksionimit të aparaturave dentare, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përgatitjen e procedurës me vlerë të vogël” i ndryshuar.

Për procedurën “Autoklavë” e cila rezultoi të jetë investim kapital, por është blerë në bazë të kontratës nr. 1561/6 prot., datë 22.08.2019, në vlerën 142,500 lekë pa TVSH dhe është likuiduar nga zëri i shpenzimeve 602 “Mallra e shërbime” veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 27.02.2019, “Për zbatimin e buxhetit të Fondit për vitin 2019”.

Kriteri: Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 28, pika 2, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1 dhe pika 8, neni 59, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: Neni 28, pika 2: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”.

Neni 40, pika 1. “Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/ mallra/ shërbim, kur vlera e përllogaritur është më e ulët se 800,000 (tetëqind mijë) lekë në vit”.

Neni 40, pika 8. “Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës përshmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit”.

Neni 59, pika 1. “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mos respektimit të legjislacionit, nga ana e komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

Ndikimi/Efekti: Për procedurat e prokurimit paraqesin shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik.

Rëndësia: E mesme.

2.6.10.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh, arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlera të vogla si dhe protokollimin e procesverbaleve për marrjen e mallrave apo shërbimeve në dorëzim.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: znj. V. C., znj. M. L., z. E. R., znj. I. H., znj. V. G., znj. E. P., znj. J. I. dhe znj. Z. K. në cilësinë e komisionit të procedurave me vlera të vogla sipas periudhave respektive.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 2, datë 30.04.2021

3.7 Mbi përdorimin e të ardhurave dytësore të Spitalit Rajonal Durrës

Nga auditimi për periudhën 01.01.2019-01.01.2021 mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore në Spitalin Rajonal Durrës u konstatua:

Spitali Rajonal Durrës, në përputhje me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, së bashku me aktet ligjore të dala në zbatim të këtij urdhri, ka përfituar të ardhura dytësore nga aktiviteti dytësor që kryen.

Për tarifat e të ardhurave dytësore, Spitali Rajonal Durrës është bazuar në: Qerata e objekteve: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kontratat e qirasë për vitin 2019

Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës është ngritur njësia monitoruese të kontratave të qirasë për vitin 2019 me urdhrin nr.4 prot dt 07.01.2019.Kërkesa me nr.181 prot dt 22.01.2019 , për dhenien me qera të ambienteve të Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2019.Kthimi Përgjigjes me Nr 27/1 prot datë 06.02.2019 nga MSHMS Tiranë e rregjistruar në SRD me nr.181/1 prot dt 11.02.2019 për miratimin e dhenies me qera të ambienteve në SRD. Me vendim qarkullues me Nr.43 dt

27.12.2019 të Bordit Drejtues i SRD është miratuar dhenia me qera të ambjenteve ne SRD.

Gjatë vitit 2019 janë lidhur këto kontrata qiraje:

- 1)Kontrate Qiraje per vendosjen e 9 Makinetave per tregtimin e pijeve te ngrohta , ftohta dhe snack me operatorin ekonomik M. T. shpk Nr.351 Rep,198/1 Kol, e rregjistruar prane SRD me Nr.181/2 prot dt 21.02.2019 me afat 1 vjecar
- 2)Kontrate Qiraje per vendosjen e 15 Makinetave per tregtimin e pijeve te ngrohta , ftohta dhe snack me operatorin ekonomik L. K. me Nr.394 Rep,223/1 Kol, e rregjistruar prane SRD me Nr.304/1 Prot dt 27.02.2020 me afat 1 vjecar
- 3)Kontrate Qiraje per vendosjen e 14 Makinetave per tregtim artikujve te ndryshem me operatorin ekonomik C. P. shpk Nr.667 Rep,377/2 Kol, e rregjistruar prane SRD Nr 469/1 Prot dt 08.04.2019 me afat 1 vjecar
- 5)Kontrate Qiraje per Vendosjen e Depove per kryerjen e Sherbimit te Lavanterise me operatorin ekonomik S. C. shpk Nr.668 Rep,378/4 Kol, e regjistruar prane SRD me Nr.281/1 Prot dt 08.04.2019 me afat 1 vjecar
- 6)Kontrate Qiraje per Vendosjen e Sherbimit te Guzhines me operatorin ekonomik Shp. shpk Nr.2137 Rep, 1127/3 Kol e regjistruar prane SRD me Nr.181/3 Prot dt 04.05.2019 me afat 1 vjecar.
- 7) Kontrate Qiraje per Ambient per ushtrimin e aktivitetetit mence operatorin ekonomik Shp. shpk me Nr.4371 Rep, 2292/3 Kol e regjistruar prane SRD me Nr.1630 Prot dt 29.08.2019 me afat 1 vjecar.
- 8) Kontrate qiraje per Vendosjen e 1 ATM me AX BANK me Nr.6618 Rep,Nr.3356/1 Kol ,e rregjistruar prane SRD me Nr.728/1 Prot dt 23.12.2019 me afat 1 vjecar.

Kontratat e qirasë për vitin 2020

Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durres me urdhrin me nr.41 prot dt 09.01.2020 është ngritur Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirase për vitin 2020. Kërkesa me Nr.187 prot dt 22.01.2020 per dhënien me qera të ambienteve te Spitalit Rajonal Durres për vitin 2020-2021.Kthim Pergjigje me Nr.443/1 prot date 10.02.2020 nga MSHMS Tiranë e rregjistruar në SRD me nr.187/1 prot dt 11.02.2020 për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në SRD.Vendim Qarkullues me nr.3 dt 17.01.2020 i Bordit Drejtues i SRD për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në SRD.

Gjatë vitit 2020 janë lidhur këto Kontrata Qiraje:

- 1) Kontrate Qiraje per vendosjen e 1 ATM-se C. Bank me Nr.204 Rep,105/3 Kol, e rregjistruar prane SRD me Nr.135 prot dt 17.01.2020 me afat 1 vjecar.
- 2)Kontrate Qiraje per vendosjen e 15 Makinetave per tregtimin e pijeve te ngrohta , ftohta dhe snack me operatorin ekonomik L. K. me Nr.999 Rep,431 Kol, e rregjistruar prane SRD me Nr.16/1 Prot dt 26.02.2020 me afat 1 vjecar
- 3)Kontrate Qiraje per vendosjen e 9 Makinetave per tregtimin e pijeve të ngrohta , ftohta dhe snack me operatorin ekonomik M. T. Nr.1103 Rep,493 Kol, e rregjistruar prane SRD me Nr.322/1 prot dt 04.03.2020 me afat 1 vjecar
- 4)Kontrate Qiraje per vendosjen e 14 Makinetave per tregtim artikujve te ndryshëm me operatorin ekonomik C. P. Nr.1429 Rep,712 Kol , e rregjistruar prane SRD Nr 728/1 Prot dt 04.05.2020 me afat 1 vjecar
- 5)Kontrate Qiraje per Vendosjen Shrbimit te Guzhines per Spitalit Rajonal Durres me operatorin ekonomik D. Al Nr.1921 Rep,975 Kol, e regjistruar prane SRD me Nr.924/1 Prot dt 03.06.2020 me afat 1 vjecar
- 6)Kontrate Qiraje per Vendosjen e Depove per kryerjen e Sherbimit te Lavanterise me operatorin ekonomik U. S. shpk me Nr.4652 Rep, 2510 Kol e regjistruar prane SRD me Nr.1812/1 Prot dt 30.10.2020 me afat 6 mujor.
- 7) Kontrate Qiraje per Vendosjen e Depove per kryerjen e Sherbimit te Lavanterise me operatorin ekonomik U. S. shpk me Nr.1758 Rep, 898/1 Kol e regjistruar prane SRD me Nr.898/1 Prot dt 26.05.2020 me afat 5 mujor.

Grupi i auditimit për vitin 2019 , konstatoi se:

Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019, konkretisht referuar kontratës së

lidhur me subjektin “A. Bank”, SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjeçar, për vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Vlera e detyrimit për tu paguar që ka mbetur pa paguar nga për llogari të SRD nga subjekti “A. Bank” është 97,080 lekë.

Në kontratën nr.659/1, datë 05.03.2018 me afat 1 vjeçar vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “Banka C.”, që ka mbetur pa paguar për llogari të SRD është 101,160 lekë.

Për pasojë për çdo kontratë sa më sipër për vitin 2019, Spitalit Rajonal ***Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 221, 640 lekë***, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë “A. Bank” dhe “Banka C.”.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2019, ngritur me urdhrin nr.4 prot 50 dt 07.01.2019, A. D., A. K., N. M., R. P., Dh. K.,E. P., R. C.

Grupi i auditimit për vitin 2020 konstatoi se:

Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “A. Bank” për llogari të SRD është 221, 640 lekë, në kontratën nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “Banka C.” për llogari të SRD është **101,160 lekë**.

Për pasojë për çdo kontratë sa më sipër për vitin **2019, 2020**, Spitalit Rajonal ***Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë***, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë “A. Bank” dhe “Banka C.”.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2020, ngritur me urdhrin nr.41 prot dt 09.01.2020 A. D., A. K., Dh. K., G. K.,A. F., H. M., A. Xh.

Tarifat e Receptioneve: Urdhri i Ministrit nr. 3715/2 prot., datë 26.10.2009, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 01.11.1993 “Për përcaktimin e cmimeve në sistemin shëndetësor shtetëror, si dhe në Urdhrin nr.116, datë 30.03.1999 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore në institucionet shëndetësore”.

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe shërbimeve dytësore:

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve miratohen me vendime të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, i bazuar në nenin 8, 9 dhe 12 të Statutit të Spitalit Rajonal Durrës, të miratuar me VKM nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloret e Spitalit Rajonal Durrës. Konkretisht, për periudhën objekt auditimi, tarifat për lëshimin e vërtetimeve janë miratuar me Vendimin nr.4, datë 13.03.2019, të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, protokolluar me nr.537 prot., datë 13.03.2019, konkretisht për: shërbimin e parkimit, dokumentacionet mjekësore etj.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga parkimi dhe vërtetimet e ndryshme të lëshuara, të ardhura të cilat janë objekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, SRD ka aplikuar tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe i ka deklaruar në librat e shitjes përgjatë periudhës objekt auditimi.

Në total tatimi mbi vlerën e shtuar, i paguar për periudhën objekt auditimi, është në **vlerën 1,553,040 lekë**.

Përdorimi i të ardhurave dytësore, miratohet me Vendim të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, dhe përdoret kryesisht për artikujt e mëposhtëm:

- Artikulli 600: Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli (për punonjësit e traut të parkimit);
- Artikulli 601: Kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore (për punonjësit e traut të parkimit);
- Artikulli 602: Mallra e Shërbime të tjera;
- Artikulli 231: Investime, të cilat në vijim të Vendimit të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.4, datë 30.04.2021

2.7.1.Titulli i Gjetjes: Detyrime të palikujduara nga 2 operatorë Qiramarrës së Ambjenteve të SRD, për vitet 2019, 2020 duke i shkaktuar Spitalit Rajonal Durrës të ardhura të munguara për pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë.

Situata: Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019 dhe vitin 2020 konkretisht referuar kontratës së lidhur me subjektin “A. Bank”, SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjeçar, për vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “A. Bank” për llogari të SRD është 221, 640 lekë, referuar detyrimeve nga kontrata nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “Banka C.” për llogari të SRD është 101,160 lekë.

Për pasojë për çdo detyrim kontraktor të pashlyer përsa më sipër për vitin 2019 dhe vitin 2020, Spitalit Rajonal *Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë*, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë “A. Bank” dhe “Banka C.”.

Kriteri: VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, Kreu VI “Monitorimi i kontratave”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekje e rregullt e veprimtarisë së qiramarrësve në ambjentet e SRD nga Grupi i Monitorimit të Kontratave.

Shkaku: Mosvlerësim nga Grupet e Monitorimit të Kontratave të Qirasë i situatës së krijuar nga zvarritja e pagesave të detyrimeve të qiramarrësve të ambjenteve të SRD-së dhe shkaktimi i të ardhurave të munguara SRD-së, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë

Rëndësia: e Lartë

2.7.1.Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat e ngritura për monitorimin e kontratave të ambjenteve me qira dhe sektorin e financës të analizojë problematikat e mbartura vit pas viti për mosshlyerjen e detyrimeve kontraktore të operatorëve qiramarrës së ambjenteve të Spitalit Rajonal Durrës.

Afati:Në vijimësi

2.7.2 Rekomandimi : Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që të ngrëjë një grup pune për amendimin e Kontratave të Qirasë duke hartuar te drejta dhe detyrime të qarta në raportin e ndërsjellë qiramarrës/qiradhënës gjithashtu shtimin në kontratën e qirave penalitetet, në raste të mosrespektimit të detyrimeve të ndërsjella kontraktore.

Në vijimësi

2.7.3 Rekomandimi : Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës 322,800 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si detyrim kontraktor i pashlyer nga kontratat e qiramarrjes së ambienteve të Spitalit Rajonal Durrës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti “A. Bank” në vlerën 221, 640 lekë dhe nga subjekti “Banka C.” në vlerën 101,160 lekë .

Menjëherë

Për sa më sipër mban përgjegjësi Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2019, ngritur me urdhrin nr.4 prot 50 dt 07.01.2019 dhe Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2020, ngritur me urdhrin nr.41 prot dt 09.01.2020, A. D., A. K., N. M., R. P., Dh. K.,E. P., R. C., G. K.,A. F., H. M., A. Xh.

1.Pretendimi i subjektit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me rekomandimin nr.3.1 masa për shpërblim dëmi Spitali Rajonal Durrës si detyrim kontraktor i pashlyer nga kontratat e qiramarrjes së ambjenteve të Spitalit Rajonal Durrës dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti “A. Bank” dhe nga subjekti “Banka C.”, SRD ka sjellë kartelat e subjektit nga sistemi ku pretendon se këto dy subjekte kanë shlyer detyrimet që

kanë ndaj SRD.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacioneve të ardhura në KLSH nga Spitali Rajonal Durrës me shkresën nr.132/7, datë 27.09.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 1.10.2021, lidhur me rekomandimin nr.3.1 masa për shpërblim dëmi Spitali Rajonal Durrës si detyrim kontraktor i pashlyer nga kontratat e qiramarrjes së ambjenteve të Spitalit Rajonal Durrës dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti "A. Bank" dhe nga subjekti "Banka C.", SRD ka sjellë kartelat e subjektit nga sistemi ku pretendon se këto dy subjekte kanë shlyer detyrimet që kanë ndaj SRD, por ky i fundit ka sjellë vetëm kartelat dhe jo urdhër transfertat nga subjektet në llogari të SRD që të vërtetojë shlyerjen e detyrimeve nga këto subjekte. Përsa më sipër, observacioni juaj nuk merret parasysh dhe do të pasqyrohet në raportin e auditimit.

3.8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve, kreditorëve si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Aktivi i Bilancit

A.I. Aktive të trupëzuara

1. Llogaria 203 "Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme"

Vlera 21.089.185 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar vlera e programeve kompjuterike.

2. Llogaria 209 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara".

Vlera 20.589.265 lekë. Kjo vlerë paraqet amortizimin e akumuluar të këtyre programeve, i llogaritur me vlere 25% për vitin 2019 dhe më pas është llogaritur në bazë të VKM nr.8, datë 09/03/2018.

A. Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

1. Llogaria 212 "Ndërtesa e Konstruksione".

Paraqitet në fund të periudhës në vlerën 2.340.022.272 lekë, e cila në krahasim me fillimin e periudhës ka një rritje prej 10.240.690 lekë. Kjo diference ka ardhur si rezultat i kryerjes së investimeve në Spitalin Rajonal Durrës me vlerë 9.913.268 lekë dhe donacioneve të ndryshme me vlerë 327.422 lekë për shërbimin e Kirurgjisë me vlerë 6.882.219 lekë i takojnë investimeve të kryera me fondet nga të ardhurat dytësore. Inventarin e ndërtesave në fund të vitit do ta gjeni në pasqyrën përkatëse bashkëlidhur këtij bilanci.

2. Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune."

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 876.049.280 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve nga të ardhurat dytësore dhe buxheti në këtë zë në vlerën 20.264.400 lekë. Në llogarinë 214 kemi pakësim në shumën 7.809.912 lekë ku përfshihet (dhënë në përdorim aparati i grafisë Spitalit të Kurbinit me rënien e tërmetit dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit me vlerë 8.585.827 lekë.

3. Llogaria 215 "Mjete Transporti":

Paraqitet e ndryshuar nga viti i mëparshëm me vlerën 77.676.898 lekë. Ka një rritje të këtij zëri me vlerë 20.377.619 lekë (Ambulancat ardhur nga QKUM) dhe paraqitet një ulje pasi është dhënë në përdorim një makinë të Qendrës Sanitare me vlerë 630.000 lekë.

4. Llogaria 218 "Inventar ekonomik".

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 151.158.055 lekë, pra me një rënie prej 6.020.898 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë dy nën llogari:

a) 218/1 "Orendi Zyre".

Vlera në fund të periudhës e kësaj nën llogarie është 109.396.387 lekë.

E cila në fund të periudhës paraqitet me vlerën 160.272 lekë, kjo rritje ka ardhur si rezultat i ndihmave të ardhura nga QSUT dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit me vlerë 5.944.230.

b) 218/6 "Pajisje Kompjuterike".

Vlera në fund të periudhës e kësaj nën llogarie është 41.761.368 lekë. Pra paraqitet me një ulje prej 236.940 lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve.

5. Llogaria 219 "Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara".

Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen 1.239.016.301 lekë. Amortizimi i llogaritur për vitin 2019 është si më poshtë:

-212. Ndërtesa	amortizimi	604.488.499 lekë
-214. Pajisje, vegla pune	“	488.660.126 lekë
-215. Mjete transporti	“	55.046.398 lekë
-218/1 - 218/6 Inventar ekonomik	“	90.821.278 lekë

B. Aktive Qarkulluese.

Aktivet qarkulluese në këtë bilanc paraqiten në vlerën 90.438.191,06 lekë.

Klasa 3. "gjendje inventari"

Gjendja e saj në fund të vitit kap vlerën 90.438.191 lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kjo klasë ka një rritje prej 9.965.442lekë. Kjo rritje i përket llogarive përbërëse të kësaj klase dhe konkretisht:

-Llogaria 31 "Materiale" me gjendjen në fund të periudhës 66.321.292 leke, me një rritje prej 8.930.339 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

-Llogaria 32 "Objekte Inventari" me gjendje në fund të periudhës =24.116.899=lekë, me një ulje prej =1.035.103=lekë në krahasim me një vit më parë si pasojë e nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit.

-Klasa 4. "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët"

Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 411. "Klientë e llogari te ngjashme"

Gjendja në fund të periudhës është 223.665 lekë.

-Llogaria 427. "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba".

Gjendja në fund të periudhës llogarisë 427 dhe 429 është 4.250.528 lekë, një rritje prej 158.278 lekë. Nga këta:

-Debitorë mbi 5 vjet 917.650 lekë.

-Në procese gjyqësore 3.336.717.97 lekë

-Nën 1 vit 1050.482 lekë (Proces gjyqësore me shoferët e Spitalit).

-Llogaria 468 "Debitorë te ndryshëm".

Gjendja e saj në fund të periudhës është 9.390.065 lekë. Pra me një rritje prej 1'306'121 lekë. Nga këto:

-Debitorë mbi 5 vjet 307'269 lekë:

Debitorë të krijuar në vitin 2014 në vlerën 1'786'100 lekë.

Debitorë të krijuar në vitin 2015 në vlerën 168'184 lekë.

Debitorë të krijuar në vitin 2016 në vlerën 1'306'125 lekë.

Debitorë të krijuar në vitin 2019 në vlerën 5.822.391 lekë.

-Klasa 5 "Llogaritë Financiare"

Gjendja e saj në fund të periudhës është 5.357.177 lekë. E analizojmë sipas llogarive që e përbëjnë :

-Llogaria 512. "Llogari në Bankë".

Gjendja e saj në fund të vitit është 6.373.551.89 lekë. Bankat me të cilat operon Spitali Rajonal Durrës janë: Banka C., R. Bank dhe A. Bank. Sa i përket burimit të këtyre fondeve ato përbëhen nga gjendja e Bankës e analizuar më 31.12.2019

-Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar".

Ka gjendje në fund të vitit vlerën 1'016'375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shumë nuk është tërhequr prej tyre deri më 31.12.2019. E analizuar kjo shumë analizohet si më poshtë:

1. Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545.856.

2. Viti 2007 garanci lekë 3.000.

3. Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467'519.

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2019 është 1'016'375 lekë.

Pasivi i Bilancit

A. Fondet e Veta

-Llogaria 10 "Fonde të veta"

Në fund të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 2.206.390.337 lekë, Kjo llogari përbëhet nga

llogaritë si më poshtë :

-Llogaria 101 "Fonde Bazë"

e cila në fund të vitit ka një gjendje prej 2.206.390.337 lekë, kjo shumë është e barabartë me vlerën neto të AQT-ve.

B. Detyrimet

-Klasa 4 "Detyrimet afatshkurtra" Gjendja në fund të periudhës paraqitet me vlerën 92.912.639 lekë pra me një rritje prej 26.057.936 lekë. Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 401 "Furnitorë paraqitet me saldo kreditore" 92.912.639 lekë. Inventarin e kësaj llogarie ia bashkëngjisim këtij bilanci. Të gjithë detyrimet që i përkasin kësaj llogarie do të shlyhen gjate vitit 2020.

-De. Im. 47'838 lekë garanci e parashikuar në kontratë,

-Kri. 18'540 lekë garanci e parashikuar në kontratë,

-Mo. 212'404 lekë nga viti 2008 mall i pa shoqëruar me procedurën përkatëse,

-NSHK 199'800 lekë faturë e thjeshtë pa kupon tatimor,

- Me. 4632 lekë garanci e parashikuar në kontratë,

-Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to" Gjendja në fund të vitit është 34.134.337 lekë dhe paraqet detyrimin e Spitalit për pagat e punonjësve të periudhës 01-31 Dhjetor 2019.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa". Gjendja e saj në bilanc është 2.877.988 lekë dhe paraqet vlerën e Tatimit për të ardhurat nga Punësimi të muajit Dhjetor 2019, që paguhet në muajin Janar 2020.

-Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore. Gjendja e saj është 9.986.384 lekë dhe paraqet detyrimin për Sigurimet shoqërore të muajit Dhjetor 2019 i cili paguhet në Janar 2020.

-Llogaria 436 "Sigurime Shëndetësore" Paraqet edhe kjo shumë prej 1.401.814 lekë e cila është vlera e sigurimit shëndetësor të muajit Dhjetor 2019 i cili paguhet në Janar 2020.

-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje". Gjendja e saj në fund të vitit është 1'013'375 lekë.

Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

1. Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545.856 (Sigers)

2. Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467'519 (Desaret)

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" Në fund të vitit paraqitet me gjëndjen 212,066 lekë

Shpenzimet

Gjatë vitit 2019 janë kryer shpenzime si më poshtë:

-Llogaria 600 "Paga dhe shpërblime te tjera personeli" 497.383.769 lekë

-Llogaria 601 "Kontribute te Sigurimeve shoqërore e shëndetësore" 82.046.597,88 lekë

-Llogaria 602 "Mallra e shërbime te tjera" 396.517.468 lekë,

Totali i llogarisë 60 "Shpenzime Korente" 975.947.835 lekë.

Të ardhurat

Në vitin 2019 të ardhurat paraqiten si më poshtë:

-"Të ardhura jo tatimore" 49.563.300 lekë e analizuar si më poshtë:

-"Të hyra sponsorime nga të tretet" 845.362 lekë, këtu përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet.

-"Të hyra nga mjetet ne ruajtje" 21.000.000 lekë.

-"Te tjera , të arkëtuara " 6.264.127,41 lekë.

-Llogaria "Grande Korrente" 885.188.000 lekë përfaqëson fondin e dhënë nga DRSKSH, për shpenzimet korrente.

Totali i llogarisë 70 "Të Ardhura Korrente" 962.860.789,41 lekë.

Inventarët:

Inventarizimet fizike janë kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria. Janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, me urdhër të brendshëm. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka bërë dhe propozimet për dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune. Ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe proces verbalet përkatëse. Të gjithë

proces verbalet vendosen në dosjet e inventarëve, duke kompletuar në këtë mënyrë dosjen e inventarizimeve fizike. Pas kompletimit të dosjeve janë kryer edhe kontabilizimet.

Buxheti

Realizimi i fondeve buxhetore në lekë dhe në përqindje për vitin 2019 në mijë lekë.

Për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2020 gjendja Financiare e Spitalit Rajonal Durrës paraqitet si më poshtë:

Aktivi i Bilancit

A. I. Aktive të trupëzuara

1. Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme”

Vlera 21.089.185 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar vlera e programeve kompjuterike.

2. Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”.

Vlera 20.643.188 lekë. Kjo vlerë paraqet amortizimin e akumuluar të këtyre programeve, i llogaritur me vlere 15% për vitin 2020 dhe më pas është llogaritur në bazë të VKM nr.8, datë 09/03/2018.

A. Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

1. Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

Paraqitet në fund të periudhës në vlerën 2.348.360.063 lekë, e cila në krahasim me fillimin e periudhës ka një rritje prej 8.337.791 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i kryerjes së investimeve në Spitalin Rajonal Durrës me vlerë 935.135 lek, investime këto të kryera me fondet nga ardhurat dytësore dhe investim nga Ministria në vlerë 7.402.656 lekë ne pavijonin Infektivit të Rriturve në linjën e oksigjenit.

2. Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune.”

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 857.417.873.69 lekë. Në Spitalin Rajonal Durrës është kryer investim nga buxheti 13.638.000 lekë dhe investim nga të ardhurat 1.162.800 leke dhe 897.600 lekë janë investim për Gota Oksigjeni Fluksi metër.

Në këtë zë ka donacione 23.369.775 lekë. Në llogarinë 214 janë nxjerrë jashtë përdorimit materiale me vlerë 57.699.582 lekë. Nga Inventari i kësaj llogarie.

Nga Spitali Korçës ka ardhur një aparat EEG me vlerë 2.130.000 lekë dhe i është bërë dalje Spitalit të Gramshit me të njëjtën vlerë 2.130.000 lekë.

3. Llogaria 215 “Mjete Transporti”:

Paraqitet e ndryshuar nga viti i mëparshëm me vlerën 81.569.978 lekë. Rezulton një rritje e këtij zëri me vlerë 3.893.080 lekë. Kanë ardhur ambulanca nga Ministria e Shëndetësisë me vlerën 12.767.040 lekë. Kanë dalë jashtë përdorimit makinat me vlerë 8.873.960 lekë.

4. Llogaria 218 “Inventar ekonomik”.

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 166.343.580 lekë, pra me një rritje prej 15.185.525.42 lekësh.

Në përbërje të kësaj llogarie janë dy nën llogari:

a)218/1 “Orendi Zyre”.

Vlera në fund të periudhës 2019 e kësaj nën llogarie është 123.197.611 lekë. Kjo vlerë në fund të periudhës paraqitet 13.801.224 lekë, dhe kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve në vlerën 18.801.600 lekë, dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit me vlerën 5.000.376 lekë.

b)218/6 “Pajisje Kompjuterike”.

Vlera në fund të periudhës e kësaj nën llogarie paraqitet 43.145.969 lekë. Pra paraqitet një rritje prej 1.620.000 lekë, pasi në këtë zë janë bërë investime. Po ashtu janë nxjerrë jashtë përdorimi materiale me vlerën 235.399 lekë.

5. Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen 1.300.338.000 lekë: Amortizimi i llogaritur për vitin 2020 është si më poshtë:

-212. Ndërtesa	amortizimi	691.276.877 lekë
-214. Pajisje, vegla pune	“	58.425.716 lekë
-215. Mjete transporti	“	50.698.534 lekë
-218/1- 218/6 Inventar ekonomik	“	99.936.873 lekë

B. Aktive Qarkulluese.

Aktivitet qarkulluese në Pasqyrën Financiare kapin vlerën 72.051.855 lekë. Analiza sipas klasave të këtij grupi paraqiten si më poshtë:

-Klasa 3. "gjendje inventari"

Gjendja e saj në fund të vitit kap vlerën 72.051.855 lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kjo klasë ka një ulje prej 18.396.336 lekë. Kjo rritje i përket llogarive përbërëse të kësaj klase dhe konkretisht:

-Llogaria 31 "Materiale" me gjendjen në fund të periudhës 50.671.704 lekë, me një ulje prej 15.649.588 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

-Llogaria 32 "Objekte Inventari" me gjendje në fund të periudhës 21.380.151 lekë, me një ulje prej =2.736.748=lekë në krahasim me një vit më parë si pasojë e nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit.

Inventarët e këtyre dy llogarive i bashkëlidhen këtij bilanci.

-Klasa 4. "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët"

Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 411. "Klientë e llogari te ngjashme"

Gjendja në fund të periudhës është 272.370 lekë.

-Llogaria 427. "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba"

Gjendja në fund të periudhës e llogarive 427 dhe 429 janë 5.945.951 lekë, me një rritje prej 1.695.423 lekësh. Vlera e tabelës 1.556.540 lekë

-Debitorët mbi 5 vjet paraqiten në vlerën 917.650 lekë

-Në procese gjyqësore 4,201,066 lekë.

-Llogaria 468 "Debitorë te ndryshëm"

Gjendja e saj në fund të periudhës është 9.146.697 lekë. Pra me një rritje prej 1'306'121 lekë. Nga këto:

-Debitorë mbi 5 vjet 307'269 lekë:

-Debitorë të krijuar në vitin 2014 në vlerën 1'786'100 lekë.

-Debitorë të krijuar në vitin 2015 në vlerën 168'180 lekë,

-Debitorë të krijuar në vitin 2016 në vlerën 1'306'125 lekë,

-Debitorë të krijuar në vitin 2019 në vlerën 5.579.023 lekë.

-Klasa 5 "Llogaritë Financiare"

Gjendja e saj në fund të periudhës është 10.289.102 lekë. Situata sipas llogarive përkatëse paraqitet si më poshtë :

-Llogaria 512. "Llogari në Bankë". Gjendja e saj në fund të vitit në bankë është 10.289.102 lekë.

Bankat me të cilat operon Spitali Rajonal Durrës janë: Banka Credins, Raiffaisen Bank dhe Abi Bank. Për sa i përket burimit të këtyre fondeve ato përbëhen si më poshtë;

Gjendja e Bankës e analizuar më 31.12.2020:

në Raiffeisen Bank vlera monetare 24.000.000 lekë të transferuara nga Ax Bank në fund të vitit si xhirim i brendshëm për të kryer likuidimin e pagave të punonjësve për muajin Dhjetor të cilat paguhen në Janar të vitit 2021.

-Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar"

Gjendja në fund të vitit paraqitet në vlerën 11'016'025 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shumë nuk është tërhequr prej tyre deri më 31.12.2019. E analizuar kjo shumë analizohet si më poshtë:

1. Viti 2006	5% garanci punimesh	lekë	545.856.
2. Viti 2007	garanci	lekë	3.000.
3. Viti 2011	5% garanci punimesh	lekë	467'519.
4. Viti 2020	5% garanci punimesh	lekë	9.999.649.6

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2019 është 11.016.025 lekë. E konfirmuar kjo me akt rakordimet me Degën e Thesarit të cilat i bashkëlidhen këtij bilanci.

Pasivi i Bilancit

A. Fondet e Veta

-Llogaria 10 "Fonde të veta"

Në fund të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 2.152.902.095 lekë. Kjo llogari përbëhet nga llogaritë si më poshtë :

-Llogaria 101 "Fonde Bazë"

Kjo llogari në fund të vitit paraqet një gjendjen prej 2.152.902.095 lekë, kjo shumë është e barabartë me vlerën neto të AQT-ve.

B. Detyrimet.

-Klasa 4 "Detyrimet afatshkurtër"

Gjendja në fund të periudhës paraqitet me vlerën 49.778.573,9; lekë pra me një rritje prej 26.057.936 lekësh.

-Llogaria 401 "Furnitorë" paraqitet me saldo kreditore prej 49.778.573.90 lekësh. Inventari i kësaj llogarie i bashkëngjitet bilanci. Të gjithë detyrimet që i përkasin kësaj llogarie parashikohet të shlyhen gjatë vitit 2020.

-De. Im. 47,838 lekë garanci e parashikuar në kontratë.

-Kri. 18,540 lekë garanci e parashikuar në kontratë.

-Me. 4,632 lekë garanci e parashikuar në kontratë.

-Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to" Gjendja në fund të vitit në këtë llogari paraqitet në vlerën 40.853.744 lekë dhe pasqyron detyrimin e Spitalit për pagat e punonjësve të periudhës 01-31 Dhjetor 2020.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" Gjendja e kësaj llogarie në bilanc paraqitet në vlerën 3.962.257,33 lekë dhe përbëhet nga që paguhet në muajin Janar 2021:

1. Tatimit për të ardhurat nga Punësimi të muajit Dhjetor 2020 në vlerën 3.884.376.6 lekë.

2. Tatimi në Burim i muajit Dhjetor 2020 në vlerën 27.847 lekë.

3. TVSH-në e muajit Dhjetor 2020 në vlerën 50.033.73 lekë.

-llogaria 435 "Sigurime Shoqërore. Gjendja e kësaj llogarie është 9,830,768 lekë dhe paraqet detyrimin për Sigurimet Shoqërore të muajit Dhjetor 2020, i cili paguhet në muajin Janar 2021.

-Llogaria 436 "Sigurime Shëndetësore". Kjo llogari në shumën prej 1,381,843 lekë, paraqet vlerën e sigurimit shëndetësor të muajit Dhjetor 2020, i cili paguhet në Janar 2021.

-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit është 11,013,025 lekë.

Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

1. Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545,856 (Sigers)

2. Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467,519 (Desaret)

3. Viti 2020 5% garanci punimesh leke 9,999,650 (Shp.-Dion)

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen 844,559 lekë.

Shpenzimet

Gjate vitit 2020 janë kryer shpenzime si më poshtë:

-Llogaria 600 "Paga dhe shpërblime te tjera personeli" 524.259.132 lekë

-Llogaria 601 "Kontribute te Sigurimeve shoqërore e shëndetësore" 80.591.086 lekë

-Llogaria 602 "Mallra e shërbime te tjera" 378.650.217 lekë

Totali i llogarisë 60 "Shpenzime Korrente" 983.500.435 lekë.

Të ardhurat

Në vitin 2020 të ardhurat paraqiten si më poshtë:

- "Te ardhura jo tatimore 44.265.761.88 lekë e analizuar si më poshtë:

- "Te hyra sponsorime nga të tretët" 2.260.255,61= lekë, këtu përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet.

- "Te tjera, të arkëtuara " 1.521.736.34 lekë,

-Llogaria "Grande Korrente" 1.004.515.000 lekë përfaqëson fondin e dhënë nga DRSKSH, për shpenzimet korrente.

Totali i llogarisë 70 Te Ardhura Korrente" 1.052.562.753.83 lekë.

Inventarët;

Inventarizimet fizike nuk janë kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria, për shkak të situatës të pandemisë Covid – 19, nga data 10.03.2020. Janë ngritur komisionet e inventarizimit për magazinat fund të vitit. Komisioni vlerësimi ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse.

Buxheti

Realizimi i fondeve buxhetore në lekë dhe në përqindje për vitin 2020 në mijë lekë.

Llogaria Ekonomike qe Buxhetoret	Buxheti Fillestar + te trashëguara	Ndryshimet gjate vitit Shtesa/Gjendja fillim viti	Pakësim	Buxheti Total Plani	Buxheti Total Fakti
600	510.000	13.415	31.12.2020	523.415	516.681
601	85.000	-900	31.12.2020	84.100	80.702
602	369.000	28.000	31.12.2020	397.000	375.000
Totali	964.000	40.515	996515	1.004.515	972.385

Regjistrimi i pronave

Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se:

Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-befotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Shumica e godinave janë të ndërtuara para vitit 1990 dhe si pasojë në ZRPP Durrës ka mungesa të theksuara të dokumentacionit teknik mbi sipërfaqet e ndërtimit të tyre. Gjatëvitit 2003 nga ana e ZRPP-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë ri azhurnimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Në vlerësimin e grupit të auditimit, nga ana e drejtimit nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekor të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.

Inventarizimi i farmacisë dhe procedurat e asgjësimit:

Farmacia - Viti 2019

-Me shkresën nr.1578 prot, datë 19.08.2019 “Urdhër inventarizimi” është ngritur komisioni i përbërë nga Dh. K., A. Ç. dhe Z. S., për kryerjen e inventarizimit fizik të farmacisë lidhur me dorëzimin e detyrës nga ish përgjegjësja e farmacisë A. M., dhe marrësit në dorëzim N. P.

-Nga Relacionin Përmbledhës nr.1578/1 prot, datë 30.08.2019 ka rezultuar se në farmaci ka pasur teprica në vlerën 649,318.4 lekë dhe mungesa në vlerën 41,941.8 lekë.

-Me urdhrat: nr.1578/4 prot, datë 18.10.2019; nr.1578/5 prot, datë 18.10.2019; nr.1578/6 prot, datë 18.10.2019 dhe nr.1578/7 prot, datë 18.10.2019, është kërkuar zhdëmtimi i mungesave të konstatuara në farmaci nga punonjëset e farmacisë G. S., M. M., A. M. dhe Z. S., si dhe regjistrimi i tepricave të konstatuara në programin Financa 5.

Farmacia - Viti 2020

-Me shkresën nr.2167 prot, datë 17.12.2020 “Urdhër inventarizimi” është ngritur komisioni i përbërë nga O. D., B. K., J. I., N. P. dhe K. H., për kryerjen e inventarizimit fizik të farmacisë.

-Nga Relacionin Përmbledhës nr.217/1 prot, datë 29.12.2020 ka rezultuar se në farmaci ka pasur mungesa në vlerën 2,332.24 lekë. Nga procesi i inventarizimit ka rezultuar se në farmaci ka pasur medikamente të skaduara në vlerën 503,970.30 lekë dhe helme të vjetra në vlerën 10,239 lekë.

-Me shkresën nr.1131 prot, datë 25.06.2020 “Mbi medikamentet e skaduara” hartuar nga farmacistet Z. S. dhe N. P., drejtuar drejtoreshës N. J. janë paraqitur medikamentet e skaduara në

vlerën 474,780.8 lekë.

-Me shkresën nr.392 prot, date 25.02.2021 “Procesverbal” nga komisioni i asgjësimit i përbërë nga: A. D., L. M., V. S., E. K. dhe A. F.; Shefja e Farmacise B. S. dhe Komisioni I monitorimit të kontratës A. D., L. S. dhe B. K. janë asgjësuar 43.3 kg medikamente.

Po në këtë datë ka ardhur dhe procesverbali i konfirmimit nga inceneratori M. për realizimin e asgjësimit, i firmosur nga përfaqësuesi i M. – T. shpk ing. E. K. dhe nga përfaqësuesit e Spitalit Rajonal Durrës A. D., L. S. dhe R. Ç.

Nxjerrje jashtë përdorimit - Tetor 2019:

-Me shkresën nr.356 prot, datë 12.02.2019 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: I. V. – Kryetare, Dh. K. – anëtare, si dhe specialist të fushave të ndryshme në varësi të listës të aktiveve, H. M., E. K., E. P. dhe I. F.

-Me shkresën nr.1248 prot, datë 27.06.2019 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., I. F., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të ndryshme në Dispanceri, Poliklinikë Kabinet, Urgjencë – Pranim, Mikrokirurgji okulistike etj me llogarinë 214 në vlerën 2,869,749 lekë dhe llogarinë 218 në vlerën 115,534 lekë.

-Me shkresën nr.1734 prot, datë 18.09.2019 “Procesverbal asgjësimi nr.2”, komisioni i asgjësimit i përbërë nga A. D. – Kryetar, N. M., E. K., A. F., O. D. – anëtarë, pranuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., është kryer asgjësimi i aktiveve të përcaktuara në shkresën nr.1248 prot, datë 27.06.2019.

Sa më sipër konstatohet se në dosjen e nxjerrjes dhe asgjësimit të aktiveve jashtë përdorimi, mungon urdhri i ngritjes të komisionit të asgjësimit, dhe procesverbali nr.1 i asgjësimit.

Nxjerrje jashtë përdorimi: Laboratori i spitalit, punëtorja, gjeneratorët, infektiv i të rriturve

-Me shkresën nr.271 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: I. V. – Kryetare, Dh. K. – anëtare, si dhe specialist të fushave të ndryshme në varësi të listës të aktiveve E. K., E. P., J. I. dhe H. M.

-Me shkresën nr.31 prot, datë 04.02.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të ndryshme me vlerë llogarinë 214 vlera 11,647,912 lekë dhe llogaria 218 për vlerën 77,550 lekë.

-Me shkresën nr.272 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve i përbërë nga: A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D..

-Me shkresën nr.465 prot, datë 20.02.2020 “Procesverbal asgjësimi nr.1”, komisioni i asgjësimit i përbërë nga A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D., pranuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., është kryer riparimi I kazanëve të plehrave, asgjësimi i aktiveve “material të buta” duke u copëtuar dhe hedhur te mbetjet urbane dhe 10,670 kg hekurishte u caktuan tu bërë hyrje në magazine dhe për shitje në ankand.

Sa më sipër konstatohet se lidhur me hekurishtet nuk ka fletë hyrje në magazine dhe të dhëna lidhur me shitjen në ankand.

Nxjerrje jashtë përdorimi: Pediatria somatike dhe infektive

-Me shkresën nr.271 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: I. V. – Kryetare, Dh. K. – anëtare, si dhe specialist të fushave të ndryshme në varësi të listës të aktiveve E. K., E. P., J. I. dhe H. M..

-Me shkresën nr.1725 prot, datë 30.09.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të llogarisë 214 në vlerën 164,760 lekë, llogaria 218 në vlerën 34,766 lekë dhe llogaria 327 në vlerën 25,345 lekë.

-Me shkresën nr.272 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve i përbërë nga: A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D..

-Me shkresën nr.465 prot, datë 20.02.2020 “Procesverbal asgjësimi nr.3”, komisioni i asgjësimit i përbërë nga A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D., pranuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., është kryer asgjësimi i aktiveve “material të buta” duke u copëtuar dhe hedhur te mbetjet urbane dhe për 2060 kg hekurishte është bërë fletë - hyrje në magazine me nr.32 dok, datë 17.10.2020, të cilat do të nxirren për shitje në ankand.

Nxjerrje jashtë përdorimi: Infektivi i madh

-Me shkresën nr.271 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: I. V. – Kryetare, Dh. K. – anëtare, si dhe specialist të fushave të ndryshme në varësi të listës të aktiveve E. K., E. P., J. I. dhe H. M..

-Me shkresën nr.1932 prot, datë 05.11.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktiveve të llogarisë 214 në vlerën 332,138 lekë, llogaria 218 në vlerën 500,077 lekë dhe llogaria 327 në vlerën 185,731.

-Me shkresën nr.272 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve i përbërë nga: A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D..

-Me shkresën nr.465 prot, datë 20.02.2020 “Procesverbal asgjësimi nr.4”, komisioni i asgjësimit i përbërë nga A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D., pranuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., është kryer asgjësimi i aktiveve “material të buta” duke u copëtuar dhe hedhur te mbetjet urbane dhe për 300 kg hekurishte do të bëhet hyrje në magazinë dhe do të nxirren për shitje në ankand.

Nxjerrje jashtë përdorimi: Neurologjia, urgjencë pranimit, administrata, magazine qendrore, radiologjia e pediatriisë, ortopedia e fëmijëve, okulistika, telemedicine, morgu, pundi i gjakut

-Me shkresën nr.271 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: I. V. – Kryetare, Dh. K. – anëtare, si dhe specialist të fushave të ndryshme në varësi të listës të aktiveve E. K., E. P., J. I. dhe H. M..

-Me shkresën nr.957/1 prot, datë 29.05.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të llogarisë 214 për vlerën 780,308 lekë dhe llogaria 218 për vlerën 1,070,686 lekë.

-Me procesverbalin e mbajtur nga E. K. dhe J. I., pa numër protokolli dhe datë, janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale të morgut (bisturi, devirikator, gersherë, klema, klema të ndryshme, klema veshi, kuti alumini, etj) dhe të pundit të gjakut (frigoriferë, mbyllëse qese gjaku, aparat tensioni etj).

-Me procesverbalin e mbajtur nga E. K. dhe J. I., pa numër protokolli dhe datë, (data 28.01.2020 e shënuar me shkrim dore) janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale të shërbimit të pediatriisë (zhvillues filmash, doreza, përparëse etj).

-Me shkresën nr.957 prot, datë 29.05.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të llogarisë 218 për vlerën 18,637 lekë dhe llogaria 327 për vlerën 4,050 lekë.

-Me shkresën nr.957/2 prot, datë 19.06.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., komisioni i vlerësimit ka përgatitur listën e mallrave të djegura nga rënia e zjarrit në godinën 4 – katëshe. Vlera e materialeve të djegura është: patologjia 209,177 lekë, ortopedia 525,000 lekë, neurologjia 432 lekë, reanimacioni i kardiologjisë 28,868 lekë.

-Me shkresën nr.1135 prot, datë 25.06.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga

zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., komisioni i vlerësimit ka kërkuar miratimin për të kaluar në humbje mungesën për shkak të vjedhjes, në vlerën 10,000 lekë në Dispanceri.

-Me shkresën nr.1135 prot, datë 25.06.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të llogarisë 218 për vlerën 347,806 lekë, llogaria 327 për vlerën 14,950 lekë, kurse vlera e llogarisë 214 (makineri, pajisje, vegla pune) është 9,081, 632 lekë.

-Me shkresën nr.951/prot, datë 29.05.2020 “Procesverbal vlerësimi – aktive për nxjerrje jashtë përdorimi”, komisioni i përbërë nga anëtarët: I. V., H. M., E. K., E. P., Dh. K., J. I., aprovuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., janë nxjerrë jashtë përdorimi dhe propozuar për asgjësim aktive të llogarisë 214 (makineri, pajisje, vegla pune) për vlerën 18,849,179 lekë.

-Me shkresën nr.272 prot, datë 30.01.2020 “Urdhër i brendshëm”, ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të përbërë nga: A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D..

-Me shkresën nr.1577 prot, datë 02.09.2020 “Procesverbal asgjësimi nr.2”, komisioni i asgjësimit i përbërë nga A. D. – kryetar, A. F., N. M., E. K. dhe O. D., pranuar nga zëvendës Drejtori Ekonomik G. K. dhe miratuar nga Drejtor N. J., është kryer asgjësimi i aktiveve “material të buta” duke u copëtuar dhe hedhur te mbetjet urbane dhe për 2450 kg hekurishte do të bëhen hyrje në magazinë dhe do të nxirren për shitje në ankand. Janë sistemuar disa prej materialeve në magazime me fletë – hyrjet: nr.24 dok, datë 02.09.2020, nr.8 dok, datë 02.09.2020 dhe nr.25 dok, datë 02.09.2020.

Debitorët

I – Per subjektin Gj. shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Urdhër për shpërblim demi, në vlerën 386,812 lekë, me Nr.56/2 Prot., date 16.01.2014 drejtuar subjektit “Gjeokonsult” shpk”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese - Padinë për shpërblimin e demit, pranë Gjykatës së Shkalles së Pare Durrës me date 16.11.2015. **2.** Me Vendimin Nr. 11-216-3987 date 22.09.2016 Gjykata Shkalles Pare Durrës vendosi rrëzimin e kërkesë. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 1995 Prot date 30.09.2016 pranë Gjykatës së Apelit Durrës. **4.** Me Vendim Gjykata e Apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të shkalles së pare dhe nga ana e SRD edhe paraqitur **5.** Rekursi me Nr. 2336 date 22.11.2017 pranë Gjykatës së Larte.

II – Për subjektin “K.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Urdhër për shpërblim demi në vlerën 1,399,288 lekë, me Nr.56/1 Prot., date 16.01.2014 drejtuar subjektit “K.” sha”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e demit, pranë Gjykatës së Shkalles së Pare Durrës me Nr. 345 prot, date 03.03.2014. **2.** Me Vendimin Nr. 11-2014-3024 date 23.06.2014 Gjykata Shkalles Pare Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr.1305 Prot, date 04.07.2014 pranë Gjykatës së Apelit Durrës. **4.** Me Vendimin Nr.10-2016-230(89) date 08.02.2016, Gjykata e Apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të shkalles së pare dhe nga ana e SRD edhe paraqitur **5.** Rekursi me nr. 576 prot, datë 07.03.2016 pranë Gjykatës së Larte.

III – Per subjektin “A. B. PF”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Urdhër për shpërblim demi në vlerën 199,500 lekë, me Nr.2216 Prot., datë 21.12.2015 drejtuar subjektit “A. B.””, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e demit, pranë Gjykatës së Shkalles së Pare Durrës me Nr. 512 date 25.02.2016. **2.** Me Vendimin Nr. 11-2017-1477 date 30.03.2017 Gjykata Shkalles Pare Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 774 Prot. Date 11.04.2017 pranë Gjykatës së Apelit Durrës. **4.** Me Vendimin Nr. 10-2018-1864/643 date 17.10.2018, Gjykata e Apelit vendosi kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkalles së Pare Durrës. **5.** Me Vendimin Nr. 586 date 08.07.2019 të Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Durrës është vendosur rrëzimi kërkesës së SRD. **5.** Kundër

vendimit te Gjykatës Administrative SRD ka paraqitur Ankimin Nr.1575 prot, date 19.08.2019 pranë Gjykatës Administrative te Apelit.

IV– Për subjektin “C.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Urdhër për shpërblim demi në vlerën 243,600 lekë, me Nr.2212 Prot., date 21.12.2015 drejtuar subjektit "C." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës se Shkalles se Pare Durrës me Nr.513 Prot. date 25.02.2016. **2.** Me Vendimin nr. 1182 date 28.06.2016 te Gjykatës Durrës u shpall mos kompetenca tokësore dhe dërgimin e çështjes ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. **3.** Me Vendimin Nr.3796 date 02.05.2017 të Gjykatës se Rrethit Tirane u vendosi rrëzimi kërkesës. **4.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 1072 Prot date 16.05.2017 pranë Gjykatës se Apelit Tirane. **5.** Me Vendim te Gjykatës për shkak te mosparaqitjes se juristit te autorizuar çështja u pushua. **6.** SRD paraqiti serish kërkesë padinë me Nr. 1481 Prot. date 11.07.2017 pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. **7.** Me Vendimin Nr.10809 date 18.12.2017 te Gjykatës se Rrethit Tiranë për te njëjtin shkak u vendos pushimi i çështjes. Nga ana e Sektorit Juridik është raportuar disa here ky fakt, përfshire edhe informacionin me nr. 2477 prot, date 18.12.2017.

V-Për subjektin “N.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Urdhër për shpërblim demi në vlerën 152,416 lekë, me Nr.2220 Prot., date 21.12.2015 drejtuar subjektit "N." shpk*”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës se Shkalles se Pare Durrës me Nr.510 Prot. date 25.02.2016. **2.** Me Vendimin Nr.1794 date 30.11.2016 te Gjykatës Durrës u vendos rrëzimi kërkesës se SRD. **4.** Spitali vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 2628 date 30.12.2016 pranë Gjykatës se Apelit Durrës. **5.** Me Vendim te Gjykatës se Apelit Durrës me Nr.10-2017-2799 date 12.05.2017 u vendos lenia ne fuqi e vendimit te shkalles se pare Durres. **5.** Nga ana e SRD edhe paraqitur Rekursi me nr. 2422 prot, date 12.12.2017 pranë Gjykatës se Larte.

VI.Për subjektin “A.” shpk, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Vendimi për shpërblim demi në vlerën 48,079 lekë, me Nr.1765 Prot., date 20.09.2019 drejtuar subjektit "A." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për objekt “shpërblimin e dëmit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkalles se Parë Durrës me Nr. 245 prot, date 29.01.2020. Aktualisht, jemi ne pritje te zhvillimit te hetimit gjyqësor nga ana e kësaj Gjykate.

VII- Për subjektin “E.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Vendimi per shpërblim demi në vlerën 117,465 lekë, me Nr.1764 Prot., datë 20.09.2019 drejtuar subjektit "E." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë per objekt “shpërblimin e demit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Durrës me Nr. 244 prot, date 29.01.2020.

VIII– Për subjektin “F.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Vendimi për shpërblim demi në vlerën 36,815 lekë, me Nr.1769 Prot., datë 20.09.2019 drejtuar subjektit "F." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për objekt “shpërblimin e dëmit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Durrës me Nr. 246 prot, date 29.01.2020.

IX – Për subjektin “I.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “*Vendimi për shpërblim demi në vlerën 30,192 lekë, me Nr.1768 Prot., date 20.09.2019 drejtuar subjektit "I." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për objekt “shpërblimin e dëmit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Durrës me Nr. 247 prot, date 29.01.2020.

X – Për subjektin “PF L. K. dhe Co. P. shpk” Spitali Rajonal Durres ka nxjerr aktet “*Vendimi për shpërblim demi në vlerën 312,000 lekë, me Nr.1771 Prot., datë 20.09.2019 drejtuar subjektit "L. K. PF" shpk. dhe Vendimi për shpërblim demi me Nr.1772 Prot., datë 20.09.2019 drejtuar subjektit "Co. P." shpk*”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për objekt “shpërblimin e dëmit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Durrës me Nr. 248 prot, date 29.01.2020. Aktualisht, jemi ne pritje te zhvillimit te hetimit gjyqësor nga ana e kësaj Gjykate.

XI – Për subjektin “M. A.” shpk Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 5,190,472 lekë, me Nr.1770 Prot., date 20.09.2019 drejtuar subjektit “M. A.” shpk”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësore duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë per objekt “shpërblimin e dëmit”, pranë Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Durrës me Nr. 906 prot, date 29.05.2020.

Debitorë sipas llogarisë 429

I – Për ish punonjësit “H. C., N. M. dhe E. M.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Urdhër për zhdëmtim dëmi në vlerat 58,880 lekë, 58,879 lekë dhe 58,880 lekë, me Nr.2219 Prot., date 21.12.2015 drejtuar Z. N. M., Z. H. C. Znj. E. M.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.514 Prot. 25.02.2016. 2. Me Vendimin Nr. 11-2016-5687, datë 09.12.2016 Gjykata Shkallës Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. 3. SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 2627 Prot date 30.12.2016 pran Gjykatës se Apelit Durrës. 4. Me Vendim Gjykata e Apelit vendosi lënien ne fuqi te vendimit te shkalles se pare dhe nga ana e SRD edhe paraqitur 5. Rekursi me Nr. 2421 date 12.12.2017 pranë Gjykatës së Lartë.

II – Për punonjësen “A. D.” dhe ish punonjësit “A. T. dhe A. S.” Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Urdhër për shpërblim dëmi në vlerat 497,621 lekë dhe 497,621 lekë, me Nr.2239 Prot., date 28.12.2015 drejtuar Znj. A. T., Znj. A. S. dhe Znj. A. D.”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr. 215, datë 25.02.2016. 2. Me Vendimin Nr. 11-2017-1673 date 07.04.2017 Gjykata Shkallës Pare Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. 3. SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 900 Prot. Date 21.04.2017 pranë Gjykatës së Apelit Durrës. 4. Me Vendimin Nr. 10-2019-48/9 date 16.01.2019 Gjykata e Apelit vendosi lënien ne fuqi te vendimit te shkalles se pare dhe nga ana e SRD edhe paraqitur 5. Rekursi me Nr. 414 Prot. Date 27.02.2019 pranë Gjykatës së Lartë.

III – Për punonjësin “T. B.” Spitali Rajonal Durrës ka nxjerrë aktin “Urdhër për zhdëmtim dëmi në vlerën 174,106 lekë, me Nr.2218 Prot., date 21.12.2015 drejtuar Z. T. B.”, dhe me pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave te mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr. 509 Prot, datë 25.02.2016. 2. Me Vendimin Nr. 1059, datë 04.07.2016 Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. 3. SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 1468 Prot, datë 15.07.2016 pranë Gjykatës së Apelit Durrës. 4. Me Vendimin Nr.10-2017-1931, datë 09.12.2017 Gjykata e Apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë dhe nga ana e SRD edhe paraqitur 5. Rekursi me Nr. 1665 date 22.08.2017 pranë Gjykatës së Lartë.

Debitorët e llogarisë 429 - Shoferët

I – Për punonjësin “E. L.” Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 78,742 lekë, me Nr. 1799 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. E. L.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e demit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.436 Prot, datë 09.02.2018. 2. Me Vendimin Nr. 1295, datë 25.07.2018 Gjykata Shkallës Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. 3. SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 2138 Prot, datë 16.08.2018 pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

II – Për punonjësin “N. P.” Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 39,855 lekë, me Nr. 1795 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. N. P.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë

Durrës me Nr. 2437 Prot date 13.12.2017. **2.** Me Vendimin Nr. 1020 date 18.06.2018 Gjykata Shkallës e Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 1805 Prot. date 09.07.2019 pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

III – Për punonjësin “T. L.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 50,363 lekë, me Nr.1798 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. T. L.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Debitori T. L. ka paraqitur Kërkese-Padinë për shfuqizimin e aktit administrativ të SRD, pranë Gjykatës Administrative Durrës. **2.** Me Vendimin Nr.224, datë 19.03.2018 Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës vendosi pranimin e kërkesës së paditësit. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr.997 prot, datë 12.04.2018 pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

IV – Për punonjësin “G. D.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 133,380 lekë, me Nr.1793 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. G. D.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr. 439 Prot, datë 09.02.2018. **2.** Me Vendimin Nr. 2048, datë 24.12.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr.407, datë 21.02.2019 pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

V – Për punonjësin “A. M.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 172,425 lekë, me Nr.1796 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. A. M.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese - Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.438 Prot, datë 09.02.2018. **2.** Me Vendimin Nr.2049, datë 24.12.2018, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr. 408 date 21.02.2019 pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

VI – Për punonjësin “A. M.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 65,042 lekë, me Nr. 1796 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. A. M.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.437 Prot, datë 09.02.2018. **2.** Me Vendimin Nr.1294, datë 25.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** SRD vazhdoi hapat duke paraqitur Ankimin Nr.2137, datë 16.03.2018 pranë Gjykatës së Apelit të Durrës.

VII – Për ish punonjesin “F. A.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerrë aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 18,910 lekë, me Nr.1792 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z.F. A.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e demit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.2436 Prot, datë 13.12.2017. **2.** Me Vendimin Nr.1371, datë 17.09.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi pushimin e çështjes dhe rasti u paraqit dhe u evidentua në analizat vjetore të SRD.

VIII – Për ish punonjësin “N. M.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerrë aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 71,446 lekë, me Nr.1791 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z.N. M.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Ka paraqitur Kërkese-Padinë për shpërblimin e dëmit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr.440 Prot, datë 09.02.2018. **2.** Me Vendimin Nr.1219, datë 16.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi pushimin e çështjes dhe rasti u pasqyrua dhe u evidentua në analizat vjetore të SRD.

IX – Për punonjësin “I. L.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 114,247 lekë, me Nr.1794 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. I. L.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Debitori I. L. z.z ka paraqitur Kërkese-Padinë për shfuqizimin e aktit administrativ të SRD me palë të paditur SRD dhe FSDKSH Tiranë, pranë Gjykatës Administrative Durrës. **2.** Me Vendimin Nr.82-2017-1322, datë 17.10.2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** Pala paditëse ka paraqitur Ankimin Nr.2245 Prot, datë 09.11.2017 pranë

Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

X – Për punonjësën “E. M.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerr aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 28,940 lekë, me Nr.1801 prot, datë 06.09.2017 drejtuar Z. E. M.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Debitori E. M. ka paraqitur Kërkese-Padinë për shfuqizimin e aktit administrativ të SRD me palë të paditur SRD dhe FSDKSH Tirane, pranë Gjykatës Administrative Durrës. **2.** Me Vendimin Nr.82-2017-1322, datë 17.10.2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** Pala e paditur ka paraqitur Ankimin Nr.2245 Prot, datë 09.11.2017 pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

XI – Për punonjësën “E. S.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerrë aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 24,675 lekë, me Nr. 1800 prot date 06.09.2017 drejtuar Z. E. S.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Debitori E. S. ka paraqitur Kërkese-Padinë për shfuqizimin e aktit administrativ të SRD me palë të paditur SRD dhe FSDKSH Tiranë, pranë Gjykatës Administrative Durrës. **2.** Me Vendimin Nr.82-2017-1322, datë 17.10.2017 Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës vendosi rrëzimin e kërkesës. **3.** Pala e paditur ka paraqitur Ankimin Nr.2245 Prot, datë 09.11.2017 pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

XII – Për punonjësën “H. O.”, Spitali Rajonal Durrës ka nxjerrë aktin “Vendimi për shpërblim dëmi në vlerën 509,440 lekë, me Nr.685 prot, datë 08.03.2018 drejtuar Z. H. O.”, dhe më pas ka vazhduar me ndjekjen e hapave të mëtejshëm gjyqësor duke realizuar veprimet:

1. Debitori H. O. ka paraqitur Kërkese-Padinë për shfuqizimin e aktit administrativ të SRD me palë të paditur SRD dhe FSDKSH Tiranë, pranë Gjykatës Administrative Durrës. **2.** Me Vendimin Nr.675, datë 02.11.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës vendosi pranimin e kërkesës. **3.** SR.D ka paraqitur Ankimin Nr.422 Prot, datë 25.02.2019, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Konkluzione:

1.Nga grupi i auditimit konstatohet se në Bilancin e Spitalit Rajonal Durrës janë regjistruar 82 punonjës të larguar nga detyra në vitin 2020. Bazuar në verifikimin e të dhënave me burimet njerëzore rezulton se janë numri i të larguarve është 79 punonjës. Po ashtu, rezulton se dhe numri i të punësuar te rinj në vitin 2020 në bilanc është regjistruar 78, numër i cili nga verifikimet rezulton 73 të punësuar.

2.Në bilancin e vitit 2020 janë regjistruar në zërin “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” në vlerën 2,866,327 lekë. Për vitin 2019 nuk ka asnjë vlerë lidhur me këtë zë të bilancit. Nga ana e Spitalit Rajonal të Durrësit është e paqartë se në cilin zë janë regjistruar këto të ardhura për vitin 2019.

3. Inventarizimet fizike nuk janë kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria, për shkak të situatës të pandemisë Covidi – 19, nga data 10.03.2020. Janë ngritur komisionet e inventarizimit për magazinat fundvit. Komisioni vlerësimit ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjesimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse. Në disa raste mungon fletë – hyrja në magazinë lidhur me materialet të cilat janë kthyer në hekurishte për tu shitur në ankand si skrap.

4. Kontabilizimi i debitorëve të ndiqet duke u bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

5. Spitali Rajonal Durrës nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga spitali nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z.N. J. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës.
- 2) I. V. në cilësinë e përgjegjësës të sektorit të Financës.
- 3) Dh. K. në cilësinë e përgjegjësës të komanduar të sektorit të Financës

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.10 , datë 30.04.2021

2.8.1 Titulli i Gjetjes : Mos raportimi i saktë i të dhënave në bilancin e spitalit.

Situata: -Nga grupi i auditimit konstatohet se në Bilancin e Spitalit Rajonal Durrës janë regjistruar 82 punonjës të larguar nga detyra në vitin 2020. Bazuar në verifikimin e të dhënave me burimet njerëzore rezulton se janë numri i të larguarve është 79 punonjës. Po ashtu, rezulton se dhe numri i të punësuar te rinj në vitin 2020 në bilanc është regjistruar 78, numër i cili nga verifikimet rezulton 73 të punësuar.

-Në bilancin e vitit 2020 janë regjistruar në zërin “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” në vlerën 2,866,327 lekë. Për vitin 2019 nuk ka asnjë vlerë lidhur me këtë zë të bilancit. Nga ana e Spitalit Rajonal të Durrësit është e paqartë se në cilin zë janë regjistruar këto të ardhura për vitin 2019.

Veprimet e më sipërme bien në kundërshtim me pikën 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar “*Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.*”.

Kriteri: Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos raportimi i saktë i të dhënave në bilanc sjell pasiguri dhe paqartësi lidhur me situatën financiare të Spitalit Rajonal Durrës.

Shkaku: Raportimi jo i rregullt i të dhënave në bilanc.

Rëndësia: E lartë.

2.8.1 Rekomandimi : Sektori i Financës të marrë masa për rakordimin dhe korrigjimin e të dhënave të punonjësve të marrë rishtaz në punë, atyre të larguar, si dhe të verifikojë dhe sistemojë vlerën e të ardhurave dytësore të spitalit.

Afati: Menjëherë.

2.8.2 Titulli i gjetjes: Regjistrim i papërfunduar i aktiveve të shoqërisë në ASHK.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se:

Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-befotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Shumica e godinave janë të ndërtuara para vitit 1990 dhe si pasojë në ASHK Durrës ka mungesa të theksuara të dokumentacionit teknik mbi sipërfaqet e ndërtimit të tyre. Gjatë vitit 2003 nga ana e ASHK-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhornimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Në opinionin e grupit të auditimit, nga ana e drejtimit nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekor të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.

Kriteri: ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

Ndikimi/Efekti: Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme.

2.8.2 Rekomandimi : Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për

përfundimin

e regjistrimit të pronave në ASHK me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor. Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme, për përditësimin dhe azhurnimin e statusit ligjor dhe fizik të pronave të SRD me qëllim përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK dhe pajisjen me Titullin e Pronësisë.

2.8.3 Titulli i Gjetjes: Procesi i inventarizimit të aktiveve i pa realizuar.

Situata: Nga grupi i auditimit u konstatua se inventarizimi fizik nuk është kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, për shkak të situatës të pandemisë Covid – 19. Komisionet përkatëse të inventarizimit janë ngritur gjatë 2020. Komisioni vlerësimi ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse. Në disa raste mungon fletë – hyrja në magazinë lidhur me materialet të cilat janë kthyer në hekurishte për tu shitur në ankand si skrap.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku citohet: *1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. 2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.*”, dhe pikat 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar ku citohet: *73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilesinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrë të duhur dhe me efikasitet të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këto udhëzime dhe nga titullari i njësisë publike. 74. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

Si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet:

“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e bërës, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhtme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Ndikimi/Efekti: Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Shkaku: Mos realizimi i inventarizimit fizik.

Rëndësia: E lartë.

2.8.3 Rekomandimi : Sektori i Financës të marrë masa për realizimin e procesit të inventarizimit fizik në Spitalin Rajonal Durrës, dhe të ndjekë e plotësojë me përgjegjshmëri hapat e proceseve të cilat lindin pas këtij procesi, si asgjësimin, plotësimi i dokumentacionit justifikues etj.

Afati: Menjëherë.

2.8.4. Titulli i Gjetjes: Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve.

Situata: -Spitali Rajonal Durrës nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga spitali nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Kriteri: -Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, ku citohet:

“Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishikohet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8, Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.”

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103, ku citohet:

Kriteret për vlerësimin e Aktiveve 103. Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve : a. kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen; b. kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër; c. kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit, d. kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm. e. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër; f. kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë; g. kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmbytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit; h. kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Ndikimi/Efekti: Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe objektive të situatës së Aktiveve Afatgjate Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme.

Rëndësia: E mesme

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

2.8.4. Rekomandime: Nga Drejtoria dhe Sektori i Financës të merren masa për vlerësimet e vlerën së mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin.

Afati: Menjëherë.

2.8.5. Titulli i Gjetjes: Paqartësitë në afatet e regjistrimit të debitorëve në kontabilitet.

Situata: Gjendja e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2020 paraqitet me vlerën **9,146,697 lekë**, pra me një rritje prej **1,306,121 lekë** krahasuar me periudhën ushtrimore pasardhëse. Kjo rritje vjen si pasojë e njohjes së debitorëve të viteve të kaluara.

Nga grupi i auditimit konstatohet se Sektori i Financës nuk është i partë lidhur me momentin në cilin duhet kryer kontabilizimi i këtyre detyrimeve, duke sjellë kështu pasiguri lidhur me vlerën e

paraqitur në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës për llogarinë 468.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, shkronjat g dhe gj, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku citohet:

"3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

Ndikimi/Efekti: Mos njohja në kohë dhe mos arkëtimi i debive mund të sjellin mungesë të likuiditetit në të ardhmen.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Paqartësia lidhur memomentin e kontabilizimit të debitorëve.

2.8.5. Rekomandime : Nga Sektori i Financës të merren masa për analizimin e vlerës prej **9,146,697 lekë** të debitorëve, ndjekjes të procedurave të regjistrimit të tyre referuar afateve të përcaktuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Afati: Menjëherë.

3.9. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raportit përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm).

1. Strukturat përgjegjëse të nivelit menaxhial dhe zbatues, të subjektit të auditimit Spitalit Rajonal Durrës zbatojnë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualin për MFK-në, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

2. Rezulton se për periudhën objekt auditimi është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhërin nr. 6, datë 21.01. 2019 "Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik" për vitin 2019 dhe me Urdhër nr. 86, datë 13.01.2020 "Për ngritjen e grupit të punës së menaxhimit strategjik" dhe nuk funksionuar **Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe funksionimit të sistemit të Menaxhimit të Riskut**. Nuk ka të dokumentuar asnjë veprimtari të GMS për periudhën objekt auditimi. Sa sipër nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin". Më konkretisht:

Manuali i MFK, i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 108, datë 17.11.2016 ka përcaktuar se:

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.

edhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

"GMS luan një rol kyç persa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe për kujdeset për performancën e njësisë publike".

✓ Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se janë zbatuar kërkesat e nënpikës nr. 3, e pikës 2.2.4 të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 16, datë 20.07.2016 "Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e Riskut në Njësitë Publike". Kështu, referuar pikës nr. 5, të shkresës me nr. 173 datë 21.01.2019, znj. I. V., Përgjegjëse e Sektorit të Financës është caktuar sekretare e GSM dhe z. G. K., z. G. K. dhe zj. Xh. D.,

koordinator të riskut për vitin 2019. Si dhe shkresës me nr. 86 datë 13.01.2020, znj. I. V., Përgjegjëse e Sektorit të Financës është caktuar sekretare e GSM dhe z. G. K., z. G. K. dhe zj. Xh. D., koordinator të riskut për vitin 2020.

✓ Nga ana e institucionit të SRD nuk është hartuar dokumenti “Plan Veprimi për MFK”, dhe “Plan për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit”, në kundërshtim me pikën 2.3.1, të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 16, datë 20.07.2016 “Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e Riskut në Njësitë Publike”, ku përcaktohet se “plani për ngritjen e sistemit të MFK bëhet një herë në vit dhe përmban një panoramë të aktiviteteve që duhen ndërmarrë. Të gjithë aktivitetet e listuara në planin për ngritjen e sistemit të MFK duhet të lidhen me komponentët përkatës të MFK”.

3. Nga auditimi i kryer në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet e politikave vijuese të dala në zbatim të tij, evidentohet **nevoja për përditësimin dhe harmonizimin e normave dhe akteve në fuqi mbi të cilat ngrihet dhe funksionon SRD me kuadrin nënligjor mbështetës**. Institucioni i SRD, ushtron veprimtarinë mbështetur në ligjin Nr.10107, datë 30.03.2010 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, i ndryshuar, VKM nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemen e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar me vendimin nr. 33, datë 17.10.2018, të Bordit Drejtues dhe vendimin nr. 4, datë 27.03.2020 të Bordit Drejtues. Kjo rregullore është në fuqi për periudhën objekt auditimi dhe aktualisht.

4. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se për Drejtorin e Spitalit Rajonal Durrës janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) në pozicionin e , si vijon:

Nëpunësi zbatues për vitin 2018, referuar shkresës nr. 1119 prot datë 19.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7381/1 prot., datë 01.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. me objekt “Konfirmim i Nëpunësit Zbatues për Spitalin Rajonal Durrës”, është caktuar znj. I. V.. me pozicion pune Shefe e Sektorit të Financës. Gjithashtu me shkresën nr. 2105, datë 09.12.2020 është deleguar firma për përgjegjësin e sektorit të financës.

Rezultoni se, pozicioni në strukturë i NZ është në linjë direkte nga NA i SRD.

Në funksion të kuadrit ligjor në fuqi, nëpunësi zbatues është niveli menaxherial në vartësi direkte të titullarit i institucionit. Në funksionet e tij, Pmbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

5. Nga ana e institucionit nuk janë përgatitur Pyetësorët e Vetëvlerësimit, dhe as Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296/2010

“Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.

2. Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimit e brendshëm në sektorin publik.

3. Ministri i Financave i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda muajit maj të çdo viti, deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të

brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë edhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit.”

Mungojnë Deklarata së nëpunësit autorizues për cilësinë e sistemit të kontrollit dhe Planin Vjetor për Zhvillimin e MFK sipas aneksit nr.1, në referim të UMF nr.16, datë 20.7.2016 si dhe Raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike.

Nuk është dërguar në Ministrinë e linjës Raporti Vjetor mbi Sistemet e Kontrollit të Brendshëm, sipas strukturës së parashikuar në Manualin e MFK (Kreu II, pika 2.2.7) dhe detyrimeve të Nenit 18/1, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, Kreu II, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010:

“Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji”,

dhe pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.11.2008, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” si dhe nenin 9, pika 3, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010:

“Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njërive raportojnë sipas shkallës hierarkike, ..., për “statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë”.

6. Institucioni i SRD ka themeluar funksionin e auditimit të brendshëm, në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, me linjë raportimi tek Drejtori i SRD. U vlerësua sistemi i buxhetimit dhe kontabilitetit dhe rezultoi se:

▪ **Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:**

Nga ana e institucionit, në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aktiveve, detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreu IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe udhëzimeve në fuqi dhe janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël është mbështetur në parimin e kontabilitetit rrjedhës, pra mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara.

7. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Në institucionin e SRD janë hartuar regjistrat e riskut për periudhën auditimit, dokument i nënshkruar nga Drejtori, ku janë evidentuar risqet para kontrollit, zotëruesit e këtyre risqeve, si dhe rezultatet pas implementimit të kontrolleve të brendshme. Ky dokument është hartuar sipas periudhave dhe është përditësuar, duke evidentuar risqet që shtohen dhe ato që hiqen nga kjo matrice. **Konstatohet se në shumë raste niveli i risqeve të evidentuar pas kontrolleve pasqyrohet në të njëjtin nivel, si ato para kontrolleve ekzistuese, si dhe në shumë raste kur niveli i vlerësuar i risqeve pas kontrollit rezulton i lartë, nuk janë parashikuar veprime korrigjuese për të adresuar boshllëqet dhe mangësitë nga zotëruesit e tyre, gjë që tregon për një proces jo të kujdesshëm në**

përgatitjen e këtij dokumenti.

Situata:

Për periudhën objekt auditimi, në SRD është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve, detyrimi i neneve 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 / (pika 2), të ligjit nr. 10296. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si dhe përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Konstatohet se janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

11. Nuk janë hartuar nga Drejtoritë/Sektorët e SRD dhe nuk janë miratuar nga ana e Titullarit të këtij institucioni publik, gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të SRD.

Kriteri:

Neni 16, i ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:

“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.

Grupi i auditimit sjell në vëmendje se:

- Sipas cilësimeve të pikës nr. 19, neni 4 të ligjit:

“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. “

- Sipas kreut 3.3. “Aktivitetet e kontrollit” të Manualit të MFK

“ Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit (Shih Aneksin nr.4) jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione... Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

12. Nga ana e institucionit të SRD zbatohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aktiveve, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa “ç”, të ligjit nr. 10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aktiveve, detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve por nuk është zbatuar kriteri i inventarizimit të përvitshëm të pasurisë, (trajtuar në kapitullin mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare)

13. U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e

Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi përgatitjen e hartës së proceseve të punës dhe manualeve të proceseve të punës. ***Nuk janë hartuar për periudhën objekt auditimi nga Drejtoritë e SRD gjurmët e auditimit dhe manualët e proceseve të punës dhe nuk janë miratuar nga Drejtori i SRD.*** Këto manuale duhet të garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Me miratimin e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, janë qartësuar problematikat në fushën e menaxhimit të aktiveve, megjithatë për këtë institucion paraqitet nevoja për rritje të kapaciteteve, nëpërmjet procesit të trajnimit, me programe specifike. Për sa sipër, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlere të vogël dhe të lartë", duhet të shërbejnë si bazë për hartimin e gjurmëve të auditit në secilën prej drejtorive dhe proceseve që zbatohen në njësinë shpenzuese të SRD.

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

1. Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, SRD ka funksionuar në bazë të Ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë". Në nenin 4 të tij është sanksionuar se: "a) ndihmë mjekësore të përgjithshme dhe të specializuar; b) mbrojtjen e shëndetit në bashkëpunim edhe me veprimtaritë e institucioneve të tjera shëndetësore; c) kushtet e duhura për përvetësimin e praktikës së punës dhe edukimin profesional dhe teknik të personelit shëndetësor dhe teknik; ç) nxitjen e edukimit higjieno-sanitar të të sëmurit dhe të të afërmeve të tij, duke u mbështetur në personelin e vet shëndetësor."

Po kështu, në Neni 2 "**Misioni**", Kreu 2, të Rregullores së Funksionimit Teknik:

"1. Spitali është qendër diagnostikimi dhe kurimi i të sëmurëve dhe shërben si njësi bazë edhënies së ndihmës mjekësore të specializuar të sëmurëve të Qarkut Durrësdhepërgjigjet për shërbimin kurativ të kësaj popullate.

2. Jep gjithashtu ndihmën mjekësore emergjente në çdo rast për të gjithë vendin.

3. Spitali shërben edhe si bazë pedagogjike e kërkimeve shkencore për formimin e studentëve të mjekësisë, mjekëve stazhier, si dhe kualifikimin e mjekëve dhe personelit të mesëm mjekësor dhe jo mjekësor."

"Vizioni"

"Rrikthimi i besimit të qytetarëve për shërbimin shëndetësor, transformimi i kujdesit shëndetësor dhe krijimi i shpresës për komunitetin nëpërmjet rritjes së cilësisë dhe gamës së shërbimeve. Sfidat janë mbrojtja e merituar përmes një sistemi shëndetësor me mbulim universal dhe t'u krijojmë profesionistëve kushtet e nevojshme për të shërbyer me cilësi. Kjo përmes:

- *Cilësisë në kujdesin mjekësor të specializuar të mbështetur në edukimin gjithëpërfshirës*
- *Zhvillimi, vlerësimi dhe përdorimi të teknikave të reja*
- *Tërheqja e stafit me vlerat më të mira mjekësore dhe shkencore*
- *Sigurimi i dhënies efektive të kujdesit shëndetësor"*

Sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, (i ndryshuar), ka përcaktuar në kapitullin e III, detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit.

Për vitin 2019 dhe 2020, nuk janë kryer takime periodike të EMP (takime periodike dhe tre mujore) me stafin menaxherial mbi diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe janë trajtuar disa aspekte të risqeve (ndër të tjera kërkohen plan pune javor nga çdo sektor, dhe ndarja e detyrave specifike mes punonjësve brenda secilit sektor).

Punonjësit e institucionit për vitin 2019 dhe 2020, (referuar dhe pikës nr. 4, Kreu I, "Mjedisi i kontrollit", të Pyetësorit të vetëvlerësimit) SRD nuk ka ndërtuar skedën e trajnimeve.

Konstatohet se nivelet menaxheriale nuk kanë zhvilluar trajnime të dedikuara mbi njohuritë për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku këto fusha janë duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm, hartimin e regjistrit të riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, raportimin e tyre si dhe hartimi i masave për parandalimin e këtyre risqeve, ka si përgjigje se janë kryer disa trajnime në bazë të programit të DPHKBFP dhe Drejtoria e harmonizimit të AB në MFE.

Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime për gjithë stafin menaxhues në drejtim të në drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë shpenzuese si dhe drejtorive të saj rajonale.

b. Etika personale dhe profesionale.

Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e saj të brendshme, ku ka të integruar rregullat e etikës për institucionin. Nga ana tjetër, në lidhje me zbatimin e Parimit 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”, dhe se “Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë” hartuar sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, konstatohet se nëpunësit e këtij institucioni bazojnë veprimtarinë e tyre në normat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

c. Struktura organizative.

Struktura e institucionit është e miratuar dhe sipas VKM nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve dhe te procedurave që dihet të ndiqen gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative në institucionet e administratës publike”.

Konstatimi:

Pozicioni në strukturë i NjAB është se emërohet, shkarkohet dhe funksion nën strukturën dhe varësinë e Drejtorit të SRD. Në arsyetimin e audituesve të autorizuar të KLSH-së, kjo situatë nuk është në pajtueshmëri të plotë me kuadrin ligjor mbi auditimin e sektorit publik, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kuadrin e standardeve profesionale në fuqi.

Në pikën nr.22, Neni 4, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, sanksionohet se,

“Titullar i njësisë publike” është kreu i organit qendror të njësisë publike”.

Në Nenin 7, të ligjit Nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, nënvizohet se,

Organet e Autoritetit janë:

1) Bordi;

2) Drejtori i përgjithshëm.

Në Nenin 4, pika 17 si dhe në nenin 8, të ligjit Nr. 114/2015 , datë 15.10.2009 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, theksohet se:

“Standardet ndërkombëtare për auditimin e brendshëm” u referohen standardeve ndërkombëtare për praktikat profesionale të audituesve të brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm.

“ Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me: a) standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrisë të Financave;”

Në Standardin e Institutit të Audituesve të Brendshëm 1110, normohet që;

SNA 1110 – Pavarësia Organizative: Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të raportojë tek një nivel brenda organizatës i tillë që t'i japë mundësi aktivitetit të auditimit të brendshëm të përmbushë përgjegjësitë e tij. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i konfirmojë bordit, të paktën një herë në vit, pavarësinë organizative të aktivitetit të auditimit të brendshëm. Interpretimi: Pavarësia organizative arrihet në mënyrë efektive kur Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm (DAB) raporton në mënyrë funksionale në Bord. Shembuj të raportimit funksional në bord e përfshijë bordin në: • Miratimin e statutit të auditimit të brendshëm; • Miratimin e planit të auditimit të brendshëm bazuar mbi rrezikun; • Miratimin e buxhetit të auditimit të brendshëm dhe planin e burimeve; • Marrjen e komunikimeve nga drejtuesi i auditimit të brendshëm mbi

performancën e auditimit të brendshëm në lidhje me planin dhe çështje të tjera; • Miratimin e vendimeve për emërimin dhe largimin e drejtuesit të auditimit të brendshëm; • Miratimin e shpërblimit (pagës) së drejtuesit të auditimit të brendshëm; dhe • Kryerjen e kërkesave drejt me menaxhimin dhe drejtuesit të auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse ekzistojnë kufizime të papërshtatshme në fushën e veprimit apo në burimet e auditimit të brendshëm.

SNA nr.1111- “Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me bordin”, që shpreh se “Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të komunikojë dhe ndërveprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë me bordin”.

Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përgjigjet përpara Bordit të Spitalit të SRD, si organi më i lartë i drejtimit të Autoritetit. Për sa më sipër, SRD në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila është institucioni përgjegjës politikë bërës në fushën e auditimit të brendshëm, duhet të standardizojë emërtesën dhe pozicionin në strukturë të Njesisë së Auditimit të brendshëm.

Konstatim:

Dokumenti i Planit vjetor dhe strategjik të auditimit, nuk është konsultuar dhe marrë opinioni i Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Bordit, përpara miratimit nga ana e Drejtorit të SRD.

Kriteri: Kreu III, pika 3.1, i Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, përcaktohet se: *Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KA-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.*

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda datës 15 Dhjetor të çdo viti përgatit planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor për të gjithë veprimtarinë e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Shkaku: Si rrjedhojë e moszbatimit të plotë nga ana e njësisë publike SRD të Manualit të Auditimit të Brendshëm,

Rëndësi: E mesme

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre sipas kuadrit ligjor (punonjës me kod pune). Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se funksionet dhe punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo nivelet e duhura menaxheriale.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 108, datë 17.11.2016, ka përcaktuar në Kapitullin III, Kreun III/1, faqe 26 në lidhje me politikat e burimeve njerëzore ka përcaktuar se ato duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
- Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;
- Një sistem stimujsh për punonjësit për t'i nxitur të rrisin cilësinë e kryerjes së detyrave të caktuara;
- Një sistem për qarkullimin e punonjësve për të lejuar punonjësit të përftojnë një eksperiencë të gjerë në njësinë ku punojnë;
- Një sistem transparent sanksionesh, që të përcjellë një ide të qartë të qëndrimit të titullarit të

njesisë ndaj shkeljes së rregullave të vendosura dhe një tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla;

□ Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit, etj.

Rezulton se, nga ana e kësaj njësie publike për vitin 2019 - 2020, nuk janë kryer vlerësime periodikë e vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e rregullores së brendshme.

2. Vlerësimi i riskut (a bën njësi vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analiza etj).

- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e SRD janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontroleve ekzistuese dhe nevojave për kontrole të reja, një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.

3. Aktivitetet e kontrollit: (a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plotë, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar mbivendosje të detyrave. U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin e tyre, etj.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Janë miratuar në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor të fond-krijuesit, etj.

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato). Drejtoret e drejtorive dhe NZ i njësisë shpenzuese SRD zotërojnë dhe shpërndajnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe me korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, ndjekjes së çështjeve të deleguara, etj. Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Për të siguruar përmbushjen e objektivave dhe koordinuar punën, punonjësit e të gjitha niveleve të institucionit të SRD kanë shkëmbyer informacionet nëpërmjet komunikimit horizontal dhe vertikal, si edhe midis institucioneve të tjera publike duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike.

5. Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuar se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).

Në SRD është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e problematikave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë, respektivisht tek Drejtori i SRD dhe Bordi i Spitalit. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet financiare vjetore institucioni i ka paraqitur në Ministrinë e Linjës administrative por nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Për sa sipër, grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, janë zbatuar kërkesat e Kreut VI, paragrafi 257,

nënpika 63 “Raportet e monitorimit”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku shprehimisht përcaktohet që: “Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive”. Me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të aktiviteteve të kontrollit, nga strukturat përgjegjëse të SRD janë ndërmarrë një sërë procesesh monitoruese periodike dhe vjetore. Titullari i institucionit është informuar vazhdimisht nëpërmjet raporteve periodike për realizimin e objektivave të punës. Gjatë takimeve periodike të punës janë analizuar objektivat dhe detyrat e përcaktuara, duke mundësuar ecurinë e punës, rreziqet dhe rivlerësimin e tyre. Çdo drejtor drejtorie ka përgatitur mendimet për përmirësimin në vazhdimësi të institucionit dhe në rastet e konsideruara të dobishme, janë përfshihen në planin e punës së institucionit për të ardhmen.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në institucionin e SRD ka një sistem të ngritur të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, por që për periudhën objekt auditimi ka reflektuar edhe mangësi e dobësi në funksionimin e tij, ndaj kërkohet përmirësimi dhe koordinimi i hallkave në të ardhmen, për të cilën kërkohet një vëmendje e shtuar nga strukturat përgjegjëse menaxheriale dhe bordit të menaxhimit.

2.9.1 Titulli i gjetjes: Për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Rajonal Durrës, nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin të menaxhimit financiar dhe kontrollin. Nga ana e subjektit u paraqit vetëm urdhëri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik por asnjë akt shkresor mbi veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. U konstatua se grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar. U konstatua se nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë u konstatua edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar.

Kriteri: Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Impakti/Efekti: Mungesa e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare

Shkaku: Mos implementimi plotësisht i procedurave për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rëndësia: I mesëm.

2.9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për të implementuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e kontrollit vertikal të SRD për dhënien e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare të tij.

Afati: Në vijimësi

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 17, date 30.04.2021

3.10. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojit të gjetjeve. Rezultatet dhe effienca e strukturave të ngritura për realizimin e auditimit të brendshëm. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

2.10.1 Titulli i gjetjes: Mbi auditimin e brendshëm

Situata: Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm është krijuar më Urdhër nr. 915 Prot., datë 29.04.2016 duke emëruar vetëm një specialist i lartë auditimi, struktura ka ndryshuar duke krijuar si sektor por përsëri brenda periudhës objekti auditimi ka funksionuar vetëm me një auditues. U konstatua se nga mos plotësimi i kriterëve ligjore, auditimi është kryer vetëm me një punonjës në kundërshtim me ligjin për auditimin e brendshëm gjë e cila nuk siguron pavarësinë e plotë të auditimeve të kryera. Nuk sigurohet kontrolli i cilësisë, raportet e auditimit nuk janë hartuar sipas afateve të përcaktuara në manual duke mos u lenë mundësinë e observacioneve njësisë që auditohet. Nga ana e njësisë së auditimit nuk është hartuar dhe miratuar karta e auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 3 ku ndër të tjera përcaktohet se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”. Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar

Impakti/Efekti: Strukturë auditimi i brendshëm jo eficiente

Shkaku: Struktura jo të plotësuar

Rëndësia: i lartë.

2.10.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e zyrës së auditimit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë objektive dhe për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës, duke kryer veprimtarinë sipas Standardeve të Auditimit dhe zbatimin e afateve sipas manualit.

Afati: Në vijimësi

Për sa më sipër mban përgjegjësi:

1. N. J., Drejtor i SRD
2. L. K., audituese

Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në sektor me varësi të drejtpërdrejtë nga titullari i Institucionit

Neni 5 Misioni , i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

“Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.”

Pika 2 e Nenit 10 i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

“2. Njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike.”

Nga ana e njësisë së auditimit nuk është hartuar dhe miratuar karta e auditimit në kundërshtim me pika 12, neni 4 i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

“12. “Karta e Auditimit” është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm.”

Gjatë periudhës objekti auditimi në strukturë ka vetë një auditues në sektorin e auditimit në kundërshtim me pikën 3 të Vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”

“Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Për vitin 2019

Shkresën nr. 2337/1, datë 17.10.2018 është dërguar Plani Strategjik 2019/2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2019 janë planifikuar 3 auditime të plota dhe 1 i pjesshëm.

Në dosjet e auditimit janë:

Auditimi i Detyrimeve

Program i Angazhimit të auditimit nr. 1076, datë 03.06.2019
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 1076/1, datë 03.06.2019
Deklarata e pavarësisë
Projektraport i auditimit nr. 1076/2, datë 29.07.2019
Raporti Final nr. 1076/3, datë 29.07.2019
Memo për Titullarin nr. 1076/4, datë 29.07.2019
Në përfundim të auditimit janë lënë tre rekomandime zbato ligjin

Auditimi i Financa – Inventarët

Program i Angazhimit të auditimit nr. 697, datë 02.04.2019
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 697/1, datë 02.04.2019
Deklarata e pavarësisë
Projektraport i auditimit nr. 697/2, datë 27.05.2019
Raporti Final nr. 697/3, datë 30.05.2019
Memo për Titullarin nr. 697/4, datë 30.05.2019
Në përfundim të auditimit janë lënë një rekomandim zbato ligjin

Auditimi i Prokurimeve

Program i Angazhimit të auditimit nr. 1700, datë 13.09.2019
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 1700/1, datë ska
Deklarata e pavarësisë
Projektraport i auditimit nr. 1700/2, datë 20.11.2019
Raporti Final nr. 1700/3, datë 20.11.2019
Memo për Titullarin nr. 697/4, datë 30.05.2019
Plani i veprimit
Në përfundim të auditimit janë lënë tre rekomandime zbato ligjin

Auditimi i Farmacisë

Program i Angazhimit të auditimit nr. 93, datë 11.01.2019
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 93/2, datë 24.01.2019
Deklarata e pavarësisë
Projektraport i auditimit nr. 93/3, datë 25.03.2019
Raporti Final nr. 93/4, datë 29.03.2019
Memo për Titullarin nr. 93/5, datë 29.03.2019
Plani i veprimit
Në përfundim të auditimit janë lënë tre rekomandime zbato ligjin.
Shkresën nr. 121/1, datë 18.02.2020 është dërguar raporti i veprimtarisë.

Për vitin 2020

Shkresën nr. 1865/1, datë 18.10.2019 është dërguar Plani Strategjik 2020/2022 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Për vitin 2020 janë planifikuar 3 auditime të plota dhe 1 i pjesshëm.
Raportimi i veprimtarisë me email 02.08.2021.
Gjatë vitit 2020 është realizuar 2 auditime.

Auditimi i Farmacisë viti 2020

Program i Angazhimit të auditimit nr. 50, datë 09.01.2020
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 50/1, datë 10.01.2020
Deklarata e pavarësisë
Projektraport i auditimit nr. 50/2, datë 30.03.2020
Raporti Final nr. 50/3, datë 30.03.2020

Auditimi i Detyrime viti 2020

Program i Angazhimit të auditimit nr. 695/1, datë 06.04.2020
Njoftimi për fillimin e misionit të auditimit nr. 695, datë 06.04.2020
Deklarata e pavarësisë

Projektraport i auditimit nr. 695/2, datë 9.06.2020

Raporti Final nr. 695/3, datë 9.06.2020

Nga auditimi i punës së auditimit të brendshëm konstatohet se cilësia e punës është shumë e ulët pasi rekomandimet në të gjitha rastet janë të llojit “zbato ligjin” dhe pa identifikuar problematika konkrete. Gjithashtu referuar numrit të gjetjeve dhe problematikave të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH arrijmë në konkluzionin që puna e auditivit të brendshëm nuk ka cilësinë e kërkuar.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm është në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm , të ndryshuar pasi nuk ka raportuar tek menaxhimi i lartë:

2.3 Pavarësia dhe objektiviteti

Standardi 1100 –Pavarësia dhe Objektiviteti Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe audituesit e brendshëm duhet të jenë objektiv në përmbushjen e detyrave të tyre.

Standardi 1110 - Pavarësia Organizative Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të raportojë tek një nivel brenda organizatës i tillë që t'i japë mundësi aktivitetit të auditimit të brendshëm të përmbushë përgjegjësitë e tij. Drejtuesi i auditimit duhet t'i konfirmojë bordit, të paktën një herë në vit, pavarësinë organizative të aktivitetit të auditimit të brendshëm.

Standardi 1120 - Objektiviteti Individual Audituesit e brendshëm duhet të kenë një qëndrim të paanshëm, pa paragjykim dhe të shmangin çdo konflikt interesi.

Standardi 1130 – Cenimet e pavarësisë ose të objektivitetit Nëse pavarësia ose objektiviteti cenohet realisht ose në dukje, detajet e cenimit duhet të raportohen tek palët e dhura. Natyra e raportimit do të varet nga shkalla e cenimit.

Kapitulli 3

Standard 2060: Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i raportojë periodikisht menaxhimit të lartë dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatit e aktivitetit të auditimit të brendshëm në raport me planin e tij. Raportimi duhet të përfshijë ekspozime ndaj rrezikut material dhe çështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes së organizatës dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi.

Nga Njësia e Auditimit nuk është hartuar Formati nr.1, Karta e Auditimit

Standardi 2030

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të sigurojë se burimet e auditimit të brendshëm janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë efektive për të përmbushur planin e miratuar.. Udhëzuesi praktik Drejtuesi i lartë i auditimit /Drejtuesi i Njesisë së AB-së është përgjegjës për menaxhimin e duhur të aktivitetit të auditimit të brendshëm që: “puna e auditimit të përmbushë qëllimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme të përshkruara në Kartë, të miratuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi. Burimet e aktivitetit të auditimit të brendshëm përdoren me efektivitet dhe efikasitet. Puna e auditimit kryhet në përputhje me Standardet IIA.”

Nuk janë respektuar afatet e hartimit të projektraportit dhe raportit përfundimtar, nuk është siguruar kontrolli i cilësisë, nuk janë reflektuar dhe as dhënë mundësia për observacione.

Nuk janë zhvilluar takimet e ballafaqimit.

Nuk është hartuar plani i veprimeve dhe ti bashkëlidhet dosjes së auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

1. Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm”
2. VKM nr.83, datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”
3. Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 20, date 30.04.2021

3.11. Mbi auditimin e fondeve të akorduara dhe të shpenzuara , për përballimin e situatës së pandemisë COVID – 19

Në zbatim të pikës 10 të programit të auditimit,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Listat e punonjësve që kanë marrë shpërblim për periudhën e pandemisë,

2) Listat e dërguara në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me këto shpërblime për konfirmim.

-Për shkak të situatës të shfaqjes të rasteve të para në Republikën e Shqipërisë dhe shpalljen e gjendjes të pandemisë, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 207, datë 10.03.2020 “Dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, duke vendosur masën e shpërblimit për personelin e angazhuar në diagnostifikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid – 19.

-Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.1429/1, datë 12.03.2020 “Dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, përcaktohet masa e shpërblimit mujor të personelit mjekësor në masën 125,000 lekë dhe masa e shpërblimit mujor për personelin mbështetës në masën 65,000 lekë. Burimi i financimit të shpërblimeve janë buxheti i miratuar i vitit përkatës ose të ardhurat dytësore që realizohen. Shpenzimet e kryera për këto shërbime do të rimbursohen nëpërmjet fondit rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2020.

Për periudhën objekt auditimi Spitalit të Durrësit i janë alokuar fonde në vlerën 34,936,482 lekë.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me fondet e alokuara për shpërblimin e personelit:

Pasqyra nr.1:Fondet e alokuara për pandeminë Covid - 19

Shkresat e alokimit te fondeve		VKM dhe urdhrat e dala per alokim fondesh nga Institucionet financuese	Shpërblimet e alokuara	Institucioni Financues	Muaji
Numri	Data				
1429/1 1689/1	12.03.2020 01.04.2020	Vendimi nr. 207, date 10.03.2020 Urdher nr.224, date 01.04.2020	1,719,773	FSDKSH	Mars 2020
2304/1	13.05.2020	Urdher nr.313	365,000 309,091	MSHMS	
3355/1 3355/2	13.07.2020 15.07.2020	Urdher nr. 414, Date 13-15.07.2020	820,681	MSHMS	Qershor 2020
3825/1	14.08.2020	Urdher nr. 473	2,725,753	MSHMS	Korrik 2020
4165/1	16.09.2020	Urdher 511	3,809,319	MSHMS	Gusht 2020
4571/1	12.10.2020	Urdher 566	3,729,319	MSHMS	Shtator 2020
5126/1	16.11.2020	Urdher 632	4,664,773	MSHMS	Tetor 2020
5523/1	15.12.2020	Urdher 672	7,756,818	MSHMS	Nentor 2020
328/1	19.01.2021	Urdher 31	9,037,955	MSHMS	Dhjetor 2020
TOTALI			34,938,482		

3) **Burimi:** Sektori i financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Po ashtu në këtë shkresë përcaktohet në pikën 4 “Lista emërore e përfituesve , përfshirë ditët e angazhimit, sipas pikave 1,2 dhe 3 të këtij vendimi, të dërgohen brenda datës 3 të muajit pasardhës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tu miratuar me urdhër të ministrit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

-Me urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr.224, datë 01.04.2020 për “Dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit në diagnostifikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga Covid - 19”, përcaktohet se titullarët e institucioneve të përfshira në këtë urdhër mbajnë përgjegjësi për hartimin e listave përfituese sipas angazhimit dhe plotësimin e dokumentacionit që vërteton përfshirjen e punonjësve në këtë angazhim.

Nga grupi i auditimit konstatohet se shpërblimet e Covid – 19 janë dhënë pas faktit. Pasi janë bërë verifikimet e pacientëve të cilët janë paraqitur në urgjencën e spitalit, apo të pacientëve të cilët janë shtruar në spital, me listat që vinin nga Instituti i Shëndetit Publik, për të nxjerrë në një moment të dytë cilët pacientë kanë rezultuar me Covid – 19. Pasi është bërë verifikimi i pacientëve të cilët kanë rezultuar të infektuar, bëhet rakordimi se cili mjek, infermier, mami, sanitare kanë pritur dhe kanë patur kontakt me të infektuarit. Në këtë moment, nga shefat e pavijoneve hartohen listat e punonjësve të cilët kanë qenë në kontakt ne të infektuarit, dhe hartohet lista përfundimtare nga sektori i financës. Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit, dhe dërgohet në mënyrë elektronike (me e - mail) në Ministrinë e Shëndetësisë. Në disa raste punonjësve ju janë dhënë më pak ditë nga sa ka qenë parashikuar në listën paraprake të dërguar në ministri.

-Me shkresat nr.686/prot, datë 06.04.2020 (mars 2020); nr.879/1 prot, datë 18/05/2020 (prill

2020); nr.879/2 prot, datë 04/06/2020 (maj 2020); nr.1321/1 prot, datë 22.07.2020 (qershor 2020); nr.1518/1 prot, datë 24/08/2020 (korrik 2020); nr.1575 prot, datë 04/09/2020 (gusht 2020); nr.1766 prot, datë 09/10/2020 (shtator 2020); nr.1951 prot, datë 11/11/2020 (tetor 2020); nr.2131 prot, datë 14/12/2020 (nëntor 2020); nr.192/1 prot, 27/01/2021 (dhjetor 2020); nr.397/1 prot, datë 26/02/2021 (janar 2020) “Për dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”, janë dhënë shpërblimet për personelin e Spitalit Rajonal Durrës, si në tabelën më poshtë:

Pasqyra nr.2: Shpërblimi i personelit mjekësor dhe atij mbështetës

Covid - 19	Mjekë	Infermierë/ Instrumentarë/ Oksigjenistë	Teknikë imazheristë/ radiologë	Koordinator	Mami	Sanitarë	Shoferë	Zëvendës Drejtori i Shërbimeve	Desifektim/ Krematorium/ Mirëmbajtje
Mars 2020	22	53	6	1	0	26	19	1	0
Prill 2020	9	15	5	1	0	8	8	0	1
Maj 2020	10	15	4	0	2	12	8	0	0
Qershor 2020	15	43	6	1	4	12	11	0	1
Korrik 2020	19	41	5	0	5	12	18	0	1
Gusht 2020	30	81	6	1	0	28	19	0	1
Shtator 2020	24	72	8	1	0	25	19	0	0
Tetor 2020	27	90	6	1	0	31	19	0	1
Nëntor 2020	40	127	7	1	0	41	18	0	3
Dhjetor 2020	49	138	7	1	0	43	18	0	3
Janar 2020	70	135	7	1	0	49	18	0	3
TOTALI	315	810	67	9	11	287	175	10	14

Burimi: Sektori i Financës dhe përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i listave të shpërblimeve rezulton se: është paguar punëtori i krematorit M. O. në vlerën 373,811.33 lekë koordinatori G. K. në vlerën 290,376.43 lekë koordinatori E. P. në vlerën 29,545 lekë dhe koordinatori B. J. në vlerën 41,364 lekë.

Nga grupi i auditimit konstatohet se në listat e shpërblimeve rezulton se ka paqartësi në funksionin e kryer nga punëtori i krematoriumit gjatë periudhës të pandemisë. Në disa raste ky punonjës paraqitet si sanitar, punonjës desifektimi, mirëmbajtës, sanitar i mbetjeve spitalore. Po ashtu janë dhënë shpërblime për Koordinatorin pa patur dokumentacion justifikues. Referuar VKM-së nr. 207, datë 10.03.2020, pika 2 “Përfitojnë një shpërblim mujor, në masën 65,000 lekë personeli mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga Covid - 19”, si dhe nga struktura organizative e Spitalit Rajonal Durrës, nuk justifikohen dhe nuk vërtetohet nga dokumentacioni bashkëlidhur me listat e hartuara lidhur me shpërblimet e Covid – 19, pagesa e punëtorit të mirëmbajtjes dhe koordinatorit dhe koordinatorit.Sa më sipër, vlera **735,096.76 lekë** konsiderohet **shpenzim i paligjshëm. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. N. J., në cilësinë e Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës.**

Sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.11, datë 30.04.2021

2.11.1 Titulli i Gjetjes: Dhënia e shpërblimeve Covid – 19.

Situata: Nga auditimi i praktikave lidhur me shpërblimin për situatën e krijuar nga pandemia COVID – 19, rezultoi se shpërblimet e punonjësve të angazhuar sa i takon kësaj periudhe janë dhënë pas faktit. Nga Spitali Rajonal i Durrësit janë bërë verifikimet e pacientëve të cilët janë paraqitur në urgjencën e spitalit, apo të pacientëve të cilët janë shtruar në spital, me listat që vinin nga Instituti i Shëndetit Publik, për të nxjerrë në një moment të dytë se cilëve nga pacientët që u është ofruar shërbimi mjekësor, kanë rezultuar me Covid – 19. Pas verifikimit të pacientëve të cilët kanë rezultuar të infektuar me COVID - 19, bëhet rakordimi se cili mjek, infermier, mami, sanitare kanë pritur dhe kanë pasur kontakt me të infektuarit. Nga shefat e pavijoneve hartohen listat e punonjësve të cilët kanë qenë në kontakt me të infektuarit, dhe lista përfundimtare lidhur me shpërblimin përpilohet nga sektori i financës. Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit, dhe dërgohet në mënyrë elektronike (me e-mail) në Ministrinë e Shëndetësisë. Në disa raste punonjësve ju janë dhënë më pak ditë nga sa ka qenë parashikuar në listën paraprake të dërguar në ministri, pra ka mos përputhje të dhënash. Nuk është hartuar një rregullore, plan veprimi dhe dhënia e shpërblimeve Covid – 19 është bërë në mënyrë rastësore bazuar në listat e paraqitura nga

shifat e pavijoneve.

Nga grupi i auditimit konstatohet se në listat e shpërblimeve rezulton se ka paqartësi në funksionin e kryer nga punëtori i krematoriumit gjatë periudhës të pandemisë. Në disa raste ky punonjës paraqitet si sanitar, punonjës desifektimi, mirëmbajtës, sanitar i mbetjeve spitalore. ashtu janë dhënë shpërblime për Koordinatorin pa patur dokumentacion justifikues.

Sa më sipër, vlera **735,096.76 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ**.

Kriteri: VKM nr. 207, datë 10.03.2020 “Dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë” pika 1, 2 dhe 3.

Ndikimi/Efekti: Vendimet për dhënien e shpërblimit për Covid – 19 i kanë shkaktuar Spitalit Rajonal Durrës shpenzimin e paligjshëm në vlerën 735,096.76 lekë

Shkak: Shpërblimi i personelit mbështetës pa kritere të përcaktuara dhe pa dokumentacion justifikues.

Rëndësia: E lartë.

2.11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me hartimin dhe miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të spitalit për periudhën e pandemisë Covid – 19, të hartohet plan veprimi lidhur me stafin mjekësor dhe atë mbështetës, bazuar në cilin më pas do të alokohen dhe shpërblimet. Po ashtu, nga Drejtoria të merren masa lidhur me analizimin vlerës të **efekt financiar negativ** në vlerën **735,096.76 lekë** të shkaktuar nga shpërblimet e dhëna ndaj stafit mbështetës të spitalit.

Afati: Menjëherë.

- Observacionet

Në përgjigje të akt-konstatimit nr. 11 datë 30.04.2021 të grupit të auditimit është paraqitur observacioni nga z. B. J. protokolluar në KLSH me nr. 135/7 datë 27.09.2021, dhe marrë në dorëzim nga Grupi i Auditimit në datë 01.10.2021, me pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

3) *Gjithashtu, shpërblimi i dhënë ndaj meje, është e drejtë që e përfitoj sipas VKM nr.207, datë 10.03.2020 “Për dhënie Shpërblimi për Personelin, mjekë, infermierë, dhe punonjës të tjerë.”, pika 2 e tij “Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID - 19”*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, nuk merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin me argumentet si vijon:

3) *Lidhur me observacionin tuaj lidhur me këtë pikë, ju sqarojmë se bazuar në rregulloren vënë në dispozicion grupit të auditimit, strukturës organike dhe shqyrtimit të dokumentacionit të venë në dispozicion, rezulton se nuk ka fakte të cilat provojnë argumentet tuaja. Grupi i auditimit ka kërkuar disa herë informacion dhe dokumente justifikuese nga administrata e spitalit lidhur me shpërblimet e dhëna për Covid – 19, bazuar në të cilat rezulton se pagesa e kryer pas faktit lidhur me këta punonjës nuk është kryer referuar kërkesave lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

- Observacionet

Në përgjigje të akt-konstatimit nr. 11 datë 30.04.2021 të grupit të auditimit është paraqitur observacioni nga znj. N. J. protokolluar në KLSH me nr. 132/5 datë 17.05.2021, dhe marrë në dorëzim nga Grupi i Auditimit në datë 19.05.2021, me pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

4) *Për shkak se këta punonjës janë të angazhuar në kryerjen e shërbimeve si koordinatorë të urgjencës, dhe si të tillë ato janë të detyruar në bazë të kontratës që kanë lidhur me SRD t'i përgjigjen të gjitha detyrave të ngarkuar, dhe pikërisht në kohën e Covid 2019, të japin shërbim ndaj personave të me Covid – 19 pranë urgjencës së SRD – së, duke filluar nga organizimi i punës në urgjencë, në menaxhimin e lëvizjes së autoambulancave, dezinfektimit të tyre, drejtimit e lëvizjes të pacientëve të drejtuar në urgjencë me Covid etj etj, pra të kryejnë*

punën sipas rregullores të brendshme të tyre, kryerje e detyrave të tilla kanë shpënë në dhënien ndihmës së parë të pacientëve dhe shpëtimin e jetës së tyre.

- 5) *Theksoj se këta punonjës nuk kanë punuar njëkohësisht, etj.*
- 6) *Për sa i përket punonjësit M. O., me anë të urdhrimit të brendshëm me nr.1278/1 prot, datë 27.07.2020 “për disa ndryshime në rregulloren e brendshme të vitit 2020-2021”, punonjësi në fjalë emërohet punonjës i krematoriumit, ku janë listuar detyrat funksionale të punëtorit të krematoriumit, i cili ndër të tjera ka realizuar dhe dezinfektimin e ambienteve ku kanë qëndruar pacientët me covid.*
- 7) *Këto shpërblime janë dhënë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi punëtori i krematoriumit dhe koordinatori janë personel mbështetës dhe kanë ofruar shërbimin e tyre ndaj personave me covid, në një kohë që disa punonjës kanë patur pamundësi apo dhe e kanë refuzuar atë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, nuk merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin me argumentet si vijon:

- 4) *Lidhur me observacionin tuaj lidhur me këtë pikë, ju sqarojmë se bazuar në rregulloren vënë dispozicion grupit të auditimit, strukturës organike dhe shqyrtimit të dokumentacionit të venë në dispozicion, rezulton se nuk ka fakte të cilat provojnë argumentet tuaja. Grupi i auditimit ka kërkuar disa herë informacion dhe dokumente justifikuese nga administrata e spitalit lidhur me shpërblimet e dhëna për Covid – 19, bazuar në të cilat rezulton se pagesa e kryer pas faktit lidhur me këta punonjës nuk është kryer referuar kërkesave lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*
- 5) *Lidhur me observacionin tuaj lidhur me këtë pikë, ju sqarojmë se në akt konstatimin nr.11, datë 30.04.2021 është pasqyruar në mënyrë të ndarë dhe të specifikuar shpërblimi që ka marrë çdo punonjës vetëm për periudhën në të cilën ka kryer detyrat funksionale në fjalë. Observacioni juaj është jashtë kontekstit.*
- 6) *Grupi i auditimit ka kërkuar dokumentacion dhe informacione shpjeguese lidhur me shpërblimet e dhëna për shkak të pandemisë Covid – 19. Ndryshimet e përmendura nga ju në këtë informacion nuk na janë vënë në dispozicion. Pas shqyrtimit të ndryshimeve në rregullore, konstatohet se ndryshimet nuk janë të miratuara nga Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës, dhe si të tilla nuk janë të vlefshme.*

Sa më sipër, argumentimi në akt konstatimin nr.11, datë 30.04.2021 ka qenë i plotë dhe shterues lidhur me veprimet dhe mosveprimet tuaja lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore.

3.12. Të tjera që mund të dalin gjatë procesit auditues

1. Nga grupi i auditimit konstatohet në datën 07.04.2021 hyrje daljet në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës mbahen me programin financiar “Financa 5”. Gjendja e farmacisë nga ekstrakti i datës 07.04.2021 rezulton: 628,854 copë medikamente në vlerën 46,866,206.50 lekë. Bazuar në përzgjedhjen rastore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas regjistrimit në sistem.

2. Nga grupi i auditimit konstatohet se programi financiar “Financa 5” është lehtësisht i aksesueshëm, dhe i modifikueshëm, duke mos dhënë kështu sigurinë e arsyeshme, rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.

Gjatë auditimit të faktit rezultoi se lidhur me medikamentin e përdorur për skanerin me kontrast “Kontrast ct”, rezultoi se nga 140 copë në programin Financa 5, në fakt në farmaci ishin vetëm 120. Kjo u justifikua nga ana e stafit të farmacisë me faktin se ka nevoja urgjente për skaner, dhe se ky medikament ishte dhënë me urdher verbal. Ditën e nesërme grupit të auditimit, ju vu në dispozicion fletë dalja me nr.dok 1936, datë 08.04.2021, sipas së cilës ishte bërë shkarkimi i 5 copë medikamente “kontrast ct”. Pra përsëri rezultonte mungesë prej 15 copë medikamentesh. Pas konstatimit nga grupi i auditimit, u bë modifikimi ku fletëdalja nr.dok. 1936, datë 08.04.2021 paraqiste shkarkimin e 20 copë medikamentesh “kontrast ct”.

3. Hyrjet dhe daljet në farmacinë e spitalit nuk mbahen me një libër të posaçëm regjistrimi, lidhur

me hyrje daljet e bëra sipas kërkesave spitalore për medikamente.

4. Nga grupi i auditimit u konstatua se dalja e medikamenteve nga farmacia, lidhur me nevojat spitalore nuk bëhet në çdo rast me kërkesë me shkrim dhe fletë daljen përkatëse. Kërkesa bëhet verbale nga mjekët, infermierët apo imazheristët, në varësi të kërkesave. Pasqyrimi i këtyre levizjeve në farmaci nuk është i menjëhershëm, por ka vonesa të cilat variojnë nga 1 – 21 ditë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar “Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin perkates te te dhenave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.”.

5. Grupi i auditimit verifikoi me zgjedhje në total 29 lloje medikamentesh duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit. Saktësisht u verifikuan: Sonde blakmore, Metmorfin, Carboplatin, Cefotaxim, Enalapril malate, Cefazoline 1 gr, Human Anti Imuglobine, Sevofluran 250 ml, Kontrast ct, Metoclopramid 10 mg, Vitamina C, Oxytocin, Kontrast Ct 370 mg / 100 ml, Diatro Cleaner, Bilirubine totale GA, Bilirubine direkte GA, Maglumi total PSA, Magnazium, Mesh PVDF/PP, Mesh PVDF, Adrenaline, pllakë dhs/scs, bombul intensive oksigjeni 3 – 5 litra, Cefepim, Cordaron, Dopamine, Docetacel, Isosorbit dinitrate 10 mg tab, Viper Venom.

Saktësisht rezultuan:

1. Mangësi në gjendjen fizike kundrejt asaj kontabël si më poshtë:

Medikamenti	Gjendja Kontabël	Gjendja fizike	Diferenca	Vlera totale (në lekë)
Metoclopramid	9313	9293	20	196
Kontrast ct	140	120	20	71,000
Oxytocin	703	675	28	2,769
Sample Cups	15	14	1	15,600
TOTAL			69	89,565

Shënim: Si gjendje kontabël është konsideruar gjendja e nxjerrë nga sistemi. Si gjendje fizike është konsideruar, gjendja reale në magazinë plus sasia e shënuar e fletë daljeve të cilat nuk ishin hedhur ende në sistem.

Mangësitë e konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”. **Vlera 89,565 lekë përbën dëm ekonomik** për Spitalin Rajonal Durrës, dhe në bazë të udhëzimit të mësipërm pika 89, ku citohet “Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vlefte, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të njësisë”, përgjegjësia për këtë vlerë i ngarkohet përgjegjësës së farmacisë së SRD, B. S..

2. Tepricë në gjendjen fizike kundrejt asaj kontabël si më poshtë:

Medikamenti	Gjendja Kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
Metmorfin	620	645	25

Shënim: Si gjendje kontabël është konsideruar gjendja e nxjerrë nga sistemi. Si gjendje fizike është konsideruar, gjendja reale në magazinë plus sasia e shënuar e fletë daljeve të cilat nuk ishin hedhur ende në sistem.

Tepricat e konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”. Për tepricat e konstatuara mban përgjegjësi përgjegjësja e farmacisë së SRD, B. S.

Vlera e tepricave kalon në favor të SRD.

Nga grupi i auditimit u konstatua se janë bërë transferime medikamentesh të ndryshme gjatë periudhës objekt auditimi. Transferimi i këtyre medikamenteve është bërë për të plotësuar / mbuluar nevojat emergjente të cilat janë shfaqur në këto spitale. Transferimi i këtyre medikamenteve realizohet me aprovimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për

vitin 2019 janë në total 4 transferime, kurse për vitin 2020 duke qenë dhe viti i pandemisë Covid – 19 janë kryer 11 transferime.

Nr	Miratim Email nga MSHMS	Medikamentet e kërkuara	Data e hyrjss	Vlera totale	Spitali
1	06/04/2020	Gemcitabin	08/04/2020	29,548	Kalim medikamenti QSUT
		Paclitacel			
		Cisplatin			
		Carboplatin			
2	17/04/2020	Paclitacel	17/04/2020	31,200	Kalim medikamenti QSUT
3	22/04/2020	Gemcitabin	24/04/2020	170,943	Kalim medikamenti QSUT
		Epirubicin			
		Trastuzumab			
		Carboplatin			
4	29/05/2020	Calcium Chloride	01/06/2020	42,650	Kalim medikamenti Spitali Shkodër
5	02/06/2020	Doxorubicin	02/06/2020	24,955	Kalim medikamenti QSUT
		Oxaliplatin			
6	16/06/2020	Dalteparine 5000UI	25/06/2020	15,839.76	Kalim medikamenti Spitali Tepelenë
7	29/06/2020	Fentanyl	30/06/2020	32,400	Kalim medikamenti Spitali Traumës
8	29/06/2020	Thiopental	01/07/2020	8750	Kalim medikamenti Spitali Shkodër
9	09/07/2020	Age Spinale	13/07/2020	24,720	Kalim medikamenti Spitali Lushnje
10	16/07/2020	Sevofluran	17/07/2020	135,125	Kalim medikamenti Spitali Tropojë
		Ondasetron			
		Midazolam			
11	21/07/2020	Fentanyl	22/07/2020	21,600	Kalim medikamenti QSUT

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. B. S., në cilësinë e përgjegjëses të Sektorit të Farmacisë, në Spitalin Rajonal Durrës.

Sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.12, datë 30.04.2021

2.12.1.Titulli i Gjetjes : Organizimi dhe funksionimi i farmacisë të Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: -Nga grupi i auditimit konstatohet në datën 07.04.2021 hyrje daljet në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës mbahen me programin financiar “Financa 5”. Gjendja e farmacisë nga ekstrakti i datës 07.04.2021 rezulton: 628,854 copë medikamente në vlerën 46,866,206.50 lekë. Bazuar në përzgjedhjen rastësore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas regjistrimit në sistem.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se programi financiar “Financa 5” është lehtësisht i aksesueshëm, dhe i modifikueshëm, duke mos dhënë kështu sigurinë e arsyeshme, rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.

- Hyrjet dhe daljet në farmacinë e spitalit nuk mbahen me një libër të posaçëm regjistrimi, lidhur me hyrje daljet e bëra sipas kërkesave spitalore për medikamente.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se dalja e medikamenteve nga farmacia, lidhur me nevojat spitalore nuk bëhet në çdo rast me kërkesë me shkrim dhe fletë daljen përkatëse. Kërkesa bëhet verbale nga mjekët, infermierët apo imazheristët, në varësi të kërkesave. Pasqyrimi i këtyre lëvizjeve në farmaci nuk është i menjëhershëm, por ka vonesa të cilat variojnë nga 1 – 21 ditë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar “Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi ne

dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.”.

Kriteri: Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Parregullsitë në mbajtjen e inventarit të medikamenteve shkaktojnë pasiguri rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.

Shkak: Mos pasqyrimi i saktë dhe i menjëhershëm i daljes nga farmacia të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.

Rëndësia: E lartë.

2.12.1 Rekomandimi: Përgjegjësja e farmacisë të Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me aksesimin dhe modifikimin në programin Financa 5, duke specifikuar punonjësin dhe kriteret e caktuara, bazuar në të cilat do të kryhen modifikimet. Të hartohet dhe mbahet libri i posaçëm i hyrje – daljeve, si dhe të merren masa lidhur me regjistrimin dhe pasqyrimin në kohë reale të lëvizjeve në farmaci, duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë justifikues.

Afati: Menjëherë.

2.12.2. Titulli i Gjetjes: Diferenca në gjendjen e farmacisë së Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: -Grupi i auditimit verifikoi me zgjedhje në total 29 lloje medikamentesh duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit. Saktësisht u verifikuan: Sonde blakmore, Metmorfin, Carboplatin, Cefotaxim, Enalapril malate, Cefazoline 1 gr, Human Anti Imuglobine, Sevofluran 250 ml, Kontrast ct, Metoclopramid 10 mg, Vitamina C, Oxytocin, Kontrast Ct 370 mg / 100 ml, Diatro Cleaner, Bilirubine totale GA, Bilirubine direkte GA, Maglumi total PSA, Magnazium, Mesh PVDF/PP, Mesh PVDF, Adrenaline, pllakë dhs/scs, bombul intensive oksigjeni 3 – 5 litra, Cefepim, Cordaron, Dopamine, Docetacel, Isosorbit dinitrate 10 mg tab, Viper Venom.

Gjatë auditimit të faktit rezultoi se lidhur me medikamentin e përdorur për skanerin me kontrast “Kontrast ct”, rezultoi se nga 140 copë në programin Financa 5, në fakt në farmaci ishin vetëm 120. Kjo u justifikua nga ana e stafit të farmacisë me faktin se ka nevoja urgjente për skaner, dhe se ky medikament ishte dhënë me urdhër verbal. Ditën e nesërme grupit të auditimit, ju vu në dispozicion fletë dalja me nr.dok 1936, datë 07.04.2021, sipas së cilës ishte bërë shkarkimi i 5 copë medikamente “kontrast ct”. Pra përsëri rezultonte mungesë prej 15 copë medikamentesh. Pas konstatimit nga grupi i auditimit, u bë modifikimi ku fletëdalja nr.dok. 1936, datë 07.04.2021 paraqiste shkarkimin e 20 copë medikamentesh “kontrast ct”.

Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit, u konstatua se:

-Në 1 rast kishte teprica në sasi të medikamenteve.

-Në 4 raste kishte mangësi në sasi të medikamenteve në vlerën **89,565** lekë.

Diferencat e konstatuara janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 89. Për pasojë vlera 84,006 lekë, që përbën vlerën e medikamenteve të munguara, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Përgjegjësia për këtë vlerë i ngarkohet përgjegjësës së farmacisë së SRD, B. S..

Kriteri: Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **89,565** lekë.

Rëndësia: E lartë

2.12.2 Rekomandim: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **89,565** lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për diferencat e konstatuara duke nxjerre dhe përgjegjësitë konkrete.

Afati: Menjëherë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Spitalit Rajonal Durrës, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë⁴

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë⁵, i mbështetur në ligjin nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Spitalit Rajonal Durrës, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000⁶)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e Spitalit Rajonal Durrës rezultoi se:

-Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht kryesisht me veprimet dhe mosveprimeve të administratës së Spitalit nga të cilat janë konstatuar dëme ekonomike në vlerën **1,198,100 lekë**, në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, shpenzime pagash, zvarritjen e çështjeve gjyqësore, mosgarantimin e zbatimit të plotë të vendimeve, mosmarrjen e masave për pjesëmarrjen në proceset për njohjen e vendimeve gjyqësore, mungesën e një analize paraparake përpara nisjes së këtyre procedurave, etj, të cilat më vete dhe së bashku kanë ndikime financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit cila kap vlerën në rreth **29,748, 222 lekë.**

Përgjegjësite e strukturave drejtuese në SRD

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësiave të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Përgjegjësite e Audituesve mbi auditimin e përputhshmërisë.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

⁵ Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

⁶ **ISSAI 4000** – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionit ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Spitalit Rajonal Durrës, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 4000 Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë;

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij .

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ligjshmërinë e vendimmarrjeve të Bordit të Spitalit Rajonal Durrës (BSRD) u konstatua:

- BSRD, gjatë vitit 2019 ka marrë 25 vendime gjithsej, nga të cilat 9 vendime i ka marrë në mënyrë qarkulluese dhe gjatë vitit 2020 ka marrë 19 vendime gjithsej të cilat i ka marrë të gjitha në mënyrë qarkulluese. Marrja e vendime qarkulluese nuk mundëson pasqyrimin e mendimeve dhe diskutimeve të secilit prej anëtarëve të bordit, në kundërshtim kjo me nenet 3; 8 dhe 11, të VKM nr.237, datë 12.04.2006“Për disa ndryshime në VKM nr.560, datë 23.10.2000 "Për Miratimin e Projektit Pilot Për Përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor" dhe nenin 16, të rregullores së Bordit Drejtues.

- Po kështu, ky Bord në vitin 2019 nuk është mbledhur 4 herë por është mbledhur 3 herë, në kundërshtim kjo me nenin 8, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës dhe me kërkesat e VKM nr.237, datë 12.04.2006. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 22-27 të raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në respektim të rolit dhe detyrës si organi më i lartë ekzekutiv i SRD, të shmangë vendimmarrjen e vendimeve qarkulluese përveçse në rastet kur e ka të pamundur mbledhjen si dhe të pasqyrojë me transparencë diskutimin e anëtarëve të bordit gjatë vendimmarrjes, duke argumentuar çdo çështje

në relacione shpjeguese dhe diskutime mbi këto vendime.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për sa i përket respektimit të strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës konstatohet se për periudhën objekt auditimi, struktura është ndryshuar nga Bordi Drejtues i Spitalit, dymbëdhjetë herë. Këto ndryshime konsistojnë në lëvizjet e pozicioneve të punonjësve të spitalit, si në administratë dhe në stafin mjekësor. Këto ndryshime tregojnë se struktura organizative nuk është e mirë studiuar dhe e konsoliduar, duke krijuar kështu pasiguri dhe performancë të ulët lidhur me pozicionet e punës.

Sa më sipër bie në kundërshtim me misionin e Spitalit Rajonal Durrës: “Misioni i Spitalit Rajonal Durrës është të përmirësojë shëndetin e komunitetit duke ofruar një standard të ri në kujdesin shëndetësor, kujdesin klinik dhe ngritjen profesionale të mjekëve specialistë duke siguruar një qendër mjekësore për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve.”(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 27-39, të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi : Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojnë situatën e krijuar për shkak të ndryshimeve të shpeshta dhe të marrin masa lidhur me konsolidimin dhe unifikimin e strukturës të spitalit.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi konstatohet se nga Spitali Rajonal Durrës, janë dhënë 75 vërejtje gjatë vitit 2019 dhe 38 vërejtje gjatë vitit 2020. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk këto procedura nuk janë transparente, dhe nuk ka komision apelimi për dhënien e masave disiplinore.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se në Spitalin Rajonal Durrës, për vitin 2019 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 68 punonjës dhe për vitin 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 79 punonjës.

-Referuar të dhënave të më sipërme rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pjesën më të madhe të rasteve është me arsyen “dorëheqje”. Konkretisht nga numri total i të larguarve nga detyra në vitin 2019 (68 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 41% infermierë/laborantë dhe 25% mjekë. Kurse për vitin 2020 (79 ndërprerje marrëdhëniesh pune), kanë dhënë dorëheqjen 31% infermierë/laborantë dhe 22% mjekë.

Po ashtu, referuar të dhënave për dhënien e masave disiplinore, nga grupi i auditimit konstatohet se për vitin 2019 (75 masa disiplinore në total), 60% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 8% mjekëve. Për vitin 2020 (38 masa disiplinore në total) 18% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 10% i janë dhënë mjekëve.

-Pra sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se për periudhën objekt auditimi, situata e krijuar në Spitalin Rajonal Durrës, për shkak të masave disiplinore të dhëna pa kriter dhe pa mundësi apelimi, mund të ndikojë në performancën e punës, në motivimin e punonjësve, dhe për më tepër të mjekëve dhe infermierëve të cilët përbëjnë 62% të stafit të larguar për periudhën objekt auditimi. Duke pasur parasysh dhe periudhën e pandemisë Covid – 19, ku nevoja për mjekë është jashtëzakonisht e rëndësishme, situata e krijuar në SRD, ndikon negativisht në plotësimin e nevojave emergjente për staf të specializuar në përmbushjen e detyrës funksionale të këtij spitali.

-Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 158 dosje personeli me përzgjedhje rastësore, nga 662 punonjës që ka Spitali Rajonal Durrës, pra 23 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërsëritur, Dëshmia e Penaltetit mungon në pjesën më të madhe të rasteve, mungon raporti mjeko ligjor, vërtetimi nga gjykata mungon në 20 raste, vërtetimi nga prokuroria mungon në 25 raste.

-Mos zbatimi i procedurave të dhënies masave disiplinore sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi dhënien e masave disiplinore duke ndikuar në performancën dhe motivimin e punonjësve të spitalit. Parregullsitë në plotësimin e dosjeve të personelit sjell parregullsi procedurale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 27-39, të Raportit të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e masave disiplinore në këtë spital.

3.2.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marri masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi konstatohet se në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës janë regjistruar të dhëna të gabuara sa i takon zërit të numrit të punonjësve dhe zërit të të ardhurave dytësore. Në bilancin e shoqërisë rezultojnë 82 punonjës të larguar nga detyra në vitin 2020. Bazuar në verifikimin e të dhënave me burimet njerëzore rezulton se numri i të larguarve është 79 punonjës. Po ashtu, rezulton se dhe numri i të punësuar te rinj në vitin 2020 në bilanc është regjistruar 78, në fakt nga verifikimet rezultojnë të jenë 73 të punësuar. Po ashtu nga regjistrimi në zërin “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” në vlerën 2,866,327 lekë. Për vitin 2019 nuk ka asnjë vlerë lidhur me këtë zë të bilancit. Nga ana e Spitalit Rajonal të Durrësit është e paqartë se në cilin zë janë regjistruar këto të ardhura për vitin 2019. Veprimet e më sipërme bien në kundërshtim me pikën 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 112-130, të Raportit të Auditimit)*

4.1Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për rakordimin dhe korigjimin e të dhënave të punonjësve të marrë rishtas në punë, atyre të larguar, si dhe të verifikojë dhe sistemojë vlerën e të ardhurave dytësore të spitalit.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se: Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-brefotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Gjatë vitit 2003 nga ana e ASHK-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhornimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Nga personat përgjegjës në vijimësi, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekar të saktë të Spitalit Rajonal Durrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8 faqe 112-130, të Raportit të Auditimit)*

5.1Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekar. Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme, për përditësimin dhe azhurnimin e statusit ligjor dhe fizik të pronave të SRD me qëllim përfundimin e regjistrimit të pronave në ASHK dhe pajisjen me Titullin e Pronësisë.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit u konstatua se inventarizimi fizik nuk është kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, për shkak të situatës të pandemisë Covid – 19. Komisionet përkatëse të inventarizimit janë ngritur gjatë 2020. Komisioni vlerësimit ka bërë dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune, ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe procesverbalet përkatëse. Në disa raste mungon fletë –

hyrja në magazinë lidhur me materialet të cilat janë kthyer në hekurishte për tu shitur në ankand si skrap, ky veprim janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku citohet: *1. në pasqyrat financiare vjetore.*”, dhe pikat 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

-Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

Mos plotësimi i regjistrimit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8 faqe 112-130, të Raportit të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për realizimin e procesit të inventarizimit fizik në Spitalin Rajonal Durrës, dhe të ndjekë e plotësojë me përgjegjshmëri hapat e proceseve të cilat lindin pas këtij procesi, si asgjësimin, plotësimi i dokumentacionit justifikues etj.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Durrës nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga spitali nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Këto veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre.

Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe objektive të situatës së Aktiveve Afatgjata Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8 faqe 112-130, të Raportit të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës dhe Sektori i Financës të merren masa për verifikimin e vlerës së mbetur dhe jetës të dobishme të AAM-ve me vlera materiale, të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet në datën 07.04.2021 hyrje daljet në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës mbahen me programin financiar “Financa 5”. Gjendja e farmacisë nga ekstrakti i datës 07.04.2021 rezulton: 628,854 copë medikamente në vlerën 46,866,206 lekë. Bazuar në përzgjedhjen rastësore, nga grupi i auditimit u bë ballafaqimi i numrit faktik të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme, me numrin e tyre sipas regjistrimit në sistem.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se programi financiar “Financa 5” është lehtësisht i aksesueshëm, dhe i modifikueshëm, duke mos dhënë kështu sigurinë e arsyeshme, rreth faktit të gjendjes të medikamenteve, kiteve dhe pajisjeve të ndryshme.

- Hyrjet dhe daljet në farmacinë e spitalit nuk mbahen me një libër të posaçëm regjistrimi, lidhur me hyrje daljet e bëra sipas kërkesave spitalore për medikamente.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se dalja e medikamenteve nga farmacia, lidhur me nevojat spitalore nuk bëhet në çdo rast me kërkesë me shkrim dhe fletë daljen përkatëse. Kërkesa bëhet verbale nga mjekët, infermierët apo imazheristët, në varësi të kërkesave. Pasqyrimi i këtyre lëvizjeve në farmaci nuk është i menjëhershëm, por ka vonesa të cilat variojnë nga 1 – 21 ditë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe pika 12, Udhëzimi Nr.30 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e

Sektorit Publik” datë 27.12.2011, i ndryshuar “Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.12, faqe 146-149 të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Sektori i Farmacisë së Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me aksesin dhe modifikimin në programin Financa 5, duke specifikuar punonjësin dhe kriteret e caktuara, bazuar në të cilat do të kryhen modifikimet. Të hartohet dhe mbahet libri i posaçëm i hyrje – daljeve, si dhe të merren masa lidhur me regjistrimin dhe pasqyrimin në kohë reale të lëvizjeve në farmaci, duke bashkëlidhur dokumentacionin e plotë justifikues.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2020 paraqitet me vlerën **9,146,697 lekë**, krahasuar me vlerën e vitit 2019 prej **10,452,818 lekë**, pra ka një rritje prej **1,306,121 lekë** krahasuar me periudhën ushtrimore pasardhëse. Kjo rritje vjen si pasojë e njohjes së debitorëve të viteve të kaluara.

Konstatohet se Sektori i Financës nuk e ka të qartë afatin dhe kohën në cilin duhet kryer kontabilizimi i këtyre detyrimeve, duke sjellë kështu pasiguri për shkak të paqartësisë lidhur me afatet e kontabilizimit të debitorëve lidhur me vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare të Spitalit Rajonal Durrës për llogarinë 468.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, shkronjat g dhe gj, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.8 faqe 112-130 të Raportit të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masa për analizimin e vlerës prej **9,146,697 lekë** të debitorëve, ndjekjes të procedurave të regjistrimit të tyre referuar afateve të përcaktuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstauan mangësi në lidhje me argumentimin teknike dhe ligjor të specifikimeve teknike, si dhe të dokumentimin e tyre në procesverbalin e mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, konkretisht:

“Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2020 – 2 lote”, me fond limit 1,689,000 lekë, kanë marrë pjesë 2-4 operator për çdo lot

“Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës, viti 2019 – 6 lote”, me fond limit 9,264,000 lekë, kanë marrë pjesë në 6 lote i njëjti operator

“Blerje Kite & Reagent për Spitalin Rajonal Durrës viti 2020 – 7 lote”, me fond limit 10,500,000 lekë, kanë marrë pjesë 1 – 2 operatorë në çdo lot

“Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës” viti 2019, me fond limit 1,444,930 lekë, kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik

“Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri viti 2019”, me fond limit 11,207,182 lekë ka marrë pjesë vetë një operator ekonomik

“Blerje protoksid azoti për SRD për nevojat e vitit 2020” me fond limit 4,568,400 lekë ka marrë pjesë 1 operator ekonomik

Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se vendosja e kriterëve të pa argumentaura ligjërishit dhe teknikisht ka sjell uljen e konkurrencës dhe paraqitjen e ofertës nga vetëm një operator i cili kishte ofertën më të ulët gjatë fazës së studimit të tregut (përlllogaritja e fondit limit) dhe oferta e ofruar nga ky operator është në kufirin e fondit limit. Në kundërshtim me neni 61, pika 2, paragrafi II e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 20 “Mosdiskriminimi” i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa që grupet e ngritura për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentojnë ligjërishit dhe teknikisht kriteret e

vendosura në procedurat e prokurimit duke shmangur konfuzion, ankesa gjatë procedurës së prokurimit, rritjen e konkurrencës si dhe tejzgjatje të procedurave.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019 me objekt “*Blerje Funizim vendosje Llampe skaneri 2019*” me garanci 1 vit për pjesët e blera, lidhur me OE “He. & Li.” me vlerë 11,207,000 lekë pa TVSH me afat zbatimi 7 ditë, u konstatua se:

Mallrat kanë ardhur shoqëruar me Faturën nr. 8237215, datë 18.07.2019 me vlerë 13,448,400 lekë me TVSH.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm me Urdhër Shpenzimin nr. 3, datë 02.08.2019 është kryer pagesa në vlerën 13.448,400 lekë

Relacioni i ekzekutimit të kontratës nr. 1851, datë 04.10.2019 i komisioni i marrjes në dorëzim shprehet se kontrata është realizuar në kohë dhe cilësi.

Me kryerjen e pagesës në vlerë të plotë (100% të vlerës) institucioni nuk ka siguruar garancinë prej 1 viti të pjesëve të blera të skanerit në kundërshtim me specifikimet teknike të Kontratës nr. 1328/7, datë 17.07.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, Grupet e Monitorimit të Kontratës dhe Sektori i Financës të marrin masa që në të ardhmen të mos kryejnë pagesa të plota të vlerave të kontratave kur në specifikimet e kontratave përfshihet periudhë garancie duke siguruar mbrojtje të Spitalit në rastet e defekteve brenda periudhës së garancisë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së “*Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës*” konstatohet se grupi i monitorimi i kontratës kryen matjen e mbetjeve me volum të cilat grumbullohen në cdo pavion me thasë mbetjesh urbane të siguruar nga kontraktori (thasë 50 litra), dhe mbushja e tyre merret e mirëqenë pa siguruar ngjeshjen e mbetjeve dhe eliminuar volumet e krijuara midis mbetjeve apo edhe brenda mbetjeve (kuti, bidona, etj.), sipas deklaratës verbale të grupit të monitorimit matja e thasëve dhe mbushjes së tyre bëhet apriori në mënyrë subjektive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës si dhe grupet e ngritura për hartimin e specifikimeve teknike të marrin masa që në kontratat e evadimit të mbetjeve urbane të ndryshojnë mënyrën e matjes nga volum (subjektive) në peshë duke shmangur subjektivizmin në matjen e tyre gjatë zbatimit të kontratës.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Shmangja e procedurave të prokurimit, mosevidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen nga Titullari i SRD-së dhe strukturat e ngarkuara me prokurimin e këtij malli, në Spitalin Rajonal Durrës **për vitin 2019**.

Në nëntor të vitit 2018, Spitali Rajonal Durrës për mbulimin e nevojave me oksigjen ka filluar procedurën e prokurimit me Objekt “**Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019**”, me fond **6,085,206 lekë pa TVSH**. Sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit të kësaj procedure, furnizimi me oksigjen do të mbulojë nevojat për oksigjen për gjithë vitin 2019. Procedura e prokurimit ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit datë 30.04.2019 me vlere me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH me operatorin fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS.

Ndërsa, furnizimi i Spitalit Rajonal Durrës me oksigjen për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën e lidhjes së kësaj kontrate (30.04.2019), është bërë faktikisht nga operatori “M. A”. Spitali Rajonal Durrës me këtë operator nuk kishte lidhur kontratë furnizimi (nëpërmjet procedurave të prokurimit), por furnizimi bëhej dhe evidentohej vetëm në bazë të procesverbaleve të marrjes në dorëzim. Referuar dokumentacionit që ju vu në dispozicion grupit të auditimit mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratës për furnizimin e SRD me oksigjen, u konstatua se në lidhjen e dokumentacionit të likuidimit të operatorit fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS, ka 12 procesverbale furnizimi me oksigjen të mbajtura midis operatorit “M. A” në cilësinë e shitësit por jo të operatorit fitues që sipas tenderit të zhvilluar në datën 19.04.2019 është shpallur bashkimi i

operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS me ofertë **6,085,206 lekë pa TVSH.**

Kështu deri në datën 19.04.2019, operatori furnizues “M. A” ka furnizuar spitalin me 47,073 litra oksigjen, me anë të procesverbaleve ku deklarohet si furnizues dhe huadhënës i oksigjenit duke ju vënë si kusht që pagesa do t’i kryhet menjëherë kur SRD t’i akordohet fondi në buxhetin e tij për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e këtij malli.

Konkretisht:

Në datën datë 20.05.2019, një muaj më pas lidhjes se kontratës më operatorin e shpallur fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS, Drejtori i Spitalit ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 për shlyerjen e detyrimit që kishte ndaj operatorin “M. A” i cili kishte furnizuar spitalin me oksigjen deri në 19.04.2019. Kjo marrëveshje është nënshkruar edhe nga operatori fitues H. & A. sh.p.k dhe GTS. Me dokumentin nr.967, datë 20.05.2019 është nënshkruar marrëveshje për njohjen dhe zgjidhjen me mirëkuptim të detyrimit të marrjes hua nga ana e Spitalit Rajonal Durrës të një sasive lëng me qëllim mbulimin e nevojave emergjente mjekësore për mirëfunktionimin e Spitalit Rajonal Durrës midis Drejtorit të Spitalit, operatorit “M. A” sh.p.k në cilësinë e furnizuesit dhe bashkimit të operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k, në cilësinë e operatorit fitues të tenderit.

Sipas kësaj marrëveshje subjekti bashkimi i operatorëve H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k shlyen detyrimin vetëm për sasinë 45,000 litra oksigjen lëng dhe mbeten për likuidim edhe 2073 litra. Sasia në litra e furnizuar nga H. & A. sh.p.k dhe GTS sh.p.k për SRD është 8830 litra oksigjen në total.

Sa sipër lidhja e marrëveshje tre palëshe mirëkuptimi me nr.967, datë 20.05.2019 ka shmangur procedurat e prokurimit duke krijuar precedent për marrëveshje midis operatorit fitues të tenderit, operatorit furnizues dhe titullarit të Spitalit Rajonal Durrës, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Për gjithçka më sipër, del qartë se, furnizimi me oksigjen deri në datën 19.04.2019 për sasinë 47,073 litra oksigjen është bërë pa procedura prokurimi në kundërshtim të hapur LPP, në një kohë Autoriteti Kontraktor i ka pasur të gjithë mundësitë që deri në përfundimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës të realizonte procedurat prokurimi me negociim pa shpallje te kontratës të parashikuara në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Për shkeljet dhe parregullsitë e mësipërme mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor, për shmangie të procedurave të rregullta të prokurimit për mos evidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen dhe mos marrje masash sipas rregullave për zhvillimin e procedurave sipas kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

13.1 Rekomandimi : Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në raport me planifikimet , nevojat dhe realizimet e kontratave të oksigjenit të analizojë dhe të identifikojë nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me këtë proces, kronologjinë e gjendjes reale të këtij malli në magazinat e SRD-së, shpërndarjen e tij dhe shmangien e procedurave që nuk sanksionohen në kontratat e lidhura me operatorët fitues të tenderit.

13.2 Rekomandimi : Titullari i Autoritetit Kontraktor në SRD, të marrë masa që të organizojë strukturat që ka ngarkuar me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në Spitalin Rajonal Durrës, për të ndjekur trajnimet që organizohen nga Agjencia e Prokurimit Publik, në mënyrë që të shmangë parregullsitë në procedurat e prokurimit në të ardhmen.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Dorëzim i mallit (“Furnizim vendosje me një ashensor të ri per godinën e hotelarisë (godinë 4 katëshe) të SRD”, për vitin 2020 pas **53 ditëve** kalendarike ose **35 ditë pune me vonesë** në Spitalin Rajonal Durrës.

Për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelarisë

(godinë 4 katëshe)”, viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 lekë pa TVSH me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.

Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç.. Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, Titullari i AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletin e APP nr.94, datë 2.11.2020.

Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.

Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.

Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje: A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.

Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit “**Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)**”, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.

Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021 , me faturën nr.150, furnitori “Hy. Kl.” ka sjellë vlerën e prokurimit për likuidim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kryer akoma likuidimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penalitetet që duhet t’i mbahen operatorit ekonomik “H. K.” sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se “Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes”.

Ashensori është dorëzuar në SRD pas **53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë**, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t’i zbresë faturës së likuidimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës **është 661,440 lekë.**

Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit 661,440 lekë lekë përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga “OE H. K.” sh.p.k. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Strukturat përkatëse të SRD-së të ngarkuara me monitorimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratave të prokurimeve të marrin masa që në të ardhmen të raportojnë në kohë vonesat mbi dorëzimin e mallit/shërbimit apo punëve publike dhe arsyet mbi këto vonesa duke mbajtur procesverbale dhe raporte me operatorët fitues të këtyre procedurave duke i parashtruar detyrimet që rrjedhin nga kontratat përkatëse dhe penalitetet nëse nuk përmbushin kushtet e

kontratave.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të programimit të buxhetit nga ana e SRD në shpenzimet korrente, fillimisht në PBA planifikohet në nivele të përafërta me vitin ushtrimor paraardhës konkretisht për vitin 2020 në vlerën 1,282,250 mijë lekë ose në vlerën 79,737 mijë lekë më shumë se vitin 2019 planifikuar në vlerën 1,202,513 mijë lekë. Ndërkohë që plani përfundimtar pas shtesave, pakësimeve dhe rialokimeve shkon për vitin 2019 në vlerën 903,656 mijë lekë realizuar në masën 100%, për vitin 2020 në vlerën 1,004,515 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 972,385 ose në masën 96.8%.

- Për vitin 2020 konstatohen nivele të ulta në realizimin e llogarive konkretisht, 600 “Paga personeli” në masën 98.7% ose ka mosrealizim në vlerën 6,734 mijë lekë, 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në masën 95.96% ose ka mosrealizim në vlerën 3,398 mijë lekë dhe 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në masën 94.46% ose ka mosrealizim në vlerën 22,000 mijë lekë. Nga analiza e artikujve buxhetor konstatohen diferenca ndërmjet planifikimit përfundimtar dhe realizimit faktik referuar veprime të kryera me bankë sipas shpenzimeve për llogaritë 600, 601 dhe 602 në nivel 7-shifror.

- Për vitet 2019 dhe 2020 në disa zëra të artikujve buxhetor kryesisht paga personeli (raporte mjekësore, shtesë turne të dyta, shtesa page, shtesë pune jashtë orarit, shpërblime) mallra dhe shërbime të tjera (pagesa të energjisë, shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna) konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin përfundimtar të buxhetit. Ndërkohë në disa zëra të llogarive buxhetore paga personeli (shpërblime, paga të personelit të përkohshëm) mallra dhe shërbime të tjera (materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme, materiale dhe shërbime special, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale) konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit buxhetor. Në të dy rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh në këto grup llogarish në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim buxhetor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontratën “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitet 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 39-44 të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që në raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi në vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.

15.2. Rekomandimi: Nga ana e SRD të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

15.3. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të eliminojnë planifikimet formale, dhe të kryejnë parashikime të besueshme, duke kryer analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatëse për këtë qëllim, me qëllimin e eliminimit e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 107 prot., datë 14.01.2020, dhe shkresën nr. 97 prot., datë 15.01.2021, SRD ka raportuar pranë FSDKSH realizimin e buxhetit për vitet 2019 dhe 2020.

Nga auditimi konstatohet se, në këto raporte nuk është raportuar pasqyra e të ardhurave dytësore sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit, veprime këto në kundërshtim me Kontratën “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitet 2019 dhe 2020 miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, datë 19.12.2019, neni 13, pika 6, neni 14, pika 6, aneksi 2, pasqyra 12. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 39-44 të Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga SRD të merren masa në mënyrë që raportimi i të ardhurave dytësore të bëhet sipas burimit të realizimit të natyrës së përdorimit, referuar përcaktimeve në kontratën dypalëshe midis Spitalit dhe FSDKSH.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës në lidhje me arkëtimet konstatohet se, midis SRD dhe OE “Shp.” SHPK është lidhur kontrata nr. 4371, datë 29.08.2019, për dhënien me qira të sipërfaqes prej 62 m² për ushtrimin e aktivitetit “Mencë” në shërbim të punonjësve/pacientëve dhe qytetarëve për shërbimet spitalore. Për këtë kontratë OE ka paguar detyrimin mbi konsumin e energjisë elektrike dhe ujit konkretisht:

- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE “Shp.” SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e energjisë elektrike në vlerën 611,320 lekë.

- Për periudhën nga data 27.01.2020 - 30.11.2020, nga OE “Shp.” SHPK janë arkëtuar pagesa si detyrim ndaj SRD për konsumin e ujit në vlerën 206,120 lekë.

Për kryerjen e këtyre veprimeve si dokumentacion justifikues shërbejnë procesverbalet e mbajtura nga përfaqësuesi inxhinier z. E. P. me përfaqësuesit e OE, për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe ujit.

Procesverbalet e mbajtura sipas muajve respektive i referohen matësit të vendosur për konsumin e energjisë elektrike dhe pagesës afrofe për konsumin e ujit. Në të dy rastet nuk disponohet asnjë urdhër apo procesverbal për vendosjen e matësit dhe caktimit të tarifës afrofe për pagesën e ujit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, deri në fund të periudhës objekt auditimi matësi i energjisë elektrike nuk është i kolauduar nga OSHEE SHA, por konsumi i saj regjistrohesh në linjën kryesore të energjisë të Spitalit.

Kjo situatë vjen si pasojë se në kontratën e qiradhënies nuk janë përcaktuar detyrimet kontraktuale midis palëve të cilat lindin për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit. Nga pjesa menaxheriale e SRD nuk janë marrë masat e nevojshme për ndarjen nga linja kryesore e Spitalit të matësit për energjinë elektrike si dhe vendosjen e një matësi për konsumin e ujit, ku të lidhen kontratat respektive me OSHEE SHA për energjinë dhe UKD SHA për ujin, dhe mbi bazën e këtyre faturave të kryen pagesat respektive nga OE. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Sektori Juridik, të marrin masa për kryerjen e amendimit të kontratës nr. 4371, datë 29.08.2019, të lidhur midis SRD dhe OE “Shp.” SHPK për dhënien me qira të sipërfaqes prej 62 m² për ushtrimin e aktivitetit “Mencë”, duke përcaktuar në të edhe detyrimet për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit sipas përcaktimeve të enteve rregullator përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:

- Në 10 raste kryesisht përgjatë vitit 2019, mungojnë kërkesës/transaksionit për likuidimin e pagesave për shpenzimet e kryera ndaj operatorëve ekonomikë.

- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli.

- Në 20 raste për vitet 2019 dhe 2020, nuk është bërë regjistrimi i saktë i skadencave së barnave dhe kite reagentëve në farmacinë e institucionit, kjo situatë vërtetohet nga rakordimet midis regjistrimeve sipas fletë-hyrjeve në magazinën e farmacisë, faturave tatimore dhe certifikatave të analizës së mallrave.

- Për 40 raste (transaksione) në vlerën 113,316,417 lekë për vitet 2019 dhe 2020, nga ana e SRD

ka vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë (në pagesave të caktuara pjesore ka vonesa nga ana e SRD deri në 3-4 muaj në likuidimin e tyre) duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive si dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”. Mos likuidimi në kohë i pagesave ndaj operatorëve ekonomik ekspozon SRD ndaj penalteteve të mundshme.

- Në të gjitha rastet për vitet 2019 dhe 2020, në setin e dokumentacionit justifikues së bankës bashkëngjitur nuk ndodhet urdhri për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

- Në gjitha raste për vitet 2019 dhe 2020, për sa i përket kontratave të lidhura për barnat, kite reagentëve, medikamenteve, bashkëngjitur dokumentacionit justifikues nuk ndodhet relacioni shpjegues ku duhet të evidentojë kronologjinë për likuidimet e kryera sipas pagesave të faturave pjesore referuar kontratave respektive të sipërpërmendura.

- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 për kontratat e barnave, kite reagentëve dhe medikamenteve, për sa i përket likuidimit të faturave pjesore seti i dokumentacionit justifikues nuk është i sistemuar sipas çdo kontrate respektive, por bashkëngjitur likuidimit ndodhen fatura pjesore për kontrata të ndryshme të cilat i përkasin të njëjtit operator ekonomikë.

- Në 5 raste për vitet 2019 dhe 2020 në setin e dokumentacionit justifikues të bankës nuk janë bashkëngjitur certifikatat e analizave të barnave, të cilat gjendeshin në farmacinë e institucionit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare” neni 4, neni 6, gërma a, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 37 dhe pika 54. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për pasqyrimin e të gjithë kronologjisë, regjistrimin në magazinë, plotësimin dhe sistemimin e dokumentacionit justifikues për kontratat e barnave, medikamenteve dhe kite reagentëve referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

18.2. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe respektive si dhe referuar afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale tregtare”, duke shmangur penaltet e mundshme.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i mallrave e shërbimeve të prokuruar dhe kategorizimi i tyre rezultoi se, për të njëjtin grup mallrash, është tejkaluar limiti ligjor prej 800,000 lekë, si më poshtë:

- Për vitin 2019, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 1,420,435 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Blerje tonera” me fond limit 716,666 lekë pa TVSH, “Blerje letër + kancelari” me fond limit 666,666 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 345,641 lekë pa TVSH duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.

- Për vitin 2020, janë realizuar 4 procedura prokurimi me vlerë të vogël në shumën 2,086,628 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Blerje letër” fond limit 557,668 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, “Blerje shtypshkrime” me fond limit 221,660 lekë pa TVSH, “Blerje tonera” me fond limit 507,300 lekë pa TVSH, duke e ndarë në procedura të tjera me të njëjtin objekt.

- Për vitin 2020, janë realizuar 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit në shumën 801,120 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin konkretisht, “Shërbime riparimi për automjete” me fond limit 692,700 lekë pa TVSH, “Shërbime riparimi për automjete” me fond limit 100,000 lekë pa TVSH, “Frena dhe pjesë të frenave” me fond limit 98,500 lekë pa TVSH.

- Për vitet 2019 dhe 2020, të gjitha praktikat e dosjeve të prokurimit me vlerë të vogla nuk janë të arkivuara në protokollin e institucionit por ndodheshin në Zyrën e Prokurimit si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli,

veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 28, pika 2, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1, pika 8, neni 59, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: SRD, Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh, arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit me vlera të vogla si dhe protokollimin e procesverbaleve për marrjen e mallrave apo shërbimeve në dorëzim.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi : Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019 dhe vitin 2020 konkretisht referuar kontratës së lidhur me subjektin “A. Bank”, SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjeçar, për vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “ABI Bank” për llogari të SRD është 221, 640 lekë, referuar detyrimeve nga kontrata nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “Banka Credins” për llogari të SRD është 101,160 lekë.Për pasojë për çdo detyrim kontraktor të pashlyer përsa më sipër për vitin 2019 dhe vitin 2020, Spitalit Rajonal ***Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë***, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë “ABI Bank” dhe “Banka Credins”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.7 faqe 109-112 të Raportit të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat e ngritura për monitorimin e kontratave të ambjenteve me qira dhe sektorin e financës të analizojë problematikat e mbartura vit pas viti për mosshlyerjen e detyrimeve kontraktore të operatorëve qiramarrës së ambjenteve të Spitalit Rajonal Durrës.

Në vijimësi

20.2 Rekomandimi : Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa që të ngrejë një grup pune për amendimin e Kontratave të Qirasë duke hartuar te drejta dhe detyrime të qarta në raportin e ndërsjellë qiramarrës/qiradhënës gjithashtu shtimin në kontratën e qirave penalitetet, në raste të mosrespektimit të detyrimeve të ndërsjella kontraktore.

Në vijimësi

21.1 Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Rajonal Durrës, nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga ana e subjektit u paraqit vetëm urdhëri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik por asnjë akt shkresor mbi veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. U konstatua se grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar. U konstatua se nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë u konstatua edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.9 faqe 130-139 të Raportit të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për të implementuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e kontrollit vertikal të SRD për dhënien e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare të tij.

Në vijimësi

22.1 Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm është krijuar më Urdhrin nr. 915 Prot., datë 29.04.2016 duke emëruar vetëm një specialist i lartë auditimi, struktura ka ndryshuar duke e krijuar si sektor por përsëri brenda periudhës objek auditimi ka funksionuar vetëm me një auditues. U konstatua se nga mos plotësimi i kriterëve ligjore, auditimi është kryer vetëm me një punonjës në kundërshtim me ligjin për auditin e brendshëm gjë e cila nuk siguron pavarësinë e plotë të auditimeve të kryera. Nuk sigurohet kontrolli i cilësisë, raportet e auditimit nuk janë hartuar sipas afateve të përcaktuara në manual duke mos u lenë mundësinë e observacioneve njësisë që auditohet në kundërshtim me Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 3 ku ndër të tjera përcaktohet se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”. Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.10 faqe 139-142 të Raportit të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e zyrës së auditit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë objektive dhe për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës, duke kryer veprimtarinë sipas Standardeve të Auditimit dhe zbatimin e afateve sipas manualit.

Në vijimësi

22.2 Gjetje nga auditimi: Pagesat e mjekëve të shërbimit të kirurgjisë si pjesë e një spitali universitar duke u bazuar në VKM nr. 70, datë 15.02.2001, ndryshuar me VKM nr.448, datë 09.07.2004, pika 1 “...dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës ...”, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika 1, 12/1, shërbimi i kirurgjikal i Spitalit Rajonal të Durrësit trajtohet si pjesë e një spitali universitar.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të parë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,000 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 8,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 7,000 lekësh të spitaleve rajonale.

-Pagesat për turnet 24 – orëshe të mjekëve roje të dytë, në shërbimin e kirurgjisë, për ditë të zakonshme paguhen 5,600 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,200 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të shtuna paguhen 6,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 5,600 lekësh të spitaleve rajonale. Për ditë të diela paguhen 7,000 lekë, përkundrejt pagesës prej 6,600 lekësh të spitaleve rajonale.

-Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, duke u bazuar në VKM – të e sipërpërmendura, për mjekët e Shërbimit të Kardiologjisë në Spitalin Rajonal Durrës, për çdo shërbim roje 24 orë pa ndërprerje, pagesat janë kryer duke e konsideruar këtë pavijon si qendër spitalore universitare, në vlerën **9,492,800 lekë**.

-Nga kontratat e lidhura me FSDKSH rezulton se në asnjë nga nenet nuk përcaktohet fakti se shërbimi i kirurgjisë trajtohet si spital universitar. Nga grupi i auditimit është bërë përllogaritja e vlerës që do të paguhej nëse mjekët e shërbimit të kirurgjisë do të paguheshin si pavijonet e tjera, vlerë e cila rezulton të jetë **8,563,800 lekë**. Referuar këtij fakti rezulton vlera e paguar shtesë prej **929,000 lekësh**. Po ashtu, dhe niveli i pagesës të mjekëve në këtë spital trajtohet si në spitalet universitare.

- Nga auditimi është konstatuar se stafi i këtij spitali është i paqartë lidhur me shërbimin 24 –

orësh pa ndërprerje të mjekëve të këtij pavijoni, duke bërë kështu që këto pagesa të kryhen në kushtet e pasigurisë dhe të pa qartësisë lidhur me statusin e pavijonit në fjalë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 27-39 të Raportit të Auditimit).

22.2.Rekomandimi: Spitali Rajonal i Durrësit në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe FSDKSH – në të marrin masa për sqarimin e statusit të shërbimit kirurgjikal në këtë spital, dhe për përcaktimin e saktë të nivelit të pagave mjekëve të shërbimit kirurgjikal.

Menjëherë

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)”, viti 2020 është konstatuar dorëzim i mallit (“Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinën e hotelerise (godine 4 katëshe) të SRD”, për vitin 2020 pas **53 ditëve** kalendarike ose **35 ditë pune me vonesë** në Spitalin Rajonal Durrës.

Për procedurën e prokurimit “Furnizim vendosje me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (godine 4 kateshe)”, viti 2020 u konstatua: Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr.1675/8, datë 28.10.2020 me operatorin fitues H. K. sh.p.k. me vlerë oferte 2,600,000 leke pa tvsh me afat realizimi 30 ditë nga dita e nënshkrimit të saj.

Titullarja e Autoriteti Kontraktor me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 ka ngritur komisionin për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje : A. F., N. M., R. Ç..Me shkresën nr.1675/10, datë 29.10.2020, titullarja e AK ka nxjerrë njoftimin e kontratës i cili është botuar në buletin e APP nr.94, datë 2.11.2020.

Operatori ekonomik me shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për pamundësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur dhe realizuar në kohë zbatimin e kontratës për shkak të vonesave në realizimin e disa pjesëve të ashensorit si dhe në ardhjen e pjesëve të tjera nga Italia për arsye të pandemisë Covid-19, dhe i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratë deri më datë 31.12.2020.

Amendimi kontratës bazuar në shkresën nr.1949, datë 10.11.2020 të operatorit ekonomik dhe nenin 23 të kontratës është nënshkruar nga AK dhe operatori ekonomik më datë 31.12.2020 dhe realizimi i saj është shtyrë deri më datë 31.12.2020.

Me procesverbalin e datës 22.02.2021 nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me përbërje:A. F., N. M., R. Ç., ngritur me urdhrin nr.1675/9, datë 28.10.2020 nga titullarja e AK është marrë në dorëzim ashensori nga vetëm dy anëtarë të komisionit të monitorimit të kontratës së mësipërme A. F. dhe R. Ç., ndërsa anëtari tjetër i grupit N. M. është larguar nga puna në datë 04.02.2021.

Përsa më sipër ashensori është dorëzuar në SRD pas 53 ditëve kalendarike ose 35 ditë pune me vonesë, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj. Nga komisioni për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës nuk ka një relacion shpjegues për vonesën e shkaktuar në dorëzimin e mallit “Furnizim vendosje me një ashensor të ri për godinën e hotelerisë (godinë 4 katëshe)”, në Spitalin Rajonal Durrës por thjesht në procesverbalin e mbajtur në datë 22.02.2021 nga grupi i monitorimit të kontratës shprehet se malli i përmbush gjithë specifikimet teknike.

Referuar ditarit të furnitorit për datën 22.02.2021, me faturën nr.150, furnitori “Hy. Kl.” ka sjellë vlerën e prokurimit për likuidim **3,120,000 lekë me TVSH**, por nuk është kyer akoma likuidimi. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një analizë mbi vonesat dhe penaltitetet që duhet t’i mbahen operatorit ekonomik “H. K.” sh.p.k që ka sjellë mallin me vonesë. Referuar kushteve të kontratës neni 23 , pika 23.3 shprehet në formë eksplicite se “Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes”.

Ashensori është dorëzuar në SRD pas **53 ditëve kalendarike** ose **35 ditë pune me vonesë**, në kundërshtim me afatet e kontratës dhe amendimin e saj, referuar nenit 24, pika a të kontratës “Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës

korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës” për rrjedhojë vlera që SRD duhet t’i zbresë faturës së likuidimit për operatorin H. K. sh.p.k nga vlera totale e kontratës **është 661,440 lekë.**

Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet.Për pasojë vlera e penalitetit **661,440 lekë lekë përbën dëm ekonomik për SRD** si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

1.1Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit të arkëtimit të shumës **661,440 lekë lekë** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE H. K. sh.p.k.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në farmacinë e Spitalit Rajonal të Durrësit janë audituar me zgjedhje në total 29 lloje medikamentesh duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit. Saktësisht u verifikuan: Sonde blakmore, Metmorfin, Carboplatin, Cefotaxim, Enalapril malate, Cefazoline 1 gr, Human Anti Imuglobine, Sevofluran 250 ml, Kontrast ct, Metoclopramid 10 mg, Vitamina C, Oxytocin, Kontrast Ct 370 mg / 100 ml, Diatro Cleaner, Bilirubine totale GA, Bilirubine direkte GA, Maglumi total PSA, Magnazium, Mesh PVDF/PP, Mesh PVDF, Adrenaline, pllakë dhs/scs, bombul intensive oksigjeni 3 – 5 litra, Cefepim, Cordaron, Dopamine, Docetacel, Isosorbit dinitrate 10 mg tab, Viper Venom.

Gjatë verifikimit të faktit rezultoi se lidhur me medikamentin e përdorur për skanerin me kontrast “Kontrast ct”, rezultoi se nga 140 copë në programin Financa 5, në fakt në farmaci ishin vetëm 120. Kjo u justifikua nga ana e stafit të farmacisë me faktin se ka nevoja urgjente për skaner, dhe se ky medikament ishte dhënë me urdhër verbal. Ditën e nesërme KLSH-së nga ana e punonjësve të farmacisë u vunë në dispozicion fletë dalja me nr.dok 1936, datë 07.04.2021, sipas së cilës ishte bërë shkarkimi i 5 copë medikamente “kontrast ct”. Pra përsëri rezultonte mungesë prej 15 copë medikamentesh. Pas konstatimit, u bë modifikimi ku fletëdalja nr.dok. 1936, datë 07.04.2021 paraqiste shkarkimin e 20 copë medikamentesh “kontrast ct”.

Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit, u konstatua se:

-Në 1 rast kishte teprica në sasi të medikamenteve.

-Në 4 raste kishte mangësi në sasi të medikamenteve në vlerën **89,565 lekë.**

Diferencat e konstatuara janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 89. Për pasojë vlera 84,006 lekë, që përbën vlerën e medikamenteve të munguara, përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.12 faqe 146-149 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandim: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit të arkëtimit të shumës **89,565 lekë lekë** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për diferencat e konstatuara duke nxjerre dhe përgjegjësitë konkrete.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2019 dhe vitin 2020 konkretisht referuar kontratës së lidhur me subjektin “A. Bank”, SRD ka lidhur me këtë subjekt kontratën me nr. 611/1, datë 31.03.2017 me afat 1 vjeçar, për vitin 2018 nuk ka kontratë, dhe as për vitin 2019 nuk ka kontratë. Në kontratat e qiradhënies së ambjenteve me qira për vitin 2020, konkretisht referuar kontratës nr.728/1, datë 23.12.2019 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “A. Bank” për llogari të SRD është 221, 640 lekë, referuar detyrimeve nga kontrata nr.135, datë 17.01.2020 vlera e detyrimit për tu paguar nga subjekti “Banka C.” për llogari të SRD është 101,160 lekë.

Për pasojë për çdo detyrim kontraktor të pashlyer përsa më sipër për vitin 2019 dhe vitin 2020,

Spitalit Rajonal Durrës i janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 322,800 lekë, vlerë e cila duhej kërkuar dhe arkëtuar për llogari të SRD nga shoqëritë “A. Bank” dhe “Banka C.”. Për sa më sipër mban përgjegjësi Njesia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2019, ngritur me urdhrin nr.4 prot 50 dt 07.01.2019 dhe Njësia Monitoruese te Kontratave te Qirasë për vitin 2020, ngritur me urdhrin nr.41 prot dt 09.01.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.7 faqe 109-112 të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Spitali Rajonal Durrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **322,800 lekë** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për SRD si detyrim kontraktor i pashlyer nga kontratat e qiramarrjes së ambienteve të Spitalit Rajonal Durrës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti “A. Bank” në vlerën 221, 640 lekë dhe nga subjekti “Banka C.” në vlerën 101,160 lekë .

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Duke u bazuar dhe në problematikën e trajtuar nga auditimi i kryer në vitin 2019 nga FSDKSH Tiranë konstatohet se, nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës për vitin 2020 për 25 transaksione në vlerën totale 18,131,495.16 lekë referuar kontratës për furnizimin me karburant naftë me bot dhe me kartë elektronike, SRD ka paguar në llogari të operatorëve ekonomikë “K.” SHPK dhe “K.” SHA vlerën e taksës së markimit (0.614 lekë/litër) në vlerën 69,295 lekë e cila nuk parashikohet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 200, datë 13.03.2013, “Për miratimin e kontratës...”, VKM nr. 498, datë 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” pika 1.3, pika 4.1, gërma b. **Vlera totale 69,295 lekë përbën dëm ekonomik për SRD dhe Buxhetin e Shtetit** vlerë e cila është përfituar padrejtësisht respektivisht nga OE “K.” SHPK në vlerën 53,869 lekë dhe OE “K.” SHA në vlerën 15,425 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: SRD të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit të arkëtimit të shumës **69,295 lekë** si përfitim i padrejtë nga operatorët ekonomikë, konkretisht shuma 53,869 lekë nga OE “K.” SHPK dhe shuma 15,425 lekë nga OE “K.” SHA.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 571/5 prot., datë 30.04.2020, titullari i SRD ka urdhëruar KPVV për zhvillimin e procedurës “Sigurim automjetesh” me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 571/8 prot., datë 05.05.2020, është shpallur fitues OE “A.” me fond limit 259,500 lekë pa TVSH. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 187, datë 05.05.2020, në vlerën 259,500 lekë. Bashkëngjitur dokumentacionit justifikues të bankës ndodhen edhe siguracionet e automjeteve. Ky shpenzim është likuiduar më datë 10.08.2020, datë 17.11.2020, dhe datë 18.12.2020, në A. Bankë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

- Më datë 29.05.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..9 D, nga z. L. Z. me detyrë shofer, z. M. Gj. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.
- Më datë 25.06.2019, është mbajtur procesverbali për konstatim defekti për Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..1 D, nga z. G. D. Z. me detyrë shofer, z. H. O. me detyrë shofer dhe z. G. K. me detyrë Koordinator i Urgjencës.
- Referuar procesverbaleve të përmendura më sipër, është mbajtur aktverifikimi nr. 712 prot., datë 23.04.2021, ku është konstatuar se të dy automjetet nuk janë në gjendje pune, ku bashkëlidhur këtij aktverifikimi ndodhen dhe fotografitë përkatëse për secilin automjet.
- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..9 D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 23, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.

- Për autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..1 D është tërhequr karburant për herë të fundit sipas fletë-daljes nr. 22, datë 08.02.2019, 400 litra/naftë me tollon elektronik.

- Për të dy automjetet përgjatë vitit 2020, nuk është tërhequr karburant.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, për Autoambulancën MB CDI Model 211 DR ..9 D, dhe Autoambulancën MB CDI Model 211 me targë DR ..1 D, nga SRD janë paguar siguracione në vlerë totale 55,000 lekë ndërkohë që të dy automjetet nuk janë në gjendje pune që prej muajve respektive Maj dhe Qershor të vitit 2019. **Vlera 55,000 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, ndryshuar me Ligjin nr. 10455, datë 21.07.2011” neni 4. (Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet kjo situatë duke nxjerrë përgjegjësitë respektive dhe të merret vendimi përkatës, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 55,000 lekë.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Bordit Drejtues nr.06, datë 19.03.2018 është miratuar sistemi i punës 12 –orë për shërbimin e Urgjencës në Spitalin Rajonal Durrës, dhe VKM nr.555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë spitalit Universitar të Traumës, si dhe për Trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, pika 1, 12/1, si dhe 12/2, pika c “për punonjësit e infermieristikës”.

Nga auditimi u konstatua se duke u bazuar nga VKM nr.555, datë 11.08.2011, Bordi Drejtues me vendimin e nr.21, datë 09.06.2011 ka caktuar pagesën e shoferëve me sistemin e shërbimit 12 – orësh, me qëllim motivimin e këtij stafi, konkretisht për ditë të zakonshme 1,880 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,350 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 3,055 lekë/ditë shërbimi. Kjo vlerë është më e lartë krahasuar me përcaktimet e VKM nr.555, datë 11.08.2011 lidhur me pagesat e mjekëve të urgjencës dhe infermierët, të cilët për të njëjtin shërbim paguhën si më poshtë:

-Mjek urgjence: për ditë të zakonshme 1,800 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 2,000 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 2,300 lekë/ditë shërbimi,

-Infermierë roje urgjence: për ditë të zakonshme 1,100 lekë/ditë shërbimi, për ditë të shtuna 1,400 lekë/ditë shërbimi dhe ditë të diela/ ditë feste 1,700 lekë/ditë shërbimi.

Pra vendimi i Bordit është jokohorent dhe i pa argumentuar dhe i kategorizuar sipas niveleve të pagave e kriterëve përkatëse, dhe bie në kundërshtim me përcaktimet në pikën 1 dhe 2, neni 80 “Shtesa mbi Pagë” i Kodit të Punës, në të cilin citohet se: “1. Me punë nate kuptohet puna e kryer nga ora 22⁰⁰ deri në orën 6⁰⁰ të mëngjesit. Vlera e paguar për periudhën objekt auditimi prej **15,001,225 lekë përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e Spitalit Rajonal të Durrësit.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 27-39, të Raportit të Auditimit)

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të analizojë efektin financiar negativ prej **15,001,225 lekësh** dhe të marrë masa për korigjimin e pagesave të shoferëve për orët shtesë sipas turneve dhe ditëve përkatëse.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 8 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,466,291 lekë** si

dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për vitin 2019 janë humbur 5 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerë **5,652,881** lekë, dhe për vitin 2020 janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit, me vlerën **2,818,410**. Këto çështje janë dërguar për rekurs në Gjykatën e Shkallës të Lartë në Tiranë. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **8,466,291 lekë** e cila konsiderohet *efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 27-39, të Raportit të Auditimit)

2.1.Rekomandim: Nga Drejtoria, sektori Juridik dhe sektori i Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shpërblyes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave lidhur me shpërblimin për situatën e krijuar nga pandemia COVID – 19, rezultoi se shpërblimet e punonjësve të angazhuar sa i takon kësaj periudhe janë dhënë pas faktit. Nga Spitali Rajonal i Durrësit janë bërë verifikimet e pacientëve të cilët janë paraqitur në urgjencën e spitalit, apo të pacientëve të cilët janë shtruar në spital, me listat që vinin nga Instituti i Shëndetit Publik, për të nxjerrë në një moment të dytë se cilëve nga pacientët që u është ofruar shërbimi mjekësor, kanë rezultuar me Covid – 19. Pas verifikimit të pacientëve të cilët kanë rezultuar të infektuar me COVID - 19, bëhet rakordimi se cili mjek, infermier, mami, sanitare kanë pritur dhe kanë pasur kontakt me të infektuarit. Nga shefat e pavijoneve hartohen listat e punonjësve të cilët kanë qenë në kontakt me të infektuarit, dhe lista përfundimtare lidhur me shpërblimin përpilohet nga sektori i financës. Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit, dhe dërgohet në mënyrë elektronike (me e-mail) në Ministrinë e Shëndetësisë. Në disa raste punonjësve ju janë dhënë më pak ditë nga sa ka qenë parashikuar në listën paraprake të dërguar në ministri, pra ka mos përputhje të dhënash. Nuk është hartuar një rregullore, plan veprimi dhe dhënia e shpërblimeve Covid – 19 është bërë në mënyrë rastësore bazuar në listat e paraqitura nga shefat e pavijoneve.

- Nga auditimi i listave të shpërblimeve rezultoi se janë paguar në vlerën 735,096 lekë, punonjësi i krematorit dhe koordinatori. Në shpërblimeve rezultoi se ka paqartësi në funksionin e kryer nga punëtori i krematoriumit gjatë periudhës të pandemisë. Në disa raste ky punonjës paraqitet si sanitar, punonjës dezinfektimi, mirëmbajtës, sanitar i mbetjeve spitalore. ashtu janë dhënë shpërblime për Koordinatorin pa pasur dokumentacion justifikues. Sa më sipër, vlera **735,096 lekë** konsiderohet *efekt financiar negativ*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.11 faqe 142-145 të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës të marrë masa lidhur me hartimin dhe miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të spitalit për periudhën e pandemisë Covid – 19, të hartohet plan veprimi lidhur me stafin mjekësor dhe atë mbështetës, bazuar në cilin më pas do të alokohen dhe shpërblimet. Po ashtu, nga Drejtoria të merren masa lidhur me analizimin vlerës të *efekt financiar negativ* prej **735,096** lekë të shkaktuar nga shpërblimet e dhëna ndaj stafit mbështetës të spitalit.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbim i evadimit të mbetjeve urbane për Spitalin Rajonal Durrës” për vitin 2019, me fond limit 1,608,029 lekë konstatohet se KVO ka skualifikuar OE A. P. me ofetë 1,188,000 lekë pasi ka paraqitur ofertë vetëm për një nga zërat e kërkuar dhe jo për shërbimin e “Transport dhe evadim dysheke” si dhe OE Fj. – 2006 me ofetë 1,240,050 lekë është skualifikuar pasi ka ofruar më shumë se sasia e kërkuar

Nr.	Emërtim	Sasia	Cmimi/njësi	Cmimi total
1	Transport dhe evadim i mbetjeve urbane	2409	450	1,084,050
2	Transport dhe evadim	130	1200	156,000

	dysheke		
Totali pa TVSH			1,240,050
Totali me TVSH			1,488,060

Sasia e kërkuar është 2079 m³

Operatori i F.-2006 është skualifikuar pasi ka ofertuar më shumë njësi si edhe shumatore e çmimit për njësi është më i madh por realisht zëri “Transport dhe evadim dysheku” është fiks në sasi dhe nuk është objekt ndryshim sasive në marrëveshjen kuadër. Zëri që është objekt ndryshimi sasive është “Transport dhe evadim i mbetjeve urbane” dhe cmimi për njësi i cili duhet të krahasuar. Gjithashtu kriteri i vlerësimit në DST është “cmimi më i ulët” dhe jo “cmimi më i ulët për njësi”. Baza për vlerësim nga KVO janë kriteret dhe metodat e përshkruara në DST.

KVO nuk ka komunikuar apo kërkuar shpjegime nga OE duke qenë se oferta e paraqitur është ekonomikisht më e favorshme dhe nga një rillogaritje e ofertës duke ulur sasinë e kërkuar oferta është 1,091,550 lekë ose 353,380 lekë më pak se OE i shpallur fitues në kundërshtim me Neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” i Vendimit të KM nr. 941, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës, komisionet e vlerësimit të ofertave të marrin masa që rast pas rasti të shqyrtojnë dhe vlerësojnë me përgjegjësi duke kërkuar shpjegime nga OE në rastet kur e gjykojnë të nevojshme dhe ofertat janë ekonomikisht të favorshme për institucionin dhe eliminimin e shpenzimeve jo efektive prej 353,380 lekë.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të furnizimit u konstatua se në 2 raste grupet e marrjes në dorëzim nuk kanë verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave të marrë në dorëzim, konkretisht:

- Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD të përfaqësuar nga G. K. (në mungesë me porosi) dhe z. B. C., administrator i G. shpk, në asnjë rast grupi i marrjes në dorëzim nuk ka dokumentuar verifikimin e kite/reagenteve në lidhje me origjinën e mallrave dhe kompanisë prodhuese në përputhje me kërkesat e kontratave të lidhura.

Si dhe grupi i marrjes në dorëzim ka pranuar kite dhe reagente jo sipas afatit të skadencës të specifikuar në kontratë në vlerën 1,223,100 lekë me TVSH, që janë në kundërshtim me specifikimet teknike të Ankesit nr. 1 të Marrëveshjes Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019.

- Nga auditimi i zbatimit të Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5 rezulton se deri në fund të periudhës objekt auditimi janë marrë në dorëzim kite dhe reagente në vlerë 1,794,360 lekë për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës dhe si e tillë nuk mund të shprehemi zbatimin e kësaj kontrate në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër nr. 1494/5, datë 07.08.2019 lidhur midis SRD dhe G. shpk, Marrëveshjes Kuadër nr. 1535/1 datë 31.08.2020 për 5 lote, me operatorin G. shpk me Lotin 1-4 dhe me operatorin K. shpk për Lotin 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 44-92 të Raportit të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Durrës dhe Grupet e Marrjes në Dorëzim të marrin masa që të verifikojnë plotësimin e të gjitha kriterëve dhe të shprehën në mënyrë eksplicite në procesverbalet e hartuara për këtë qëllim.

Spitali Rajonal Durrës të analizojë situatën për pranimin e mallrave jo sipas specifikimeve teknike në vlerën **1,223,100 lekë** me TVSH dhe mos shprehjen e plotësimin të kriterëve në vlerën **1,794,360 lekë** për të cilat nga grupi i marrjes në dorëzim nuk ka verifikuar plotësimin e kushtit të skadencës.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:

- Për kontratën nr. 20795/5 prot., datë 18.09.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "B11-Blerje barna anestezi renimacion dhe sistem kardiovaskular" me fond limit 104,040 pa TVSH, për Lot 2 afati i skadimit të barnave (Adrenalinë në vlerën 36,393 lekë) është 8.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (9.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.

- Për kontratën nr. 2079/6 prot., datë 18.09.2019, të lidhur midis SRD dhe OE "M." SHPK për procedurën "Blerje barna sistemi nervor" me fond limit në vlerën 1,407,888 lekë pa TVSH, për Lot 1 afati i skadimit të barnave (Morfine 10mg/1mlx10amp në vlerë 211,680 lekë) është 9.5 muaj, pra më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (10.5 muaj) dhe më pak se 12 muaj, referuar të dy klauzolave të përcaktuara në specifikimet teknike në kontratë.

- Për kontratën nr. 2308/7 prot., datë 04.10.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite Reagent (teste) për analizën e astrupogrames dhe elektroliteve" me fond limit në vlerën 768,000 lekë pa TVSH, afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Kartixhe Ph PO2PCO2 në vlerën 364,875 lekë) është më pak se 12 muaj.

- Për kontratën nr. 1836/6 prot., datë 01.08.2018, të lidhur midis SRD dhe OE "G." SHPK për procedurën "Blerje Kite dhe Reagent për SRD" me fond limit në vlerën 9,999,999 lekë pa TVSH, për Lot 8 afati i skadimit të Kiteve Reagentëve (Blood-Agrar në vlerën 36,000 lekë dhe X.L.D. Agrar në vlerën 30,552 lekë) të marra në dorëzim është më pak se 24 muaj.

Referuar kontratave të sipërpërmendura Barnat dhe Kite Reagentëve të cilat janë marrë jashtë afateve të skadencës jo sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, **vlera 679,500 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi**, veprime këto në kundërshtim me afatet e skadencave të përcaktuara Aneksi nr. 2, (sipas DST ref. Shtojca nr. 10) referuar kontratave respektive të lidhura midis SRD dhe OE. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD, të analizojnë efektin negativ financiar në vlerën 679,500 lekë si dhe të marrin masa për të ngritur një grup pune për verifikimin nëpërmjet sistemit të fletëdaljeve nga Farmacia e Spitalit, sasinë e medikamenteve të konsumuara brenda afatit të skadencës referuar kontratave të sipërpërmendura. Në rast evidentimi të sasisë së mbetur të skaduar nga këto medikamente, të llogaritet vlera e tyre dhe t'i kërkohet operatorëve ekonomikë sipas kontratave përkatëse si dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës për pranimin e mallit jashtë kushteve kontraktuale. Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, të zbatohen me përpikëmeri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për një rast të përfitimit të shërbimit nga OE "Albtelecom", për të cilën nuk është përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimit publik" i ndryshuar, neni 4. SRD për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 21.11.2019, ka përfituar shërbim nga OE "Albtelecom" për përdorimin e telefonave fiks. Në total për këtë shërbim SRD i ka paguar vlerën 211,590 lekë OE "Albtelecom". Për këtë shërbim nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këtë shërbim kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik. **Vlera 211,590 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 4. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Financës të evidentohen të gjitha rastet të

cilat janë objekt i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për kontratat e lidhura pa i’u nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike siç është ai i rastit të mësipërm në vlerën 211,590 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për procedurën “**Punime hidroizolim tarrace për godinën e Kirurgjisë së SRD**” me fond limit 8,679,321 lekë pa TVSH, më datë 29.06.2018, është shpallur fitues OE “M.” SHPK me fond limit 5,034,331 lekë pa TVSH. Midis SRD dhe OE “M.” SHPK është lidhur kontrata dypalëshe nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018. Më datë 02.10.2018, nga OE është mbajtur situacioni përfundimtar i punimeve. OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 94, datë 02.10.2018, në vlerën 5,921,933 lekë me TVSH, likuiduar me transaksionin më datë 24.01.2019, në A. Bankë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, SRD nuk ka bërë zbritje garancinë në masën 5% në vlerën 296,097 lekë por likuidimi është kryer për të gjithë vlerën e faturës tatimore dhe kontratës duke shpërndarë marrëdhëniet kontraktuale me OE “M.” SHPK duke tejkaluar angazhimet e kontratës dypalëshe ku përcakton se pagesa e garancisë duhet të kryhet pasi të përfundojë afati prej 24 muaj i garancisë për mbulimin të defekteve. Sipas të dhënave të pasqyruara në certifikatën e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve, “Shuma prej 296,097 lekë me TVSH”, ekuivalente me 5% të vlerës me të cilën mbyllet punimet do të zhbllokohet në favor të Kontraktuesit pas përfundimit të periudhës së garancisë së defekteve me (24 muaj pas certifikimit të marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve). **Vlera 296,097 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe krijon risk të lartë për garantimin e defekteve të punimeve brenda periudhës së garancisë**, veprimeve këto në kundërshtim me Kontratën dypalëshe lidhur midis SRD dhe OE “M.” SHPK nr. 2208/2 prot., datë 04.09.2018, neni 14.1. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të Raportit të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Bordi Drejtues i SRD të analizohet efekti negativ financiar në vlerën 296,097 lekë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos mbajtjen e garancisë së punimeve për procedurën e prokurimit “Punime hidroizolimi tarrace për godinën e Kirurgjisë së SRD”, si dhe është e domosdoshme marrja e masave urgjente për evidentimin dhe korrigjimin e të gjitha praktikave, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për automjetet që disponon SRD konstatohet se, nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe përlllogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkruara dhe nuk justifikohet me dokumentacion justifikues konkretisht janë tërhequr më tepër 1452 litra/naftë në vlerën 235,581 lekë, të cilat nuk janë plotësuar me dokumentacion justifikues. Nga ana menaxheriale e administrimit të SRD, Drejtori i Spitalit në cilësinë e nëpunësit zbatues, Përgjegjësit të Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, Sektori Teknik, pjesa menaxheriale e caktuar për menaxhimin e aktiveve nuk janë marra masat për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të SRD, nuk janë kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit. **Vlera 235,581 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ financiar në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.** (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të*

Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: SRD, Sektori i Financës, Sektori Teknik, të marrë masa, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij.

9.2 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Sektori Teknik të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2019, numri mesatar faktik i punonjësve në SRD ka qenë 656 punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat ka rezultuar në vlerën 493,405,888 lekë.

Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 655 punonjës. Fondi i pagave i planifikuar është 493,014,000 lekë, pra **391,888 lekë** më shumë se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 648.8 punonjës. Fondi i pagave është 508,000,000 lekë, kurse realizimi është 491,796,305, pra 16,203,695 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 700 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në **Janar 2021** është realizuar 669 punonjës. Fondi i pagave është 53,475,000 lekë, kurse realizimi është 47,833,915 lekë, pra 5,641,085 lekë më pak se programi.

-Lidhur me nivelin e pagave, nga auditimi konstatohet se për **vitin 2019**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 58,692 lekë/punonjës, kurse fakti është 61,599 lekë/ punonjës, pra **tejkallim** në vlerën **2,907 lekë/punonjës**.

-Për **vitin 2020**, parashikimi i nivelit mesatar të pagave është 60,476 lekë/punonjës, kurse fakti është 63,167 lekë, pra ka **tejkallim** në vlerën **2,691 lekë/ punonjës**.

-Për **muajin Janar 2021**, parashikimi i nivelit të pagave është mesatarisht 76,393 lekë/punonjës, kurse fakti është mesatarisht 71,500 lekë, pra ka **mos realizim** në vlerën **4,893 lekë/ punonjës**.

Sa më sipër tejkallimi i fondit të parashikuar të pagave për vitin 2019 përbën efekt **financiar negativ** në vlerën **391,888 lekë**. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3.3, faqe 27-39 të Raportit të Auditimit*).

10.1.Rekomandim: Bordi Drejtues dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal të Durrësit të merren masa për analizimin e vlerës të efektit financiar prej **391,888 lekësh** dhe për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi për sa i përket furnizimit me ujë të vet institucionit, SRD operon nëpërmjet dy kontratave të lidhura me UKD SHA konkretisht, kontrata nr. 1527002 dhe kontrata nr. 1088586. Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se, për 61 transaksionet e kësaj periudhe (2019-2020) në vlerën 31,399,200 lekë rezultojnë kamatëvonesa të akumuluar të mbartura para periudhës objekt auditimi të cilat linden detyrimin në vlerën 380,114 lekë ndaj UKD si pasojë e mos likuidimit në kohë të faturave për konsumin e ujit. Shlyerja e detyrimeve në vlerën **380,114 lekë për SRD dhe Buxhetin e Shtetit, do të sjellë efekt negativ financiar**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv” i ndryshuar, neni 1. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3.6, faqe 92-109 të Raportit të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga Bordi Drejtues i SRD të analizohet vlera 380,114 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, si detyrime të mbartura. Të evidentohen përgjegjësit dhe të merret vendimi përkatës. Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mos likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj UK Durrës SHA, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të

E. MASA DISIPLINORE

E.1 Mbështetur në nenin 12 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës miratuar me VKM nr.560, datë 23.10.2000 ndryshuar me VKM nr.237, datë 12.04.2006 dhe VKM nr.76, datë 19.01.2007, i rekomandojmë Bordit të Spitalit të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive dhe shkallës së përgjegjësisë për Drejtorin e Spitalit Rajonal Durrës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore **“Largim nga detyra”** për :

Znj. N. J. me detyrë Drejtoreshë e Spitalit Rajonal Durrës për rastet e trajtuara më poshtë, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Nga auditimi i procedurës **“Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019”** i dosjes fizike dhe në sistemin e APP, është konstatuar:

Shmangja e procedurave të prokurimit, mos evidentim dhe rakordim të situatës emergjente dhe nevojës së SRD për oksigjen nga Titullari i SRD-së dhe strukturat e ngarkuara me prokurimin e këtij malli, në Spitalin Rajonal Durrës **për vitin 2019.**

Në nëntor të vitit 2018, Spitali Rajonal Durrës për mbulimin e nevojave me oksigjen ka filluar procedurën e prokurimit me Objekt **“Blerje oksigjen lëng për SRD për nevojat e vitit 2019”**, me fond **6,085,206 lekë pa TVSH.** Sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit të kësaj procedure, furnizimi me oksigjen do të mbulojë nevojat për oksigjen për gjithë vitin 2019. Procedura e prokurimit ka përfunduar me lidhjen e kontratës së furnizimit datë 30.04.2019 me vlere me ofertë 6,085,206 lekë pa TVSH me operatorin fitues JV H. & A. sh.p.k dhe GTS.

